



AKADEMIA E FORCAVE TË ARMATOSURA
INSTITUTI KËRKIMOR SHKENCOR USHTARAK
REVISTË TEORIKO-SHKENCORE
QERSHOR 2023

REVISTA USHTARAKE

(edicioni i dytë)

INSTITUTI KËRKIMOR SHKENCOR USHTARAK © 2023

Botim i Akademisë së Forcave të Armatosura
Miratuar me vendim nr. 1, datë 01. 05. 2023
të Bordit Drejtues të Revistës Ushtarake

Bordi Drejtues i Revistës Ushtarake

Kryetari i Bordit

Gjeneral Brigade Prof. Asoc.*¹ **Bilbil Bitri**

Anëtarët e Bordit

Prof. Asoc. Dr. **Teki Kurti**

Dr. **Etleva Smaçi**

Kolonel (R) Dr. **Ahmet Leka**

Kolonel Dr.* **Ulsi Rexhaj**

Kolonel Dr.* **Hysni Gjergji**

Kolonel Dr.* **David Rroku**

Msc. **Blerina Vorpsi**

Përgatiti për botim: Grupi i Redaktimit dhe i Publikimit

Art design: Engjellushe Llulla

ISSN 2227-8133 (Print), ISSN 2227-8141 (Online)

Copyright © 2023 nga Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak në Akademinë e Forcave të Armatosura.

Akademia e Forcave të Armatosura zotëron liri akademike dhe respekton detyrimet ligjore të përcaktuara shprehimisht në ligjin për Arsimin e Lartë si dhe të gjitha aktet e tjera ligjore që janë të detyrueshme për institucionet publike.

Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura në “Revista Ushtarake” janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë qëndrim zyrtar të Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm të FARSH dhe Akademisë së Forcave të Armatosura. Autorët e shkrimeve nuk do të jenë subjekt i ndëshkimit për shprehjen e lirë të qëndrimeve dhe pozicioneve të tyre individuale, edhe sikur përmbajtja e tyre të mos jetë në përputhje me qëndrimet zyrtare të institucionit të mbrojtjes. Njëkohësisht, autori/autorët mbajnë përgjegjësi për shtrembërimet e fakteve si dhe kopjimet e pa referuara të krijimeve dhe mendimeve të autorëve të tjerë.

Akademia e Forcave të Armatosura

Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak

Shtypur: Qershor 2023

^{*1} VKM nr. 156, datë 19.02.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë AFA, si institucion i vetëm publik i Arsimit të Lartë, në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë kombëtare, si dhe organizimin e funksionimit të saj”, germa a dhe b, pika 12.

PËRMBAJTJA

RUBRIKA E PARË: Analiza dhe vlerësime për sigurinë dhe mbrojtjen.....	7
“Zgjimi” i paralajmëruar i Kinës dhe efektet në sigurinë globale dhe rajonale Kolonel Dr. Hysni Gjergji, Nënkolonel Dr. Lirim Hasa Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak.....	11
Rusia në kërkim të “Restore Diplomacy” për të strukturuar rendin e ri botëror Dr. Glevin Dervishi, Fakulteti i Mbrojtjes dhe i Sigurisë Migena Kerciku Ministria e Mbrojtjes.....	25
Strategjitë e fshehta për operacionet speciale ushtarake, metodë justifikuese e luftës pushtuese të Federatës Ruse në Ukrainë Nënkolonel (R) Dr. Kanan Himaj Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak.....	39
Rajoni i Ballkanit Perëndimor dhe implikimet nga agresioni rus ndaj Ukrainës Gjeneral brigade (R) Prof. Asoc. Muhamet Buçpapa, Nënkolonel (R) Dr. Kristo Rapo Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak.....	59
Operacionet e ardhshme: Operacionet multi domain Nënkolonel Msc. Nikolin Lazri Forca Ajrore.....	75
Lidershipi dhe menaxhimi i ndryshimit Prof. Asoc. Dr. Edmond Braneshi Fakulteti i Mbrojtjes dhe i Sigurisë.....	87
RUBRIKA E DYTË : Mbrojtja kibernetike dhe zhvillimi inovativ në FA.....	101
Sfidat e sigurisë së informacionit në hapësirën kibernetike Kolonel Dr. Ulsi Rexhaj Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak.....	103

Inteligjenca artificiale: përparësi, rreziqe dhe masa mbrojtëse	
Msc. Roland Tashi	
AlSM, Ministria e Mbrojtjes.....	115
Aplikimi i teknikave statistikore në sigurinë kibernetike në epokën e Big Data	
Dr. Gentian Hoxhalli	
Fakulteti i Mbrojtjes dhe i Sigurisë.....	123
Kapacitetet dhe mundësitë e përdorimit të avionëve pa pilot të armatosur të tipit TB-2 “Bayraktar”	
Nënkolonel Msc. Eduart Pllaha	
Forca Ajrore.....	137
RUBRIKA E TRETË : Punime historike.....	153
Vizita e marshallit Zhukov në Shqipëri (1957): Ndikimi në rritjen e kapaciteteve të Ushtrisë Popullore	
Dr. Etleva Smaçi	
Fakulteti i Mbrojtjes dhe i Sigurisë.....	155
Karakteristika dhe dukuri të Zonës së Parë Operative gjatë Luftës II Botërore	
Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj	
Instituti i Studimit të Historisë Ushtarake.....	165
Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare: emërtimi, organizimi dhe funksionimi	
Kolonel (R) në pension Sali Onuzi	177

RUBRIKA E PARË

Analiza dhe vlerësime për sigurinë dhe mbrojtjen

Në këtë rubrikë autorët sjellin mendime dhe vlerësime për mbrojtjen dhe sigurinë në vend e rajon, duke shprehur pikëpamjet dhe konsideratat e tyre, në mënyrë analitike apo duke bërë sintezë dhe cilësime ndaj situatës dhe rrugëzgjidhjeve për kohën dhe hapësirën që na rrethon.

Shkrimi i parë i kësaj rubrike *“Zgjimi” i paralajmëruar i Kinës dhe efektet në sigurinë globale dhe rajonale* i autorëve kolonel Hysni Gjergji dhe nënkolonel Lirim Hasa, është përqendruar në vlerësimin dhe analizimin e qasjeve, politikave, investimeve, aleancave dhe qëndrimeve strategjike të viteve të fundit të Kinës në rang botëror, evropian dhe atij rajonal. Vlen të përmendet samiti më i fundit i G7, i mbajtur në maj 2023, në Japoni, ku vendet e G7 i bëjnë thirrje Kinës që të ushtrojë presion ndaj partnerit të saj strategjik Rusisë, për t’i dhënë fund luftës kundër Ukrainës. Ndërsa udhëheqësit e Quad-it, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Japonisë, Indisë dhe Australisë, kundërshtuan fuqishëm veprimet destabilizuese ose të njëanshme që synojnë të ndryshojnë *status quo*-në me forcë, duke përdorur gjuhë diplomatike që i referohet taktikave ekonomike të Kinës për të rritur ndikim mbi vendet më të varfra, si dhe për zgjerimin e saj ushtarak në Paqësor.

Lufta e Rusisë kundër Ukrainës përfaqëson një pikë kthese historike në mbarë botën. Në lidhje me zhvillimet më të fundit në zonën e këtij konfliktit, shkrimet në këtë rubrikë ofrojnë analiza, parashikime dhe vlerësime mbi konceptin se çfarë do të thotë kjo luftë për balancën globale të pushtetit, ekonominë kombëtare dhe rajonale, tregjet e energjisë, sistemin global financiar dhe monetar, përhapjen e armëve bërthamore dhe çështje të tjera kritike.

Punimi “*Rusia në kërkim të “Restore Diplomacy” për të strukturuar rendin e ri botëror*” i trajtuar nga z. Glevin Dervishi, merr në analizë ecurinë e konfliktit të Rusisë, të paprovokuar nga Ukraina dhe ndalet në rëndësinë e zgjidhjes paqësore të saj, duke vënë theksin në përdorimin e mjeteve diplomatike që vendosin garancitë e nevojshme për të ardhmen e Ukrainës. Për Rusinë, agresioni në Ukrainë është sfida politike, diplomatike dhe ushtarake më komplekse po aq edhe përcaktuese për politikën e saj të jashtme dhe të sigurisë e dekadave të fundit.

Në shkrimin me titull “*Strategjitë e fshehta për operacionet speciale ushtarake, metodë justifikuese e luftës pushtuese të Federatës Ruse në Ukrainë*”, të nënkolonel në rezervë Kanan Himaj, trajtohet koncepti rus i “operacionit special ushtarak”, i cili është përcaktuar si një formë ekstreme e zgjidhjes së konfliktit, e karakterizuar nga përdorimi i dhunës së armatosur dhe të llojeve të tjera të dhunës për arritjen e qëllimeve socio-politike, ekonomike, ideologjike, territoriale, kombëtare, etnike, fetare dhe të tjera. Dhe jo rastësisht Rusia zgjodhi ta emërtojë luftën e saj në këtë mënyrë. Modeli agresiv i Rusisë përforcohet nga aftësitë në rritje të projektimit të fuqisë së forcave të armatosura, të cilat janë krijuar për të kërcënuar krahun lindor të NATO-s dhe rajonin e Detit të Zi.

Ndërsa me analizën “*Rajoni i Ballkanit Perëndimor dhe implikimet nga agresioni rus ndaj Ukrainës*”, autorët Gjeneral brigade Muhamet Buçpapa dhe nënkolonel në rezervë Kristo Rapo bëjnë një kronologji të ardhjes deri te konflikti, pasojat që ai po shkakton jo vetëm në Ukrainë, por edhe në rajonin tonë gjeopolitik, e më gjerë. Punimi paraqet disa mendime dhe rekomandime, të cilat do ta ndihmojnë lexuesin për një orientim me të qenësishëm dhe objektiv për përgatitjen e gjithanshme të kapaciteteve lokale e kombëtare e si aleancë për t’u përballur me situata të tilla të vështira dhe për t’u dhënë atyre zgjidhjet adekuate, duke pasur si orientim vlerësimin e masave parandaluese dhe ndërmartjen pro aktive të mekanizmave dhe institucioneve apo agjencie ligjzbatuese në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.

Mjedisi strategjik i sigurisë ka ndryshuar në mënyrë dramatike. Lufta në Ukrainë ka demonstruar dhunimin e rregullave dhe parimeve ku bazohet dhe funksionon arkitektura e sigurisë rajonale e botërore. Ndaj është e domosdoshme përgatitja dhe vënia në funksion të sigurisë dhe mbrojtjes e të gjitha kapaciteteve dhe përdorimi i tyre nëpërmjet zhvillimit të operacioneve multi domain, në 5 (pesë) Fushat e Përkatësisë dhe në 3 (tre) dimensionet. Një informacion të përgjithshëm në lidhje me operacionet *multi domain*, e sjell për lexuesin e RU-së nënkolonel Nikolin Lazri me shkrimin “*Operacionet e ardhshme: Operacionet multi domain*”.

Rubrika e parë mbyllet me shkrimin e Prof. Asoc. Dr. Edmond Braneshi *“Lidershipi dhe menaxhimi i ndryshimit”*, i cili trajton ndryshimin si proces, qartësimin e kuptimit të ndryshimit, fazat nëpër të cilat kalon ky proces, menaxhimin e rezistencës ndaj ndryshimit dhe rolin e lidërsipit në mënyrë që procesi të jetë i suksesshëm. Detyrë e lidërsipit është kuptimi i çastit se kur është nevoja për ndryshim në organizatë. Kryerja e ndryshimit të brendshëm për t’iu përshtatur ndryshimit të jashtëm është reaktiv ose kundërveprues, ndërsa lidërsipi (veçanërisht në nivele të larta) duhet të jetë proaktiv. Prandaj, punonjësit në organizatë duhet të arsimohen, trajnohen, të bëhen pjesë e ndryshimit dhe përfitimi duhet të ndahet midis punonjësve dhe organizatës.

“ZGJIMI” I PARALAJMËRUAR I KINËS DHE EFEKTET NË SIGURINË GLOBALE DHE RAJONALE

Kolonel Dr. Hysni GJERGJI,
Nënkolonel Dr. Lirim HASA
Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak

Trajtesë e shkurtuar.

Në këtë punim do të shtjellohet “zgjimi” i paralajmëruar i Kinës dhe efektet në sigurinë globale dhe rajonale, duke u fokusuar në vlerësimin dhe analizimin e qasjeve, politikave, investimeve, aleancave dhe qëndrimeve strategjike të viteve të fundit të Kinës në rang botëror, evropian dhe atij rajonal. Kina, si fuqia e dytë botërore, ka detyruar SHBA-të që buxheti¹ i mbrojtjes i vitit 2024 të rritet afro një trilion dollarë, me qëllim përballjen e mundshme me Kinën konkurrenente. Për këtë, SHBA-të po rrisin gjithashtu kapacitetin industrial bërthamor të mbrojtjes, përmes partneritetit historik AUKUS². Kina ka akorduar 8 trilion dollarë për të financuar në formën e kredive të buta për “Rrugën e Mëndafshit”, ku një nga kushtet e panegociueshme është që ndërtimi të kryhet nga firma me paratë kineze të quajtur ndryshe: Diplomacia e Borxhit”, e cila është shtrirë pothuaj në të gjithë botën, duke përfshirë edhe Ballkanin.

Qeveria një partiake kineze me monopolin e rrjetit 5G ose të njohur si “Rruga Digjitale e Mëndafshit” zotëron privilegjin e të pasurit “monopol” të këtij

¹ Burimi elektronik: <https://www.airandspaceforces.com/pentagon-leaders-2024-budget-is-first-and-foremost-about-procurement/>

² AUKUS: Pakti trepalësh i sigurisë midis Australisë, Mbretërisë së Bashkuar dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për rajonin Indo-Paqësor.

rrjeti, duke synuar të ketë edhe çelësin, që ta çaktivizojë këtë rrjet jetik, duke shkaktuar katastrofë, varësi dhe kaos të plotë për përdoruesit. Për analogji, ky monopol i mundshëm ka efekt të ngjashëm me varësinë nga gazi dhe drithi rus i Europës, përgjatë vitit 2022 dhe në vazhdim. Perëndimi për të shmangur monopolin e 5G, duke mësuar nga rasti i Rusisë, është duke hartuar strategji të diversifikimit të ofertuesve, për kompani nga shtete të tjera demokratike.

Nga viti 2010, Kina i ka shumëfishuar përpjekjet për të rritur rolin edhe në Ballkan, duke shfrytëzuar nevojën që rajoni ynë ka për kapitalin dhe investimet, kryesisht në infrastrukturë. Përveç kësaj, Pekini po përpiqet të përdorë institucionet e brishta shtetërore të shteteve të Ballkanit, nivelin e korrupsionit dhe marrëdhëniet e pa stabilizuara të rajonit me BE-në, të cilat kanë krijuar terren të favorshëm për kompanitë shtetërore kineze, që të depërtojnë lehtësisht drejt rajonit tonë me para dhe projekte, për qëllimet e tyre strategjike.

Fjalët kyçe: Kina, rrjeti 5G, siguri kibernetike, Ballkani, AUKUS.

Shteti një partiak, arsyeja e “mungesës së besueshmërisë” së Perëndimit për investime të Kinës

Në librin e shkrimtarit dhe politikanit francez Alain Peyrefitte “Kur Kina të zgjohet, bota do të dridhet”³, flitet për luftën civile dhe forcat komuniste që, ende pa ardhur në pushtet, e quajnë vendin e tyre “Republika Sovjetike e Kinës”⁴. Huazuar nga Napoleon Bonaparti rreth dy shekuj më parë, zgjimi i Kinës tingëllon aktual dhe i vërtetuar, nëse analizojmë lëvizjet gjeostrategjike të Pekinit në vitet e fundit. Kina, duket se është “zgjuar” tashmë, madje ndikimet dhe përpjekjet e saj për lidhshirë global të saj, i shohim në Azi, Amerikën Latine, në Afrikë⁵, Europë, Ballkan madje edhe në vendin tonë. Fuqia e dytë botërore, pas SHBA-së, Kina, po shfaqet qartë në ekonomi, teknologji, bujqësi, infrastrukturë dhe më e rëndësishmja në fushën e sigurisë dhe atë ushtarake. Pekini po mbështet Moskën me armatim dhe municion në shkëmbim të gazit dhe naftës ruse, duke e bërë Rusinë të varur ekonomikisht por edhe politikisht. Përpjekja e Pekinit për të negociuar mes Rusisë dhe Ukrainës është një hap tjetër drejt rritjes së fuqisë së diplomacisë kineze anëtare e KS të OKB, si element bazë i fuqisë së saj kombëtare.

³ Peyrefitte, Alain, “Quand la Chine s’éveillera...: ... Le monde tremblera”, Librairie Arthème Fayard, 1973.

⁴ Burimi elektronik: <https://www.faktor.al/2021/09/05/kur-te-zgjohet-kina-bota-do-te-dridhet/>

⁵ Burimi elektronik: <https://www.brookings.edu/blog/africa-in-focus/2015/11/05/what-do-we-know-about-the-chinese-land-grab-in-africa/>

Partia (shtet) Komuniste Kineze (PKK) pas shumë vitesh, ka rishkruar rregulloren e saj politike duke fshirë referencat për të gjithë ideologjinë, përveç asaj të liderit suprem të partisë Xi Jinping, duke rrëshqitur më shumë në totalitarizëm⁶ dhe në marrëdhënie vëllazërore me Rusinë. Referencat ndaj marksizmit, leninizmit, mendimit të Mao Ce Dunit, mendimit të Deng Xiaoping dhe ideologjive të ish-presidentëve Jiang Zemin dhe Hu Jintao janë fshirë nga botimi i ri i dokumentit të titulluar “Procedurat e punës për Këshillin e Shtetit” që u botua më 18 mars 2023⁷. Komiteti Qendror i PKK nisi një fushatë disiplinore mbarëkombëtare që do të inspektojë 90 milionë anëtarë të PKK për besnikëri ndaj liderit suprem Xi Jinping dhe do të pastrojë “delet e zeza” dhe zyrtarët “me dy fytyra” nga pozicionet e pushtetit, të cilët u vendosën atje nga fraksionet politike rivale. Amendamentet në statutin e partisë të miratuara gjatë kongresit të 20-të në tetor 2022 përshkruanin mendimin e Xi Jinping si “thelbin e kulturës kineze dhe frymën e kohës”, e miratuan ideologjinë e tij dhe u kërkuan anëtarëve të “mbronin” pozicionin e tij si “udhëheqësi kryesor”.

Një tjetër konkurrent kryesor pas SHBA-së, Kina ka BE-në dhe si synim ka pushtimin e saj të butë me para, projekte, teknologji dhe investime, të cilat kanë rezultuar të pabesueshme. Kjo pabesueshmëri ka ardhur si rezultat i varësisë totale të kompanive kineze nga shteti i centralizuar. Në tetor 2019, u bë publikimi i një raporti të vlerësimit të rrezikut të BE-së për sigurinë kibernetike të rrjeteve 5G nga shtetet anëtare të unionit, në të cilin thuhej se kërcënimet e paraqitura nga shtetet ose aktorët privatë të mbështetur nga shteti, duhet të vlerësohen të një rëndësie të veçantë. 5G është projektuar që të ndikojë në sigurinë dhe ekonominë, ushtrinë dhe armatimin e digjitalizuar; kujdesin shëndetësor në distancë, energjinë, financën, bujqësinë, logjistikën e dixhitalizuar etj. Në Evropë kishte rezistencë ndaj presionit të SHBA-së, Japonisë dhe vendeve të tjera Five Eyes⁸ për të përjashtuar teknologjinë kineze 5G, pasi ofertat kineze deri në 2009 ishin më cilësore dhe të lira se Ericsson dhe Nokia.

Përveç kërcënimeve të konfidencialitetit dhe privatësisë, rrjetet 5G pritet të bëhen shtylla kurrizore e shumë aplikacioneve kritike të teknologjisë së informacionit civile, ushtarake dhe të ChatGPT⁹-së. Aftësia e ChatGPT

⁶ Burimi elektronik: <https://www.rtklive.com/sq/news-single.php?ID=624286>

⁷ Burimi elektronik: <https://www.rfa.org/english/news/china/new-rulebook-03292023124017.html> Nga Gu Ting, për Radion Azia e Lirë, 29.03.2023.

⁸ The Five Eyes (FVEY) është aleanca e shërbimeve të inteligjencës së 5 vendeve: Australia, Kanada, Zelanda e Re, Britania e Madhe dhe SHBA. Këto shtete janë pjesë e marrëveshjes multilaterale UKUSA, traktat i bashkëpunimit në fushën e SIGINT (signals intelligence).

⁹ ChatGPT është një chatbot i zhvilluar nga OpenAI në nëntor 2022. ChatGPT është një model më i avancuar që është trajnuar mbi një grup të dhënash masive në internet.

për të prodhuar me shpejtësi tekste dhe audio autentike e bën atë ideal për qëllime propagande politike dhe dezinformimi ushtarak, duke i lejuar përdoruesit shtetërorë (kinezë) të prodhojnë dhe të shpërndajnë mesazhe drejt kundërshtarëve strategjikë. Një studim nga firma amerikano-izraelite e inteligjencës për kërcënimet kibernetike (CPR¹⁰) ka treguar se si *chatbot* mund të përdoret për të depërtuar në sistemet *online* duke krijuar *email-e phishing*. Sipas Europol¹¹, është jashtëzakonisht e rëndësishme të rritet ndërgjegjësimi për këtë çështje për t'u siguruar që çdo boshllëk potencial të zbulohet dhe mbyllet sa më shpejt të jetë e mundur.

Ndërtimi i rrugës së vjetër të mëndafshit “one belt one road” nga toka dhe kryerja e lidhjes së Pekinit dhe Londrës në rrugë tokësore, është një tjetër objektiv i strategjik i qeverisë kineze, për të cilin ka punuar në dekada. Ndërtimi dhe rikonstrukcioni i porteve dhe pikave kyçe përgjatë rrugës së vjetër tregtare të mëndafshit synon të lidhë qytetet bregdetare kineze me qytetet bregdetare mesdhetare. Kina ka akorduar 8 trilion dollarë për të financuar në formën e kredive të buta, për shtetet që preken nga ky projekt të ashtuquajtur edhe si “diplomacia e borxhit”, ku një nga kushtet e panegociueshme është që ndërtimi të kryhet nga firmat kineze.

Ngritja e infrastrukturës ushtarake kineze përgjatë këtyre rrugëve është një tjetër kërcënim afatgjatë dhe i shtrirë në gjeografinë globale. Infrastruktura ushtarake përgjatë rrugës së mëndafshit, parashikohet të justifikohet si masë për të siguruar arteriet jetësore të furnizimit me lëndë të parë nga Afrika, si dhe rrugët tregtare që vijnë nga Europa. Dhënia e kredive me interes shumë të lartë, vendeve në aksin e kësaj rruge, bëhet me qëllim që këto kredi të jenë të pashlyeshme dhe për pasojë kthim të këtyre shteteve në “satelitë” të Kinës. Deri tani në përmbushje të këtij objektiv, Pakistani mori një kredi të butë në këmbim të portit të Gëitar që do t'i mundësojë Kinës një rrugë më të shkurtër për transportin e naftës nga Lindja e Mesme. Kina i akordoi një kredi prej 1.5 miliard dollarë Sri-Lankës¹² dhe si pasojë e mos shlyerjes së kredisë, i “konfiskoi” portin e Hambantota-s dhe e ktheu atë në një bazë ushtarake për anijet e saj luftarake.

Kina intensifikon “pushtimin paqësor” nga SHBA drejt Europës

Kina është zotuar të “ribashkohet” me Tajvanin në kundërshtim me reagimin ndërkombëtar ndaj një lëvizjeje të tillë që konsiderohet nga SHBA-të si

¹⁰ Burimi elektronik: <https://research.checkpoint.com/2023/opwnai-cybercriminals-starting-to-use-chatgpt/>

¹¹ Europol - strukturë policore ndërkombëtare, me seli në Hagë dhe misioni i saj është që të mbështesë shtetet anëtare dhe jo anëtare në parandalimin dhe luftën kundër të gjithë formave serioze të krimit ndërkombëtar, krimit të organizuar, krimit kibernetik dhe terrorizmit.

¹² Burimi elektronik: <https://albanian.cri.cn/2023/02/03/ARTIZTZEsgYzJbPMPuPNem28230203.shtml>

“sfida e saj kryesore e ritmit” ose një epokë - sfide përcaktuese strategjike. Ka një studim për ndikimin e Kinës në 82 vende të botës, i cili u krye dhe u publikua nga rrjeti *China in the World* (CITW)¹³, një iniciativë e grupit kundër dezinformimit me bazë në Tajvan, “Doublethink Lab¹⁴”. Raporti përbëhet prej nëntë pyetjesh që përfshinin median, akademinë, ekonominë, shoqërinë, ushtrinë, zbatimin e ligjit, teknologjinë, politikën e brendshme dhe politikën e jashtme. Raporti mat ndikimin përmes tre treguesve: ‘ekspozimit’, ‘presionit’ dhe ‘efektit’¹⁵. Për këto arsye, monopoli i rrjeteve 5G bëhet shqetësimi kryesor i sigurisë kombëtare të çdo anëtar, si dhe një sfida e sigurisë nga perspektiva e BE-së. SHBA-të, përmes partneritetit historik AUKUS, planifikojnë të rrisin kapacitetin industrial të mbrojtjes, duke përfshirë zhvillimin e nëndetësve të reja të klasit SSN AUKUS, i cili ndryshon qasjen strategjike për Shtetet e Bashkuara, Mbretërinë e Bashkuar dhe Australinë në Indo-Paqësorin.

SHBA-të, me Kinën konkurrense kryesore në rajonin Indo-Paqësor, kanë shpërndarë një pjesë të madhe të buxhetit amerikan të vitit 2024. Buxheti i mbrojtjes i planifikuar për vitin 2024 i SHBA-ve është një buxhet i imponuar nga strategjia dhe i nxitur nga serioziteti i konkurrencës strategjike me Republikën Popullore të Kinës. Me 842 miliardë dollarë të planifikuar, ka një rritje prej 3.2 për qind krahasuar me vitin fiskal 2023 dhe 13.4 për qind më i lartë se viti 2022. Kërkesa për buxhetin e vitit 2024 shënon investimin më të madh të departamentit në kërkim dhe zhvillim inovativ në 145 miliardë dollarë: rreth 170 miliardë dollarë për të ruajtur mbizotërimin e ajrit dhe detit: rreth 61 miliardë dollarë financojnë për B-21 Raider i sapozbuluar, ndërsa 48 miliardë dollarë mbështesin ndërtimin e nëntë anijeve të forcave luftarake për Marinën e SHBA-ve. Kërkesa për vitin 2024 përfshin 37.7 miliardë dollarë për të financuar trekëndëshin bërthamor (3K)¹⁶.

Liderët politikë perëndimorë (BE, UK dhe SHBA) kanë qenë të kujdesshëm dhe thonë se AUKUS nuk ka të bëjë me Kinën në mënyrë specifike. Megjithatë marrëveshja, që mbulon planet për t’i shitur Australisë tre nëndetëse të klasës Virxhinia të marinës amerikane në fillim të viteve 2030, me një nën-dizajn të ri bërthamor me bazë në Mbretërinë e Bashkuar (MB), tregon në një farë mënyre arsyen pse nevojiten kapacitete bërthamore në këtë rajon. Hyrja në shërbimin e nëndetësve bërthamore në MB në fund të viteve 2030, si dhe në

¹³ Burimi elektronik: <https://china-index.io/citw>

¹⁴ Burimi elektronik: <https://doublethinklab.org/>

¹⁵ “Ekspozimi” ndaj iniciativave të Kinës jashtë vendit e bën një vend të prekshëm, si varësia ekonomike ose marrja e përfitimeve të tjera. Sa ‘presion’ ushtron Kina mbi një vend të caktuar përfshin veprime të drejtpërdrejta ose të tërthorta nga Pekini, me synimin për të ndryshuar sjelljen e njerëzve të këtij vendi. Ndikimi aktual ose shkalla në të cilën një vend përshtat dhe pranon kërkesat e Kinës, përshkruhet si ‘efekt’ në studim.

¹⁶ 3K : Komandim; kontroll; komunikim bërthamor.

shërbimin australian në fillim të viteve 2040, është parë nga Pekini si përballje dhe konflikt i mundshëm.

Australia e përqafon modelin SSN AUKUS¹⁷ dhe partneritetin e zgjeruar me SHBA-të dhe MB-në, bazuar në një vlerësim të sfidave dhe kërcënimeve të ardhshme ushtarake dhe në nevojën për “të pasur një nëndetëse me shumë autonomi dhe e aftë për shpejtësi dislokimi.”¹⁸ Për sa i përket një konfrontimi të plotë detar midis konkurrentëve dhe veçanërisht kur flasim për Kinën, një nga aftësitë më të mira që do të lejojë të operohet në një mjedis të kontestuar, janë asetet nënujore, veçanërisht nëndetëset me energji bërthamore. Kjo për të vetmen arsye se marrëveshja ofron një grup më të madh nëndetësesh me energji bërthamore, jo vetëm nga SHBA, por edhe Australia dhe MB në Indo-Paqësorin.

Edhe pse nëndetëset e SSN AUKUS nuk janë planifikuar të dalin në det për Australinë deri në fillim të viteve 2040, vendosja e nëndetëseve amerikane në portet australiane dhe shtimi i nëndetëseve të klasës Virxhinia në arsenalin e marinës detare të Australisë do të ketë një ndikim të menjëhershëm. “Sigurisht që AUKUS nuk është krijuar për të këtë qëllim”, - është shprehur për “The Telegraph Sunday”, ministri australian i mbrojtjes Richard Marles¹⁹, më 19 mars 2023. Ky zhvillim dhe avancim në drejtim të rritjes së kapacitetit bërthamor nënujor të Australisë mund dhe duhet të ketë vetëm efekt parandalues²⁰. Nëndetëset SSN AUKUS do të zëvendësojnë SSN-të e Marinës Mbretërore dhe do ta bëjnë Kinën të cënueshme ndaj sulmeve kundër “platformave kritike amfibe”, deri tani të suksesshme pasi ishin jashtë rrezes së aseteve sipërfaqësore të SHBA-ve. Nëndetëset e reja janë të dizajnuara për lëshime të armëve hipersonike, duke ofruar aftësi sulmi përtej bombarduesve strategjikë, pasi raketat hipersonike mund të montohen në anijet SSN AUKUS.

Ushtria amerikane në marrëdhëniet me vendet aleate dhe partnere ka gjithashtu një fokus për buxhetin e vitit 2024, si në Azi ashtu edhe në Evropë. Në tetor të vitit 2022, Komisioni Evropian i kërkoi disa shteteve anëtare të zbatojnë

¹⁷ SSN-AUKUS, është pjesë e flotës konvencionale e nëndetëseve bërthamore e ndërtuar nga forcat detare australiane dhe britanike si pjesë e marrëveshjes trepalëshe me SHBA-të të firmosur në shtator 2021.

¹⁸ Nick Childs, bashkëpunëtor i lartë për forcat detare dhe sigurinë detare në Institutin Ndërkombëtar për Studime Strategjike (IISS), një institut kërkimor për mbrojtjen dhe sigurinë me bazë në Mbretërinë e Bashkuar. Burimi elektronik: <https://www.iiss.org/people/defence-and-military-analysis/nick-childs>

¹⁹ Burimi elektronik: <https://breakingdefense.com/2023/03/how-the-new-aukus-sub-agreement-impacts-beijings-calculus-on-taiwan/>

²⁰ Sidharth Kaushal, bashkëpunëtor hulumtues në institutin e mbrojtjes të Institutit Mbretëror të Shërbimeve të Bashkuara me bazë në Mbretërinë e Bashkuar. Burimi elektronik: <https://uk.linkedin.com/in/dr-sidharth-kaushal-2168b7127>

në mënyrë më efektive masat mbrojtëse kibernetike nga ndikimi i rrjeteve 5G. Shteteve anëtare iu kërkua të përfshijnë urgjentisht zbatimin e masave të rekomanduara në tërësinë e masave të BE-së për sigurinë kibernetike 5G. Shtetet anëtare, që nuk kishin vendosur ende, duhet ta bëjnë këtë pa vonesë, duke pasur parasysh se koha e humbur mund të rrisë cenueshmërinë e rrjeteve në BE.

Sa është duke u përdorur teknologjia kineze 4G/5G ende në vitin 2023 në BE? Përgjigja nuk mund të jetë e saktë, pasi shumë kompani të telekomit evropian nuk janë transparente në këtë drejtim edhe pse John Strand dhe ekipi i tij në Strand Consult kanë dalë me një hulumtim shumë interesant në këtë fushë²¹. Në fund të vitit 2019, vetëm tre vende në Evropën Perëndimore operonin me teknologji 100% kineze 4G RAN, ku përfshihet edhe Belgjika ose “kryeqyteti” i institucioneve të BE-së. Gjermania ishte ajo që përdori më shumë teknologjinë kineze 4G, deri me 57%, Italia në vendin e dytë, me 52%, Holanda është në 47%, Spanja me 36% dhe Franca me vetëm 25% pajisje kineze 4G. Operatorët e mëdhenj që përdorin më shumë pajisje kineze janë Vodafone dhe Deutsche Telekom, ndërsa Orange dhe Telefónica kanë shifra më të ulëta. Ka kompani si Proximus në Belgjikë, me teknologji 100% kineze, ndërsa Telekom Austria përdor 0% teknologji kineze. Sipas Strand për vitin 2023, Gjermania që ka një varësi prej afër 60%, duke e bërë atë mjaft të cenueshme dhe të varur, ndërsa Norvegjia dhe Belgjika kanë ulur në mënyrë drastike varësinë e tyre nga teknologjia kineze RAN në 5G. Për shumë vite, Ballkani dhe BE-ja ka përdorur teknologjinë kineze 3G dhe 4G nga shitës me çmim të lirë, por edhe cilësorë kinezë të Huawei dhe ZTE.

BE-ja, Britania e Madhe dhe Kina janë përplasur për një varg çështjesh me njëra-tjetrën, duke nisur nga spiunazhi ekonomik deri te pozicionimi ushtarak i Pekinit në Tajvan. Kina në BE, konkretisht, zotëron rreth 9,5 për qind të aksioneve në aeroportin Heathrow të Londrës, 49,9 për qind të aksioneve në aeroportin e Tolouse të Francës dhe 82,2 për qind të aeroportit Hahn pranë Frankfurtit në Gjermani. Pekini ka parashikuar investime me vlerë deri në 7 miliardë euro në portet italiane të Genoas dhe Triestes në Itali, pasi pjesa e Mesdheut vlerësohet me interes për investitorët kinezë. Në vitin 2016, Greqia i ka shitur Kinës portin në Pireut²², kompanisë shtetërore kineze Cosco, e cila ka investuar rreth 385 milionë euro. Qëllimi i këtij investimi është të rrisë tregtinë me vendet e Bashkimit Evropian dhe ta përdorë njëherësh atë si portë

²¹ John Strand dhe ekipi i tij në Strand Consult janë një firmë e madhe konsulente, për operatorët e telekomit dhe për këtë arsye kanë akses në të dhënat përkatëse të 4G dhe 5G në BE. Burimi elektronik: <https://strandconsult.dk/team/john-strand/>

²² Grupi COSCO bleu 51 për qind të aksioneve në portin e Pireut: Burimi elektronik: <https://www.monitor.al/kinezet-forcoje-pozitat-ne-ballkan-cosco-blen-pjesen-te-madhe-te-portit-te-pireut/>

për projektin “Rruga e Mëndafshit”. Në janar 2020, Këshilli Evropës miratoi masat e nevojshme të Sigurisë Kibernetike të BE-së për uljen e rrezikut në teknologjinë kineze 5G që po afrohej. Më 17 mars 2023, parlamenti i UK, pas BE-së dhe SHBA-ve, mori vendimin për heqjen e aplikacionit “tik tok” nga smartphonët e zyrtarëve, për arsye se është provuar përdorimi i të dhënave të tij, nga qeveria kineze, në dëm të sigurisë kombëtare.

Shteti një partiak kinez mundet ta përdorë teknologjinë 5G për t’i transferuar të dhënat e rrjetit evropian, tek intelijenca shtetërore totalitare kineze duke i bërë këto kompani “ofertues të pabesueshëm”. Pekini nëse e merr monopolin e këtij rrjeti, është i aftë edhe ta çaktivizojë këtë rrjet në një moment që ajo dëshiron, duke i lënë vendet që e përdorin në errësirë dhe kaos të plotë. Për analogji, varësia nga 5G kineze e disa shteteve të Europës, ka efekt të ngjashëm me varësinë nga gazi dhe drithi rus të Europës, përgjatë vitit 2022. Për të shmangur këtë varësi monopol, është e nevojshme një strategji e diversifikimit të shitësve të 5G ndoshta duke e përfshirë edhe Kinën.

Grupi i shtatë i vendeve të pasura dhe demokratike të botës (G7²³) më 20 maj 2023 i bëri thirrje Kinës që të ushtrojë presion ndaj partnerit të saj strategjik Rusisë, për t’i dhënë fund luftës kundër Ukrainës. Liderët e G7²⁴ theksuan se ata nuk duan të dëmtojnë Kinën dhe kërkojnë “marrëdhënie konstruktive dhe të qëndrueshme” me Pekinin, duke njohur rëndësinë e angazhimit të sinqertë dhe duke ia shprehur shqetësimet drejtpërdrejt Kinës.

Grupi deklaroi se bashkëpunimi me Kinën është i nevojshëm, duke pasur parasysh rolin e saj global dhe madhësinë ekonomike. Liderët shprehën “shqetësim serioz” për situatën në Detin e Kinës Lindore dhe Jugore, ku Pekini po zgjeron praninë e tij ushtarake dhe po kërcënon të përdorë forcën për të ushtruar kontroll mbi Tajvanin e vetëqeverisur. Udhëheqësit e G7 kërkojnë një “zgjidhje paqësore” të pretendimeve të Kinës ndaj Tajvanit, të cilat kanë mbetur të pazgjidhura që kur komunistët morën pushtetin në territorin kinez në vitin 1949. Në deklaratë thuhet se “nuk ka asnjë bazë ligjore për pretendimet e zgjeruara detare të Kinës në Detin e Kinës Jugore” dhe se ata kundërshtojnë aktivitetet e militarizimit të Kinës në rajon. Një Kinë në rritje që luan sipas rregullave ndërkombëtare do të ishte me interes global. G7 u bashkua gjithashtu për të shprehur shqetësimin për të drejtat e njeriut në Kinë, duke përfshirë Tibetin, Hong Kongun dhe rajonin e largët perëndimor të

²³ Nën kryesimin e Japonisë, në qytetin Hiroshima, filloi Samiti G7 më 19 maj 2023.

²⁴ Samiti i G7 organizohet nga kryeministri japonez Fumio Kishida, ndërsa marrin pjesë presidenti i SHBA-ve, Joe Biden, kryeministrja italiane Giorgia Meloni, kryeministri kanadez Justin Trudeau, presidenti francez Emmanuel Macron, kryeministri britanik Rishi Sunak, kancelari gjerman Olaf Scholz, presidenti i Këshillit Evropian, Charles Michel dhe presidentja e Komisionit Evropian (KE), Ursula von der Leyen.

Xinjiangut, ku çështja e punës së detyruar ka qenë një problem i përhershëm.

Në samitin e Hiroshimës mori pjesë edhe lideri i ftuar, presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, të cilët liderët e G7 i premtuan se do të sigurojnë mbështetje diplomatike, financiare, humanitare dhe ushtarake për sa kohë të nevojitet për Ukrainën. Prezenca e presidentit ukrainas dhe vendi i samitit nuk i janë përshtatur dhe nuk janë mbështetur nga qeveria kineze²⁵.

Pekini ka akuzuar vendet e G7 se bashkëpunojnë për të “përlyer dhe sulmuar” Kinën²⁶, pasi samiti i Hiroshimës lëshoi një komunikatë që paralajmëroi Pekinin për “aktivitetet e tij të militarizimit” në rajonin Azi-Paqësor.

Kina thirri ambasadorin japonez për t’i dorëzuar një protestë zyrtare si dhe paralajmëroi Mbretërinë e Bashkuar të ndalonte “shpifjet”, për të shmangur dëmtimin e mëtejshëm të marrëdhënieve dypalëshe. Rregullatorët kinezë zgjodhën gjithashtu datën 20, një ditë pas fillimit të samitit, për të njoftuar se firma amerikane e çipave, Micron Technology, kishte dështuar në një vlerësim sigurie dhe do të ndalohej të përdorej në infrastrukturën kritike kineze.

Komunikata e G7 deklaroi se dëshironte “marrëdhënie konstruktive dhe të qëndrueshme” me Pekinin, duke iu referuar “uljes së tensionit” të marrëdhënieve, në vend që të “shkëputet” nga mosbashkëpunimi i tyre me Kinën, pas paralajmërimeve nga Franca se samiti nuk duhet të shihet si kundër Pekinit. Komunikata gjithashtu nënvizoi shqetësimet kryesore për militarizimin në detet e Kinës Lindore dhe Jugore, synimet e Kinës ndaj Tajvanit dhe shqetësimet e të drejtave të njeriut në Xinjiang dhe Tibet.

Udhëheqësit e Quad-it, të Shteteve të Bashkuara, Japonisë, Indisë dhe Australisë, gjithashtu bënë një kritikë të drejtpërdrejtë²⁷, duke bërë thirrje për “paqe dhe stabilitet në rajonin detar Indo-Paqësor”.

Shtetet e Quad-it kundërshtojnë fuqimisht veprimet destabilizuese ose të njëanshme që synojnë të ndryshojnë *status quo*-në me forcë, duke përdorur gjuhë diplomatike që i referohet taktikave ekonomike të Kinës për të rritur ndikim mbi vendet më të varfra, si dhe gjithashtu zgjerimin e saj ushtarak në Paqësor. Në përgjigje, Ministria e Punëve të Jashtme e Kinës akuzoi më 20 maj 2023 G7 për “pengim të pages ndërkombëtare, minimin e stabilitetit rajonal dhe frenimin e zhvillimit të vendeve të tjera”. Më 22 maj 2023, zëvendësministri i jashtëm i Kinës, Sun Weidong e quajti “hije rreth çështjeve të lidhura me

²⁵ Burimi elektronik: <https://www.theguardian.com/world/2023/may/22/china-summons-japanese-ambassador-over-smears-at-g7-summit>

²⁶ Burimi elektronik: <https://www.theguardian.com/world/china>

²⁷ Burimi elektronik: <https://www.theguardian.com/world/2023/may/20/australia-india-japan-and-us-take-thinly-veiled-swipe-at-china>

Kinën” në samit. Sun pretendoi se Japonia kishte bashkëpunuar me vendet e tjera në samit përmes “aktiviteteve dhe deklaratave të përbashkëta”, për të njoftosur dhe sulmuar Kinën, duke ndërhyrë rëndë në punët e brendshme të Pekinit. Zv. ministri i jashtëm kinez deklaroi se veprimet e Japonisë ishin të dëmshme për sovranitetin, sigurinë dhe interesat e zhvillimit të Kinës dhe se Kina është “shumë e pakënaqur dhe i kundërshton fuqishëm” ato.

Japonia duhet të korrigjojë qëndrimin e saj për Kinën, të kuptojë autonominë strategjike dhe të promovojë me të vërtetë zhvillimin e qëndrueshëm të marrëdhënieve dypalëshe me një qëndrim konstruktiv. Zyrtarët japonezë deklaruan se pozicioni i vendit të tyre ndaj Kinës kishte qenë i qëndrueshëm, ndërsa Hideo Tarumi, ambasadori japonez në Kinë tha se G7 do të vazhdojë t’i referohet çështjeve me interes të përbashkët për sa kohë që Kina nuk ndryshon sjelljen e saj, sipas një deklaratë. Kina duhet së pari të ndërmarrë hapa pozitivë për të adresuar ato çështje shqetësuese, nëse kërkon të mos iu referohet atyre. Ambasada kineze në Britani iu kundërpërgjigj komenteve të kryeministrit të Mbretërisë së Bashkuar Rishi Sunak, duke thënë se ***Kina përfaqëson sfidën më të madhe në botë***²⁸ për sigurinë dhe prosperitetin, por se ekonomitë e tjera kryesore nuk duhet të shpëputen prej saj. Deklarata e ambasadës i kërkoi qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të ndalojë shpifjet dhe sharjet ndaj Kinës për të shmangur dëmtimin e mëtejshëm të marrëdhënieve Kinë-Mbretëri e Bashkuar. Vërejtjet përkatëse nga pala britanike janë thjesht fjalë papagalli të të tjerëve dhe përbëjnë shpifje dashakeqe në mospërfillje të fakteve. Kina e kundërshton me vendosmëri dhe e dënon fuqishëm këtë, - thuhet në deklaratë. G7 ka rënë dakord gjithashtu të krijojë një nismë për të kundërshtuar “shtrëngimin” ekonomik. Kundërshtimi i Pekinit ndaj samitit gjithashtu vazhdoi të shfaqet në mediat shtetërore. Gazeta zyrtare e lajmeve Xinhua raportoi se G7 “mbuloi shumë tema, por fatkeqësisht përfundoi me fokusin në ndërhyrjen në punët e brendshme të vendeve të tjera dhe pengimin e zhvillimit të tyre”.

Pavarësisht zemërimit të Pekinit, presidenti amerikan Joe Biden u shpreh para mediave se së shpejti do të ketë përmirësime në marrëdhëniet SHBA-Kinë. “Për sa i përket bisedës me Pekinin, mendoj se do ta shihni këtë shkrim shumë shpejt”, - u shpreh Biden. Marrëdhëniet SHBA-Kinë janë përqesuar vitet e fundit dhe përpjekjet për t’i rikthyer ato në rrugën e duhur u prishën në shkurt, kur SHBA ***rrëzoi një balonë spiune kineze***²⁹, e cila fluturonte në hapësirën ajrore të SHBA.

²⁸ Burimi elektronik: <https://www.theguardian.com/world/2023/may/21/china-poses-biggest-threat-to-global-security-says-sunak>

²⁹ Burimi elektronik: <https://www.theguardian.com/world/2023/apr/03/china-spy-balloon-us-military-intelligence>

Ballkani merr gjysmën e investimeve kineze në Europë

Ndikimi më i madh i Kinës është vërejtur në Serbi, ku Pekini ka eksportuar, përveç produkteve industriale, edhe armë, raketa, kamera të sigurisë së lartë, e të tjera mallra sensitive të spektrit të sigurisë³⁰. Projektet e infrastrukturës në Ballkan i kanë siguruar Kinës kontrata fitimprurëse për kompanitë e saj shtetërore, si dhe kanë mundësuar lidhje diplomatike, politike dhe ekonomike të saj në rajon.

Aktualisht, investimet kineze në Ballkan përfshijnë shumë projekte ndër të cilat mund të përmendim: një urë të financuar nga BE në Pelješac të Kroacisë (me kosto 340 milionë euro); autostradat Pojate-Preljina dhe Novi Sad-Ruma (Serbi, 850 milionë dollarë); autostradën Preljina-Pozega (Serbi, 500 milionë euro); autostradën Kërçovë-Ohër (Maqedonia e Veriut, 375 milionë euro); si dhe autostradën Banja Luka-Prijedor (Bosnjë-Hercegovinë, 297 milionë euro). Kompanitë kineze po punojnë për përfundimin e pjesës serbe të hekurudhës së shpejtësisë së lartë Beograd-Budapest (943 milionë euro); metronë e Beogradit (3 miliard euro), si dhe termocentralin në Kostolac B3 (293 milionë dollarë).

Banka kineze “Exim Bank³¹” në vitin 2014, ka lëvruar një hua prej 687 milionë eurosh për qeverinë e Malit të Zi, në ndërtimin e 41 km rrugë të autostradës me 2 për qind interes në vit, ndërsa shlyerja e borxhit do të kryhej pjesë-pjesë në 20 vjet. Banka kineze mori përsipër të sigurojë 85 për qind të financimit, ndërsa 15 % (120 milion euro), duhet të sigurohej nga autoritetet malazeze. Në terrenin shkëmbor të Malit të Zi, rruga kërkonte të ndërtoheshin 20 ura dhe 16 tunele. Duke shtuar kostot shtesë me luhatjet e çmimeve, u rrit barra financiare të projektit, i cili arriti në afro 1 miliard dollarë. Kjo është një shumë e madhe për një vend me një prodhim të përgjithshëm bruto më shumë se 5.5 miliardë dollarë.

Në vitin 2021, për shkak të pandemisë, borxhi publik arriti në 105 për qind të PBB-së të Malit të Zi. Autostrada nxori në pah rreziqet e varësisë financiare nga Kina. Kredia arrinte 60% e GDP aktuale të Malit të Zi dhe borxhi do të kalonte 90% të GDP të 2020³². Nëse Mali i Zi nuk paguan kredinë, çfarë do të kërkojë Kina në shkëmbim? BE-ja, duke “mësuar” nga rasti i Podgoricës, i kërkoj grante dhe hua preferenciale nga Banka Evropiane e Investimeve

³⁰ Burimi elektronik: <https://www.evropaelire.org/a/serbia-blen-arme-nga-kina/31798671.html>

³¹ Banka e Eksportit-Importit të Kinës është një nga dy bankat institucionale në Kinë të krijuara për të zbatuar politikat shtetërore në industri, tregtinë e jashtme, ekonominë dhe ndihmën e huaj për vendet e tjera në zhvillim dhe të sigurojë mbështetje financiare për politikat për të nxitur eksportin.

³² Burimi elektronik: <https://www.evropaelire.org/a/evropa-ndihmon-malin-e-zi-per-borxhin-masiv-ndaj-kines/31319227.html>

(EIB), (BERZH) etj., përmes Planit Ekonomik të Investimeve prej 9 miliardë euro për Ballkanin Perëndimor, të miratuar në vitin 2022. Roli i Kinës lidhur me Kosovën do të varet kryesisht nga marrëdhëniet midis Pekin-Uashington. Nëse të dyja palët arrijnë të vendosin kufij për mosmarrëveshjet e tyre dhe të fillojnë të kërkojnë mënyra për t'i tejkaluar ato, mund të jetë e mundur që të diskutojnë për Kosovën dhe të arrijnë marrëveshje lidhur me çështje të tjera të hapura me interes reciprok dhe botëror.

Shqipëria pritet të ketë rritje të ndikimit të Kinës në ekonomi edhe për faktin se është bërë vendi i dytë në këtë rajon për heqjen reciproke të vizave, e cila hyri në fuqi më 17 shkurt 2023. Një raport i Qendrës për Analizë të Politikave Evropiane (CEPA)³³, i publikuar në gusht 2022, thuhet “Kina kërkon lidhje më të ngushta me Shqipërinë, në kuadër të projektit të Partisë së saj Komuniste për të zgjeruar ndikimin e Pekinit dhe për t’u bërë aktor kryesor në Ballkanin Perëndimor dhe në Evropë”. Heqja e vizave është një akt pozitiv në zgjerimin e marrëdhënieve ekonomike e tregtare me Kinën, përmes reduktimit të kostove dhe barrierave të lëvizjes. Importet e mallrave kineze në Shqipëri janë rritur nga rreth 140 milionë euro në vitin 2005, në mbi 600 milionë euro në 2023, duke shënuar rritje mbi 5.5 herë. Eksportet e produkteve shqiptare drejt Kinës janë rritur gjithashtu, nga rreth 3 milionë euro në rreth 90 milionë aktualisht afërsisht 30 herë. Pra, në një periudhë prej gati një dekade e gjysmë, tregtia e jashtme mes dy vendeve është rritur me ritme mjaft të shpejta.

Importet shqiptare dominohen nga prodhimet e tekstit, makineritë dhe pajisjet, si dhe produktet e industrisë plastike dhe kimike, ndërsa ne eksportojmë drejt Kinës produktet e papërpunuara minerale. Heqja e barrierës që përfaqëson sistemi i vizave ndërmjet dy vendeve favorizon më shumë mekanizmat ekonomiko-tregtarë kinezë, që të qarkullojnë lirshëm në Shqipëri, duke rritur kështu edhe praninë ekonomike, industriale etj. Qeveritë shqiptare asnjëherë nuk kanë ofruar garanci për investimet kineze, ndryshe nga rajoni. Një nga projektet më ambicioze ka qenë financimi i Rugës së Arbrit, për të cilën konkurrentët kinezë e siguronin vetë edhe financimin, por nuk u pranuan nga autoritetet shqiptare. Në vitin 2016, një kompani kineze bleu 100 për qind të aksioneve në aeroportin “Nënë Tereza”, por marrëveshja u anulua. Në fund të vitit 2019, Shqipëria nuk e nënshkroi rrjetin e internetit 5G³⁴, duke u bërë një nga vendet e para në rajon që e refuzoi këtë projekt. Megjithatë, këmbëngulja kineze, në forma të reja dhe tradicionale dhe teknologjike drejt rajonit dhe Shqipërisë, vazhdon.

³³ Burimi elektronik: <https://www.evropaelire.org/a/investimet-kineze-ne-shqiperi/32254534.html>

³⁴ Burimi elektronik: <https://www.monitor.al/shqiperia-heq-dore-nga-kalimi-i-shpejte-ne-5g/>

Përfundime

1. Influenca e Kinës, si fuqia e dytë ekonomike botërore, me investime të jashtëzakonshme në gjithë botën, me kontrollin shtetëror një partiak të rrjeteve 5G, Huawei dhe ZTE si dhe aplikacionit “tik tok”³⁵, nuk është larg, përkundrazi, është e pranishme dhe po afrohet çdo ditë edhe më shumë edhe në Shqipëri.
2. Ballkani përfaqëson një trampolinë dhe urë për vendosjen e pranisë ekonomike kineze në Evropë. Më shumë se gjysma e investimeve të kompanive kineze në Evropë janë të vendosura pikërisht në Ballkanin Perëndimor.
3. Ndikimi më i madh i Kinës është në Serbi, ndërsa Mali i Zi është një nga tetë vendet më të rrezikuara me prani kineze. Në Bosnjë dhe Hercegovinë, më saktësisht në Republikën Srpska, është i pranishëm një numër i madh i investimeve kineze në infrastrukturë, ndërsa në Maqedoninë e Veriut nuk ka arritur të ketë ndikim të rëndësishëm. Ndërsa Rusia kërkon të nxisë kaosin dhe paqëndrueshmërinë, Kina po merr sistematikisht hapa për të integruar dhe kontrolluar ekonominë e vendeve të Ballkanit.
4. Nisur nga avantazhi i fuqisë ekonomike që posedon, bashkëpunimi ekonomik me Pekinin shërben si një mekanizëm kushtëzues gjeopolitik, sepse Kina aktualisht është partnerja e tretë tregtare e Shqipërisë, pas Italisë dhe Turqisë.
5. Gjiri i Adriatikut të Shqipërisë është një objekt interesi i shprehur për iniciativën e një rruge kineze drejt Mesdheut. Shqipëria, një nga vendet më pak të ekspozuara ndaj ndikimit të Kinës në Indeks mori një vlerësim 16 për qind për ekspozimin, 10 për qind për presionin dhe 5 për qind për efektin. Sipas raportit të indeksit³⁶, ndikimi i Kinës në Shqipëri është më aktiv në fushën e medias, teknologjisë, politikës së brendshme dhe ekonomisë.
6. Historia gjithashtu, nuk duhet të harrohet. Një periudhë e ndjeshme e komunizmit, i lidhi shumë dy vendet së me njëra-tjetrën. Pavarësisht se lidhjet u prishën në vitet 70³, kujtesa historike mbetet dhe ka vijuar edhe më pas, me qasjen e Shqipërisë drejt demokracisë.

³⁵ Pas NATO-s, SHBA, BE-së edhe BBC këshillon stafin të fshijnë TikTok-un nga telefonat e korporatës. <https://zeri.info/auto-amp-tech/485578/bbc-ja-keshillon-stafin-te-fshijne-tiktok-un-nga-telefonat-e-korporates/>.

³⁶ Burimi elektronik: <https://www.zgjhushqiptar.info/2022/12/sa-ndikim-ka-kina-ne-shqiperi.html>

Bibliografia

1. Borici, Gjon “Marrëdhëniet shqiptaro-kineze në Luftën e Ftohtë, 1956-1978”.
2. Plashek, David “Propaganda kineze po intensifikohet në Ballkan”.
3. Zeneli, Valbona. 2019. “China in the Balkans: Chinese investment could become a challenging factor for the European future of the Western Balkans”.
4. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, buletin informativ 17-18-19; Ekspozita e librave “Autorë shqiptarë për Kinën, autorë kinezë për Shqipërinë”.
5. Gladstone, Rick. 2020. How the Cold War Between China and U.S. Is Intensifying. New York Times. July 22. <https://www.nytimes.com/2020/07/22/world/asia/us-china-cold-war.html>
6. *The Globalist*. <https://www.theglobalist.com/balkans-china-fdi-belt-and-road-eu/>
7. <http://www.asa.edu.al/site/libraria/?product=shqiperia-dhe-kina-marredhenie-e-ngushte-ne-sfondin-e-luftes-se-ftohte-dokumente-1956-1978>
8. <https://www.top-channel.tv/2022/08/23/cepa-si-kina-po-rrezikon-sigurine-kombetare-te-shqiperise/>
9. <https://www.telegraph.co.uk/world-news/2023/03/19/australia-wont-support-us-defence-taiwan-aucus-dea>
10. AUKUS Archives - Breaking Defense.com/tag/aukus/
11. <https://www.globalsecurity.org/wmd/library/news/china/2023/04/china-230424>
12. <https://www.aa.com.tr/sq/ballkani/shqip%C3%ABria-dhe-kina-n%C3%ABnshkrualn%C3%AB-marr%C3%ABveshjen-p%C3%ABr-heqjen-reciproke-t%C3%AB-vizave/2789764>
13. <https://www.naval-technology.com/projects/ssn-aukus-class-nuclear-attack-submarines-uk/>
14. <https://www.albanian.cri.cn/2022/09/23/ARTIkkCMkfWsdtt0Kt8xmzBH220923.shtml>

RUSIA NË KËRKIM TË “RESTORE DIPLOMACY” PËR TË STRUKTURUAR RENDIN E RI BOTËROR

Dr. Glevin DERVISHI

Fakulteti i Mbrojtjes dhe i Sigurisë

Migena KERCIKU

Ministria e Mbrojtjes

Trajtesë e shkurtuar.

Punimi merr në analizë ecurinë e konfliktit të paporovokuar të Rusisë në Ukrainë dhe ndalet në rëndësinë e zgjidhjes paqësore të saj, duke vënë theksin në përdorimin e mjeteve diplomatike që vendosin garancitë e nevojshme për të ardhmen e Ukrainës. Lufta që ka mbërthyer Ukrainën prej më shumë se një vit nuk është thjesht një agresion i armatosur mes dy vendeve kufitare, por ajo është më shumë produkt i asaj çka përfaqësojnë këto dy vende për njëra-tjetrën, pasi përbëjnë një shumatore të faktorëve historikë, kulturorë, politikë, ideologjikë dhe identitarë, pa harruar këtu dhe komponentin gjeopolitik. Në këtë përplasje përfshihen faktorët historikë, njerëzorë, gjeopolitikë, siguria, aleancat politiko-ushtarake, zonat e ndikimit, komunitetet etno-gjuhësore, ndërlidhja infrastrukturore dhe energjetike, si dhe aksesit në rrugët detare që janë në themel të projeksionit të fuqisë dhe ndikimit në teatrin global.

Ky konflikt përveç se nxori në pah shumë prej dobësive të ushtrisë ruse në front, nuk duhet harruar fakti që përveç frontit aktiv ushtarak në Ukrainën lindore, Rusia është njëkohësisht e angazhuar në një front brenda saj, ku dinamikat e brendshme janë aq të ndryshueshme sa është shumë e vështirë të kuptosh çfarë mund të ndodh brenda Rusisë. Për Rusinë, agresioni në Ukrainë

është sfida politike, diplomatike dhe ushtarake më komplekse po aq edhe përcaktuese për politikën e saj të jashtme dhe të sigurisë e dekadave të fundit. Ajo përcakton raportet NATO - Rusi, pozicionin e popullsisë ruse të Ukrainës, rajonet e destabilizuara të Dombas dhe Luhansk, Krimenë dhe leksionin që Rusia dëshiron t'i japë fqinjëve të saj të dalë nga shpërbërja e "Perandorisë Sovjetike". Përtej impaktit në rajon, ajo përcakton autoritetin e Rusisë në skenën globale si një aktor që përdorimin e forcës së armatosur e ka në themel të ushtrimit të ndikimit politiko-diplomatik, marrëdhëniet me BE-në, vendet anëtare të unionit si partner tregtar, si dhe mundësinë për të përfutur objektiva të tjera diplomatike përballë kundërshtarëve të saj. Zgjidhja e çështjes së Ukrainës duhet parë si një pjesë e kësaj pakete të "Restore Diplomacy", sepse në thelb, Rusia e ka në dorë ndalimin e operacioneve ushtarake dhe ofrimin e një zgjidhjeje për Ukrainën, por për të, Ukraina është vetëm fusha ku luhen objektiva më të mëdha.

Fjalët kyçe: konflikt, Restore Diplomacy, Rusia, Ukraina, luftë, agresion, operacion ushtarak, marrëveshje, forcë e armatosur etj.

Hyrje

Lufta e Rusisë në Ukrainë nuk është thjesht një agresion i armatosur mes dy vendeve kufitare, por ajo është më shumë produkt i asaj çka përfaqësojnë këto dy vende për njëra-tjetrën, pasi përbëjnë një shumatore të faktorëve historikë, kulturorë, politikë, ideologjikë dhe identitarë, pa harruar këtu dhe komponentin gjeopolitik. Në pamje të parë, lufta shkatërrimtare që ka mbërthyer Ukrainën prej më shumë se një viti, duket si një trill individual politik e lidërshiptit rus që i është kundërvënë të drejtës fundamentale të Ukrainës për të zgjedhur vetë orientimin e saj në politikë të jashtme dhe siguri. Dhunimi i kësaj të drejte ka shkelur një sërë aktesh ndërkombëtare si Kartën e OKB-së, Aktin Final të Helsinkit, por edhe Memorandumin e Budapestit¹ të vitit 1994, ku një nga palët garantuese të sovranitetit të Ukrainës është dhe vetë Federata Ruse. Pas rënies së BRSS, Rusia u vendos në një dilemë të orientimit të saj në politikë të jashtme. Për të rifutur hapësirën imediate të hinterlandit të saj ajo organizoi ish-republikat sovjetike në Komunuelthin e Shteteve të Pavarura, me përjashtim të tre republikave baltike, si një organizëm bashkërendues, por edhe në këtë organizëm, që prej fillimit, raportet e vështira mes Rusisë dhe Ukrainës dominuan agjendën². Edhe pse NATO është zgjeruar në lindje gjatë

¹ Burimi elektronik: https://www.securitycouncilreport.org/atf/cf/%7B65BFCF9B-6D27-4E9C-8CD3-CF6E4FF96FF9%7D/s_1994_1399.pdf

² Joshua S. Goldstein, *Marrëdhëniet Ndërkombëtare*. Tiranë, 2003. Shtëpia botuese "Dituria". fq. 109.

tre dekadave të fundit, duke pranuar shtete që dikur bënë pjesë në Paktin e Varshavës, Rusia ka gëzuar siguri të paprecedentë në krahun e saj perëndimor, por sërish Moska nuk ka dashur ta lexojë kështu këtë realitet.

Në këtë përplasje përfshihen faktorët historikë, njerëzorë, gjeopolitikë, siguria, aleancat politiko-ushtarake, zonat e ndikimit, komunitetet etno-gjuhësore, ndërlidhja infrastrukturore dhe energjetike, si dhe aksesit në rrugët detare që janë në themel të projeksionit të fuqisë dhe ndikimit në teatrin global. Për të kuptuar më së miri këtë shumatore duhet të kryejmë një analizë të të gjitha elementeve që ndërthuren në këtë përplasje.

Rivaliteti për pronësinë mbi historinë

Kievi dhe Moska kanë një histori vëllazërie të vështirë që daton që në shekullin IX, kur dinastia e parë sllave me Vladimirin e Madh, princi i Novgorodit do të themelonte në vitin 980 shtetin e parë të Kiven-Rus, të drejtuar nga dinastia Rurike me qendër Kievin, vit ky në të cilin shteti i ri do të përqafojë si fe zyrtare kristianizmin bizantino-ortodoks. Përgjatë historisë së tyre të përbashkët, Ukraina ka qenë dhe vendi nga i cili kanë dalë një sërë figurash politike, ushtarake, të shkencës, artit dhe kulturës që kanë dominuar perandorinë e madhe cariste dhe më pas atë sovjetike. Ky themel i përbashkët e përndjek deri më sot fatin e dy fqinjëve më me peshë në botën sllavo-lindore. Por tashmë pronësia për të shkuarën është kthyer edhe në element gjeopolitik, ku “arkitekti” i Rusisë së re, Vladimir Putini, i quan rajonet e Ukrainës lindore si “*Novorasia*”, duke u vendosur kështu qartazi kundër shtetësisë aktuale të Ukrainës. Presidenti rus gjatë dekadës së fundit është angazhuar personalisht në thellimin e kësaj narrative të hidhur që ka në themel mosekzistencën e shtetësisë së Ukrainës si entitet politik, kulturor dhe gjuhësor. Goditjen e parë, Rusia e dha gjatë aneksimit të Krimesë në vitin 2014, e cila u pasua edhe me nisma të tjera destabilizuese që u kulmuan me sulmin e armatosur në shkurt 2022. Në këtë përplasje narrativash është përfshirë dhe presidenti ukrainas Zelenski, i cili ka prezantuar një peticion *online* për t’i ndryshuar emrin Rusisë në “*Moskovia*”³. Ky propozim sërish e gjen frymëzimin në shtratin historik, pasi gjatë shekullit XIII Moska do të kthehej në kryeqendrën e re dhe me shumë ndikim në jetën politike të vendit, duke shërbyer dhe si qendër unifikuese, pasi Pjetri i I-rë e shpalli Mbretërinë e Moskës si Perandoria Ruse. Iniciativa e Zelenskit për t’i ndryshuar emrin Rusisë në “*Moskovia*” mund të lexohet si një përpjekje për të vendosur vijat e kuqe përballë “*Novorasisë*” së Putinit, por ajo reflekton dhe dilemën historike të përcaktimit se cili është pasuesi legjitim i shtetit të parë të Kiven-Rus.

³ Burimi elektronik: <https://www.insider.com/zelenskyy-backs-petition-change-russias-name-muscovy-2023-3>

Ukraina, kurthi gjeopolitik i Rosisë

Për Rusinë, agresioni në Ukrainë është sfida politike, diplomatike dhe ushtarake më komplekse po aq edhe përcaktuese për politikën e saj të jashtme dhe të sigurisë e dekadave të fundit. Ai përcakton raportet NATO-Rusi, pozicionin e popullsisë ruse të Ukrainës, rajonet e destabilizuara të Dombas dhe Luhansk, Krimenë dhe leksionin që Rusia dëshiron t'i japë fqinjëve të saj të dalë nga shpërbërja e "Perandorisë Sovjetike". Përtej impaktit në rajon, ky agresion përcakton autoritetin e Rosisë në skenën globale si një aktor që përdorimin e forcës së armatosur e ka në themel të ushtrimit të ndikimit politiko-diplomatik në marrëdhëniet me BE-në dhe vendet anëtare të unionit si partner tregtar, si dhe mundësinë për të përfutur objektiva të tjera diplomatike përballë kundërshtarëve të saj. Për Rusinë basti është i lartë, ndaj aksioni ushtarak që ka filluar, do të vazhdojë gjatë deri sa Rusia të arrijë objektivat e saj gjeopolitike, pavarësisht kostove.

Rusia e ka të qartë objektivin e saj afatshkurtër të agresionit në Ukrainë: të detyrojë NATO-n dhe perëndimin që të ulen me të në tryezë për të përcaktuar termat e referencës në raport me angazhimin e NATO-s në lindje. Për t'i dhënë tonin e duhur që kjo është një përplasje e Rosisë me perëndimin dhe që Ukraina është vetëm kolateral i kësaj përplasjeje, Rusia ka dalë ose e kanë larguar nga disa forume të kontaktit të saj me perëndimin si: Këshilli i Evropës⁴ (2022), Këshilli NATO-Rusi (2021)⁵ dhe traktatet ndërkombëtare si: Traktati i Reduktimit dhe Limitimit të Mëtejshëm të Armëve Ofensive Strategjike Nukleare New START (2023), Traktati i Qiejve të Hapur (2022)⁶, apo edhe nga Gjykata Ndërkombëtare Penale (2016). Ajo vendosi të ndjekë rrugën e saj të shkatërrimit të qasjes me perëndimin, duke synuar ardhjen e një momenti të dytë të "*Restore Diplomacy*" për të rifilluar angazhimin e saj me perëndimin dhe SHBA-të për të strukturuar rendin e ri global, duke u imponuar për të akomoduar interesat ruse. Nga kjo qasje shkatërruese shantazhuese, Rusia kërkon që të farkëtojë autoritetin e saj si aktor që duhet të merret në konsideratë. Në dekadat e fundit, ajo ka ndërtuar profilin e një aktori që aktivizohet në çdo krizë si oponent i perëndimit, si në Siri, Kaukaz apo në Kirgistan, por gjithashtu ajo po kërkon që të fitojë hapësirën e humbur të manovrueshmërisë në ish-botën sovjetike. Paralelisht me frontin në Ukrainë, Rusia po punon në aktivizimin e vatrave të reja të konfliktit në shtetet e brishta prej ekuilibrave të brendshëm si Moldavia dhe Gjeorgjia. Kjo e fundit e gjunjësuar që prej luftës

⁴ Burimi elektronik: <https://www.coe.int/en/web/portal/-/the-russian-federation-is-excluded-from-the-council-of-europe>

⁵ Burimi elektronik: https://www.nato.int/cps/en/natohq/topics_50091.htm

⁶ Burimi elektronik: <https://www.aljazeera.com/news/2023/2/21/ten-times-countries-decided-to-exit-international-agreements>

në 2008 me Rusinë e ka të pamundur për të vepruar si një entitet i pavarur për fatet e saj, falë “arritjeve strategjike” të Rosisë.

Objektivi afatgjatë i Rosisë është që Ukraina, ashtu si Gjeorgjia, me çdo kosto të mbetet jashtë NATO-s dhe të shërbejë si zonë tampon dhe e pamundur të veprojë si një entitet i pavarur për fatet e saj dhe ku Rusia të ketë domenin e saj të sigurisë në ish-republikat sovjetike jo anëtare të NATO-s. Ky element mund të shihet mjaftueshëm me mbajtjen të pushtuar të tre rajoneve të aneksuara ilegalisht të Krimesë, Luhansk dhe Donesk. Për këtë objektiv politiko-ushtarak, Rosisë i duhet të gjejë balancën mes listës së gjatë të implikimeve ndërkombëtare, pasi është pozicionuar qartë si agresor, sanksioneve që e presin dhe kostove pafund që mund të prodhojë një humbje ushtarake në Ukrainë si në planin e jashtëm dhe të brendshëm, por edhe të arritjes me çdo kusht të një stadi të avancuar si aktor përcaktues nëpërmjet ushtrimit të forcës në arenën rajonale dhe globale.

Diplomati i njohur amerikan George Kennan ka thënë se *“tragjedia e Rosisë është se e sheh Ukrainën, ose si vasale të saj, ose si armike”*. Ukraina nuk është vetëm rivali për pronësinë e historisë, ajo është porta e saj në detet e ngrohta që nga koha e Katerinës së Madhe dhe ka shërbyer si pikë aksesit gjeografik për të ushtruar ndikimin në Botë. Pas shpërbërjes së BRSS, të dyja vendet u përfshinë në diskutime të forta për pronësinë e bazës së Sevastopolit në Krime dhe në vitin 1997, ato nënshkruan marrëveshjen për ndarjen e saj, çka i mundësoi Rosisë që të ketë nën kontrollin e saj shtëpinë e Flotës Ruse të Detit të Zi⁷. Shteti i Ukrainës, i dalë nga shpërbërja e Bashkimit Sovjetik, është për Rusinë një nga rrugëkalimet më të mëdha të eksportit të gazit rus drejtë Evropës Qendrore dhe Perëndimore, nëpërmjet sistemit të transmisionit të gazsjellësve Bratstvo dhe Soyuz.

Historia politike e Ukrainës si shtet i pavarur që prej vitit 1991 e në vazhdim është një histori përpjekjesh për të shpëtuar nga ndikimi rus me çdo çmim, një luftë e ashpër politike mes formacioneve pro dhe kundër Moskës, pro dhe kundër perëndimit, revolucioneve e protestave paqësore apo të përgjakshme për dinjitet, liri dhe demokraci. Për ukrainasit lufta është pika kulminante e këtyre përpjekjeve 30-vjeçare të Ukrainës për liri politike dhe kjo për ta është kronikë e një ngjarjeje të paralajmëruar. Kjo luftë është thellimi i një epoke të errët që tani vendos në pikëpyetje ekzistencën e Ukrainës si shtet, tërësinë territoriale, pa harruar humbjet njerëzore, materiale dhe shkallën e lartë të shkatërrimit në një luftë brutale që ka hyrë në vitin e dytë të saj.

Përveç mbijetesës së saj, Ukrainës i është dashur të angazhohet në një sërë

⁷ Burimi elektronik: https://en.wikisource.org/wiki/Partition_Treaty_on_the_Status_and_Conditions_of_the_Black_Sea_Fleet

përpjekjesh sflitëse për të ngritur dhe mbajtur të bashkuar një koalicion shtetesh dhe vlerash demokratike rreth Ukrainës. Për Kievin është e qartë që, nëse del me dinjitet deri në fund nga kjo luftë, e ardhmja euroatlantike e Ukrainës do të shënojë një rrugë pa kthim. Në kuadër të këtij vendimi, BE-ja nëpërmjet një lëvizjeje të fortë gjeopolitike, vendosi që t'i japë statusin e vendit kandidat Ukrainës dhe Moldavisë, jo vetëm si shenjë mbështetje për sakrificat e qytetarëve të tyre, por edhe si dëshmi e angazhimit të unionit kundrejt këtyre dy vendeve⁸.

Për aktorët e tretë të angazhuar direkt apo indirekt në këtë luftë, ky front është një mundësi për të mbajtur Rusinë të angazhuar sa më gjatë në një luftë gërryese dhe rraskapitëse si në planin njerëzor, ekonomik, ashtu edhe atë ushtarak. Një Rusi e dobësuar në të gjitha drejtimit, me rusët që ngrihen kundër lidershit politik është një objektiv me kosto të ulët për rivalët e saj. Kjo luftë në aspektin ekonomik përveç impaktit negativ në tregjet botërore i ka shërbyer fuqive ekonomike evropiane që të eksplorojnë rrugë të reja në sigurimin e burimeve natyrore dhe shkëputjen e varësisë nga gazi rus, të cilin Rusia në shumicën e rasteve e përdorte si një instrument shantazhi dhe presioni për të arritur objektivat gjeopolitike. Me objektivin në horizont për një Europë të gjelbër, misioni i ri i BE-së është pajtimi i sigurisë së energjisë me tranzicionin ekologjik. Lufta e paprovokuar e Rusisë në Ukrainë ka sjellë ndryshimin e një sërë ekuilibrash në teatrin evropian, ku Finlanda dhe Suedia braktisën pozicionimin e tyre gati shekullor neutral për t'iu bashkuar NATO-s, ndërsa Gjermania nga ana tjetër ka vendosur të kryejë një kthesë historike nëpërmjet zbatimit të “*Zeitenwende*” në fushën e mbrojtjes. Ndërkohë, kjo luftë ka dëshmuar një solidaritet unik brenda NATO-s dhe ka shërbyer për të ripërtërirë lidhjen transatlantike, si dhe në forcimin e prezencës së NATO-s në lindje nëpërmjet grup-batalioneve nga Baltiku në Detin e Zi⁹. Nga ana tjetër, Rusia ka ndërmarrë një sërë ndryshimesh në korpusin e dokumenteve strategjike, ku më i rëndësishmi është miratimi i një strategjie të re të politikës së jashtme (prill 2023), në të cilën Shtetet e Bashkuara dhe Perëndimi renditen si burim i “kërcënimit ekzistencial” për Moskën¹⁰.

Në kërkim të balancimit të dinamikave të reja të krijuara në fushën gjeopolitike, Rusia dhe partnerët e saj e panë këtë luftë si një mundësi për të thelluar bashkëpunimin mes tyre në një botë ku përplasjet për të strukturuar rendin e ri global multipolar po bëhen edhe më të thella. Në këtë luftë, aktorët e

⁸ Burimi elektronik: <https://www.euractiv.com/section/europe-s-east/news/eu-leaders-grant-candidate-status-to-ukraine-and-moldova/>

⁹ Burimi elektronik: https://www.nato.int/cps/fr/natohq/topics_136388.htm?selectedLocale=en

¹⁰ Burimi elektronik: <https://vesanews.al/strategjia-e-re-e-politikes-se-jashtme-ruse-perendimi-eshte-nje-kercenim-ekzistencial/>

tjerë të pozicionuar përballë perëndimit kanë parë mundësinë për të formësuar një koalicion “anti hegjemonist unipolar”, koalicion ky që po merr dita-ditës ngjyra më të theksuara me fuqi të mëdha dhe të mesme, globale dhe rajonale si: Rusia, Kina, Bjellorusia, Irani, Koreja e Veriut, vende të brezit të Kaukazit, Afrikës Subsahariane dhe Serbisë. Kjo e fundit e dyzuar më së shumti prej rezultateve të pakta të arritura deri tani nga fushata ushtarake ruse në Ukrainë, se sa nga mungesa e qartësisë dhe përkatësisë gjeopolitike serbe.

Një front paralel brenda Rusisë

Nuk duhet harruar fakti që përveç frontit kinetik aktiv ushtarak në Ukrainën lindore, Rusia është njëkohësisht e angazhuar në një front jo kinetik brenda saj, ku dinamikat e brendshme janë aq të ndryshueshme sa është shumë e vështirë të kuptosh çfarë mund të ndodhë brenda Rusisë. Të parashikosh Rusinë është më shumë sesa një sfidë, madje është thjesht e pamundur, pasi siç thotë dhe një shprehje e vjetër ruse: *“Rusia është një vend me një të kaluar të paparashikueshme!”*. Ndërsa sa i takon kompleksitetit të Rusisë, Churchill-i thoshte: *“Rusia është një enigmë e mbështjellë me një mister brenda një gjëegjëze”*. Brenda këtij ekuacioni kaq kompleks, siç është vetë Rusia, historia e saj ka treguar se dështimet ushtarake kanë prodhuar rënie të dhunshme të lidërshit politik të saj të shoqëruar me tronditje të ekuilibrave të brendshme, ndërsa sukseset ushtarake kanë prodhuar gjithnjë tre fatura për Rusinë; kosto njerëzore, zgjerim territorial dhe forcim të autoritetit politik. Në kontekstin etno-kulturor, Rusia përbën një mishelë shumë ndezëse për të prodhuar dinamika të dhunshme për së brendshmi, pasi ajo është një mozaik etnish (193 grupe etnike, por 72% e popullsisë janë rusë etnikë), kulturash, gjuhësh (35 gjuhë zyrtare dhe 100 gjuhë të grupeve etnike), besimesh (70% e popullsisë janë ortodoksë, por 65% e gjithë popullsisë janë besimtarë), nuancash dhe shtresash të mbivendosura historike, çka e bën të vështirë të përcaktosh shtratin dhe rrënjët etno-kulturore të rusëve. Në eksperiencën e tij gjatë pushtimit të Rusisë Napoleon Bonaparti u shpreh: *“Gërvisht një rus dhe do të gjesh një tartar”*. Për shkak të këtij kompleksiteti përgjatë historisë së saj, Rusia është dominuar nga qeverisje me dorë të hekurt, me një aparat represiv të centralizuar, me një popull të përulur ndaj autoritetit dhe që e ka më të lehtë të besojnë atë që u thotë qeveria, pasi në thelb Rusia është një vend kontradiktash.

Ajo është vendi me sipërfaqen më të madhe në botë prej 17 milionë kilometër katror, që përbën 1/8 e sipërfaqes tokësore të botës, me 11 zona orare nga Kaliningradi në Vladivostok, e ndarë në 89 subjekte federale nga të cilat 24 janë republika. Rusia është çatia e botës dhe shteti i dy kontinenteve. Ky dimension i stërmadh gjeografik është i mishëruar në kulturën ruse në këtë trajtë: *“Nëse në Azi ndjehesh evropian dhe në Evropë ndihesh aziatik, atëherë ti je rus”*.

Ky identitet i dyfishtë i ka bërë ata që të kërkojnë një identitet global si fuqi e madhe. Rusët kanë qenë përherë në sakrificë dhe garë për të mos e lënë vendin e tyre pas në garën me botën dhe modernitetin. Ata kanë një lidhje të veçantë me vendin e tyre që është testuar përgjatë gjithë historisë së tyre të mbushur në sakrifica. Ndjenja e tyre pasionante për madhështinë e Rusisë minohet shpesh në mënyrë paradoksale nga një pesimizëm themelor dhe gërryes. Kjo ndjenjë zbutet nga pakënaqësia që vendi i tyre nuk kuptohet dhe respektohet sa duhet nga të huajt. Për rusët fjala “komb” ka një kuptim mistik, pasi ata besojnë se i tyri është i jashtëzakonshëm, i zgjedhur nga Zoti ose Historia për të sjellë ndriçim në një botë të fundosur. Kjo ndjenjë mesianike lindi nga Ortodoksia në Muscovy-n mesjetare dhe ka mbijetuar që atëherë.

Nisja e luftës në Ukrainë u shoqërua me një reagim të fortë popullor kundër në Rusi, por po aq e fortë ishte dhe përgjigja e aparatit të sigurisë ndaj këtij reagimi popullor që kundërshtonte luftën dhe lidhshkrimin politik-ushtarak në Kremlin. Menjëherë në vend u miratuan një sërë aktesh ligjore që e kriminalizojnë kritikën kundër luftës dhe ushtrisë ruse, kontroll tërësor i çdo media apo forumi për çdo lajm nga “Operacioni Special Ushtarak”. Establistmenti politik në Rusi, i ndërgjegjshëm për fuqinë tektonike të vendit, e kuptoi shpejt që pas shtypjes së revoltës së brendshme dhe mos lejimit të një fronti destabilizues brenda Rusisë, i duhet të unifikojë rreth kësaj sipërmarrjeje gjithë rusët, duke i përbashkuar te shpirti rus, sakrifica historike e luftës kundër nazizmit dhe rrezikut që “për fat të keq” këto kërcënime janë tashmë reale nga qeverisja e Kievit. Ky moment i shërbeu gjithashtu Rusisë për të “trajtuar” varfërinë¹¹ e rajoneve të dominuara nga grupet etnike nëpërmjet kontratave për ushtar në front si kazakët, çeçenët, tatarët, ingushët, osetianët, mongolët, kalmykët¹², çka për rrjedhojë solli edhe numrin më të lartë të të rënëve në front nga radhët e këtyre grupeve etnike. Dërgimi drejt vdekjes i djemve që vijnë nga një sfond i tillë etnik është parë me shumë kritikizëm nga një sërë organizmash ndërkombëtarë që monitorojnë respektimin e të drejtave të minoriteteve etnike, duke e akuzuar Moskën se po kryen një “luftë të pistë” në Ukrainë jo vetëm në front por edhe brenda Rusisë.

Burimet ruse në funksion të luftës

Shumë në përfundim kanë pritur që efektet e sanksioneve ekonomike dhe fatura e lartë e luftës në Ukrainë do të shërbenin si një mekanizëm ndezës i pakënaqësisë popullore ruse, e cila do të ishte e mjaftueshme për të prodhuar ndryshime politike. Por me një nëntokë që mbart gjithë Tabelën e Mendelejevit,

¹¹ Burimi elektronik: <https://www.ft.com/content/e98976cd-27e2-455d-806a-fe1618b86cb5>

¹² Burimi elektronik: <https://foreignpolicy.com/2022/09/23/russia-partial-military-mobilization-ethnic-minorities/>

toka ruse është një minierë e vërtet ekonomike për vendin dhe qytetarët e saj, ndonëse aksesit dhe përfitimi nga të mirat natyrore të vendit ka qenë historikisht i limituar për rusët e zakonshëm duke përfituar përherë shteti dhe një pakicë oligarkike pranë pushtetit. Ndonëse me një listë të gjatë sanksionesh dhe ndalimesh eksporti, Rusia edhe gjatë gjithë vitit të parë të luftës në Ukrainë arriti të siguronte mesatarisht rreth 800 milion \$ në ditë vetëm nga të ardhurat e eksporteve të naftës dhe gazit¹³. Sipas analizave të ofruara nga agjencitë financiare, gjatë vitit të parë të luftës Rusia ka shpenzuar mesatarisht rreth 10 miliard \$ në muaj për luftën në Ukrainë¹⁴. Kjo balancë financiare rraskapitëse, ndonëse shumë e lartë, sërisht mbetet më e ulët sesa të ardhurat që siguron Rusia vetëm nga një zë i eksporteve të saj, duke i dhënë asaj mjetet e nevojshme për të lubrifikuar makinerinë e luftës në këtë sipërmarrje të çmëndur. Këto të dhëna shpjegojnë faktin pse shpesh autoritetet në Kiev artikulojnë faktin që sanksionet nuk kanë prekur siç duhet sektorin jetik të ekonomisë ruse që përdoren në funksion të luftës.

Por ndryshe nga të mirat materiale në raport me burimet njerëzore, performanca është me bilanc jo fort premtuese për Rusinë, pasi në një popullsi prej 146 milion banorësh, vetëm 11 milion përbëjnë grupmoshën 20-30 vjeç (meshkuj dhe femra) dhe 1/3 e rusëve janë mbi 50 vjeç. Çdo vit para nisjes së luftës në Ukrainë, Rusia rekrutonte mesatarisht 270 mijë rekrutë të rinj në shërbimin aktiv të detyrueshëm ushtarak. Këto raporte janë shumëfishuar gjatë vitit të parë të luftës ku humbjet e mëdha në front falë rezistencës frymëzuese ukrainase, Rusia është detyruar të mobilizojë një numër jo të vogël të rezervave të saj njerëzore¹⁵. Në disa programe rekrutimi dhe shtimi të forcës efektive aktive, Rusia ka kryer dy fushata të mëdha rekrutimi dhe mobilizimi, si dhe parasheh që një valë tjetër prej 400.000 trupash t'i bashkohen frontit, duke nxjerrë sërisht në pah një veti të vjetër të ushtrisë ruse, atë të mbështetjes në trupa rezerviste dhe rekrutë në operacionet ushtarake. Në këto shifra nuk janë përfshirë rreth 50.000 trupa të ushtrisë private Wagner dhe rekrutimet nga rajonet e pushtuara të Dombas dhe Krimesë.

Ukraina rrëzoi disa nga mitet e Rusisë

Në fazën e parë të luftës, Rusia grumbulloi dhe futi në territorin e Ukrainës rreth 130 mijë trupa nga rreth 10-12 divizione të strukturuar në 65-70 batalione taktike mësimëse autonome të përforcuara dhe të mbështetur nga divizione parashutiste dhe specialët e Spetnaz në një front që shkon rreth 1200 kilometra.

¹³ Burimi elektronik: <https://www.statista.com/statistics/1314448/russia-fossil-fuel-export-revenue/>

¹⁴ Burimi elektronik: <https://thehill.com/opinion/international/3756097-real-costs-of-russias-ukraine-war/>

¹⁵ Burimi elektronik: <https://www.dw.com/en/will-russia-launch-another-mobilization-drive/a-64345837>

Në këtë fazë u angazhuan edhe 27 mijë personel ajror në dispozicion dhe mbështetje të operacioneve mësymëse. Ukraina mobilizoi ushtrinë e saj aktive prej 209 mijë trupash, forcoi radhët e saj edhe me 20 batalione të Njësisë të Mbrojtjes Territoriale të përbërë me vullnetarë civilë në mbështetje të operacioneve të ushtrisë së rregullt, pa përfshirë këtu edhe rreth 1 milion rezervistët, të cilët ka deklaruar se po marrin trajnimet e nevojshme për t'iu bashkuar frontit sipas nevojave. Në traditën e saj të luftimit, Rusia ka dëshmuar disa herë përgjatë historisë që ekonomizimi i jetëve njerëzore në luftë është në plan të dytë përballë objektivave politiko-ushtarake, ndaj valët e mobilizimit të rekrutëve në Rusi do të përsëriten pa hezitim nga komanda ushtarake e vendit.

Një nga elementet që u vu re në këtë luftë ishte vendosja në kryesimin e sulmeve ruse për të marrë territore e disa njësisë paraushtarake mercenare që operojnë me taktika brutale mesjetare jashtë kornizës së të drejtës ndërkombëtare të konfliktit të armatosur si Wagnerat apo Kadirovët, që shpesh janë futur në konkurrencë të hapur me ushtrinë e rregullt ruse. Jashtë çdo parashikimi, ushtria ruse jo vetëm që nuk arriti një fitore të shpejtë, por pësoi humbje të thella duke lënë pas një numër të konsiderueshëm të forcës së saj mësymëse bashkë me teknikën luftarake. Viti i parë i luftës mund të quhet pa rezerva si viti i hedhjes poshtë të miteve për forcat ushtarake ruse dhe i nxjerrjes në pah të dobësive themelore të saj në disa elemente si: mungesë organizimi dhe koordinimi, mungesë motivimi, mosvendosja e dominimit ajror, mungesa e linjave të furnizimit dhe logjistikës, trajnimi i pakët dhe mungesa e mbështetjes. Madje përveç rezistencës, ushtria ukrainase arriti të kalojë në kundërsulm duke rimarrë jo pak territore në verën e vitit 2022, duke ia arritur që jo vetëm ta shtyjë forcën ruse në një rajon të vetëm ndryshe nga ai i muajve të parë, duke e mbajtur atë jashtë qendrave politike dhe ushtarake kryesore të vendit dhe duke ia kufizuar veprimet vetëm në rajonin e Dombasit. Krejt ndryshe nga sa pritej, Ruisë i ra poshtë dhe miti i saj si triumfuese në luftën e dimrit. Për shekuj me radhë si kundërshtarët e Ruisë edhe vetë kasta ushtarake e saj kanë dëshmuar se *“Gjeneral Janari dhe Gjeneral Shkurti janë gjeneralët më të mëdhenj të ushtrisë ruse”*, por Ukraina ia doli që ta zhbëjë edhe këtë mit historik.

Në kushtet që Rusia nuk ishte në gjendje që të mbante një front të gjerë në Ukrainë, u detyrua që të fokusohet në frontin e Dombasit dhe të ndërmarrë sulme brutale raketore në zonat e banuara, në infrastrukturën kritike dhe rrugët e furnizimit të Ukrainës, me synimin që të shkaktonte sa më shumë dëme dhe presioni i brendshëm mbi qeverinë në Kiev të arrijë deri në kapitullim. Ky skenar ashtu siç edhe i pari, ai i një fitoreje të shpejtë, nuk gjeti zbatim falë jo vetëm rezistencës dhe profesionalizmit ukrainas, por edhe prej mbështetjes me teknikë, teknologji dhe informacion të dorës së parë nga vendet anëtare

të NATO-s për Ukrainën, duke rritur kostot e këtij angazhimi të Rusisë në Ukrainë përtej çdo plani apo ideje fillestare. E gjendur përballë këtij realiteti të ri, Rusia është detyruar që të tërhiqet në veprime sulmuese në disa rajone: stabilizoi frontin, ekonomizoi teknikën luftarake dhe shtoi valët e burimeve njerëzore në front, duke u përgatitur për një luftë shkatërrimtare të gjatë që tashmë ka në thellim tre objektiva:

- të vijojë sa më gjatë luftën me shpresën që mbështetja për Ukrainën nga vendet perëndimore të bjerë gradualisht, si rezultat dhe i faturës së lartë financiare dhe efekteve që po përballen qytetarët perëndimorë;

- të shterojnë burimet materiale dhe teknika luftarake e Ukrainës duke e bërë më të lehtë avancimin, nga ana tjetër duke shtuar ritmin prodhues të kompleksit industrial rus në funksion të luftës;

- koagulimin e një aleance “anti hegjemoniste unipolare”, me shpresën që do të hapë fronte të tjera destabiliteti në Moldavi, Gjeorgji, Ballkan, apo edhe t’i vijnë në ndihmë aleatët e saj në rajone të tjera si në Tajvan.

Së fundmi, në funksion të kësaj narrative i ka ardhur në ndihmë edhe marrëveshja e vendeve të AUKUS¹⁶ mes Australisë-Britanisë së Madhe dhe SHBA-ve për furnizim me nëndetëse me energji bërthamore të Australisë. Këtë lëvizje Rusia dhe Kina e kanë parë si një bashkim forcash për t’iu kundërvënë interesave kineze dhe ruse në botë. Për ta konsoliduar lidhjen e tyre, Rusia dhe Kina së fundmi kanë përcaktuar partneritetin e tyre si “një partneritet pa limite”, duke lënë të hapur mundësinë për të bashkëpunuar në çdo fushë, në funksion të realizimit të objektivave dhe përballjes me kundërshtarët e tyre.

Fundi i luftës gjendet larg fushës së betejës

Pavarësisht humbjeve të mëdha njerëzore për të dyja palët, humbjeve materiale të pamatshme për Ukrainën dhe humbjeve të teknikës ushtarake në të dy palët ndërluftuese, miliona ukrainasve të zhvendosur si refugjatë lufte, shtu këtu dhe efektet e krizës ekonomike, furnizimit me lëndë të parë, kjo luftë duket ende larg përfundimit. Rusia është shumë larg arritjes së objektivave të saj për të cilët ndërmori këtë luftë, ndërkohë Ukraina në të drejtën e saj legjitime për vetëmbrojtje dhe ekzistencë është e ngecur në pamundësinë për të rifituar nëpërmjet forcës ushtarake të gjithë territorin e saj. Nga ana tjetër, Rusia ka deklaruar zyrtarisht aneksimin dhe bërjen pjesë të Federatës Ruse të “Republikave Autonome të Luhansk-ut dhe Donesk-ut”, përveç Krimesë së aneksuar ilegalisht në vitin 2014, territore për të cilat lidhshipi politik dhe ushtarak në Rusi ka deklaruar se do t’i mbrojë me çdo kusht si pjesë territoriale

¹⁶ Burimi elektronik: <https://www.brookings.edu/blog/order-from-chaos/2023/03/15/around-the-halls-aukus-defines-an-emerging-alliance-at-sea/>

e vendit, duke mos përjashtuar këtu edhe përdorimin e kapaciteteve taktike bërthamore. Për ta bërë edhe më realiste këtë sipërmarrje, Rusia ka nisur edhe rindërtimin e qyteteve tashmë nën kontrollin e saj si rasti i Mariopolit.

Nisur nga kjo sipërmarrje, Rusia duhet të llogarisë mirë pasojat e humbjes jo vetëm përballë ligjit ndërkombëtar, efekteve të brendshme, kundërshtarëve të saj, por edhe përballë 25 milionë rusëve që jetojnë në ish-republikat sovjetike, nga të cilët 8 milionë vetëm në Ukrainë. Në këtë kontekst, agonia e dhimbjeve të luftës duhet të zhvendoset në tryezat e negociatave ku aktorët si në mënyrë bilaterale apo edhe në formate më të gjëra duhet të skicojnë rrugën e daljes nga transhetë e fortifikuara rëndë, për të konsoliduar paqen. Disa përpjekje janë bërë në Bjellorusi por pa sukses, një tjetër fuqi aleate e Rusisë si Kina është ofruar për të ndërmjetësuar një armëpushim dhe paqe, por që është parë me rezervë nga aleatët e Ukrainës.

Në këtë fazë që ka hyrë konflikti është e rëndësishme që të ruhet paqja në kontinentin evropian dhe i vetmi aktor me peshë që mund të luajë një rol përballë Rusisë janë SHBA-të, të cilat do të duhet të angazhohen për të ringritur pikat e kontaktit, mundësimin e një armëpushimi dhe arritjen e një zgjidhjeje politike për Ukrainën duke vendosur garancitë përkatëse. Vijimi i furnizimit të Ukrainës me teknikën e nevojshme ushtarake pavarësisht se forcon pozitat e saj në një negociatë për paqe, në thelb i orienton energjitë drejt konfliktit duke zgjatur agoninë, humbjet në jetë nga të dyja palët dhe do të thellonte terrenin për një luftë aktive por të harruar në kufijtë lindorë të kontinentit. Nga ana tjetër, Rusia ka vendosur në front jo pak kapacitete ushtarake që qëndronin si stoqe nëpër depo, si dhe ka rritur ritmin e prodhimit në kompleksin e saj industrial ushtarak për të plotësuar nevojat në front.

Në kuadër të një mekanizmi që mund të sjellë një *“Restore Diplomacy”*, Rusia pret që përfundimi të gjejë një mënyrë që të riintegrojë Rusinë në forumet ekzistuese si: Këshilli i Evropës, Këshilli NATO-Rusi dhe në traktatet ndërkombëtare si: Traktatet e Reduktimit dhe Limitimit të Mëtejshëm të Armëve Ofensive Strategjike Nukleare New START, Traktatit të Qiejve të Hapur, rikthimin në Gjykatën Ndërkombëtare Penale. Zgjidhja e çështjes së Ukrainës duhet parë si një pjesë e kësaj pakete të *“Restore Diplomacy”*, pasi në thelb Rusia e ka në dorë ndalimin e operacioneve ushtarake dhe ofrimin e një zgjidhjeje për Ukrainën por për të, Ukraina është vetëm fusha ku luhen objektiva më të mëdha. Gjithashtu natyra aktuale e përplasjes, që ka marrë trajtesën e një konflikti Rusi - Perëndim, mund të sjellë nevojën e ngritjes së mekanizmave të reja të angazhimit dhe një *“Jalta 2.0”* si një mundësi që do të rristrukojë rendin botëror dhe të ulë tensionet edhe përtej zonës së konfliktit.

Në thelb, Rusia është një aktor që ka një sërë nyjesh lidhëse historike dhe

ndërveprimi me Evropën, pa harruar këtu faktin që qasja destruktive e saj mund të aktivizohet në disa shtete evropiane ku jetojnë pakica ruse duke ndërmarrë veprimtari subversive dhe separatiste. Si një fuqi e madhe evropiane natyrisht që edhe Rusia ka interesa të saj për të artikuluar; ndonëse forma agresive që ajo ka zgjedhur nuk mund të përligjet për asnjë rast, ajo është në kërkim të një koncesioni që kënaq interesat ruse. Nëse këto interesa nuk do të realizohen si pjesë e një pakete më të madhe, agjenda e zhvillimeve në Ukrainë do të mbahet e kyçur si kolateral i përplasjes Rusi - SHBA, NATO, BE, por edhe kolateral i egos së rrënuar të Rusisë.

Strategjia e daljes nga konflikti duhet të përfshijë një paketë të madhe aktesh që “*Restore Diplomacy*”, ku veç qasjes makro në nivel me mikro, duhet të përfshijë dhe një sërë elementesh shumë të kundërta si: garancitë për sovranitetin dhe tërësinë territoriale të Ukrainës, statusin e saj në raport me NATO-n dhe BE-në, definimin e statusit të rajoneve të banuara nga rusët në Ukrainë, statusin e flotës ruse në Detin e Zi, garancitë që kërkon Rusia për rolin e NATO-s në kufijtë e saj. Nëse në Gjeorgji Rusia kishte interesa që ta mbante larg atë nga NATO dhe dhënien e një “mësimi” Gjeorgjisë, në Ukrainë kompleksiteti i interesave ekonomike, strategjike, gjeopolitike, historike dhe pesha e rusëve brenda saj, e bënë Rusinë që të jetë shumë e interesuar dhe për rrjedhojë të gatshme për të paguar çdo kosto që akomodon interesat e saj. Është me rëndësi thelbësore që Ukraina të mos përfundojë njësoj si Gjeorgjia, ndaj lidhshipi në Kiev përtej drejtimit ushtarak duhet të gjejë dhe drejtimin për një zgjidhje politike për luftën që po zhvillohet në territorin e saj, duke rrezikuar të kthehet në një luftë të harruar në lindje të Evropës.

STRATEGJITË E FSHEHTA PËR OPERACIONET SPECIALE USHTARAKE, METODË JUSTIFIKUESE E LUFTËS PUSHTUESE TË FEDERATËS RUSE NË UKRAINË

Nënkolonel (R) Dr. Kanan HIMAJ
Instituti Kërkimit Shkencor Ushtarak

Trajtesë e shkurtuar.

Rusia e ka paraqitur në mënyrë të vazhdueshme luftën në Ukrainë me termin operacion ushtarak special, qëllimet e të cilit janë deklaruar nga presidenti rus Putin për çmilitarizimin dhe denazifikimin¹ e Ukrainës. Në kontekstin më të gjerë, ekziston një përpjekje perandorake e Rusisë për të forcuar fuqinë dhe ndikimin e saj në rajon me një luftë sulmuese dhe agresive ndaj të gjitha rajoneve pro ruse dhe jo vetëm.

Në këtë shkrim përcaktohet ndryshimi thelbësor midis strategjive të përdorura në operacionet speciale dhe të ashtuquajturit operacion special ushtarak, në kontekstin e cilësimit bashkëkohor të Kremlinit. Gjithashtu, punimi argumenton mënyrën në të cilën Rusia po përpiqet të justifikojë luftën dhe të diskutojë realitetin e saj në termat e së drejtës ndërkombëtare.

Fjalë kyçe: Rusia, strategji, operacion special ushtarak, teori ushtarake, konflikti ushtarak.

¹ Procesi i sjelljes së liderëve të regjimit nacional-socialist në Gjermani para drejtësisë dhe i pastrimit të të gjithë elementëve të nazizmit nga jeta publike, i kryer veçanërisht midis viteve 1945 dhe 1948.

Hyrje

Lufta e agresionit të Rusisë në Ukrainë ndryshon rrënjësisht nga e shkuara, Le cila ka sjellë vuajtje dhe shkatërime të mëdha njerëzore, “mjekimi” i të cilave nuk shihet askund, por gjithashtu ajo jep mendime të kundërta se çfarë është në të vërtetë. Ndasitë, përçarjet dhe shkatërimi po shihet si rreziku, sfida dhe kërcënimi me të cilin Aleanca duhet të përballët përmes një mbrojtjeje, parandalimi dhe angazhimi. Për të përshkruar fushatën e saj në Ukrainë, Moska insiston thelbësisht në përdorimin e termit “*operacion special ushtarak*” (spetsial naya voyennaya operatsiya), i cili përdoret zakonisht në një kontekst të njohur dhe gradualisht po hyn në kontekstin e teorisë ushtarake Ruse. Fakti që autoritetet Ruse dhe media shtetërore janë kaq të kujdesshme për të shmangur përdorimin e fjalës “luftë” dhe në vend të kësaj flasin për një “*operacion special ushtarak*” është jo i zakonshëm. Në fillimin e agresionit, nuk kishte asnjë përkufizim formal apo term të pranuar përgjithësisht për të sqaruar konceptin strategjik dhe operacional në doktrinën Ruse. Nga pikëpamja doktrinare, kjo është disi e pazakontë, duke pasur parasysh aktivitetet e ngjashme ushtarake të kryera në të kaluarën (Gjeorgji, Çeçeni, etj.), kur qëllimi i tyre, ngjashëm me rastin e Ukrainës, ishte të siguronin mbijetesën vendeve nën ndikimin e Moskës dhe për t’i mbajtur ato në sferën e interesave të saj. Prandaj ishte befasuese që rusët filluan të përdorin këtë term mjaft specifik në lidhje me luftën në Ukrainë. Ajo e shihte të nevojshme të mbrohej strategjia e përdorur në konceptin “*agresioni*”, të përcaktohej dhe të shpjegohej se çfarë saktësisht do të thotë “*operacion special ushtarak*”, jo vetëm për konceptin e sigurisë dhe mbrojtjes shtetërore, por veçanërisht për publikun rus.

Ndryshe është situata në Perëndim, ku për shkak të rrethanave të agresionit Rus, ndoshta pak ose aspak është menduar se çfarë do të thotë saktësisht ky term. Shumica e tyre në përgjithësi e kuptojnë atë si një shfaqje e butë për pushtimin ushtarak dhe luftën, disa prej tyre e mohojnë atë si një shembull të gazetave ruse që nuk meritojnë vëmendje. Kjo lloj lufte specifike fillon me stërvitjet ushtarake dhe rekrutët të cilëve u thuhet se shkojnë në territor vetëm për stërvitje. Strategjia e tyre është që me të mbërritur në një vend të huaj, ushtria urdhëron trupat e saj të angazhohen për të shkatërruar ndërtesat e banimit, shkollat, spitalet, termocentralet, impiantet, duke vrarë pa dallim civilë dhe duke kryer krime të shumta lufte. Gjatë bisedimeve publike, në vend të gjitha këtyre detajeve tmerrësisht të çrregullta, është i kuptueshëm veprimi “*operacioni ushtarak special*”, në përpjekje për të bërë të pranueshme luftën brutale dhe çnjerëzore nga pushtuesi².

² Fjalor Urban, 26 shkurt 2022. Burimi elektronik: <https://www.urbandictionary.com/define.php?term=operacion+ushtarak+special>

Përpyekjet për interpretim profesional nuk janë shumë të dukshme për momentin edhe nga këndvështrimi i faqes së internetit “Fjalori Urban”³, i cili ekzagjeron “*operacionin special ushtarak*” si më poshtë: “*Pushtim. Sidomos kur drejtohet nga një regjim autoritar*”, dhe shton: “*Ky nuk është një pushtim i shtetit sovran të Ukrainës. Është një operacion ushtarak special*”.⁴

Për rusët, kuptimi i termit të përshkruar nuk ishte i rëndësishëm më parë. Sidoqoftë, përfshirja e “*operacioneve speciale ushtarake*” në teorinë dhe terminologjinë ushtarake ruse, hedh dritë të mbi synimet dhe qëllimet e Moskës, për të mos përmendur zgjedhjen e mjeteve, aftësitë e përdorura dhe mundësitë e përshkallëzimit të mëtejshëm të konfliktit. Rusia nuk zgjodhi ta emërtojë luftën e saj në këtë mënyrë rastësisht. Modeli agresiv i Rusisë përforcohet nga aftësitë në rritje të projektimit të fuqisë së forcave të armatosura, të cilat janë krijuar për të kërcënuar krahun lindor të NATO-s dhe rajonin e Detit të Zi⁵.

Qëllimi i artikullit është të përqendrohet në sqarimin e konceptit strategjik në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes të termit “*operacionit special ushtarak*” dhe konteksteve të tjera që rrjedhin nga lufta në kontekstin e interpretimit bashkëkohor të Kremlinit, të cilin pala ruse përpiket të mbulojë qëndrimin e saj agresiv ndaj shtetit sovran, Ukrainës. Artikulli mund të gjejë aplikimin e tij si në ambientet e njohjes profesionale por edhe midis medias së gjerë të interesuar në kontekstin më të gjerë të luftës në Ukrainë.

Përkufizim terminologjik i termave

Në botimet doktrinare dhe fjalorët terminologjikë ushtarakë, termi “*operacion special ushtarak*” nuk është përcaktuar. Vetëm termi “*operacion special*” ka ankorimin e tij terminologjik, përmbajtja e të cilit nuk korrespondon me termin e mësipërm. Sipas botimit AAP-06, operacionet speciale përkufizohen si: aktivitete ushtarake të kryera nga forca të përcaktuara, të organizuara, të përzgjedhura, të trajnuara, të armatosura dhe të pajisura posaçërisht që përdorin teknika dhe metoda jokonvencionale të operacionit.⁶ Kuptimi identik i termit është gjithashtu i dhënë në doktrinën e aleancës për operacione speciale.⁷ Fjalori i termave të Forcave të Armatosura të SHBA-së për termin operacione speciale thotë: Aktivitete ose veprime që kërkojnë metoda unike përdorimi,

³ Po aty.

⁴ Po aty. Prandaj koncepti është i nevojshëm për të kuptuar interpretimin me të cilin Rusia përpiket të objektivizojë dhe justifikojë luftën.

⁵ Koncepti Strategjik NATO, 2022.

⁶ AAP-06(2017). Fjalori i NATO-s me terma dhe përkufizime (anglisht dhe frëngjisht). Zyra për Standardizimin e Mbrojtjes, Katalogimin dhe Sigurimin e Cilësisë Shtetërore Departamenti i Standardizimit të Mbrojtjes. 2018, f. 301.

⁷ AJP-3.5. Doktrina e Përbashkët NATO për Operacione Speciale, Botimi A Version 1, Agjencia e Standardizimit të NATO-s, Dhjetor 2013.

teknika taktike, pajisje dhe trajnime, të kryera shpesh në kushte armiqësore, të mohuara ose politike.⁸ Një term i veçantë “*operacion special ushtarak*” nuk është krijuar apo përdorur në asnjë aleancë apo botim kombëtar.

Operacionet speciale kryhen nga forcat speciale, jo vetëm nga ushtria

Forcat speciale janë caktuar për të kryer operacione speciale. Si rregull, këta janë të caktuar elementë aktivë ose rezervë të organizuar, të trajnuar dhe të pajisur posaçërisht për të kryer dhe mbështetur operacione speciale. Operacionet speciale shpesh kryhen në kushte armiqësore, një mjedis “i mohuar” ose politikisht i ndjeshëm për të arritur objektiva ushtarake, diplomatike, informative dhe/ose ekonomike duke përdorur aftësi të tilla ushtarake që nuk kërkojnë normalisht nga forcat konvencionale. Ato mund të kryhen në mënyrë të pavarur, në bashkëpunim me forcat konvencionale ose organizata të tjera qeveritare, mund të përfshijnë operacione të kryera nga/ose nëpërmjet forcave ose përfaqësuese. Operacionet speciale janë të zbatueshme në të gjithë spektrin operacionet ushtarake që përfshijnë një gamë të gjerë detyrash të ndryshme, të cilat përshkruhen në rregulloret përkatëse doktrinarë. Ato ndryshojnë nga operacionet konvencionale në shkallën e rrezikut fizik dhe politik, teknikat operacionale, metodat e përdorimit, pavarësinë nga vetëmbështetja, varësia nga inteligjenca e përdorimi i mjeteve dhe burimeve të popullsisë vendase. Një tipar tipik i operacioneve speciale është natyra e tyre që kërkon kohë, fshehtësia, d.m.th. duke vepruar në të ashtuquajturën zonë gri – një mjedis konfliktesh të armatosura të brendshme, trazirash dhe tensionesh. Në këtë mjedis, forcat speciale sjellin vlerën më të lartë të shtuar brenda aftësive të tyre specifike dhe raportit çmim, performancë, përfitim.

Nga përshkrimi i mësipërm dhe qëllimi i operacioneve speciale është e qartë, forcat speciale drejtojnë ose mbështesin këto operacione. Pra, nuk ka asnjë lidhje në kuptimin e “*operacioneve speciale ushtarake*”. Nga këndvështrimi i Federatës Ruse, është ndryshe kur agresioni në Ukrainë paraqitet dhe publikohet me një sinonim “*operacion special ushtarak*”. Në pamje të parë, mund të duket se ky term është pothuajse identik dhe duket si një sinonim i mundshëm për atë që është karakteristikë e operacioneve të forcave speciale. E vërteta është se kuptimi dhe mbrojtja ruse e konceptit të operacioneve speciale, domethënë, më saktë “operacionet speciale ushtarake” janë diametralisht të kundërta.

Koncepti rus i “Operacionit Special Ushtarak”

Siç u përmend, nuk ka asnjë përshkrim doktrinar të termit “*operacion special ushtarak*” për të treguar kontekstin e tij të përgjithshëm ose specifik. Në varësi të mënyrës se si shpjegohet dhe paraqitet ky term në Rusi, ai mund

⁸ DOD Dictionary of Military and Associated Terms, f. 199.

të përmblihet si pyetje gjeopolitike, ushtarako-strategjike, teoriko-ushtarake dhe të tjera që udhëheqja ruse përpiqet t'i imponojë popullatës së saj.

¹ Ballkani Perëndimor është një grup vendesh që janë në qendër të politikës së zgjerimit të BE-së. Ky grup fillimisht përbëhej nga Shqipëria, Kroacia, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina, Serbia dhe Kosova. Kroacia u bashkua me Bashkimin Evropian në vitin 2013 dhe për këtë arsye nuk është më në këtë grup nga politika e BE-së në Ballkanin Perëndimor

një komunitet që ndajmë jo vetë vlera të njëjta të përbashkëta por që marrim përsipër edhe përgjegjësi dhe ndajmë barrën e pasojave midis nesh. Me rëndësi mbeten edhe përpjekjet për krijimin e kapaciteteve ndër rajonale mbi platformat smart, sidomos për investimet e përbashkëta në fushën e mbrojtjes, mjedisit, emergjencave civile etj.

Ky punim mund t'iu vijë në ndihmë stafit akademik për të pasuruar sado pak literaturën në lidhje me tematikat e marrëdhënieve ndërkombëtare apo ato që lidhen me analizën e ndryshimeve të mjedisit të sigurisë e veçmas ato që lidhen me zhvillimet e rajonit tonë.

Fjalë kyçe: NATO, BE, Ballkani Perëndimor, Rusia, Ukraina, Kina, Kosova, Shqipëri, Maqedonia e Veriut, Mali Zi, Serbi, mjedis sigurie, kapacitete kombëtare, agresion ushtarak, krizë energjetike, financiare etj.

Hyrje

Ky punim ka si objektiv të nxjerrë në pah shkaqet e agresionit rus ndaj Ukrainës dhe të analizojë pasojat që ai ka përhapur jo vetëm në rajonin euroatlantik dhe atë botëror, por edhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor, i cilësuar për shekuj si “fuqi baruti”², apo si një “brez përplasje”³ implikimet e mundshme duke shfrytëzuar edhe kontradiktat dhe mosmarrëveshjet ekzistuese dhe pasojat që ato mund të kenë mbi mjedisin e sigurisë duke rrezikuar paqen dhe stabilitetin në rajon, duke ndërprerë, devijuar apo rritur koston e agjendës integruese të rajonit në institucionet euroatlantike e organizmat e tjerë ndërkombëtarë.

Implikimet e këtij konflikti apo “*operacioni special ushtarak*”, siç e quajnë vetë autoritetet politiko-ushtarake ruse që po rezulton në një agresion barbar mbi pronën dhe jetën e popullsisë së pafajshme civile me shkatërrime të tmerrshme të infrastrukturës kritike veçmas asaj energjetike e shoqëruar nga krime monstruoze për jetën e popullsisë në tërësi. Ky konflikt vazhdon të ushtrojë presion të shtuar e shumëfishtë mbi rajonin tonë, ndikimi më i ndjeshëm shihet në marrëdhëniet mes shteteve të rajonit e sidomos ecurinë e bisedimeve apo tensionimit të vazhdueshëm të situatës në Kosovë e manipulimin e serbeve që banojnë atje, B&H i tendencat separatiste të Republikës Serbska, Mal të Zi mosmarrëveshje institucionale trazira sociale, pa përjashtuar edhe tre vendet e tjera Shqipëri, Maqedoninë e Veriut subversion e veprime destabilizues, dhe në Serbi ndjenja pro Rusisë e politikave luftënxitëse të Putinit dhe fryme anti - NATO-s dhe antiperëndimore.

² Bashkurti, Lisen; Ballkani, “fuqi baruti” i Evropës. Burimi elektronik: <https://www.epokaere.com>

³ Saul Bernard Kohen, Geopolitics: the geography of international relations; viti 2014, f.36-44.

Në çështjen e fundit jepen disa përfundime dhe rekomandime mbi mundësinë e përfundimit të konfliktit faktorët që ndikojnë në këtë drejtim, si dhe rrugët dhe mjetet që duhet të shfrytëzojë rajoni tonë për çuarjen përpara të agjendës integruese, prosperitetin ekonomik dhe ç ‘tensionimin dhe relaksimin e marrëdhënieve ndërshtetërore e në mënyrë të veçantë mes Kosovë dhe Serbisë, zgjidhjen e mospajtimeve për qeverinë e re në Mal të Zi, largimin e serbëve të Bosnjës nga axhenda e tyre separatiste, dhe presionin e shtuar ndaj Serbisë për një politike të jashtme të unifikuar me relaksimin e marrëdhënieve me Kosovën dhe avancimin e axhendave integruese drejt BE.

Agresioni rus në Ukrainë, ngjarja më e rëndësishme gjeopolitike e kohës

Agresioni ushtarak rus ndaj Ukrainës vlerësohet si ngjarja më e rëndësishme gjeopolitike në botë që nga 22 shkurti i vitit 2022. Ajo tashmë ka qenë dhe mbetet në krye të axhendave dhe nismave më të mëdha të fuqive dhe organizmave globalë, subjekti më i diskutueshëm sot në nivel botëror, si dhe është ngjarja që ka mbivendosur një sërë krizash njëra mbi tjetrën, me pasoja të pallogaritshme për sigurinë, ekonominë, për jetën në tërësinë e saj. Ka argumente të shumta për shkaqet e krizës, por ajo që mund të sjellim nga studimet dhe analizat e ndryshme vlerësohen si shkaqe historike, gjeopolitike, kulturorë, ekonomike, territoriale dhe ushtarake por pse jo edhe ambicie personale të lidhshpimit aktual rus etj.

Nga një këndvështrim tjetër është thjesht kontradikta në botëkuptimet që përfaqësojnë dy vendet Ukraina vokacion perëndimor dhe rusët lindorë (liberalizëm demokratik – autokraci), se si i shohin sot zhvillimet e qytetërimeve aleancave dhe tendencave perëndimorë dhe lindore në një koncept të gjerë dhe shumë planesh.

Për më tepër në këtë konflikt zë një peshë të madhe specifike mendimi se konkurrenca Lindje - Perëndim dhe tendencat e shtrirjes së NATO-s në kufijtë e Rusisë ka qenë indikator kryesorë i konfliktit Rusi – Ukrainë.

Në vazhdim këtu mund të shtojmë edhe filozofinë predominante se Rusia është e paplotë dhe nuk mundë të zotërojë kapacitete të një lojtari global pa Ukrainën dhe tendencat e saj për integrim euroatlantik do të varrosnin përgjithmonë ëndrrën për ribërjen e perandorisë së re Ruse putiniste. Analiza ruse pas kuotave apo ajo e nëndheshme ka dalë në pah prej kohësh se Rusia në vetvete nuk është as superfuqi diplomatike, as ekonomike, as financiare dhe aq më pak demografike përveç asaj ushtarake që së fundi po luhate edhe këtë realitet për shkak të efektivitetit të demonstruar në konfliktin në fjalë.

Në këtë mega-lojë, nëse mund të themi, nuk është vetëm aq sa duket konflikt

mes Rusisë dhe Ukrainës shume analistë dhe njohës të këtij procesi e vlerësojnë si një konflikt mes qytetërimit perëndimor dhe mbrojtësve të tij nga njëra anë dhe vendeve autoritare që në këtë rast përfaqësohen nga Rusia.

Këto e ngjarje të tjera të mbështetura nga edhe Kina dhe aktorë të tjerë por edhe të stimuluar nga një tërheqje e shpejtë dhe disi kaotike të Perëndimit nga Afganistani mund të vlerësohen si një shtysë tjetër në këto zhvillime. Sidoqoftë lufta vazhdon NATO, BE dhe SHBA, kanë krijuar një koalicion të quajtur “Grupi për Mbështetjen e Ukrainës”, duke demonstruar qëndrueshmëri, unitet dhe kohezioni të jashtëzakonshëm, që në sinergji me vullnetin dhe sakrificat e heroizmin e pashoq të Ukrainasve do triumfojnë mbi këtë të keqe të madhe dhe do të hapë rrugën e zhvillimit dhe prosperitetit të Ukrainës dhe do çlirojë perëndimin nga krizat e mbi palosura të energjisë dhe asaj financiarë e ekonomike në tersi.

Agresioni rus si kudo ka ashpërsuar marrëdhëniet mes Perëndimit dhe Rusisë por veçmas vendeve të vogla ballkanike natore të NATO-s dhe saj, duke i shpallur ato vende jo mike me përjashtim të Serbisë, bëjmë fjalë për vendet e Ballkanit Perëndimor. Në këtë kontekst nën kërcënim të hapur ka qenë Kosova nga trazirat, në rrugë dhe ato politike të tërheqjes së administratës dhe politikës që përfaqëson lista serbe në kuvendin e Kosove, tendencat destabilizuese në Mal të Zi e ato separatiste në Republikën Serbska në Bosnje-Hercegovinë.

Ballkani Perëndimor dhe ndikimi i konfliktit Rusi - Ukrainë

Ballkani Perëndimor (BP), një nocion i ri gjeopolitik i krijuar pas rënies së “Murit të Berlinit”, që i bën një lloj karshilleku Ballkanit Gjeografik, pjesë e të cilit tashmë janë bërë anëtarë të Bashkimit Evropian, ruan ende me fanatizëm karakterin e një minibrezi gjeopolitik përplasje midis interesave dhe ndikimeve të fuqive rajonale, por jo vetëm edhe atyre global, apo siç rëndom jemi mësuar t’i cilësojmë disa të tjera edhe si aktorë të tretë. Rajoni në tersi ka bërë ndryshime thelbësore në kompleksitetin e tij. Rajoni në tërësinë e tij është anëtarësuar në organizmat euroatlantikë ose është në proces të kësaj ndërmarrje kaq jetësore për të pasur një mjedis sa më të paqtë e të begatë për të ardhmen, peshën dhe rëndësinë gjeostrategjike që ai mbarte për vetë kontinentin Evropian.

Aktualisht, 3 nga 6 shtetet përbërëse të tij janë anëtare të NATO-s, konkretisht, Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi, dy të tjerat kanë prezencën ushtarake të NATO-s në vendet e tyre, siç janë Kosova dhe Bosnje-Hercegovina, ndërsa Serbia është një nga anëtarët më të reja të programit “Partneritet për

Page”⁴, bashkëngjitur këtij procesi që në dhjetor të vitit 2006, por specifike për të është se njëkohësisht ka shpallur edhe politiken e saj të neutralitetit ushtarak, pa çka se ruan dhe forcon marrëdhënie të ngushta ekonomike dhe ushtarake me Rusin dhe në territorin e saj është e vendosur një bazë ruse gjoja humanitare por tashmë e vërtetuar katërcipërisht se është ushtarak.

Për më tepër vendet e rajonit janë jo vetëm të përfshira por kanë bërë një progres të dukshëm në rrugën drejt Bashkimit Evropian, konkretisht Serbia, Mali i Zi, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut kanë kaluar etapat përgatitore dhe kanë hapur negociatat me BE-në, pra 4 nga 6 shtetet e këtij rajoni, ndërkohë Bosnja-Hercegovina është njohur me statusin e vendit kandidat për hyrje në 2022 dhe vendi i fundit Kosova ka bërë kërkesën formale t’i bashkohet Unionit më 14 dhjetor 2022, firmosur nga presidentja Vjosa Osmani.

Gjeopolitikisht, specifike në rajon mbetet Serbia, që nga njëra anë ka bërë hapa të vlerësuar në rrugën e anëtarësimit në Bashkimit Evropian, e cila është në një stad me të përparuar se vendet e tjera të rajonit në këtë proces, por nga ana tjetër pa ndonjë interes të shtuar për anëtarësimin në NATO. Përveç sa theksuam më lart, ajo vazhdon të mbajë lidhje të ngushta diplomatike, ekonomike, ushtarake e kulturore me Rusinë nga ana tjetër, pra duke tentuar të ulet në dy karrige njëkohësisht. Në të njëjtën kohë, Ballkani është kthyer në një arenë ku Bashkimi Evropian është përballur me aktorë të tjerë gjeopolitikë si Rusia, Kina, Irani të cilat mbrojnë synime dhe platforma ekspansioniste të tyre me theks të ndryshëm por qëllime të njëjta si në fushën diplomatike ekonomike, financiare, energjetike, ushtarake, teknologjike, kulturore etj.

Ballkani Perëndimor mban mbi kurriz edhe një numër të konsiderueshëm mosmarrëveshesh dypalëshe mes vendeve të ndryshme të tij. Gjendja mbetet problematike, duke pasur parasysh se bashkëpunimi rajonal dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë përbëjnë kushtet bazë dhe standardet kryesore të procesit të zgjerimit të Bashkimit Evropian. Mosmarrëveshjet në fjalë mund të ndahen afërsisht në tre kategori: “Mosmarrëveshjet mbi territorin, mosmarrëveshjet për të drejtat e minoriteteve, si dhe grindjet që kanë të bëjnë me politikën ndërshtetërore.”⁵

Kërcënimet që vijnë si pasojë e agresionit rus bëhen më akute për shkak të një shtrati miqësor nga disa aktorë vendimmarrës të brishtë në rajonin tonë të kombinuar e duke shfrytëzuar edhe falangat e saj shtetërore dhe joshtetërore

⁴ Partneriteti i NATO-s ka filluar në vitin 1990, kur në Samitin e Londrës, NATO u zotua të zgjasë dorën e miqësisë ndaj ish-kundërshtarëve të saj të Luftës së Ftohtë. Programi i Partneritetit për Page filloi në vitin 1994. Shqipëria është vendi i parë që ka aplikuar në këtë program, më 23.02.1994. Nga rajoni i BP, Kosova nuk është pjesë e këtij programi. Burimi elektronik: https://www.nato.int/topics/50349_

⁵ Stanislav Secieru, “*Rusia in the Western Balkans*”, EUISS, 2019, f. 2.

të instaluar sidomos në Serbi, Republika Serbska, Veriun e Kosovës, pa anashkalluar e nënvleftësuar këtë ndikim edhe në zonat tjera të rajonit, si Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi dhe në ndonjë rast edhe vendin tonë, siç rezultojë ngjarja e fundit vitin të kaluar me sulmin e një grupi me përbërje shtetas rus ndaj uzinës së armëve në Çekin të Bashkisë Gramsh.

Në këtë punim, kryesisht do të përqendrohem te ndikimi aktual rus në rajonin e BP, pasi përhapja e krizës në rajonin tonë është interes parësor e kësaj të fundit për momentin me qëllim që duke shkaktuar një krize tjetër në zonën euroatlantike, zbeh vëmendjen, shpërqendron angazhimin e perëndimit ndaj rajonit tonë, por ajo që është jetike tani minimizon cilësinë, sasinë dhe produktivitetin e ndihmës së gjithanshme të perëndimit për Ukrainën.

Ballkani Perëndimor është më i lakmuari prej saj edhe për qëllimet dhe synimet e saj gjeopolitike të daljes në detet e ngrohta nga ky drejtim, duke vlerësuar se edhe mjedisi i sigurisë është më i brishtë si shkak i mbizotërimit të ndasive dhe problematikave të pazgjidhura mes vendeve, dezinformimi nga aktoret e tretë, irredentizmi, nacionalizmi, popullzimin shfrytëzimi i pakicave etnike, fetare për të destabilizuar vendet ku ato jetojnë dhe dobësitë e tjera që vijnë si rezultat e keqqeverisjeve, mungesës së transparencës për investimet publike, kapjes së shtetit, korrupsionit kriminel të organizuar, emigrimit masiv dhe largimit të trurit nga këto vende.

Disa ide se po kthehet Rusia në Ballkan nuk janë domethënëse, pasi në kontekstin historik ajo ka ndikuar dhe influencuar në këtë rajon që pas Krizës Lindore, e Kongresit të Berlinit dhe vazhdim, pavarësisht endacakeve të këtyre zhvillimeve. Ndikimi në këtë rajon është sot më i ndjeshëm, pasi influenca ruse nuk është vetëm një alibi, por ajo ka prezencën e vet ushtarake në rajon, pavarësisht pretendimeve për një stacionim të natës humanitare ka fakte të pakundërshtueshme për trupa ushtarake të zbulimit kryesisht por edhe me detyra të tjera specifike të karakterit jo humanitare në qytetin juglindor të Nishit në Serbi. Në fushën e vështirë të sigurisë në Ballkanin Perëndimor, Rusia vendosi heshtje për unipolaritetin e krijuar, ajo hoqi dorë nga përgjegjësia për policimin e rajonit ndaj NATO-s dhe BE-së dhe paqeruajtësit e fundit rusë u larguan nga Kosova dhe Bosnja dhe Hercegovina në 2003.⁶

Pas agresionit rus mbi Ukrainë, dezinformimi përçarës dhe diversioni kanë marre ngjyra me të theksuara dhe kudo në Ballkan ndihet kjo frymë, në radhe të parë politika ruse akuzoj se shqiptarë nga rajoni po marrin pjesë në luftime në Ukrainë si mercenare e veçmas sipas tyre nga Shqipëria dhe Kosova, në Mal të Zi po nxiti dhe vazhdon të mbështes elementët destruktiv dhe trazira për të destabilizuar shtetin atje, në Maqedoninë e Veriut me

⁶ Stanislav Secieru, “*Rusia in the Western Balkans*”, EUISS, 2019, f.4

dhjetëra dezinformime dhe sinjale për vendosje bombash nëpër shkolla dhe institucione e tjera shtetërore dhe publike janë raportuar kohë të fundit duke terrorizuar popullatën, për të gjitha këto ka indikatorë të dukshëm se kanë dorën e fshehtë të shërbimeve sekrete të Federatës Ruse. Kësaj klime i është mbivendosur edhe ndikimi i aktorëve të tjerë sidomos ai i sulmeve kibernetike të kohëve të fundit ku më të ashprat ishin ato ndaj Shqipërisë, pa lënë jashtë vëmendjes edhe Kosovën e Malin e Zi e Maqedoninë e Veriut por edhe Serbin të cilat ishin gjithashtu subjekte të këtyre sulmeve.

Sipas një hetimi të thelluar dhe në bashkëpunim me vendet aleate e kryesisht SHBA, vërtetohen se ato kishin si origjine Republikën Islamike të Iranit, por në disa raste edhe nga Rusia apo ndonjë vend tjetër që ndjek politika përçarëse në kohezion me këto dy të parat. Këtij spektri të gjerë e shumërolesh kërcënimesh destabilizuese u mbivendosen edhe propaganda përçarëse, dezinformimi nxitja e konflikteve me baze etnike e fetare, sabotazhi, diversioni, veprimtaritë agjenturore, kriza e financiare, inflacioni gjithnjë e në rritje, kriza energjetike, ajo ushqimore dhe rreziku nga epidemitë dhe sëmundjet infektive, korrupsioni, krimi i organizuar etj. Mjedisi aktual i sigurisë i mbingarkuar nga një gamë e gjerë faktorësh fenomenesh shqetësuese vjen ndërkohë në përkeqësim edhe për shkak të trusnisë nga konfliktit Rus - Ukrainë, e nxitur dhe koordinuar nga Rusia dhe aleatët e saj, ndaj vendeve jo mike, siç janë nominuar tashme prej saj vendet tona të rajonit me përjashtim të Serbisë.

Qasje të tilla kanë si qëllim dhe synojnë të krijojnë destabilitet në këto vende me pasoja të paparashikueshme për të ardhmen e rajonin tone të BP e më gjere, duke hapur një vatër tjetër konflikti që detyron angazhimin e aleancës Veri - Atlantike në menaxhimin e saj, e për pasojë largon jo vetëm vëmendjen nga krimet dhe masakrat që po shoqërojnë konfliktin e armatosur rus ndaj Ukrainës, por njëkohësisht edhe të s'balancoje përpjekjet perëndimore të ndihmës dhe mbështetjes aq të ngutshme dhe domosdoshme për Ukrainën që të përballet me agresionin rus dhe që të mbroje territorin e të rikthejë atë të humbur për momentin. Nga ana tjetër të përhapë frikë dhe shkaktojë kaos dhe në njëfarë mënyre të maskojë dështimet e deritashme në arritjen e objektivave politiko-ushtarake të saj në Ukrainë, duke shpresuar për një ripërtëritje të fuqisë saj goditëse në pranverën e këtij viti për të arrirë objektivin e saj strategjik për pushtimin dhe nënshtrimin e Ukrainës.

Kjo situatë e rënduar e sigurisë po shfrytëzohet nga aktorët dominantë në rajon për t'i fryrë zjarrit të konfliktit e kryesisht këto vijnë nga Republika e Serbisë, dhe ajo Serbska në Bosnje - Hercegovinë, me synim destabilizimin e Kosovës nga njëra ana duke përdorur serbët vendore dhe përfaqësuesit e saj politikë siç është "Lista Serbe", dhe duke nxitur frymën nacionaliste dhe tendencat separatiste në republikën Serbska, pa anashkaluar edhe presionin ndaj Malit të

Zi, Maqedonisë së Veriut dhe vendit tonë gjithashtu.

Këto ngjarje në thelb destabilizuese kanë si mbështetje dorën e fshehtë të Rusisë dhe aktoreve të tjerë që kanë një kohezion me të në politiken e saj antiperëndimore të inspiruar nga platforma “Bota Ruse”, shëmbëlltyra e saj “Bota Serbe”, në Serbi një rizgjim i përpjekjeve shekullore për dominim mbi popujt e tjerë fqinjë e veçmas shqiptar. Kohët e fundit kemi parë një korrelacion midis presionit në rritje për destabilizimin e Kosovës nga njëra anë dhe nga ana tjetër edhe protesta pro ruse në Beograd ku linçohet veçmas presidenti i Ukrainas Zelensky si një terrorist i NATO-s, “Zelensky NATO ’s Terrorist”, duke i shkuar për filli politikës filo - ruse e duke theluar ndarjet nga kohezioni perëndimor në mbështetje të luftës së drejte të Ukrainasve dhe lidërshiptit të spikatur, frymëzues dhe i pashoq i Presidentit Zelensky që ka fituar admirimin e gjithë Botes demokratike dhe jo vetëm asaj perëndimore e popullit të tij.

“Bota Serbe”, sot përfaqëson “Naçertanjen Moderne”, të Ilija Garashanit në kushtet moderne, të aplikuar në vitet nëntëdhjetë nga kasapi i Ballkanit Slobodan Millosheviçi, ku nën platformën të “gjithë serbet në një shtet”, shkaktoj konfliktin ma të përgjakshëm në Evropë pas luftës së Dytë Botërore dhe la fitilin ndezur të cilit po përpiqen ti venë përsëri zjarrin ish bashkëpunëtorët e tij me “fytyrë të re”, për destabilizimin e rajonit. Kjo platformë e “luftës speciale” ka shërbyer si plan program i Pashiqit, Krajl Nikollës, Çubrilloviqit, Andriqit, Rankoviqit, Mugoshas, Tempos, Joviqit, Trajkoviqit, Millosheviqi. Plani “Neçertanie” i krijuar nga Ilia Garashanini ishte një platformë që synonte shfarosjen e shqiptarëve si dhe aneksimin e shumë territoreve të Ballkanit si (B&H, Mali i Zi, Shqipëria Veriore).⁷

Përkeqësimi i mjedisit të sigurisë nga verimet e përsëritura destabilizuese të kohëve të fundit në Veriun e Kosovës e kanë origjinën tek platforma “Bota Serbe”, e nxitur nga Beogradi dhe e mbështetur nga Rusia dhe shërben si një shembull ku serbet në veri në rrethana të reja po shëmbëllojnë me rajonin separatist të Donbasit në Ukrainë, për të krijuar kushtet për një konflikt të ngrirë dhe situatë destabilizuese në Republikën e Kosovës. Jo pa adrese dhe e paplanifikuar është pretendimi i presidentit Vuçiç për stacionimin e trupave të tij në Kosovë mbështetur në Rezolutën e 1244 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, dhe duke provokuar Kosovën dhe NATO-n pra trupat e KFOR-it, për konflikt të hapur dhe duke nxitur në këtë mënyrë destabilitet në rajon e më gjerë me pasoja të paparashikueshme e që i shkojnë kaq shume për fill asaj çfarë po përpiqet të mbjellë aleanca sllavo ortodokse me Rusinë

⁷ Dr. Besnik Bardhi, Historia mësohet për t’u mos harruar kurrë, Wikipedia, enciklopedia e lire, qershor 22, pasqyra nr. 66.

inspiruese, mbështetëse dhe drejtuesi në këtë mision fatkeq për të gjithë ne e veçmas Kosovën.

Si në rastin e konfliktit në Ukrainë për analogji serbet pretendojnë për Kosovën gjera të paqena dhe pa fakte, por ngjarje të sajura apo te përfituara nga padrejtësitë shekullore që janë bërë popullit Shqiptare të Kosovës për mbi një shekull që në vigjilje të Kongresit famë keq të Berlinit deri në vitin 1999, kur fale sakrificës dhe gjakut të derdhur nga bijtë dhe bijat e saj më të mirë dhe mbështetjes së fuqive perëndimorë e demokratike, veçmas SHBA-ve, fitojë lirinë duke realizuar kështu ëndërron e saj shekullore, për një shtet të pavarur, demokratik e të lirë, ku mbrohen në mënyrë të barabartë të drejtat dhe liritë e çdo individi, pronën dhe dinjitetin njerëzor pavarësisht përkatësisë fetare etnike, respekton fqinjët e ndërton dhe mban lidhje të palëkundur me vendet demokratike perëndimore e SHBA-në para së gjithave.

Rrënjët e konfliktit mund t'i vlerësojmë nga etnike, fetare, deri tek lakmitë për burime ujore energjetike, pasuri të tjera nëntokësorë, territore, për dominim apo krijimin dhe ruajtjen një vatre të një konflikti të ngrirë aq të dëmshëm dhe papranueshëm më objektivin strategjik të Evropës së Bashkuar se pa Ballkanin Perëndimor ajo është e paplotë gjeografikisht, dhe e pa unifikuar politikisht dhe më e dobët ekonomikisht.

Retorika me një gjuhë të papranueshme, informacionet de informuese dhe përçarëse, nënvlehtësimi deri tek nxitja në raste të veçanta e urrejtjes nacionale veçmas ajo ndaj shqiptareve e instrumentalizuar dhe mbështetur nga media serbe, qarqet nacionaliste e deri tek udhëheqësit politikë që e quajnë Kosovën në vijimësi “Kosovo e Metohia” dhe jo në emrin e saj juridik, paçka se ata e kanë të qartë se Republika e Kosovës edhe nën juridiksionin e ish-Jugosllavisë është quajtur Krahina Autonome Socialiste e Kosovës dhe ka qenë element konstituiv i ish-Federatës Jugosllave gjendje e cila i sigurohej një status të barabartë në shumë fusha me ato të republikave tjera jugosllave.

Pra, siç shihet Kosova nuk vjen nga hiç dhe nuk mund të mohohet as emri dhe as kontributi i saj shtet formues, as në kontekstin historik dhe as atë aktual të vlerësuar edhe nga “Gjykata e Drejtësisë Ndërkombëtare”, që përcaktoi se “Deklarata e shpalljes së pavarësinë së Kosovës është në përputhje të plotë me të drejtën ndërkombëtare”. Ngjarjet e ndodhura në Veriun e Kosovës dhe përgjatë kufirit mes saj dhe Serbisë në mënyrë të përsëritur, por veçmas ato gjatë vitit që lamë pas treguan për mungesë të vullnetit nga pala serbe për të vënë në zbatim marrëveshjet e firmosura në Bruksel prej kohesh, veçmas ajo në lidhje me targat e makinave të banoreve serbë që banojnë në Kosovë. Pala serbe jo vetëm që nuk u përgjigj por projektoi dhe realizoi dy here me radhe, instrumentalizimin e të ashtuquajturve serbë të Veriut të Kosovës, konkretisht

ata të Zubin Patokut, Leposaviqit, Zverçanit dhe Mitrovicës se Veriut, dhe njëkohësisht kërcënoi me përdorimin e forcës ushtarake ndaj Kosovës duke bërë demonstrime force në kufirin me Kosovën të shoqëruar dhe mbështetur edhe nga diplomat rus e persona të armatosur me simbole ruse e të grupit famëkeq të mercenarëve Wagner. Në këto veprime destabilizuese ka informacion se është edhe dora e shërbimit ushtarak rus GRU, pjesëtares e së cilës janë të instaluar në të ashtuquajturën qendër për asistencën humanitare në qytetin jugor serb të Nishit, që të gjitha gjasat tregojnë se vetëm e atillë ajo nuk është.

Ngjarjet e dhjetorit që pasuan vendimin e qeverisë së Kosovës për fillimin e zbatimit të marrëveshjes për targat pas një shtyrje me ndërhyrjen e BE-SHBA-ës, acaroi më tepër situatën konfliktuale. Situata kulmoj me tërheqjen e të gjithë administratës policore gjyqësore, pushteti lokal etj., të serbëve të Kosovës nga institucionet dhe lënies së mandateve nga lista serbe.

Caktimi i datës së zgjedhjeve për pushtetin lokal në katër komunat me shumicë serbe në veri nxiti akte dhune ndaj qendrave të komisionit zgjedhor dhe njëkohësisht reagimin e institucioneve duke arrestuar një ish drejtues policie nga të dorëhequrit, me akuza për veprime terroriste dhe sulme ndaj institucioneve. Në kundërveprim të masave të qeverisë, serbët në veri me një plan të detajuar në mënyrë progresive vunë barrikada në rrugët lidhëse që të çojnë në Bërnjakë dhe Jaranë dy pikat kryesore të kufirit tokësor që lidhin Kosovën nga drejtimi verior me Serbinë, duke përkeqësuar edhe më shumë situatën e sigurisë veçmas në këtë zonë të territorit të Kosovës i banuar me shumicë nga Serbet.

Veprimet pasuan me retorika nga të dyja palët, nga heqja me forcë e barrikadave në veri deri tek kërkesat e palës serbe për tu vendosur në Kosovë rreth 1000 trupa ushtarake, duke shfrytëzuar një klauzole të “Rezolutës 1244 të Këshillit të sigurimit të OKB-së”, gjë e cila u refuzua nga vendet perëndimore dhe Komanda e KFOR-it, pavarësisht se të gjithë e dimë se KFOR-i është ai që ka si mision të sigurojë lëvizjen lirë në territorin e Republikës së Kosovës, dhe deri diku po i bëhej karshillëk këtij të fundit me sjelljet agresive nga ana e Serbisë duke demonstruar forcën ushtarake në kufi, dhe kërkesës së Qeverisë së Kosovës për largimin e menjëhershëm të barrikadave nga Forcat e KFOR-t.

Faktet se barrikadat u hoqën nga vetë serbet pas bisedave të Presidentit serb Vuçiç me përfaqësuesit e Serbëve të veriut të Kosovës tregon se çdo gjë është e dirigjuar nga Beogradi dhe se serbët e Kosovës po përdoren për agjendat nacionaliste, pushtet personal, dhe në thelb jo vetëm në dëm të Kosovës por edhe vetë serbeve që jetojnë në këtë vend.

Ngjarja tjetër e ndodhur në Shtërpecë qytet në Kosovën Jugore i banuar nga serbët është si rrjedhojë e kësaj psikologjie, pasi edhe atje ngjarja ka si

shkak kryesore bllokimin e rrugës dhe presion ndaj kalimtareve në këtë rast shqiptarëve, që përfundoj me një ngjarje që askujt në Kosovë nuk i shkon përshtat, me përjashtim të falangave serbo – ruse për ta trajtuar rastin si konflikt etnik dhe për të paraqitur një tablo sigurie që gjoja rrezikon serbët në Kosovë. Kjo gjë nuk qëndron dhe as që ka pasur apo ka një platformë të tillë që inspirohet dhuna sipas pretendimeve serbe nga shumica shqiptare në Kosovë dhe politika e saj në veçanti për asnjë pakicë dhe aq më tepër për atë serbe, e cila gëzon të drejta të pakrahasueshme me pakicat tjera në rajon edhe sikur të krahasohet me atë të shqiptarëve që jetojnë në Luginën e Preshevës si pjesë territoriale e Republikës së Serbisë, ku organizohet shpopullim me metoda administrative të motivuara etnikisht kundra shqiptarëve të kësaj treve.

Duke analizuar me realitet dhe në mënyre kronologjike ngjarjet në veriun e Kosovës që nga tentativat për futjen e një treni në veri të tejmbushur me piktura kishtare, simbole nacionaliste e me mercenarë e deri tek sulmet dhe bllokatat në Jerine, Bërnjake dhe Mendarë kohet e fundit që kulmojnë me tërheqjen nga parlamenti dhe institucionet të pjesëtareve të listës serbe nga parlamenti i Kosovës dhe pjesëtareve të tjerë të policisë e administratës gjyqësore dhe shoqërimi me vendosjen e barrikadave në mënyrë të përshkallëzuar nëpër rrugët që të çojnë drejt pikave kufitare të veriut që lidhin Kosovën me Serbinë arrihet në një konkluzion se Serbia po tenton të aplikoje një lloj lufte hibride në nivele mikro në raport me ato që pamë nga ndërthurja ruse në Krime në vitin 2014. Pra flitet për një transplantime të platformave ruse tashmë të njohura si luftë hibride në Ballkan me prioritet Kosovën dhe destabilizimin e saj. Në forma dhe mënyra të tjera kjo lloj sjellje nuk len jashtë kësaj loje edhe rajonet të tjera sidomos Bosnje-Hercegovinën e Malin e Zi dhe diçka më të zbehta këto “valë goditëse” po ndihen në Shqipëri dhe Maqedoninë e Veriut.

Duke vlerësuar rrezikun e përshkallëzimit të situatës kanë reaguar organizmat ndërkombëtare dhe veçmas NATO, BE dhe SHBA-të, për të ulur retoriken e për gjetur rrugë për dialog e ç’ tensionim të situatës.

Për situatën ka reaguar në mënyre shqetësuese veçmas udhëheqësit në Kosovë si Presidentja Vjosa Osmani ashtu edhe Kryeministri Albin Kurti, i cili theksoj se Serbia po zhvillon një lufte hibride ndaj Kosovës. Ai duke folur për shtypin holandez gazetën NCR, theksoi se: *“Njerëzit po sillen me autobus nga Serbia për të udhëhequr barrikadat. Ne kemi prova se këta njerëz të maskuar me shenja të milicisë ruse “Wagner”, Ujqërit të Natës (një bandë ruse motoçikletash besnik ndaj Putinit) dhe të ashtuquajturit Brigadë e Veriut”*.⁸

Marrë shkas nga situata në muajt e fundit zëvendëssekretari i Përgjithshëm

⁸ Albin Kurti: Grupi Wagner dhe Ujqërit e Natës ishin në barrikadat në Veri të Kosovës. Burimi elektronik: <https://newsbomb.al>.

i NATO-s z. Mircea Geoana mirëpriti në selinë e saj të hënën (9 janar 2023) zëvendësndihmëssekretarin e SHBA-së Gabriel Escobar dhe Përfaqësuesin Special të BE-së për “Dialogun Beograd-Prishtinë” dhe çështje të tjera rajonale të Ballkanit Perëndimor, Miroslav Lajčák. Takimi i tyre ishte pjesë e konsultimeve të rregullta për situatën në Kosovë dhe zhvillimet në rajonin e Ballkanit Perëndimor e më gjerë, bashkë me këta të fundit përpjekjeve për vazhdimin e bisedimeve dhe normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi ju bashkëngjiten edhe të dërguarit special të Presidentit Francës, Kancelarit të Gjermanisë dhe Kryeministres Italiane.

Për më tepër në këtë rast zëvendëssekretari i Përgjithshëm Geoană theksoi përpjekjet intensive të kryera nga Aleatët e NATO-s dhe Bashkimi Evropian për të zbutur tensionet e fundit, veçanërisht në veri të Kosovës. Ai gjithashtu nënvizoi mbështetjen kryesore të ofruar nga misioni i KFOR-it të udhëhequr nga NATO dhe misioni i Sundimit të Ligjit (EULEX) i udhëhequr nga BE-ja në çmontimin e suksesshëm të postblloqeve, të cilat kanë ndihmuar në rivendosjen e plotë të lirisë së lëvizjes në mbarë Kosovën.⁹

Në fokusin e ngjarjeve shqetësim është implementimi i marrëveshjeve të firmosura, sidomos për palën Kosovare zbatimi i marrëveshjes për krijimin e “Asociacionit të komunave me shumice serbe”, e firmosur nga pala Kosovare por që Gjykata Kushtetuese e Kosovës e ka vlerësuar në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Në këtë kontekst i dërguari i posaçëm i SHBA-së, Gabriel Escobar ka thënë në një intervistë për “Radion Evropa e Lirë” në muajin dhjetor 2022 se, nëse Qeveria e Kosovës nuk gjen mënyrë për formimin asociacionit, SHBA-ja do të kërkojë “partner alternativ”¹⁰. është tashme e ditur se nga 33 marrëveshjet të firmosura midis dy vendeve në procesin e dialogut dypalësh vetëm marrëveshja që lidhet me “Asociacionin të komunave me shumice serbe”, është gjetur e papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Këtë çështje e trajton edhe analisti i njohur Daniel Server i cili ka theksuar se *“I pari nga paragrafët s’është i mirë meqë dështon t’i referohet Kushtetutës së Kosovës si bazë për marrëveshje konkrete. Po ashtu mungon edhe zgjidhja reciproke për shqiptarët që jetojnë në Serbi, dështimi për të marrë njohje nga pesë shtetet e BE-së është një prishje e marrëveshjes”*.¹¹

Objekt i shqetësimeve të përdorimit të aktivisteve të grupit mercenar Wagner

⁹ Zv. Sek. Përgj. i NATO-s Mircea Geoană: NATO, EU and US consult on development in Kosovo, Western Balkans. Tweeter 09.01.2023.

¹⁰ Gazeta Panorama, dt 25.01.23.

¹¹ Daniel Server: “Versioni i fundit i planit franko-gjerman avancon asociacionin dhe nuk pranon reciprocitet për shqiptarët në Serbi”. Burimi elektronik: <https://www.radiokosovaelire.com>

e paraqiti edhe Këshilltari i Lartë i Departamentit të Shtetit, Derek Chollet kur u shpreh se “Aktivitetet e grupit janë të pa tolerueshme... dhe se Serbia duhet të firmosë sanksionet ndaj Rusisë”.¹² Duke perifrazuar edhe më në detaje ngjarjet e fundit në rajon e veçmas Kosovë, Dr. prof. Lisen Bashkurti thekson se “Prapa hienave të së kaluarës të krahëve serb bashkëngjiten në mënyrë të pashqitshme ambiciet ogurzeza të carëve të Rusisë. Pjetri i Madh dhe Stalini ringjallën nëpërmjet Putinit në kohët tona në çdo ëndërr të Serbisë”.¹³

Në tematiken rreth marrëdhënieve të nxehta e veçanërisht siç është ajo e “Asociacionit të Komunave me Shumice Serbe”, përveç analizës dhe prononcimit të diplomacisë e veçmas asaj Amerikane kemi edhe reagime të figurave elitare të botes intelektuale perëndimore që deri diku i japin shtytje asaj që perifrazohet jo rrallë si teoria e reciprocitetit në marrëdhëniet mes Kosovës dhe Serbisë duke folur për këtë çështje analisti i njohur Amerikan Profesori i Universitetit “Johns Hopkins”, Daniel Serwer theksoi se “Kosova është një mbështetëse e fortë e perëndimit në përgjithësi, e SHBA-së në veçanti dhe se dëshiron të jetë anëtare NATO-s”¹⁴ dhe në vazhdim të analizës rreth marrëdhënieve Kosovë-Serbi, theksoi “Ku është asociacioni i komunave me shumicë shqiptare brenda Serbisë, ku janë përfaqësuesit, vendet rezervë për shqiptarët në parlamentin serb”?¹⁵.

Në analizën e ngjarjeve vlen të sillet në vëmendje edhe vlerësimi i analistit, diplomatit të sigurisë së rajonit tonë Shaban Murati ku në analizën e tij sjell në vëmendjen tonë se as Vuçiçi, as Daçiçi dhe as garnitura nacionaliste politike, ushtarake, diversioniste serbe, që kanë pushtetin në Beograd, nuk kanë ndryshuar. Presidenti Serb Vuçiç po zbaton programin kriminal të Millosheviçit, “të gjithë serbët e rajonit në një shtet”, që i ka vënë tani emrin “Bota Serbe”¹⁶. Në këtë vijimësi edhe përfaqësues nga serbët e Kosovës siç është Ministri për Komunitetet në Qeverinë e Kosovës Rasiç, ka theksuar se, “duhet të analizohen edhe rekomandimet e “Gjykatës Kushtetuese të Kosovës”, për harmonizimin e asociacionit me Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës”.¹⁷

Deputeti serb Pavle Gerboviç, kryetar i “Lëvizjes së Qytetarëve të Lirë”, në

¹² <https://www.cox.com. News ap e US. State Department Counselor Derek Chollet>

¹³ Prof. Dr. Lisen Bashkurti. Serbo –Rusie e kaluara që rron. Facebook 16.01.2023.

¹⁴ Profesor Daniel Serwer, universiteti Johns Hopkins “emisioni special”, agjensia GENEL By BLUETV 28 July 2022

¹⁵ Po aty.

¹⁶ Shaban Murati “Qëndrimi dinjitoz i Kroacisë ndaj Serbisë, mësim i madh për shqiptarët”; 12.01.23

¹⁷ Gazeta Panorama dt 25.01.23.

forumin ballkanik me temën “Quo vadis Balkans?”, (Çfarë jeni duke bërë në Ballkan?), të organizuar në 10 qershor 2022 deklaroi: “Serbia ka çështje të hapura politike me pothuaj të gjithë fqinjët e saj. Marrëdhëniet e Serbisë me vendet e tjera në rajon nuk mund të jenë të mira, nëse Serbia i trajton ata si pjesë e territorit të saj dhe jo si fqinjë.”¹⁸

Në këtë kontest duhet vlerësuar edhe asociacioni i komunave më shumicë serbe, pasi 10 komuna pothuajse një etnike që shtrihen nga veriu në qendër, lindje dhe jugë të Kosovës përbëjnë 124.300 njerëz ose 6.63% të numrit të përgjithshëm të popullsisë së Kosovës prej rreth 1.873.000 njerëzish dhe shtrihen në 1.709 km² ose 15.6 % të sipërfaqes së përgjithshme të Kosovës prej 10.887 km². Në të ardhmen pa një siguri të faktorit ndërkombëtar ku mundë të jetë një aktorë që destabilizon Republikën nëse shpreh sjellje shëmbëlltore të krahinave lindore të Ukrainës krizë të cilën Rusia po tenton t’i zhvendosë drejt Ballkanin Perëndimor.

Duke parë situatën e rënduar për një mijë e një arsye e jo vetëm konfliktit Rusi Ukrainë aktorët kryesore vendimmarrës përëndimorë kanë shtuar presioni për pranimin e të ashtuquajturit drafti franko-gjerman për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi, në fakt pala kosovare kërkon që kjo marrëveshje të këtë në epiqendër njohjen reciproke dhe problemi i asociacionit të jetë pjesë e marrëveshjes, kurse ajo serbe përqendrohet, tek ajo që njohja, asociacioni dhe siguria e serbeve janë vijat e kuqe për Serbinë.

Kështu në datën 4 shkurt, botimi ushtarak qeveritar rus “*Vëzhgimi ushtarak*” në adresën e internetit “*topwar.ru*” sulmonte Britaninë e Madhe për mbështetjen, që po i jep Prishtinës në prapaskenat e tanishme të ndezura diplomatike për “zajdenicen serbe” në Kosovë.” Ja qëndrimi zyrtar, që jep media e mësipërme ruse: “*Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, duke përdorur mbështetjen jozyrtare të Britanisë së Madhe, po saboton krijimin e zajdenicen serbe. Për këtë ai paraqiti edhe gjashtë kushtet për realizimin e saj, të cilat gjithashtu i mbështet Londra*”.¹⁹ Rusia, e cila as që shqetësohet fare për pickim sanksionesh nga një shtet plesht si Serbia, sepse ajo nuk po pyet as për sanksionet e 30 shteteve të BE dhe as për sanksionet e SHBA-së, po ndërhyr në këto tratativa BE-Serbi, direkt dhe indirekt. Diplomacia ruse nxit presidentin serb të luajë teatër diplomatik me kartën e sanksioneve, me strategjinë që të sigurojë nga BE me zajdenicen kontrollin defacto të Serbisë dhe të Rusisë në Kosovë.²⁰

¹⁸ Shaban Murati po aty.

¹⁹ Shaban Murati: Pas “zajdenicen serbe” në Kosovë është Rusia! Burimi elektronik: www.gazetadita.al

²⁰ Po aty.

Përfundime

Parantezë për një përqaasje sa më objektive të këtyre çështjeve sa delikate aq edhe me të panjohura është thënia e gjeneralit dhe teoricienit ushtarak prusian Carl von Clausewitz kur shkruan se: “Një pjesë e informacionit të marrë në luftë është kontradiktore, një pjesë akoma më e madhe është e rreme dhe pjesa më e madhe është e një karakteri të dyshimtë”²¹.

Parashikimi për rezultatet e kësaj lufte dhe implikimet në rajonin tonë është pothuajse i pamundur por disa premisa apo opsione mundë të na çojnë në disa përfundime të përafërta si më poshtë vijojnë:

Agresioni i paprovokuar dhe barbar rus mbi Ukrainën nxitja dhe mbështetja e minikonflikteve të tjera siç janë trazirat në Veri të Kosovës, tendencat separatiste në Bosnje - Hercegovina apo destabilitetit politik në Mal të Zi janë përpjekje të sinkronizuara ruse me aktorët që e mbështesin atë për destabilizimin e rajonit të Ballkanit Perëndimor.

Problematikat, mosmarrëveshjet dhe çështjet e pazgjidhura në rajon të negociohen me transparence e vullnet të mirë në interes ecjes përpara në rrugën e integritetit Euro-Atlantik, duke qëndruar larg retorikës që sjell përçarje dhe eskalim të situatës së brishtë të mjedisit të sigurisë në rajonin tonë

Qendra e rëndësës për një rajon të qetë të paqte e në shina të sigurta drejte BE-së, mbetet relaksimi përfundimtar i marrëveshjeve Kosove - Serbi, dhe heqja dorë e Republikës Serbska nga tendencat separatiste, dhe i gjithë energjia e rajonit të shkojë në interes të agjendës integruese ën BE.

Kosova duhet të konsolidojë qëndrimin e përbashkët të gjithë spektrit politik dhe opinionit të bre ndeshem në kohezion me BE dhe veçmas SHBA-në për vazhdimin e dialogut me Serbinë nëpërmjet një marrëveshje të qenësishme për paqen ku në thelb të përmban njohjen reciproke mes dy shteteve.

Zhvillimi i një platforme të përbashkët veçanërisht Shqipëri- Kosovë, por edhe me vendet tjera të rajonit pavarësisht diferencave në rrugën e zhvillimit e përparimit të shteteve tona, është jetësore njohja e rakordomi i nivelit të zhvillimit, gjendjes së burimeve mundësive potenciale të zhvillimit të të gjitha fushave dhe aplikimi i projekteve të përbashkëta në fushën politike, diplomatike, ekonomike, ambientale, kulturore të trashëgimisë, e deri te fusha e mbrojtjes dhe e sigurisë që mund ta bëjnë rajonin tonë më të paqtë, begatë në radhe të pare për popujt tanë.

Me një mjedis sigurie të relaksuar ofrojmë një rajon më atraktiv ndaj axhendës

²¹ Gjeneralmajor (R) Mick Ryon “Lufta, transformimi ka të bëjë me luften e shekullit të 21-të”.

integruese të BE-së nga ku mund të ketë përfitime të dyanshme në fuqizimin e kapaciteteve jo vetëm kombëtare e të rajonit të Ballkanit Perëndimor, por edhe për zhvillimin, forcimin, prosperitetin dhe stabilitetin e shtuar të vetë Evropës së Bashkuar e cila pa këtë të fundit si pjesë të saj integruese do të mbetet e brishtë, jo e plotë dhe me diferenca në përballje dhe konkurrencën strategjike globale të fuqive të tjera të mëdha në rritje e zhvillim të vazhdueshëm.

Bibliografia:

1. Dr. Besnik Bardhi: “Historia mësohet për t’u mos harruar kurrë”, Wikipedia, enciklopedia e lirë Qershor, 22, pasqyra nr. 66.
2. Joseph Ney Harvard University, 2004, Book Soft Power: The means to success in the World Politics.
3. Shaban Murati: Qëndrimi dinjitoz i Kroacisë ndaj Serbisë, mësim i madh për shqiptarët. 12.01.23, Gazeta Panorama.
4. Prof. Daniel Server: Universiteti Johns Hopkins “Emisioni special” lajme, agjencia Genel By Bluetv 28 July 2022.
5. Saul Bernard Kohen, Geopolitics: the geography of international relations; viti 2014.
6. Stanislav Secrieru, “Rusia in the Western Balkans”, EUISS, 2019.
7. Daniel Server: “Versioni i fundit i planit Franko-Gjerman avancion.” Burimi elektronik: <https://www.radiokosovaelire.com>
8. Lisen Bashkurti, “Ballkani, Fuqi Baruti i Evropës”. Burimi elektronik: <https://www.epokaere.com>.
9. Albin Kurti: “Grupi Wagner dhe Ujqërit e Natës ishin në barrikadat në Veri të Kosovës”; burimi elektronik: <https://newsbomb.al>.
10. News ap e US. State Department Counselor Derek Chollet. <https://www.cox.com>.
11. Zv. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Mircea Geoană: “NATO, EU and US consult on development in Kosovo, Western Balkans”. Tweeter 09 Jan. 2023.
12. Christopher Stevens dhe Jane Kennan, “Reform in Eastern Europe and the Development Country Dimension”, viti 1992.
13. Gazeta Tema 21.10.2021. “Bota Serbe një koncept që nervozon rajonin dhe çfarë thotë Edi Rama?”

OPERACIONET E ARDHSHE: OPERACIONET MULTI DOMAIN

Nënkolonel Msc. Nikolin LAZRI
Forca Tokësore

Trajtesë e shkurtuar.

Ky punim jep një informacion të përgjithshëm në lidhje me operacionet multi domain. Përgatitja e këtij materiali është bërë duke u mbështetur në përcaktimet e Manualit Fushor (MF) të ushtrisë amerikane (FM-3.0), botuar me 1 Tetor 2022, me përdorim të thënieve nga Klauzevitch, Makiaveli dhe Sun Tzu, për të përforcuar argumentet dhe shtjellimet e bëra në material. Ajo që është parashtruar në material është një përpjekje modeste për të ofruar të dhëna bazë mbi operacionet multi domain, pasi koncepti, parimet dhe zhvillimi i këtyre lloj operacionesh mbulojnë një hapësirë të madhe, trajtimi i të cilave kërkon një ekspertizë të veçantë. Ky material nuk është shterues (pyetje të cilat kërkojnë përgjigje, ka me shumicë). Përpjekja ka qenë për të paraqitur ato gjëra që shihen si baza e këtyre operacioneve. Në mënyrë të përmbledhur, duke përdorur edhe ilustrime grafike, të marra nga FM-3.0, janë trajtuar çështjet që lidhen me këto operacione, duke ndërthurur edhe citime, për dhunën, luftën, pushimin e qëndresës së kundërshtarit, bërë nga strategë të njohur ushtarak.

Pjesa kryesore e materialit trajton Fushat e Përkatësisë (FP) në mënyrë të përgjithshme, dhe në mënyrë më të veçantë Fushën e Përkatësisë Tokësore. Gjithashtu, në mënyrë të sintetizuar dhe grafike është paraqitur ndërvarësia ndërmjet Fushave të Përkatësisë, duke pasur në fokus Fushën e Përkatësisë Tokësore. Pamja grafike e paraqitur në material, ofron një kuptim më të qartë sesa shpjegimet më fjalë.

E veçanta e këtij materiali është dhënia e informacionit të përgjithshëm dhe shtjellimi me grafikë dhe fjalë i niveleve të luftës, kontekstit strategjik dhe mjedisit operacional, duke i përdorur këto si një urë lidhëse për të kaluar tek njohuritë për operacionet multi domain. Citimet janë futur si argument, por janë lënë qëllimisht të pashtjelluara, për të pasur mundësi që secili të krijojë këndin e vet të vështrimit dhe qasjes.

Fjalë kyçe: Domain, fushë përkatësie, luftë, krizë, konflikt i armatosur, operacion, dimension, mjedis operacional.

Hyrje

Mjedisi strategjik i sigurisë ka ndryshuar në mënyrë dramatike. Aktivitetet e fundit ushtarake (lufta në Ukrainë) kanë demonstruar dhunimin e rregullave dhe parimeve ku bazohet dhe funksionon arkitektura e sigurisë rajonale e botërore. Aktorë agresorë e kanë orientuar pozicionin e tyre drejt luftës, duke shkelur çdo normë apo ligj ndërkombëtar.

Kërcënimet për luftë dhe fillimi i luftës janë kryefjala e zhvillimeve aktuale. Kërcënim për përdorim të armëve bërthamore. Kërcënim për ndryshim kufijsh me dhunë. Kërcënim për përdorim të teknologjisë së fundit për të mposhtur popujt. Por të zotërosh këto kapacitete dhe të kërcënosh të tjerët për përdorimin e tyre nuk është lojë fjalësh. *“Kërcënimi për gjakderdhje, në vetvete, është më i rrezikshëm sesa vetë gjakderdhja”*¹. Çdo shtet ushtron të drejtën e tij legjitime për t’u mbrojtur në rast se kërcënohet për luftë ose sulmohet, pasi: *Lufta përbën diçka me vlerë thelbësore për shtetin: një çështje për jetë a vdekje; “shtegun pra, që të shpie drejt mbijetesës ose rrënimit”*².

Pavarësisht rregullave ndërkombëtare, të pranuara dhe të miratuara, zhvillimeve teknologjike, përmirësimeve dhe adaptimeve në koncepte, doktrina e manuale, realiteti tregon që natyra e luftës mbetet e pandryshuar (e dhunshme, gjithëpërfshirëse dhe tërësisht politike).

Politika agresive, luftënxitëse, imponuese dhe gllabëruese ka rritur fërkimet në mes shteteve, ka shtuar tensionet si dhe ka përgjakur popuj të pafajshëm. E gjitha kjo për të realizuar objektiva kombëtarë të paligjshëm dhe të papranuar nga komuniteti ndërkombëtar, duke i shtruar rrugën luftës. Kjo tregon që *qëllimi politik është objektivi dhe lufta është mjeti dhe një mjet pa qëllim s’ka si kuptohet*³.

Megjithatë, dalja haptas e disa aktorëve në veprimet e tyre, nuk i ka gjetur të

¹ Nikola Makiaveli. “Mbi komplotet dhe ese të tjera”, Shtëpia botuese Shtëpia e librave sh.p.k, 2022, faqe 11.

² Sun Tzu. “Arti i Luftës”, Shtëpia botuese Pema, 2018, faqe 11.

³ Karl fon Klauzevitch. “Mbi luftën”, Shtëpia botuese Helga Secrets, 2020, faqe 46.

papërgatitur shtetet udhëheqës në sektorin e sigurisë kombëtare, rajonale, dhe ndërkombëtare. *Dhuna për të përballur dhunën përvetëson shpikjet, artet dhe shkencën. Dhuna është mjeti: qëllimi është që t'i diktohet armikut vullneti ynë*⁴. Përgatitjet për të qenë garantuesit e sigurisë janë bërë me kohë, duke përfaqësuar zhvillimet më të fundit teknologjike, të mbështetura nga koncepte, parime dhe doktrina, duke demonstruar vendosmërinë për t'u përgjigjur me të gjitha mjetet në dispozicion si dhe dëshmuar superioritetin në mjedisin operacional.

Megjithatë, duhet pranuar se nuk ka një rrugë fikse që të mundësojë eliminimin e plotë të rreziqeve dhe pasiguritë. Njohja e kundërshtarit nuk do të thotë që të gjitha aspektet e luftës janë të qarta dhe kundërshtari është i parashikueshëm në çdo hap. Ajo që mund të bëhet është përgatitja dhe vënia në funksion të sigurisë dhe mbrojtjes e të gjitha kapaciteteve dhe përdorimi i tyre nëpërmjet zhvillimit të operacioneve multi domain, në 5(pesë) Fushat e Përkatësisë dhe në 3(tre) dimensionet.

Kuptohet, jo të gjitha shtetet i kanë mundësitë dhe aftësitë për të mbuluar të gjitha këto FP dhe organizuar dhe zhvilluar OMD, por gjatë procesit të planëzimit dhe zhvillimit të operacioneve, duhet kuptuar se të gjithë janë përfitues në forma dhe mënyra të ndryshme nga produktet dhe aktiviteti i kapaciteteve të këtyre fushave.

Përcaktimi / kuptimi i termave

Pavarësisht se në material janë trajtuar edhe sfidat, të cilat do të shoqërojnë këto operacione, sfida më e madhe është sjellja në shqip e koncepteve dhe termave të përdorura në manualin e ushtrisë amerikane (FM-3.0). Gjithsesi, për të shmangur keqkuptimet dhe për të ofruar një pamje sa më e qartë, një vend i veçantë i është kushtuar përcaktimit dhe sqarimit të termave të përdorura në material. Kuptimi i tyre është si më poshtë vijon:

- a) **Forca Tokësore.** *Në këtë material termi përdoret jo si komponent por si struktura që veprojnë me bazë në tokë (për të shmangur keqkuptimin në përkthimin në shqip: Army=Ushtri. Në SHBA është një nga shërbimet).*
- b) **Fusha Përkatësie.** *Është në kuptim të fjalës «Domain» dhe përzgjedhur si një nga përkthimet e mundshme.*
- c) **Konkurrim.** *Dy ose më shumë shtete ose kundërshtarë jo shtetërore kanë interesa që nuk përputhen, por nuk kërkojnë konflikt të armatosur.*
- d) **Krizë.** *Një incident apo situatë që kërcënon interesat kombëtare dhe krijon kushtet për përdorimin e forcave ushtarake për të arritur objektivat*

⁴ Karl fon Klauzevitch. "Mbi luftën", Shtëpia botuese Helga Secrets, 2020, faqe 21.

kombëtare/strategjike.

- e) **Konflikt i Armatosur.** *Aktor shtetëror ose jo-shtetëror përdor forcat vdekjeprurëse si mjeti parësor për të arritur interesat e tyre.*
- f) **Luftë.** *Gjendje e konfliktit të armatosur në mes shteteve të ndryshme, entiteteve në formë shteti ose grupe të armatosura për të arritur objektiva politike.*
- g) **Armë të kombinuara.** *Aplikimi i njëkohshëm dhe i sinkronizuar i armëve për të arritur një efekt më të madh se sa do të arrihej nëse çdo element do të përdorej i ndarë ose njëri pas tjetrit.*
- h) **Avantazh relativ.** *Një kusht apo vendndodhje, në çdo fushë përkatësie, në varësi të kundërshtarit apo armikut, i cili siguron mundësinë për të ecur përpara apo për të arritur një objektiv.*
- i) **Multi Domain.** *Shumë Fusha Përkatësie njëherësh.*


Nivelet e luftimit

Të fituarit njëqind herë në njëqind beteja nuk përbën kulmin e zotësisë. Të nënshtruarit e armikut pa qenë nevoja të luftohet, përbën atë që cilësohet kulmi i përsosmërisë.⁵

Është e mundur që niveli strategjik i shteteve, nëpërmjet politikave kombëtare dhe strategjisë globale, të sigurojë interesat kombëtare, duke ia hequr dëshirën shteteve agresore për të ndërmarre veprime që mund të përshkallëzohen në përdorimin e dhunës.

Gjithsesi, kur çështja shkon në nivele më poshtë, atëherë pa diskutim që flitet për kryerje operacionesh (fushata, operacione të mëdha, beteja dhe ndeshje).

Synimi do jetë për të arritur përsosmërinë, por pa harruar zhvillimin e kapaciteteve për të kryer operacione (OMD).



⁵ Sun Tzu. "Arti i Luftës", Shtëpia botuese Pema, 2018, faqe 19.

Konteksti strategjik

Lufta nuk shpërthen kurrë në mënyrë të papritur dhe nuk përhapet brenda një çasti. Secili nga të dy kundërshtarët mund të formojë, pra, në një shkallë të gjerë, mendim për tjetrin, duke parë se si është dhe çfarë bën në realitet dhe jo⁶.

Nëpërmjet ilustrimit me grafikën shoqëruese jepet pamja e kontekstit strategjik dhe diapazonit të operacioneve ushtarake. Kontekstet në të cilin mund të zhvillohen operacionet janë:

a) Konkurrimi në nivel më të ulët se konflikti i armatosur. *Forma elementare të luftës: Dueli. Lufta nuk është gjë tjetër veçse një duel në një shkallë më të gjerë⁷.*

b) Kriza.


c) Konflikti i Armatosur.

Sa më i madh të jetë niveli i dhunës dhe sa më shumë të rritet niveli i interesave kombëtare aq më i madh do të jetë niveli i përfshirjes në duel (duke nisur nga konkurrimi, kaluar në krizë dhe përfshirja në konflikt të armatosur).

Sa më të mëdha dhe të fuqishme të jenë shkaqet e luftës, sa më shumë ato të prekin interesat jetike të popujve, sa më i madh të jetë tensioni që ndiqet nga lufta, aq më shumë kjo e fundit i afrohet formës së saj abstrakte, aq më mirë përputhet qëllimi politik me atë ushtarak dhe aq më shumë karakteri i luftës do të duket thjesht ushtarak dhe më pak politik⁸.

Operacionet Multi Domain

Lufta nuk përbëhet nga një veprim i vetëm i çastit⁹. Përballja me forcat agresore dhe sigurimi i epërsisë në zotërimin e mjedisit operacional duhet bërë me qasje gjithëpërfshirëse dhe me mbulim 360°. Që të arrihet kjo, qasja do të jetë planëzimi dhe kryerja e Operacioneve Multi Domain (OMD/MDO).



⁶ Karl fon Klauzevitch. "Mbi luftën", faqe 27, Shtëpia botuese Helga Secrets, 2020.

⁷ Po aty, faqe 20.

⁸ Po aty, faqe 46.

⁹ Po aty, faqe 28.

Përkufizimi për Operacionet Multi Domain: përdorimi i *armëve të kombinuara* të kapaciteteve të Forcave Tokësore dhe atyre të bashkuara (Joint) për të krijuar dhe shfrytëzuar *avantazhe relative* të cilat mundësojnë arritjen e objektivave, mposhtjen e forcave të armikut, konsolidimin e suksesit në emër të Komandantëve të Forcës së Bashkuar.

Të gjitha operacionet janë operacione *multi domain*. Forcat Tokësore përdorin kapacitetet e tyre në organikë në shumë lloje operacionesh duke përfituar vazhdimisht nga kapacitetet e Fushave të tjera të Përkatësisë (transporti strategjik detar, ajror, nga kapacitetet hapësinore dhe kibernetike, të cilat nuk i kanë në kontroll, përfshi pozicionimin global, komunikimin satelitor si dhe zbulim, vëzhgim dhe rikonicion).

Në nivele të ulëta të komandimit mund të mos vihen re mundësitë e krijuara nga strukturat eprore apo forcat që veprojnë në Fusha të tjera Përkatësie, megjithatë drejtuesit e tyre duhet të kuptojnë se sa ndikon në konceptin e operacioneve mungesa e këtyre mundësive.

OMD-Koncept i ri?

Operacionet multi - domain (OMD/MDO) nuk janë të panjohura ose të reja. Përkufizimi “*përdorim i armëve të kombinuara...*”, sjell në vëmendjen tonë që përdorimi i armëve në interes të njëra-tjetres është koncept i vjetër sa vetë historia e luftërave. Forcat Tokësore kanë përdorur kapacitete tokësore, detare dhe ajrore për më shumë se një shekull, duke filluar nga balonat, avionët, raketat dhe satelitët. Gjithashtu prej më shumë se 2 dekadash janë duke përdorur kapacitete hapësinore dhe kibernetike.


Gjithsesi, termi “Operacione Multi Domain” është përdorur për herë të parë në vitin 2018 nga ushtria amerikane si koncept doktrinar kombëtar. Përtej ushtrisë amerikane, veçanërisht në NATO, termi është më i përgjithshëm, dhe është e qartë që për shtete të ndryshme ka kuptime të ndryshme.

Pavarësisht se si kuptohet në ushtrinë amerikane apo vendet e NATO-s, mund të vihet re një gjë e përbashkët: dëshira e shteteve aleate dhe partnere për të vazhduar përpara dhe për të përballuar sfidat e imponuara nga luftimet komplekse të ardhshme nëpërmjet shfrytëzimit të teknologjisë. Komandantët dhe shtabet e tyre, përtej traditës për zhvillimin e operacioneve konvencionale, duhet të përfshijnë në idetë e tyre edhe dronet, satelitët dhe piraterinë kibernetike.

Pamja e mjedisit operacional (pamje grafike)

Mjedisi operacional, mjedis në të cilin do të zhvillohen operacionet *multi domain*, përbëhet nga 5 fusha dhe 3 dimensione, paraqitur grafikisht në vijim.

Pamja paraqet ndarjen e fushave dhe dimensioneve si dhe ndërveprimin në mes tyre.



Fushat e Përkatësisë (*Domains*)

Në kontekstin e mjedisit operacional, një Fushë Përkatësie (FP) është pjesa e përcaktuar fizikisht/qartësisht e një mjedisi operacional që kërkon një set unik të kapaciteteve dhe aftësive për luftim.

Mjedisi operacional përbehet nga 5 (pesë) Fusha Përkatësie, të cilat nuk janë me kufij që tregojnë ndarje të plotë me njëra-tjetrën (ka mbivendosje në vijat e ndarjes). Në vija të përgjithshme kuptimi i tyre është si më poshtë vijon:

- Fusha e Përkatësisë Tokësore (*Land Domain*), e cila është hapësira e sipërfaqes tokësore deri në brigjet e deteve/oqeanëve.
- Fusha e Përkatësisë Detare (*Maritime Domain*) e cila përfshin oqeanë, dete, gjire, ishuj, vija bregdetare dhe hapësira ajrore sipër tyre.
- Fusha e Përkatësisë Ajrore (*Air Domain*), e cila është atmosfera, duke filluar nga sipërfaqja e Tokës/globit deri në lartësitë ku efektet e tyre në operacione bëhen të papërfillshme.
- Fusha e Përkatësisë Hapësinore (*Space Domain*) e cila fillon mbi lartësitë ku efektet në hapësirën e atmosferës mbi objektivat ajrore bëhen të papërfillshme.
- Fusha e Përkatësisë Kibernetike (*Cyberspace Domain*) e cila ka të bëjë me rrjete të ndërvarura të infrastrukturës së teknologjisë së informacionit dhe të dhënave të ruajtura, përfshi internet, rrjete të telekomunikacionit, sistemet

kompjuterike, procesorë të instaluar si dhe të pjesë të veçanta të spektrit elektromagnetik.

Fusha e Përkatësisë Tokësore

Fusha e Përkatësisë Tokësore është më e rëndësishmja. Operacioni mund të zhvillohet në det apo në ajër, por, nëse “këpuca e ushtarit” nuk prek tokën, operacioni nuk garanton arritjen e objektivave politikë apo ushtarakë. Konkurrenca, hasmëritë, sulmet, dhe aktivitetet e tjera, kërcënuese, aktualisht “gatuhen” në tokë. Pasojat dhe përfitimet më të mëdha janë në tokë.

Përtej kësaj, duhet theksuar që shumëllojshmëria e konfigurimeve të terrenit, kushteve klimatike si dhe diversiteti i popullsisë, kanë një ndikim më të madh në operacionet e kryera në Fushën e Përkatësisë Tokësore, krahasuar me fushat e tjera të përkatësisë. Natyra e luftimit në operacione tokësore është unike për arsye të ndikimit që ka terreni në të gjitha funksionet e luftimit dhe në aplikimin e fuqisë luftarake. Sidoqoftë, duhet pasur parasysh që terreni ofron mundësi për të rritur nivelin e qëndrueshmërisë dhe mbijetesës së forcave, por, këtë mundësi e ofron edhe për armikun.

Fusha e Përkatësisë Tokësore është e ndërvarur me fushat e tjera, kontribuon por edhe përfiton. Kontribuon pasi 4 fushat e tjera të përkatësisë janë në njëfarë mënyre të varura nga fusha e përkatësisë tokësore (aeroporte, porte, stacionet e kontrollit, server, radarë etj.). Këto fusha kanë shumicën e kapaciteteve kibernetike si dhe burimet që përdoren për ushqimin e tyre të instaluar në rrjete të vendosura në tokë. Energjia që përdoret për furnizimin e shumicës së platformave detare, ajrore dhe hapësinore vjen nga vendvendosje në tokë.

Përfiton pasi operacionet në fushën e përkatësisë tokësore varen në kapacitetet e fushave të tjera të përkatësisë (transporti ajror, detar, rrjetet kibernetike, format e zbulimit, vëzhgimit dhe përnjohjes si dhe zjarret të pabazuara në tokë).

Pavarësisht rëndësisë që ka aktiviteti i kryer në Fushën e Përkatësisë Tokësore, duhet mbajtur parasysh që fitorja nuk është e garantuar. *Edhe pse mund të jetë pushtuar territori, lufta nuk ka përfunduar sa kohë që nuk është nënshtruar edhe vullneti i armikut, pra sa kohë që qeveria e tij dhe aleatët e tij nuk janë të vendosur të nënshkruajnë paqen*¹⁰.

Dimensionet

Mjedisi operacional ndahet në 3 dimensione: Fizik, Informacion dhe Njerëzor. Operacionet reflektojnë realitetin që lufta është akt force (në dimensionin fizik) që detyron/imponon (në dimensionin e informacionit) marrjen e vendimit dhe sjelljen e forcave të armikut (në dimensionin njerëzor).

¹⁰ Karl fon Klauzevitch. “Mbi luftën”, faqe 51, Shtëpia botuese Helga Secrets, 2020.

*Lufta është një akt dhune që synon ta detyrojë kundërshtarin të zbatojë vullnetin tonë*¹¹. Kuptimi i dimensioneve të çdo Fushe Përkatësie ndihmon komandantët dhe shtabet për të vlerësuar dhe pritur ndikimet që ato kanë në operacionet e tyre. Veprimet në njërin dimension influencojnë faktorët në dimensionet e tjera. Kuptimi i ndërlidhjes dhe ndërveprimit në mes dimensioneve e ndihmon procesin e vendimmarrjes, në atë se si të krijohen dhe shfrytëzohen përparësitë në një dimension për të arritur objektivat në dimensionet e tjera, pa shkaktuar pasoja apo efekte të padëshiruara.

Përshkrimi dhe shtjellimi në detaje i këtyre dimensioneve kërkon një trajtim të veçantë, por në vija të përgjithshme ofrohen të dhënat në vijim.

Dimensioni Fizik (Physical Dimension). Karakteristikat e materialit dhe kapacitetet, së bashku natyrore dhe industriale, brenda një mjedisi operacional. Ndërkohë që lufta është përpjekje njerëzore, ajo zhvillohet në një mjedis material dhe kryhet me gjëra fizike (teren, moti, formacionet ushtarake, valët elektromagnetike, sistemet e armëve dhe shumë gjëra të tjera që mbështesin operacionet). Aktivitetet dhe kushtet në dimensionin fizik krijojnë efekte në dimensionin e informimit dhe atë njerëzor. Spektri elektromagnetik është një nga karakteristikat materiale që kryqëzon të gjitha fushat e përkatësisë.


Dimensioni i Informimit (Information Dimension). Pajisje, të dhëna dhe procese që përdoren nga individë, grupe dhe sisteme informimi për të komunikuar. Informacioni transmetohet nëpërmjet të gjitha fushave të përkatësisë në një mënyra a tjetër.

Dimensioni Njerëzor (Dimension). Njerëzit dhe ndërveprimet në mes tyre, mbi bazën se si i kuptojnë informacionet dhe ngjarjet, marrin vendime, nxisin dëshirën për të vepruar dhe veprojnë brenda një mjedisi operacional. *Ndërluftuesit i diktojnë ligje njëri-tjetrit*¹².

¹¹ Karl fon Klauzevitch. “Mbi luftën”, faqe 20, Shtëpia botuese Helga Secrets, 2020.

¹² Po aty, faqe 24.

Ndërvarësia e Fushave të Përkatësisë (grafike)



Fushat e përkatësisë nuk janë të ndara, të izoluara apo të veçuara. Nëpërmjet grafikës së mëposhtme është paraqitur ndërvarësia në mes tyre, duke e pasur në fokus Fushën e Përkatësisë Tokësore, si përfitues nga fushat e tjera. Përfitimet dhe kontributet ndërmjet FP janë më të shumta se sa këto të paraqitura në këtë material (janë listuar vetëm disa nga aktivitetet e tyre).

Sfidat

Kryerja e operacioneve *multi domain* do të ketë sfidat e veta. Pikë së pari, jo të gjithë i kanë mundësitë për të organizuar këto lloj operacionesh. Së dyti, vetë organizimi, koordinimi dhe sinkronizimi i aktiviteteve në të gjitha Fushat e Përkatësisë nuk është i lehtë. Nëse vendoset për të përdorur këto lloj operacionesh, kjo vjen si rezultat i nevojës për të hequr çdo mundësi të kundërshtarit për të reaguar. *Me qëllim që kundërshtarit t'i nënshtrohet vullnetit tonë, duhet të vihet në gjendje më të vështirë sesa sakrificat që kërkojmë prej tij*¹³.

Të kesh një vizion, të kesh një mjet, të kesh një dëshirë janë nevoja të dorës së parë dhe guri i themelit për të garantuar siguri dhe superioritet në raport me kundërshtarin. Por kur vjen puna tek materializimi i tyre në praktikë nuk është aq e lehtë. *Në luftë gjithçka është shumë e thjeshtë, por gjëja më e thjeshtë nuk është e lehtë*¹⁴.

Megjithatë, janë edhe faktorë të tjerë që kanë ndikime sa i takon planëzimit,

¹³ Karl fon Klauzevitch. "Mbi luftën", faqe 24, Shtëpia botuese Helga Secrets, 2020.

¹⁴ Po aty, faqe 112.

organizimit dhe zhvillimit të këtyre operacioneve. Aktualisht, në operacione përfshihen komponentë dhe shtete të ndryshme, të cilët kanë veçoritë e tyre që burojnë nga: gjuha, kultura, niveli i zhvillimit teknologjik, procedura, kufizime kombëtare etj.

Përfundime

Natyra e luftës nuk ka ndryshuar, ka ndryshuar karakteri i luftës. Përdoret çdo lloj mjeti, forme dhe metode për të arritur objektivat politik, nëpërmjet përdorimit të instrumentit ushtarak.

OMD nuk janë një koncept i së ardhmes por një koncept operacional. Zhvillimi i operacioneve duhet të sigurojë mbrojtje 360 gradë, duke i demonstruar kundërshtarit aftësinë reaguese dhe forcën me të cilën do të përballlet nëse kërkon ndeshjen.

Planifikimi i operacioneve *multi domain* është sinjali më i qartë që i jepet armikut, se nëse kërkon përballje, do marrë përgjigje të menjëhershme në hapësirë dhe kohë, dhe do e gjejë veten në pozicione tepër inferiore. *Gjendja më e pafavorshme e një shteti ndërluftues është të ndodhet krejtësisht në pamundësi për t'u mbrojtur*¹⁵.

Fushat e përkatësisë dhe dimensionet janë të ndërvarura dhe ndër veprojnë me njëra-tjetrën. Veprimet në njërin dimension apo Fushë përkatësie influencojnë faktorët në fushat e Përkatësisë dhe dimensionet e tjera.

Fusha e përkatësisë Tokësore është më e rëndësishmja. Dimensioni njerëzor, aktualisht, e ushtron aktivitetin, merr vendime dhe kërkon zgjidhje në fushën e Përkatësisë Tokësore. “Këpuca e ushtarit në tokë” është vendimtare.

Forcat Tokësore përdorin jo vetëm kapacitete të vendosura në tokë por edhe ato të vendosura në platformat në det, ajër, hapësirë dhe si dhe ato kibernetike, duke kontribuar dhe përfituar njëkohësisht.

Edhe nëse nuk zotërohen kapacitete të 5 fushave të përkatësisë, përfitimi vjen nga këto shërbime.

Bibliografia:

1. FM 3-0, dated 1 October 2022.
2. Karl Klauzeviç “Mbi luftën”, Shtëpia botuese Helga Secrets, 2020.
3. Sun Tzu, “Arti i Luftës”, Shtëpia botuese Pema, 2018.
4. Nikola Makiaveli, “Mbi komplotet dhe ese të tjera”.

¹⁵ Karl fon Klauzevitch. “Mbi luftën”, faqe 24, Shtëpia botuese Helga Secrets, 2020.

LIDERSHIPI DHE MENAXHIMI I NDRYSHIMIT

Prof. Asoc. Dr. Edmond BRANESHI
Fakulteti i Mbrojtjes dhe i Sigurisë

Trajtesë e shkurtuar.

Ndryshimi është dukuri e përhapur gjerësisht në shoqërinë tonë dhe përbën një realitet në jetën e organizatave. Thënia e filozofit kinez Lao Tzu se udhëtimi prej mijëra kilometrash fillon me një hap, do të thotë që hapi i parë përbën fillesën e ndryshimit. Me ndryshim nënkuptojmë kalimin (transformimin) nga një formë në një formë tjetër të vepruari brenda organizatës. Pyetja që shtrohet është: nga vjen kjo nxitje për ndryshim në organizatë? Përgjigja e thjeshtë është se shtysa për ndryshim në organizatë vjen drejtpërsëdrejti nga mjedisi. Çdo ndryshim në mjedis e bën të nevojshme përfshirjen e organizatës në ndryshimet prej sistemeve, nënsistemeve dhe proceseve të brendshme. Drejtuesit e kuptojnë mirë se ndryshimi është një proces i pandërprerë dhe se ndryshimet në mjedis sjellin ndikime të pashmangshme në organizatat e tyre. Ndryshimi në organizatë ka të bëjë me ndryshimin e qëllimit, kulturës, strukturës dhe metodës së punës së saj në përgjigje të ndryshimeve të konstatuara ose të parashikuara në mjedisin e dhënë.

Detyrë e lidërshiptit është kuptimi i çastit se kur është nevoja për ndryshim në organizatë. Kryerja e ndryshimit të brendshëm për t'iu përshtatur ndryshimit të jashtëm është reaktiv apo kundërveprues, ndërsa lidërshipi (veçanërisht në nivele të larta) duhet të jetë proaktiv. Në këtë rast, një “platformë” e detajuar dhe e menaxhuar me kujdes mund të ndihmojë në zhvillimin me sukses të procesit. Ndryshimi ka të bëjë me mbijetesën. Në këtë shkrim do të trajtohen ndryshimi si proces, qartësimi i kuptimit të ndryshimit, fazat nëpër të cilat

kalon procesi i ndryshimit, menaxhimi i rezistencës ndaj ndryshimit dhe roli i lidershit që procesi të jetë i suksesshëm.

Fjalë kyçe: ndryshim, rezistencë, proces, drejtues, organizatë, grup, rritje organizative, fazë, shkrirja, lëvizja, ringrirja, i vazhdueshëm, mjedis.

Hyrje

Ndryshimi është i pashmangshëm. Asgjë nuk është e përhershme përveç ndryshimit. Është detyrë e drejtuesit ta menaxhojë siç duhet atë. Organizatat duhet të monitorojnë nga afër mjedisin dhe të përfshijnë ndryshime të përshtatshme nëse e kërkon situata. Ndryshimi është një dukuri e vazhdueshme. Organizatat duhet të jenë proaktive për të ndikuar në ndryshim. Edhe në shumicën e organizatave me performancë të lartë, ndryshimi është i nevojshëm si një domosdoshmëri për të mbajtur një nivel të qëndrueshëm. Kur përjetojmë ndryshimin, ne lëvizim nga diçka që njohim dhe bëjmë, nëpër një periudhë tranzicioni, për të arritur më pas tek një mënyrë e re dhe e dëshiruar e të sjellurit dhe e të bërit të punës tonë.

Forcat kryesore mjedisore, të cilat e bëjnë ndryshimin të domosdoshëm janë teknologjia, forcat e tregut dhe faktorët socio-ekonomikë. Rezistenca ndaj ndryshimit nuk është e dëshirueshme. Është kundërproduktive për rritjen apo forcimin dhe ka prirje të një natyre shkatërruese. Drejtuesit duhet të zhvillojnë politika për të ndikuar në ndryshim. Sipas Barney-it dhe Griffin-it, “arsyeja kryesore e përmendur për problemet organizative është dështimi i drejtuesve për të parashikuar siç duhet ose për t’iu përgjigjur forcave për ndryshim”¹.

Ndryshimi dhe kuptimi i tij

Ndryshimi i referohet çdo shndërrimi apo transformimi që ndodh në të gjithë mjedisin e punës të një organizate. Ai mund të lidhet me ndryshimin në teknologji, strukturën organizative, proceset e punës, mjedisin e punës, politikën organizative e madje, edhe me rolet që luajnë njerëzit. Ndryshimi në një pjesë të organizatës detyron ndryshimin në pjesën tjetër të saj. Nëse ai është i dobishëm, njerëzit e pranojnë atë me dëshirë. Nëse nuk është i dëshirueshëm, ndryshimi do të hasë rezistencë të madhe. Nëse kjo nuk ka asnjë pasojë për njerëzit, ata mund të mbajnë një qëndrim indiferent. Nëse ata e konsiderojnë ndryshimin të dëmshëm për rritjen dhe progresin ose përparimin e tyre, ata mund të rezistojnë përmes kundërshtimit. Ky reagim bazohet jo domosdoshmërisht në realitetin apo faktet, por në perceptimin e tyre. Prandaj, ndryshimi duhet të jetë shumë bindës për të kapërcyer kundërshtimet.

¹ V. K. Kondalkar, “Organizational Behaviour”, Published by New Age International (P) Ltd., Publishers, 2007, ISBN (13): 978-81-224-2487-4, p. 293.

“Sipas Institutit të Menaxhimit, - thekson B. Tracy, - cilësia më e rëndësishme për të cilën ju do të keni nevojë për t’u bërë të suksesshëm në shekullin XXI është cilësia e elasticitetit, veçanërisht në mënyrën se si ju mendoni. Elasticiteti i referohet dëshirës për të ndryshuar dhe provuar gjëra të reja. Kjo veçanërisht do të thotë që ju keni aftësinë për të braktisur vazhdimisht të vjetrën, ide të vjetra në favor të së resë, ide më efektive”². Për shkak të përparimit të teknologjisë dhe mjedisit shoqëror, ndryshimi është bërë një domosdoshmëri. Nëse ndryshimi ndodh, organizata arrin drejtpeshimin e kërkuar (e pritshëm). Kështu, njerëzit prirën të pranojnë marrëdhëniet e ndryshme mjedisore brenda organizatës, ata mësojnë të përshtaten. Thelbi është se kur njerëzit e ndjejnë se kanë nevojë për të ndryshuar, dhe kur ndryshojnë, ata në të vërtetë po përshtaten me situatën përkatëse, kështu që arrihet një ekuilibër me mjedisin e ndryshuar. Ky proces vazhdon dhe nuk përfundon kurrë sepse ndryshimi ndodh vazhdimisht.

Rritja organizative si një lloj ndryshimi

Larry E. Greiner, një ekonomist i shquar amerikan, ish-profesor i menaxhimit dhe organizatave në Universitetin e Kalifornisë Jugore në Los Anxhelos, ka përpunuar teorinë e ndryshimit, duke e konsideruar “rritjen” (zhvillimin) si një faktor ndryshimi. Ai ka identifikuar probleme të ndryshme në çdo fazë të evolucionit. Zgjidhja e problemit sjell ndryshimin. Për ta ilustruar, ai merr si shembull një organizatë që dëshiron të realizojë “rritjen” e saj. Fillimisht, rritja arrihet përmes krijimtarisë së themeluesve të cilët zakonisht janë të orientuar drejt sipërmarrjes, por që krijon një problem (nevojë) lidërshtipi. Lidhur me problemin e udhëheqjes, bordi përkatës punëson personel me aftësi të mira drejtuese e menaxhuese, të cilët marrin përgjegjësi të plotë për situatën. Me kalimin e kohës vihet re se lidërshtipi i tejzgjatur përqendron pushtetin në organizatë. Për pasojë, vartësit duhet të presin vendime edhe për çështje të parëndësishme. Prandaj, ndryshimi është i nevojshëm dhe kjo bën të domosdoshme delegimin e autoritetit te vartësit. Kjo çon në një problem tjetër të bazuar mbi autonominë në nivel grupi dhe kontrolli bëhet i vështirë. Meqenëse organizata tashmë ka ndryshuar nga një proces qendërzimi të çdo gjëje në proces delegimi, a është e mundur të përballohet ky ndryshim (ose kjo situatë e re) për të ushtruar kontrollin përkatës mbi grupin?

Ndryshimi është në formën e lëshimit të urdhrave të rinj dhe udhëzimeve të detajuara për secilën çështje të perceptueshme, në mënyrë që ndërsa individi gëzon autonomi në kulturën e punës, ai ende duhet të punojë brenda kornizës së rregullave, udhëzimeve dhe rregulloreve. Më vonë u vu re se rregullat dhe rregulloret e tepërta sollën me vete një lloj burokracie. Ky problem çon

² Brian Tracy, “Ndryshoni të menduarit tuaj, ndryshoni jetën tuaj, si të zbulosh potencialin tënd për sukses e arritje”, Botimet Elta BS, Viti 2009, ISBN; 987-9951-544-08-5, faqe 182.

në ndryshimin e filozofisë së bashkëpunimit. Në këtë situatë të ndryshuar, puna kryhet nga individë, ekipe apo grupe pune. Do të shihet se rritja e performancës së organizatës, do të bëjë që ajo të ndryshojë strategjinë e saj, duke filluar nga sipërmarrja, lidhshipi - delegimi - autonomia e grupeve të punës – bashkëpunimi, që do të çojë në strategjinë aktuale të vetëkontrollit, vetëdisiplinës dhe etikës individuale të punës.

Është e rëndësishme të kuptohet se çdo ndryshim që ndodh shoqërohet me probleme të paparashikueshme. Do të shihet gjithashtu se ndryshimi është i nevojshëm në çdo fazë. Nëse kjo nuk zbatohet, organizata nuk do të jetë në gjendje të ecë përpara.




Figura 1. Modeli Greiner i rritjes Organizative³

Modeli Greiner tregon fazat e ndryshme nëpër të cilat një organizatë ka të ngjarë të kalojë gjatë periudhës së rritjes së saj. Theksohen çështjet dhe problemet e mundshme ndërmjet fazave. Në këtë kuadër, problemi kryesor është ai i sjelljes drejtuese: domethënë çfarë duhet të bëjnë drejtuesit për të kapërcyer këto kriza në lidhje me hapësirën kohore.

Procesi i ndryshimit

Kurt Lewin-i, (1890 - 1947) psikolog gjermano-amerikan, i njohur si një nga pionierët modernë të psikologjisë sociale, organizative dhe të aplikuar

³ V. K. Kondalkar, "Organizational Behaviour", Published by New Age International (P) Ltd., Publishers, 2007, ISBN (13): 978-81-224-2487-4, p. 294.

në Shtetet e Bashkuara, propozoi modelin e procesit të ndryshimit për zhvendosjen e organizatës nga pozicioni aktual në pozicionin e ndryshuar⁴. Ky model përbëhet nga tri faza:

Faza 1: Shkrirja (krijimi i motivimit dhe i gatishmërisë për të ndryshuar).

Shkrirja, si fazë e parë e ndryshimit, përfshin përgatitjen e organizatës për të pranuar se ndryshimi është i nevojshëm, ajo përfshin prishjen e *status quo*-së ekzistuese para se të krijoni një mënyrë të re të funksionimit. Procesi i shkrirjes i bën individët të gatshëm për ndryshim. Lewin-i beson se punonjësit duhet të informohen paraprakisht për ndryshimin e afërt dhe se ata nuk duhet të habiten. Kjo fazë përfshin shkrirjen e sjelljeve ose situatës së vjetër. Edgar Schein-i mori këtë ide të shkëlqyer të propaganduar nga Lewin-i dhe e përmirësoi, duke specifikuar mekanizmin psikologjik të përfshirë në secilën fazë të modelit. Shkrirja përfshin krijimin e motivimit dhe gatishmërisë për të ndryshuar, duke krijuar një mjedis moskonfirmimi të ekzistencës së sigurisë psikologjike në modelin e ndryshuar të sjelljes.

Kjo mund të arrihet duke bërë njoftimet përkatëse, takime dhe duke promovuar idenë (vizionin, pikësynimet) në të gjithë organizatën përmes buletineve, bordeve, kontakteve personale dhe konferencave në grup. Njoftimi i vizionit për ndryshim në organizatë është tepër i rëndësishëm. Ndryshimi është i pamundur të realizohet nëse njerëzit nuk tregojnë gatishmëri për t'u përfshirë dhe ndihmuar në këtë proces. Takimet ndihmojnë për të komunikuar vizionin të gjithë pjesëtarëve të organizatës, por mjeti më i fuqishëm dhe më efikas është mënyra e sjelljes dhe qëndrimi i drejtuesve në organizatë. Sipas Kotter-it (1995), drejtuesit e nivelit të lartë duhet të veprojnë gjithnjë në pajtim me vizionin e caktuar. Ata, për një komunikim sa më efikas të vizionit, duhet të mishërojnë mesazhet lidhur me vizionin në veprimtaritë e tyre të përditshme si dhe të përdorin çdo mjet komunikimi për të bërë njoftimin përkatës⁵.

Procesi i shkrirjes në thelb pastron dhe fshin “psikozën” e vjetruar (penguese) në mënyrë që modelet e reja të sjelljes, zakoneve, traditave të mund të nguliten, dhe më pas të shndërrohen në një mënyrë të re të të bërit të gjërave. Sipas Xhon Mejnard Kejns-it: “*Vështirësia nuk gjendet në zbatimin e ideve të reja, por në shkëputjen e ideve të vjetra*”⁶.

Faza 2: Lëvizja/ndryshimi përmes ristrukturimit njohës. Pas pasigurisë së krijuar në fazën e shkrirjes, faza e ndryshimit është ajo ku njerëzit fillojnë

⁴ Lewin Kurt, “Field Theory in Social Science”. Harper and Row, 1951.

⁵ R. Gjataja, A. Lala, K. Xharo, E. Braneshi “Udhëheqja Strategjike”, Shtëpia Botuese “GEER”, Tiranë 2010, ISBN: 978-9928-105-15-8, faqe 302.

⁶ Laurence Haughton, “Jo çfarë thua por çfarë bën”, Shtëpia Botuese “Max”, Tiranë 2006, ISBN: 99943-37-50-5, faqe 220.

të zgjidhin dilemën e tyre, duke kërkuar mënyra të reja për të bërë gjërat. Njerëzit fillojnë të besojnë dhe veprojnë në mënyrë që të mbështesin drejtimin e ri. Në këtë kuadër, pasi të përfundojë procesi i shkrirjes, ndodh lëvizja, e cila në vetvete përfshin ndryshimin. Personat i nënshtrohen ristrukturimit njohës. Procesi kryhet me tri metodat e mëposhtme të propozuara nga Kelman-i⁷.

- **Pajtueshmëria:** Pajtueshmëria arrihet duke dhënë shpërblime dhe ndëshkime. Është vërtetuar se individ i pranohet ndryshimin nëse shpërblehet ose ndëshkohet. Ky është një mjet për modifikimin e sjelljes.
- **Identifikimi:** Anëtarët janë të impresionuar psikologjikisht për të zgjedhur modelin e tyre dhe të modifikojnë sjelljen. Nëse një drejtues mund të veprojë si një model, ndryshimi është më i lehtë.
- **Ndryshimi i brendshëm:** Ndryshimi i brendshëm është një proces ndryshimi në mënyrën e të menduarit të individit me qëllim që të përshtatet me një mjedis të ri. Anëtarët këshillohen të kryejnë kërkime shpirtërore dhe të përvetësojnë një sjellje të re.

Kalimi nga shkrirja në ndryshim nuk ndodh brenda natës: njerëzit marrin kohë për të përqafuar drejtimin e ri dhe për të marrë pjesë në mënyrë proaktive në ndryshim. Një model përkatës ndryshimi, përqendrohet në çështjen specifike të kalimeve personale në një mjedis në ndryshim dhe është i dobishëm për të kuptuar këtë aspekt në mënyrë më të detajuar.




Figura 2. Procesi i ndryshimit organizativ sipas Lewin-it⁸

⁷ V. K. Kondalkar, "Organizational Behaviour", Published by New Age International (P) Ltd., Publishers, 2007, ISBN (13): 978-81-224-2487-4, p. 297.

⁸ Dritan Shoraj, Doktoratura: "Impakti i lidershipit, kulturës dhe ndryshimeve organizative në efektivitetin organizativ të sistemit bankar sekondar në Tiranë", (Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë, Departamenti i Manaxhimit), Tiranë 2014, faqe 59.

Faza 3: Ringrirja, ka të bëjë me integrimin e sjelljeve të reja në personalitetin dhe qëndrimin e vetë personit. Kjo i referohet qëndrueshmërisë së tij. Ndryshimi i normave të sjelljes duhet domosdoshmërisht të përshtatet me mjedisin shoqëror. Ringrirja ndodh kur sjellja e re përshtatet në një mënyrë jetese normale. Sjellja e re duhet të zëvendësojë të vjetrën në mënyrë të përhershme. Sjelljet e reja duhet të përforcohen vazhdimisht në mënyrë që të “zënë vend”. Ndryshimet marrin formën e kërkuar dhe njerëzit kanë përqaftuar mënyrat e reja përkatëse, organizata është gati të ngrijë përsëri. Shenjat e jashtme të ringrirjes janë një tabelë e qëndrueshme organizative, përshkrime të qëndrueshme të punës, etj. Gjithashtu, faza e ringrirjes duhet të ndihmojë njerëzit dhe organizatën të brendësojë ose institucionalizojë ndryshimet. Ndryshimi nuk është një proces që ndodh një herë dhe me kaq mbaron, ai është i vazhdueshëm, për rrjedhojë edhe shkrirja, ndryshimi dhe ringrirja do të jenë gjithashtu të vazhdueshme.

Rezistenca ndaj ndryshimit

Ndryshimi është një dukuri e vazhdueshme. Forcat dinamike janë gjithmonë në lojë dhe, për këtë arsye, individët duhet të përshtaten me të dhe të bëjnë ndryshime. Shpeshherë do të vëreni se njerëzit e suksesshëm kanë një hije vetëbesimi dhe bindjeje, një ndjenjë rehatie dhe ndoshta edhe pak arrogancë. Përpara se të mendoni se kanë lindur “ndryshe”, duhet të kuptoni se këto cilësi i kanë fituar si rezultat i ndërmarrjes së veprimeve. *Guximi u vjen atyre që veprojnë, jo atyre që mendojnë presin dhe pyesin veten. E vetmja mënyrë për ta kultivuar këtë veçori është duke vepruar*⁹. Nëse ndryshimi nuk zbatohet, shoqëria do të ngecë dhe do të bëhet e pashpresë. Individët e pranojnë ndryshimin në fushën teknike, përtej kësaj i rezistojnë tjetrit, pasi ai ka pasojë të mëdha për ndryshimin shoqëror. Ndryshimi sado i dobishëm të jetë, përgjithësisht has pengesa (kundërshtime) dhe është gjithmonë i vështirë për t’u zbatuar. Duhet theksuar se ndryshimi sjell me vete sfida të reja, përvoja të reja, frymë dhe shpërblime që lidhen me to dhe, për këtë arsye, ai duhet të mirëpritet dhe të zbatohet me pozitivitet dhe mbështetje të plotë.

Ndryshimi prek njerëzit në organizatë. Është gjithmonë më mirë t’u shpjegosh atyre pse është i nevojshëm ndryshimi, çfarë përfitimesh ka të ngjarë të rrjedhin si rezultat i ndryshimit dhe se si këto përfitime do të ndahen nga punonjësit dhe organizata. Drejtuesit flasin në përputhje me botëkuptimin e tyre. Shpesh, ata çuditërisht nuk flasin për atë që kanë bërë apo do të bëjnë, por për atë që shohin. Ata ravijëzojnë pamjen e një bote që të tjerët nuk mund ta përfytyrojnë, dhe u a shprehin këtyre të fundit përfytyrimin e tyre me fjalë.

⁹ Grant Cardone, “10 X: Rregulli i vetëm që bën dallimin ndërmjet suksesit dhe dështimit”, Shtëpia Botuese “Minerva”, Viti 2020, ISBN: 9789928261128, faqe 185.

Ata nuk përdorin statistika për të vërtetuar opinionet e tyre, por shëmbëlltyra të gjalla.¹⁰ Rrjedha e lirë e informacionit dhe komunikimi i dyanshëm është i nevojshëm. Nëse nuk mbahet komunikimi i duhur, ka të ngjarë të formohen qëndrime negative gjatë zbatimit të ndryshimit.

Ekziston një përshtypje e përgjithshme se përfitimet nga ndryshimi që kanë kosto për punonjësit, grumbullohen në organizatë dhe drejtuesit mund të kenë përfitimet përkatëse. Kjo është një përshtypje e rreme dhe duhet korrigjuar nga autoriteti përkatës. Duhet pasur parasysh se pa bashkëpunimin e plotë të punonjësve asnjë ndryshim nuk mund të planifikohet, zbatohet apo të marrim përfitimet. Asnjë rritje apo përparim nuk do të ketë organizata nëse punonjësit nuk janë pjesë e ndryshimit. Organizatat e konsoliduara kanë një forcë të brendshme, që është rezistente ndaj ndryshimeve. Sindroma e ashtuquajtur *“kjo nuk është shpikur këtu”* dhe trysnia e natyrshme për t’i bërë njerëzit *“të presin radhën e tyre”* qëndron përpara rrugës së ndryshimit në udhëheqje, por edhe në inovacione. Mposhtja e rezistencës institucionale kërkon vëmendjen e plotë të një drejtuesi¹¹. Liderhipi duhet të kuptojë se punonjësit janë elementi kyç i çdo organizate dhe se ata duhet të përfshihen që në fazën e planifikimit për ndryshim. Kjo do të mbështesë rritjen e performancës së organizatës. Të qenët pjesë e ndryshimit nuk duhet të jetë thjesht një akt mekanik i thirrjes *“...ejani të merrni pjesë”*. Duhet të kuptohet qartë se nuk ka asnjë shembull (shabllon) të thjeshtë për t’u përdorur në të gjitha situatat. Kombinimet e ndryshme të metodave, teknikave dhe procedurave është mirë që të provohen. Mund të ketë nevojë për këshillim dhe trajnim të njerëzve. Nëse situata nuk ka garancinë e duhur për të dalë me sukses, plani dhe mund të bjerë poshtë. Drejtuesit duhet të bëjnë përpjekje serioze për të larguar frikën nga punonjësit. Drejtuesit idealistë të inovacionit janë programues të mirë; ata kanë të zhvilluar një matës të brendshëm që i mban me këmbë në tokë; janë ndërtues, investues dhe zhvillues. Përpiqen të krijojnë një botë më të mirë për njerëzit e organizatës si dhe për investuesit jashtë saj. Më e rëndësishme është se *drejtuesit shohin të jashtëzakonshmen aty ku të tjerët shohin të zakonshmen*¹². Ata marrin parasysh aspektet e gjenisë së të tjerëve dhe veprojnë sikur secili ka rëndësinë e tij, sepse në fakt ashtu është. I ndihmojnë njerëzit të zbulojnë dhe zhvillojnë pjesën e tyre të gjenisë. Pjesëmarrja duhet të jetë pjesë e trajtimit total të ndryshimit.

¹⁰ Dale Carnegie, “Arti për t’u bërë i paharrueshëm”, Shtëpia Botuese “Pegi”, Tiranë 2018, ISBN: 978-9928-233-24-0, faqe 14.

¹¹ John A. Barnes “Udhëheqja e John F. Kennedy, (Mësimet dhe trashëgimia e një Presidenti)” Shtëpia Botuese Universitare “UET Press”, Tiranë, Dhjetor 2013, ISBN: 978-9928-4193-2-3, faqe 31-32.

¹² Nitin Nohria dhe Rakesh Khurana, “Manual i Teorisë dhe Praktikës së Liderhipit”, Shtëpia Botuese “U.F.O Press”, Tiranë 2011, ISBN në botimin anglisht: 978-1-4221-3879-3, faqe 654.

Një pjesëmarrje e tillë e punonjësve do të siguronte angazhim dhe përkushtim për zbatimin e ndryshimit. Përfshirja individuale që nga faza e planifikimit të ndryshimit është thelbësore për të siguruar angazhimin e plotë. Në fund të fundit, duhet të duket se punonjësit kërkojnë ndryshimin dhe drejtuesi po e zbaton atë sipas variantit më të mirë të mundshëm të tyre. Është vënë re se drejtuesi konsiderohet si nxitësi i ndryshimit dhe organizmat konsiderohen si shtylla (baza) e ndryshimit¹³. Prandaj i takon lidershit që të punojë në mirëbesim me drejtuesit vartës për situatën përkatëse, në mënyrë që ata të jenë në gjendje të bindin anëtarët për nevojën dhe dobinë e ndryshimit. Është e rëndësishme që punonjësit të ndiejnë se ata mund të diskutojnë modalitetet e ndryshimit dhe të kuptojnë natyrën e frikës që mund të kenë, të dinë vetë se nuk ka asnjë rrezik apo kurth në ndryshimin e planifikuar dhe se ndryshimi është për të mirën e tyre dhe të organizatës.

Ne do të bëhemi më të mirë, duke kuptuar së pari vetveten, duke ndryshuar mënyrën e të menduarit dhe duke ndryshuar rrjedhimisht edhe sjelljen tonë. Bindja jonë është se pavarësisht nivelit ku je, mund të bëhesh më i mirë. Siç shprehej Jim Collins: *“Udhëtimi drejt progresit në një organizatë vizionare nuk mund të jetë kurrë i kënaqshëm, në asnjë rrethanë. Edhe kur ajo ka shumë sukses, gjithmonë mund të bëjë edhe më mirë, mund të shkojë edhe më tej, mund të gjejë mundësi të reja”*¹⁴. Në fund të fundit, të gjithë biem dakord që ritmi i ndryshimeve shkon duke u rritur dita ditës, por rrallëherë ndodh që trurit tonë t’i pëlqejnë këto ndryshime të përhershme. Ne kërkojmë modele të qëndrueshme në përditshmëri, kemi dëshirë që gjërat të jenë deri diku të parashikueshme dhe shpesh preferojmë që të mendojmë në pista mendimesh të praktikuara më parë. Sipas S. Soderfjall-it, *“Në mënyrë që organizatat të mos e humbasin hapin, që të përshtaten dhe zhvillohen në këtë botë të ndryshueshme, kërkohet natyrisht që njerëzit t’i ndërpresin modelet e rëndomta të mendimeve dhe sjelljeve, të cilat kanë përfunduar së promovuari qëllimin e veprimtarisë. Gjithashtu është e nevojshme aftësia për të shpikur metoda të reja pune, produkte dhe shërbime të cilat i zgjidhin problemet dhe i plotësojnë nevojat e palëve të interesuara, në një mënyrë më të mirë dhe më efektive”*¹⁵.

Studimi i Coch-it dhe French-it tregoi se grupi, që ishte i informuar për ndryshimin dhe i qartësuar me arsyetimin pse do të ndodhte, mori pjesë në

¹³ V. K. Kondalkar, “Organizational Behaviour”, Published by New Age International (P) Ltd., Publishers, 2007, ISBN (13): 978-81-224-2487-4, p. 305.

¹⁴ Vasil Naçi, Alma Bici, “Është rruga jonë, rruga e suksesit në AGNA Group”, botuar nga AGNA Leadership Academy, viti 2015, faqe 68.

¹⁵ Stefan Soderfjall, “Libri i vogël i lidershit”, Shtëpia Botuese “Pema”, Prishtinë 2019, ISBN: 978-9951-721-85-1, faqe 91-92.

hartimin dhe planifikimin e vendeve të reja të punës, si dhe “memorizimin” e programeve, demonstroj një përshtatje shumë të suksesshme ndaj ndryshimit krahasuar me të tjerët¹⁶. Këto përfshinin: 1) Grupin i cili nuk kishte orientim për ndryshim përveç një njoftimi të shkurtër nga drejtuesi se ndryshimi do të bëhej. 2) Grupin i cili u informua nga drejtuesi për nevojën për ndryshim dhe problematikat apo ndërlikimet e tij; dhe punonjësve iu kërkua të zgjidhnin përfaqësuesit e tyre për të ndihmuar (rishikuar) në hartimin e programeve të nevojshëm, zbatimi i të cilëve do të jepte rezultatin e duhur. Rezultatet ishin shumë më të mira në grupin e dytë që përfshinte gjithçka, krahasuar me grupin e parë në të cilin u bë vetëm një njoftim në lidhje me ndryshimin.

Rezistenca ndaj ndryshimit në vetvete nuk mund të themi që është e mirë apo e keqe, ose mund të jetë e bazuar ose jo, por gjithmonë ajo është një sinjal i rëndësishëm që kërkon analizë të mëtejshme nga drejtuesi. E rëndësishme është të kuptohet natyra e vërtetë e rezistencës. Njerëzit, ndoshta nuk i rezistojnë ndryshimit teknik, por për sa i përket ndryshimit në marrëdhëniet njerëzore që shoqërojnë ndryshimin teknik ndoshta po. Gjithsesi, drejtuesit duhet të jenë shumë të kujdesshëm në këtë drejtim. Disa çaste të rëndësishme rreth rezistencës gjatë ndryshimeve që duhet të mbahen parasysh janë:

- Rezistenca përçon një mesazh, është një mënyrë për të thënë se një individ ka nevojë që nuk po i plotësohen.
- Rezistenca është një shenjë për të kuptuar se procesi i ndryshimit ka filluar.
- Rezistenca shpesh keqinterpretohet sikur njerëzit nuk duan të ndryshojnë. Në të vërtetë, njerëzit duan të rriten e zhvillohen në organizatë. Por mënyra se si ndryshimi menaxhohet sjell ankth tek njerëzit dhe ata shfaqin rezistencë.
- Rezistenca e hapur është “e shëndetshme” sepse kuptohen shqetësimet e njerëzve dhe është më e lehtë për të punuar me ta. Ndërsa rezistenca e pashprehur është më e vështirë për t’u trajtuar sepse për aq kohë sa problemet nuk shprehen, ato nuk mund të trajtohen.
- Mënyra se si rezistenca trajtohet do të ndikojë faktin nëse ajo do të kthehet në një pengesë për ndryshimin apo jo.
- Rezistenca duhet të konsiderohet “si një formë e rëndësishme *feedback-u*”. Nëse i kushtohet rëndësi të kuptuarit dhe të mësuarit nga sjelljet që perceptohen si kërcënuese, atëherë do të merren përfundimisht rezultate më të mira. Nëse mësoni si ta pranoni rezistencën, ju mund ta përdorni atë si një burim dhe të gjeni rrugën tuaj për një zgjidhje më të mirë.

¹⁶ V. K. Kondalkar, “Organizational Behaviour”, Published by New Age International (P) Ltd., Publishers, 2007, ISBN (13): 978-81-224-2487-4, p. 306.

Në vend të mbylljes

Në librin “Duajini punonjësit, që të mos i humbisni” me autorë B. Kaye, Sh. J. Evans, në një kapitull të titulluar “Ngrini pikëpyetje”, citohet opinioni i një menaxheri firme në lidhje me punonjësin e sapoardhur: *“Darreni ishte punonjës i ri, që u punësua për të na sjellë ide të reja dhe një këndvështrim nga jashtë. Gjatë muajit të parë filloi të na mërziste. Bënte vazhdimisht pyetje të tilla, si: “A keni menduar që ta bëni këtë në këtë mënyrë” apo “Pse duhen tetë veprime për ta kryer këtë proces, kur mund të bëhet me katër veprime?”*. Ne iu përmbajtëm fort mënyrës se si ishin bërë gjërat: pse t’i ndryshonim ato, kur ishin të sakta? Darreni qëndroi në punë rreth gjashtë muaj. Më pas na tronditi të gjithëve kur u largua nga puna. Ai tha se idetë e tij të reja nuk vlerësoheshin. Më e trishtueshmja ishte se kishte të drejtë”¹⁷. Ky është një shqetësim i singertë i këtij menaxheri, që për hir të rregullave ata nuk donin të dilnin nga *status quo*-ja përkatëse për të mos pasur probleme me eprorët e tyre, por që në këtë rast dha efektin e kundërt. A duhet që drejtuesit të jenë vazhdimisht të rreptë ndaj zbatimit të rregullave të vendosura dikur në organizatë? Natyrisht që bota do të ishte më e rrëmujshme nëse nuk do të kishte rregulla. Ne mbështetemi te rregullat që të ofrojmë siguri dhe gjykim të shëndoshë në bashkësitë dhe në vendet tona të punës. Prapëseprapë, shumica prej nesh është dakord me mendimin se ecuria kërkon ngritjen e pikëpyetjeve mbi rregullat. Po sikur personat e mëposhtëm të mos i kishin vënë në pikëpyetje rregullat? *Vëllezërit Rait*: Pse njerëzit nuk mund të fluturojnë; *Stiv Xhobs*: Pse nuk mund të ketë gjithësecili kompjuterin e vet?; *Tomas Edison*: Pse nuk mund të ndriçojmë shtëpitë tona me energji elektrike?; *Fred Smith*: Pse nuk mund t’i transportojmë dërgesat në mbarë botën, brenda natës?

Arrini ta kuptoni idenë. Novatorët tanë janë ata që vënë në diskutim rregullat dhe përfundimisht, ata që i shkelin këto rregulla. Ata përmirësojnë jetën tonë dhe janë shtylla e organizatave të suksesshme. Kur novacioni është kaq i rëndësishëm, pse qenka kaq e vështirë për ta mbështetur? Pse qenka kaq e lehtë që më parë të verifikohet nëse ka ndonjë precedent, lidhur me atë që kërkon të bëjë një punonjës? Kur punonjësit tuaj ju parashtrojnë ide dhe koncepte të reja apo thyerje rregullash, ata dëshirojnë të dëgjojnë: “E paska një kuptim”, “Le ta provojmë një herë” ose “Ndoshta do të sjellë rezultat”. Ata duan që të vlerësohen për idetë e tyre dhe zgjidhjet novatore, madje duan që ju si drejtues t’i mbështesni pyetjet që ata bëjnë. Ju do t’i shtoni mundësitë e mbajtjes në punë të punonjësve të talentuar, nëse i besoni që të ngrenë pikëpyetje mbi rregullat e kryerjes së punës, madje dhe në ato që lidhen me vendin e punës.

¹⁷ Beverly Kaye, Sharon Jordan-Evans, “Duajini punonjësit, që të mos i humbisni” (Si duhen trajtuar njerëzit e mirë, që të qëndrojnë në punë, 26 strategji për menaxherë aktivë, që dinë t’i angazhojnë njerëzit në punë), botimet “Max”, Tiranë 2005, ISBN: 978-99943-37-87-3, faqe 241.

Më të suksesshmit shkojnë përtej konceptit të ndryshimit dhe sfidojnë mendësinë tradicionale. Vështroni organizatat si Google, Apple, Facebook etj., e do të vëreni kompani që sfidojnë traditat dhe krijojnë mënyra të reja për t'i bërë gjërat. Ata e thyejnë atë çfarë tashmë funksionon, në mënyrë që të përmirësojnë. Më të suksesshmit kërkojnë të krijojnë tradita të reja – jo të ndjekin ato që tashmë ekzistojnë¹⁸. Mos u bëni një i burgosur i mendësisë së rënë dakord prej të tjerëve. Zbuloni mënyra për të shfrytëzuar në maksimum mendësinë tradicionale e cila pengon të tjerët.

Çdo ndryshim shoqërohet me skepticizmin përkatës të të tjerëve. Prandaj drejtuesit në organizatën e tyre duhet të jenë mjaft të kujdesshëm për të minimizuar rezistencën ose pengesat. Ata duhet të pyesin veten se sa kohë ka kaluar që kur i kanë vënë në pikëpyetje rregullat, dhe sa i inkurajojnë ata vënien në diskutim të tyre? Është në të mirën e performancës së organizatës që drejtuesit t'i lejojnë punonjësit e tyre të bëjnë pyetje lidhur me kryerjen e punës, rregullat që pengojnë rendimentin dhe kënaqësinë e tyre; t'i mbështesin ata kur vënë në pikëpyetje rregullat; t'i ndryshojnë ose interpretojnë këto rregulla sipas rastit; t'i thyejnë nëse munden, me qëllim që punonjësit të arrijnë atë që duan. Vetëm kështu drejtuesit do të ruajnë drejtpeshimin mes njerëzve dhe procesit.

Përfundime

Ndryshimi është një dukuri e përhershme. Është i nevojshëm për shkak të forcave të jashtme si teknologjia, sistemet dhe ndryshimet shoqërore që ndërveprojnë me variablat e brendshme të organizatës. Për të zbatuar ndryshimin, sipas modelit të Kurt Lewin-it, domosdoshmërisht kjo dukuri duhet të kalojë sipas fazave përkatëse: shkrija e situatës, zbatimi i ndryshimit dhe ringriri. Ndryshimet individuale, të grupit dhe organizatës ndodhin vijimësisht. Ndryshimi individual i referohet ndryshimit të qëndrimit, perceptimit dhe gjithashtu, fitimit të aftësive të reja për të përballuar mjedisin e jashtëm. Grupi është njësi (struktura) e rëndësishme e organizatës. Ai është i angazhuar në punë dhe ai është i suksesshëm për shkak të normave dhe mendimit në grup. Për këtë arsye, kultura organizative duhet të jetë në përputhje me kulturën e shumicës së anëtarëve dhe, ata do të ndihen si në shtëpinë e tyre përgjatë punës. Gjithashtu, qëndrimi i drejtuesve luan një rol jetik në ndryshimin e qëndrimit të vartësve. Për një drejtues, sfida më e madhe do të ishte të bindnin çdo punonjës që të hiqte dorë nga idetë e vjetra. Kultura e lidhshimit pjesëmarrës kërkon një proces të gjatë në arritjen e bindjes dhe vullnetit apo gatishmërisë për punë të anëtarëve. Duhet të kihet parasysh se ky

¹⁸ Grant Cardone, "10 X: Rregulli i vetëm që bën dallimin ndërmjet suksesit dhe dështimit", Shtëpia Botuese "Minerva", Viti 2020, ISBN: 9789928261128, faqe 187.

është një proces i vazhdueshëm dhe të gjithë anëtarët duhet të bëjnë përpjekje të singerta për të përmirësuar kulturën e punës në organizatë dhe për të ndryshuar qëndrim. Ndryshimet në nivel organizativ mund të zbatohen duke përcaktuar qartë objektivat dhe planet e nevojshme për ndryshim. Forcat lëvizëse dhe ato frenuese (penguese) duhet të vlerësohen gjatë zbatimit të ndryshimit. Ndryshimi është i strukturuar (detajuar) kur planet janë të mirëstudiuar dhe e kundërta, ndryshimi është i pastrukturuar kur ai zbatohet si rezultat i reagimit të menjëhershëm ndaj një situatë. Gjendet një rezistencë e madhe ndaj ndryshimit për shkak të frikës nga e panjohura. Sipas L. Haughton-it, *çdo gjë e re do të hasë në kundërshti. Kështu ka qenë gjithmonë. Çdo organizatë ka një sistem të qëndrueshëm me antitrupa, që i sulmojnë automatikisht ndryshimet*¹⁹. Prandaj, punonjësit në organizatë duhet të arsimohen, trajnohen, të bëhen pjesë e ndryshimit dhe përfitimi duhet të ndahet midis punonjësve dhe organizatës. Është trajtimi i emocioneve të punonjësve dhe përgatitja e tyre psikologjike që i bën të gatshëm të zbatojnë ndryshimin i cili përfundimisht do të funksionojë. Frika duhet të hiqet nga mendjet e njerëzve. Ndryshimi duhet të merret me optimizëm sepse ai do të jetë në të mirë të organizatës. Është e vështirë të parashikohet se cila strategji do të ketë sukses në zbatimin e ndryshimit. Komunikimi efikas, edukimi i njerëzve për ndryshimin e afërt, pjesëmarrja e përfshirja aktive dhe e fundit, por jo për nga rëndësia, ndarja e përfitimeve të ndryshimit me njerëzit është kërkesa thelbësore për kapërcimin ose mposhtjen e rezistencës ndaj ndryshimit.

Bibliografia:

1. John A. Barnes, “Udhëheqja e John F. Kennedy, (Mësimet dhe trashëgimia e një Presidenti)” Shtëpia Botuese Universitare “UET Press”, Tiranë, Dhjetor 2013, ISBN: 978-9928-4193-2-3.
2. Grant Cardone, “10 X: Rregulli i vetëm që bën dallimin ndërmjet suksesit dhe dështimit”, Shtëpia Botuese “Minerva”, Viti 2020, ISBN: 978-9928-2611-2-8.
3. Dale Carnegie, “Arti për t’u bërë i paharrueshëm”, Shtëpia Botuese “Pegi”, Tiranë 2018, ISBN: 978-9928-233-24-0.
4. R. Gjatoja, A. Lala, K. Xharo, E. Braneshi “Udhëheqja Strategjike”, Shtëpia Botuese “GEER”, Tiranë 2010, ISBN: 978-9928-105-15-8.
5. Larry E. Greiner, “Patterns of Organizational Change”. Harward Business Review, 1967.

¹⁹ Laurence Haughton, “Jo çfarë thua por çfarë bën”, Shtëpia Botuese “Max”, Tiranë 2006, ISBN: 99943-37-50-5, faqe 212.

6. Laurence Haughton, “Jo çfarë thua por çfarë bën”, Shtëpia Botuese “Max”, Tiranë 2006, ISBN: 99943-37-50-5.
7. Beverly Kaye, Sharon Jordan-Evans, “Duajini punonjësit, që të mos i humbisni” (Si duhen trajtuar njerëzit e mirë, që të qëndrojnë në punë, 26 strategji për menaxherë aktivë, që dinë t’i angazhojnë njerëzit në punë), botimet “Max”, Tiranë 2005, ISBN: 978-99943-37-87-3.
8. V. K. Kondalkar, “Organizational Behaviour”, Published by New Age International (P) Ltd., Publishers, 2007, ISBN (13): 978-81-224-2487-4.
9. Kurt Lewin, “Field Theory in Social Science”. Harper and Row, 1951.
10. Vasil Naçi, Alma Bici, “Është rruga jonë, rruga e suksesit në AGNA Group”, botuar nga AGNA Leadership Academy, viti 2015.
11. Nitin Nohria dhe Rakesh Khurana, “Manual i Teorisë dhe Praktikës së Liderhipit”, Shtëpia Botuese “U.F.O Press”, Tiranë 2011, ISBN në botimin anglisht: 978-1-4221-3879-3.
12. Stefan Soderfjall, “Libri i vogël i liderhipit”, Shtëpia Botuese “Pema”, Prishtinë 2019, ISBN: 978-9951-721-85-1.
13. Dritan Shoraj, Doktoratura: “Impakti i liderhipit, kulturës dhe ndryshimeve organizative në efektivitetin organizativ të sistemit bankar sekondar në Tiranë”, (Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë, Departamenti i Menaxhimit), Tiranë 2014.
14. Brian Tracy, “Ndryshoni të menduarit tuaj, ndryshoni jetën tuaj, si të zbulosh potencialin tënd për sukses e arritje”, Botimet Elta BS, Viti 2009, ISBN; 987-9951-544-08-5.

RUBRIKA E DYTË

Mbrojtja kibernetike dhe zhvillimet inovative në FA

S hoqëria sot po kalon në etapën më të zhvilluar në fushën e informacionit. Përhapja dhe përdorimi gjerësisht i teknologjisë të informacionit dhe komunikimit në jetën tonë të përditshme kanë sjellë ndryshime dhe zhvillime të reja të paprecedentë në shkëmbimin e informacionit dhe komunikimit, por në të njëjtën kohë rreziqe dhe kërcënime serioze që mund të ndikojnë në sigurinë kombëtare. Duke qenë se siguria kibernetike ndikon sigurinë kombëtare, atëherë kjo varësi nga hapësira kibernetike kërkon që ne t'i kushtojmë të gjitha mjetet e nevojshme për t'i vënë aftësitë tona në shërbim të sigurisë kibernetike.

Këto problematika i sjell në vëmendjen e lexuesve të RU-së kolonel Ulsi Rexhaj me shkrimin *“Sfidat e sigurisë së informacionit në hapësirën kibernetike”*, i cili thekson se plotësimi i domosdoshmërive strategjike në fushën e sigurisë kombëtare është një proces që kërkon zbatimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare, e cila ka rëndësi jetike për të ardhmen e vendit dhe mbrojtjen e vlerave tona kombëtare.

Strukturat dhe organet e ndryshme ligjzbatuese, në zbatim të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen kibernetike, duhet të përcaktojnë rregullat dhe përgjegjësitë mbi masat e sigurisë së informacionit dhe të stimulojnë nëpërmjet testimeve të ndryshme aftësitë dhe kapacitetet e strukturave në përballimin, ose jo, të këtyre sulmeve.

Punimi i dytë në këtë rubrikë vjen nga autori Roland Tashi, me titull *“Inteligjenca artificiale: përparësi, rreziqe dhe masa mbrojtëse”* Krahas përfitimeve që sjell përdorimi i inteligjencës artificiale në të gjitha fushat, veçanërisht gjatë krizave dhe operacioneve ushtarake në fushën e luftës, autori

vë theksin edhe në disa kufizime, të cilat mund të klasifikohen në tri kategori kryesore: ligjore, operacionale dhe strategjike.

“Për të arritur në përdorimin e kontrolluar të AI, për të krijuar një kuadër të plotë dhe gjithëpërfshirës ligjor, është e nevojshme të sigurohet një bashkëpunim i fortë midis juristëve, projektuesve, prodhuesve dhe specialistëve ushtarakë, për të gjetur ekuilibrin e duhur midis teknikës, ligjit, etikës, sjelljes dhe fuqisë ushtarake. Sistemet e drejtuara nga AI duhet të operojnë në përputhje me ligjin dhe parimet njerëzore, për të parashikuar zhvillimin e operacioneve luftarake, jo vetëm brenda një skenari lufte tradicionale, por edhe gjatë operacioneve komplekse asimetrike dhe hibride, të cilat duket se po dominojnë luftën klasike”, përfundon z. Roland Tashi.

Në artikullin *“Aplikimi i teknikave statistikore në sigurinë kibernetike në epokën e Big Data”* autori Gentian Hoxhalli, shqyrton teknikat statistikore që përdoren për analizën dhe zbulimin e rrezikut në sigurinë kibernetike në epokën e *big data*. Përfitimet potenciale të përdorimit të statistikave në sigurinë kibernetike përfshijnë zbulimin e rrezikut të parakohshëm, ndërprerjen e sulmeve të ndërlikuara dhe rritjen e aftësisë për të parandaluar kërcënimet e ardhshme në ambientet kibernetike.

Avionët pa pilot të tipit TB-2 “Bayraktar”, dronët që mund të ndryshojnë konceptin e luftës ajrore, janë bërë të njohur në fushën e betejës për aftësitë, kapacitetet dhe detyrat e ndryshme të kryera me sukses, veçanërisht për rolin e rëndësishëm në konfliktet, si Azeri-Gjeorgjian, Libi, Siri dhe ai më i fundit midis Rusisë dhe Ukrainës. Me punimin e tij *“Kapacitetet dhe mundësitë e përdorimit të avionëve pa pilot të armatosur të tipit TB-2 “Bayraktar”*”, nënkolonel Eduart Pllaha e informon lexuesin rreth rrisë më të fundit në lidhje me këta avionë, të cilët shumë shpejt do të jenë pjesë e Forcës Ajrore Shqiptare për plotësimin e misionit të saj kushtetues por edhe kontributin mbështetës për Forcën Tokësore, Detare, si dhe mbështetjen e organeve të tjera ligjzbatuese të vendit tonë. Këto sisteme të armatosura të zbulimit ajror TB-2 mund të angazhohen për goditjen në kohë reale të objektivave statikë ose të lëvizshëm me efikasitet të lartë në front, në thellësi operative dhe strategjike.

SFIDAT E SIGURISË SË INFORMACIONIT NË HAPËSIRËN KIBERNETIKE

Kolonel Dr. Ulsi REXHAJ

Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak

Trajtesë e shkurtuar.

Shoqëria sot po kalon në etapën më të zhvilluar në fushën e informacionit. Përhapja dhe përdorimi gjerësisht i Teknologjisë të Informacionit dhe Komunikimit në jetën tonë të përditshme kanë sjellë ndryshime dhe zhvillime të reja të paprecedentë në shkëmbimin e informacionit dhe komunikimit, por në të njëjtën kohë rreziqe dhe kërcënime serioze që mund të ndikojnë në sigurinë kombëtare.

Mjedisi i përditshëm është dinamik në të cilin ne përballemi me shumë pasiguri dhe sfida, për të cilat institucionet shtetërore dhe joshetërore duhet të marrin masat e duhura për t'i përballuar ato në funksion të mbrojtjes së interesit të qytetarëve shqiptarë.

Ekzistojnë shumë faktorë që kontribuojnë në përhapjen e veprimeve kriminale në hapësirën kibernetike: shfrytëzimi i saj për përfitime në terma ekonomikë, politikë ose të tjerë; lehtësia dhe kostoja e ulët e përdorimit të mjeteve që përdoren për të organizuar sulme; lehtësia me të cilën sulmuesit mund të realizojnë këto aktivitete në mënyrë anonime dhe nga kudo në botë.

Profilat e ndryshme të sulmuesve shfrytëzojnë dobësitë dhe boshllëqet teknologjike për të mbledhur informacion, për të vjedhur asete shumë të vlefshme dhe për të kërcënuar shërbimet bazë që janë thelbësore për

funksionimin normal të vendit. Duke realizuar ndikime ndërsektoriale si në sektorin publik dhe privat por dhe te vetë qytetarët, ata rrezikojnë disa nga të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë dhe në të drejtën ndërkombëtare.

Duke qenë se siguria kibernetike ndikon sigurinë kombëtare, atëherë kjo varësi nga hapësira kibernetike kërkon që ne t'i kushtojmë të gjitha mjetet e nevojshme për t'i vënë aftësitë tona në shërbim të sigurisë kibernetike.

Siguria kibernetike sot është në krye të vëmendjes për sigurinë kombëtare, për çdo sektor shtetëror, publik apo privat dhe bordet e administrimit të tyre, përballë një rritjeje të pamëshirshme të kërcënimeve kibernetike.¹

Fjalët kyçe: siguri kibernetike, teknologji informacioni, haker, kërcënim, intelijenca artificiale, siguri kombëtare, globalizim teknologjik.

E ardhmja e sigurisë kibernetike

Siguria kibernetike është ngritur në krye të agjendave të institucioneve shtetërore, organizmave ndërkombëtare, të korporatave, pasi administratat dhe bizneset vazhdojnë të përballen me kërcënimet kibernetike që lidhen së tepërmi me shtimin e punës në distancë dhe rritjen e tregtisë nëpërmjet internetit të nxitur nga pandemia COVID-19 dhe dixhitalizimin e vazhdueshëm të shërbimeve në administratë. Sipas një hulumtimi nga Gartner², 88% e administratës shtetërore dhe bordeve tani e konsiderojnë sigurinë kibernetike si një rrezik për sigurinë kombëtare dhe jo thjesht një problem teknik për IT.

Sipas parashikimeve të Gartner, shqetësimet e shtuara për sigurinë kibernetike, së bashku me një mungesë të vazhdueshme të profesionistëve të sigurisë kibernetike, do të nxisin gjithashtu ndryshime në strategjitë e sigurisë kibernetike dhe politikat e vendeve të punës në vitet e ardhshme, duke përfshirë të dhënat statistikore, si më poshtë:

1. Deri në vitin 2025, pritet që 60% e institucioneve do të konsiderojnë rrezikun e sigurisë kibernetike si një përcaktues kryesor në kryerjen e transaksioneve të palëve të treta dhe angazhimeve të biznesit.
2. Deri në vitin 2025, rreth 80% e institucioneve dhe kompanive do të miratojnë një strategji për të unifikuar web-in, shërbimet cloud dhe aksesin

¹ Karen Scarfone është konsulente kryesore për sigurinë kibernetike Scarfone në Clifton, Virxhinia, e cila zhvillon botime sigurie për agjencitë federale dhe publikun. Burimi elektronik: <https://www.researchgate.net/profile/>

² Gartner, Inc është një kompani kërkimore dhe konsulence teknologjike me bazë në Stamford, Konektikat që kryen kërkime mbi teknologjinë dhe ndan këto kërkime si përmes konsulencës private, ashtu edhe përmes programeve ekzekutive dhe konferencave.

e aplikacioneve private nga platforma e fundit e shërbimit të sigurisë së një shitësi të vetëm.

3. Deri në vitin 2026, 50% e punonjësve të nivelit C do të kenë të përcaktuara kërkesat e performancës në lidhje me rrezikun e integruar në kontratat e tyre të punës.

Tendencat e sigurisë kibernetike

Zhvillimet moderne teknologjike dhe ritmi i shpejtë i integritit të tyre në jetën e përditshme të njeriut na vënë përballë dilemave në lidhje me sigurinë e të dhënave tona dhe zgjedhjet që duhet të bëjmë kur përdorim rrjetet kompjuterike në punë apo shtëpi.

Siguria kibernetike i referohet një kuadri kompleks teknologjik që ka të bëjë me sigurinë e rrjeteve, aplikacioneve, mënyrën se si ato përdoren, të dhënat që duam të mbrojmë, përdorimin e vazhdueshëm të infrastrukturës dhe rrjedhimisht edukimin tonë.

Zhvillimi aktual në fushën e teknologjisë së informacionit dhe puna në distancë (on-line) kanë bërë të nevojshme që të rivlerësohen rreziqet e sigurisë individuale, organizative, kombëtare dhe ndërkombëtare dhe përgjigjet ndaj tyre.

Si rrjedhojë, po rendisim pesë tendencat e sigurisë kibernetike, që administrata shtetërore, sektori publik dhe ai privat duhet të përqafojnë ndërsa ecin përpara nga post pandemia.

Trendi 1: Puna në distancë bëhet e përhershme.

Pandemia e COVID-19 ka ndryshuar në mënyrë drastike kulturën e punës së pranuar në administratë dhe në shumë organizata. Numri i personelit që punojnë nga shtëpia për disa javë tashmë është rritur ndjeshëm. Disa organizma kanë hequr dorë nga marrja e zyrave me qira dhe kanë zgjedhur punën në distancë (on-line) në periudha kohore afatgjata, me qëllim që të ulin shpenzimet. Në disa struktura të tjera, të punësuarit kanë kërkuar të vazhdojnë punën nga distanca me kohë të pjesshme ose të plotë.

Gjatë pandemisë, shumica e institucioneve duhej t'i zhvendosnin shpejt shërbimet dhe aplikacionet e tyre nga ambientet e zyrës në atë kompjuterike on-line dhe kjo arkitekturë e re me burime të bazuara në shërbimin *cloud* dhe fuqi punëtore në distancë u mendua të ishte e përkohshme. Funkcionaliteti i saj u vlerësua natyrshëm në vend të sigurisë, sepse objektivi kryesor ishte që institucionet të funksiononin. Por, me institucionet që vendosën të bëjnë shndërrime afatgjata ose të përhershme për të punuar nga distanca, ekipet e sigurisë duhet të rimendojnë marrëveshjet “e përkohshme” dhe të bëjnë atë

që nevojitet për të përditësuar politikat, proceset dhe teknologjitë e sigurisë. Me siguri do të ketë sfida në zbatimin e kontrolleve të sigurisë, ruajtjen e mosdepërtimit në çështjet e sigurisë dhe demonstrimin në pajtueshmëri me kërkesat e sigurisë.

Një element i fundit i rikalibrimit të strategjive institucionale **të sigurisë kibernetike për punën në distancë** është: “Mos harroni të kaloni pak kohë për t’u siguruar që personeli i ekipit të sigurisë të jetë në gjendje të punojë të gjithë së bashku në këtë mjedis të ri, si dhe të ndërveprojë dhe komunikojë me teknologjitë dhe grupet e tjera të biznesit.”

Trendi 2: Automatizim, automatizim, automatizim.

Ekipet e sigurisë prej vitesh janë në një situatë të pasuksesshme. Ata e kanë të vështirë të vazhdojnë me **të gjitha kërcënimet** me të cilat përballet rrjeti i tyre gjithnjë e më i madh dhe kompleks i burimeve kompjuterike. Kërkesa për ekspertë të sigurisë kibernetike dhe cilësia e tyre vazhdon të rritet dhe është koha që institucionet të pranojnë se kjo nuk do të korrigjohet së shpejti.

Në vend që të përpiqen të rrisin burimet e tyre njerëzore për të përballuar mangësitë në mjete dhe teknologji, institucionet dhe korporatat duhet të rrisin mbështetjen e tyre tek automatizimi. Sigurimi i teknologjive që **përdorin inteligjencën artificiale** dhe mekanizmin e të mësuarit dhe që kryejnë analiza të vazhdueshme të të dhënave në burimet e monitoruara të çështjeve të sigurisë mund të zbulojnë kërcënime të reja shumë më shpejt se sa njerëzit. Ato mund të zbulojnë sisteme të sofistikuara të aktivitetit keqdashës që një njeri nuk mund do t’i vinte re. Në mënyrë të ngjashme, automatizimi i sigurisë mund të identifikojë vazhdimisht praninë e dobësive të reja të softuerit, gabimet e konfigurimit dhe probleme të tjera dhe të sigurojë që çdo problem të eliminohet shpejt.

Rritja e volumit të automatizimit dhe përmirësimi i cilësisë së teknologjive të automatizimit zvogëlon ngarkesën e përditshme për ekspertët e paktë të sigurisë kibernetike. Këta ekspertë më pas mund të shfrytëzojnë kohën e tyre duke u fokusuar në çështje më strategjike, nga të cilat mund të përfitojnë më shumë institucionet në planin afatgjatë.

Trendi 3: Adoptimi i parimit të besimit zero

Besimi zero është një emër i ri për një koncept të vjetër: Asnjëherë mos supozoni se duhet t’i besohet ndonjë gjëje ose dikujt. Verifikoni besueshmërinë e çdo pajisjeje, përdoruesi, shërbimi ose subjekti tjetër përpara se t’i jepni akses dhe shpesh riverifikoni besueshmërinë e tij për t’u siguruar që entiteti nuk është komprometuar. Jepini çdo entiteti akses vetëm në burimet që i nevojiten në mënyrë që të minimizohet ndikimi i çdo shkeljeje të besimit. Parimet e

besimit zero mund të zvogëlojnë si shpeshtësinë dhe shkallën e rrezikshmërisë të incidenteve që ndodhin.

Besimi zero është një parim, jo një kontroll apo teknologji sigurie. Ai mbështetet në të gjithë infrastrukturën teknologjike që po projektohet për të kontrolluar dhe rishikuar identitetin dhe pozicionin e sigurisë së çdo entiteti dhe për të monitoruar vazhdimisht aktivitetet që përfshijnë çdo ent. Arritja e kësaj kërkon bashkëpunim të gjerë midis arkitektëve dhe inxhinierëve të sigurisë, administratorëve të sistemit dhe rrjetit, zhvilluesve të programeve kompjuterike dhe profesionistëve të tjerë të teknologjisë. Zbatimi është një përpjekje e vazhdueshme me faza, shumëvjeçare, dhe kjo është arsyeja pse ka presion në rritje për të filluar miratimin e parimeve të besimit zero sa më shpejt të jetë e mundur. Ky është rasti kur duhet t'i nënshtrohesh presionit.

Trendi 4: Përmirësimi i aftësive reaguese

Tashmë me dhimbje por është bërë e qartë se shumica e institucioneve dhe organizatave duhet të përmirësojnë aftësitë e tyre të reagimit. Sulmi ndaj institucioneve, kompanive apo organizmave përmes “ransomware”³ është bërë një biznes aktual, sulmuesit në mënyrë efektive bllokojnë përdoruesit, nxjerrin jashtë sistemeve të dhënat e tyre dhe më pas kërkojnë që të marrin shpërblime të mëdha për të rivendosur aksesin. Në të njëjtën kohë, këta sulmues kryejnë shkelje të mëdha të informacioneve personale, duke mbledhur sasi të mëdha të dhënash sensitive dhe duke kërkuar më pas shpërblime për të parandaluar lëshimin ose shitjen e tyre.

Të gjitha institucionet dhe organizmat shtetërorë ose jo duhet të përgatiten për t'iu përgjigjur **incidenteve “ransomware”** në shkallë të gjerë, dhe kjo do të thotë që reaguesit ndaj incidenteve duhet të punojnë ngushtë jo vetëm me ekspertë të sigurisë, por edhe me administratorët e sistemeve, këshilltarët ligjorë, marrëdhëniet me publikun dhe të tjerë për të siguruar që kundërpërgjigja të jetë e shpejtë e pa probleme dhe shërbimet të rikthehen shpejt. Përgatituni për të parandaluar kërkesat për shpërblime përpara se ato të bëhen.

Trendi 5: Njohja e rreziqeve nga zinxhirët e furnizimit

Ne zakonisht i besojmë asaj që na japin shitësit dhe ofruesit tanë të shërbimeve. Incidenti⁴ si i përdori Rusia SolarWinds⁵ për të hakuar Microsoft, Intel, Pentagon dhe rrjete të tjera, na ilustron se sa i rrezikshëm është ai besim në

³ Një lloj softueri me qëllim të keq i krijuar për të bllokuar aksesin në një sistem kompjuterik derisa të paguhet një shumë parash.

⁴ Hakerët rusë shfrytëzuan boshllëqet në mbrojtjen e SHBA-ve dhe kaluan muaj në rrjetet qeveritare dhe korporative në një nga fushatat më efektive të spiunazhit kibernetik të të gjitha kohërave.

⁵ SolarWinds Corporation është një kompani amerikane që zhvillon softuer për bizneset për të ndihmuar në menaxhimin e rrjeteve, sistemeve dhe infrastrukturës së teknologjisë së informacionit.

zinxhirët tanë të furnizimit. Një kompani e vetme mund të infiltrohet me sukses nga një shtet komb dhe kjo kompani mund të ofrojë produkte ose shërbime teknologjike të komprometuara për mijëra kompani të tjera. Këto kompani, nga ana tjetër, jo vetëm që do të rrezikohen vetë, por ato mund të ekspozojnë të dhënat e klientëve të tyre ndaj sulmuesve origjinalë ose të ofrojnë shërbime të komprometuara për klientët e tyre. Ajo që fillon me një kompani të vetme të infiltruar mund të çojë në rrezikimin e miliona organizatave dhe individëve.

Është tepër e vështirë për t'i dhënë një përgjigje kësaj, prandaj shumë aspekte të **strategjisë** dhe teknologjisë të sigurisë duhet të përmirësohen. Ajo që është më e rëndësishme në këtë kohë është që institucionet të njohin dhe pranojnë **rreziqet që vijnë nga zinxhirët tanë të furnizimit** dhe të kërkojnë që ne të gjithë të bëjmë më të mirën. Nëse kjo nënkupton që përgjegjësia për praktikën e dobët të sigurisë t'ju adresohet shitësve, atëherë duhet kërkuar shumë më tepër transparencë në praktikën e sigurisë së tyre përpara rinovimit të kontratave ose shtimit të kërkesave për prokurimet e reja, veçmas çdo institucion apo organizëm individualisht duhet të rrisin ndërgjegjësimin për këto çështje dhe të ushtrojnë presion mbi shitësit dhe ofruesit e shërbimeve për të bërë më të mirën.

Hakerët iranianë spiunojnë gazetarët dhe zyrtarët qeveritarë

Studiuesit e sigurisë kibernetike kanë zbuluar një tjetër grup hakerësh të sponsorizuar nga shteti iranian që ka shënjestruar zyrtarë qeveritarë, gazetarë, akademikë dhe liderë të opozitës në mbarë botën për të paktën shtatë vjet. Sipas hulumtimit të publikuar nga kompania e sigurisë kibernetike Mandiant⁶, grupi i avancuar iranian i kërcënimit të vazhdueshëm, i cili njihet si APT42, është i lidhur me shërbimet e inteligjencës së vendit.

Mandiant ka konfirmuar të paktën 30 operacione kibernetike të kryera nga APT42 që nga viti 2015, megjithëse studiuesit thonë se numri i saktë ka të ngjarë të jetë shumë më i lartë. Ndër operacionet e tyre, grupi synoi sektorin farmaceutik në fillimin e pandemisë COVID-19 dhe ndoqi grupet opozitare vendase dhe të huaja përpara zgjedhjeve të fundit presidenciale iraniane.

Madhësia e grupit është e paqartë, por besohet se APT42 disponon “burime të bollshme”, pasi shpesh prokuron infrastrukturë të re dhe njëkohësisht kryen operacione të grumbullimit dhe mbikëqyrjes së kredencialeve, si dhe duke inkorporuar *malware* të Windows në aktivitetin e saj. Grupi “mund të ketë ekipe të shumta përgjegjëse për elementë të ndryshëm të operacioneve të tyre”.⁷

⁶ Mandiant është një kompani amerikane e sigurisë kibernetike dhe një filial i Google.

⁷ Emiel Haeghebaert, analisti i Mandiant.

Raporti i Mandiant përkoji me njoftimin e Shqipërisë se ajo ndërpreu marrëdhëniet diplomatike me Iranin dhe dëboi personelin e ambasadës së vendit për një sulm kibernetik në faqet e internetit të qeverisë shqiptare që dyshohet se ishte kryer nga Teherani. Shqipëria, një anëtare e NATO-s, është vendi i parë që ndërpreu marrëdhëniet diplomatike në përgjigje të një sulmi kibernetik.

Zëdhënësja e Këshillit të Sigurisë Kombëtare të SHBA-së Adrienne Watson e quajti sulmin kibernetik iranian ndaj Shqipërisë “një precedent shqetësues për hapësirën kibernetike”, ndërsa sekretari i jashtëm i Mbretërisë së Bashkuar James Cleverly tha se veprimet e Iranit treguan “një shpërfillje të hapur” për popullin shqiptar. Zyrtares ukrainas i sigurisë Victor Zhora e quajti sulmin një shembull tjetër të “terrorizmit kibernetik të sponsorizuar nga shteti”.

Një operacion ndaj një vendi të veçantë por edhe global

Sipas këtij studimi mbi APT42, Britania e Madhe, SHBA-të dhe Ukraina janë ndër objektivat e grupit, së bashku me Australinë, Italinë, Izraelin, Bullgarinë dhe Norvegjinë. Hakerët iranianë kanë shënjestruar vazhdimisht institucionet perëndimore, studiuesit, gazetarët, zyrtarët e qeverisë perëndimore, ish-zyrtarët e qeverisë iraniane dhe diasporën iraniane jashtë vendit. Në shtator 2021, për shembull, APT42 përdori një llogari të komprometuar të postës elektronike të një qeverie evropiane-për të dërguar një e-mail phishing në pothuajse 150 adresa që lidheshin me individë të shoqërisë civile dhe organizatave qeveritare në mbarë botën. Megjithatë, pjesa më e madhe e aktivitetit të APT42 është e përqendruar në Lindjen e Mesme, duke përfshirë vetë Iranin, ku hackerët pro-qeveritarë spiunojnë grupet e opozitës, gazetarët e pavarur dhe aktivistët e të drejtave të njeriut.

Operacionet, sipas Mandiant, janë në interes të Teheranit: “APT42 është i besuar nga qeveria iraniane për të reaguar shpejt ndaj ndryshimeve gjeopolitike.” Hakerët e grupit ndjekin një model të ngjashëm, së pari, ata ndërtojnë besim dhe raport me viktimat e tyre për të fituar akses në llogaritë personale dhe të korporatave të postës elektronike. Ndonjëherë ata kalojnë ditë ose javë duke kultivuar një viktимë përpara se të dërgojnë një lidhje me qëllim të keq. Në një rast, një hacker i paraqitur si një gazetar i njohur nga një organizatë mediatike amerikane komunikoi me viktimat e tij për 37 ditë përpara se t’i drejtonte së fundmi në një faqe me kredencialet e mbledhura.

Përveç mbledhjes së kredencialeve, grupi përdor gjithashtu “malware celular”⁸ për të synuar të ashtuquajturit «armi q të regjimit». APT42 ka të ngjarë të

⁸ Malware celular është softuer me virus që synon telefonat celularë ose pajisjet e aktivizuara me valë, duke shkaktuar kolapsin e sistemit dhe humbjen apo rrjedhjen e informacionit konfidencial.

dërgojë malware-in e tij Android, si VINETHORN dhe PINEFLOWER, përmes mesazheve me tekst. Kjo lejon APT42 të marrë informacione të ndjeshme për viktimat e tij, duke përfshirë lëvizjen e tyre, kontaktet dhe informacionin personal. Aftësia e grupit për të regjistruar thirrjet telefonike, për të aktivizuar mikrofonin dhe për të regjistruar audio, për të lexuar mesazhe SMS dhe për të gjurmuar vendndodhjen GPS “paraqet një rrezik në botën reale” për viktimat e saj.

Mandiant arriti në përfundimin se APT42 do të vazhdojë të kryejë operacione kibernetike për të mbështetur prioritetet strategjike të Iranit. Operacione të tilla kibernetike janë “një plotësues” i mjeteve të tjera të përdorura nga këto shtete për të çuar përpara interesat e tyre brenda vendit, në rajon dhe në mbarë botën.

Ashtu siç tregon vendimi i Shqipërisë për të ndërprerë marrëdhëniet diplomatike me Iranin, qeveritë i marrin seriozisht këto operacione kibernetike dhe duhet të jenë të gatshme të ndërmarrin veprime konkrete ndaj tyre.

“Nëse këto operacione kibernetike kanë efekte të prekshme përçarëse, siç ishte rasti me operacionin e Iranit në Shqipëri, shtetet mund të zgjedhin të përdorin cilindo nga mjetet e tyre ekonomike, diplomatike ose ushtarake në një përgjigje proporcionale në përpjekje për të penguar aktivitete të ngjashme në të ardhmen”.⁹

Siguria kibernetike në sistemin e sigurisë kombëtare

Në mbrojtje të interesit kombëtar, zhvillimi i politikave të sigurisë kibernetike duhet të promovohet dhe të mbështetet *të koordinuara me ato të Bashkimit Evropian*, partnerëve, aleatëve dhe organizatave ndërkombëtare të sigurisë dhe mbrojtjes. Për zbatimin e këtyre politikave duhet të nxitet bashkëpunimi në kuadrin e anëtarësimit në BE, me organizatat ndërkombëtare dhe rajonale si: Agjencia Evropiane e Mbrojtjes (EDA), Agjencia e Bashkimit Evropian për Sigurinë e Rrjetit dhe Informacionit (ENISA), Qendra Evropiane e Krimit Kibernetik pranë EUROPOL, Kombet e Bashkuara (OKB), Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO) dhe Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD), etj.

Aktualisht, ne na mungon siguria e mjaftueshme kibernetike dhe aftësia e inteligjencës dhe kjo bën që të varem shumë nga aleatët dhe partnerët tanë strategjikë. Jo vetëm vendet e vogla por dhe për shtete më të fuqishme se ne, ekziston mungesa e aseteve për mbrojtjen kibernetike. Si shembull mund të marrim rastin e Japonisë:

⁹ Emiel Haeghebaert, analisti i Mandiant.

“Japonisë i mungon siguria e mjaftueshme kibernetike dhe aftësia e inteligjencës, duhet të varet shumë te Shtetet e Bashkuara. “Pa siguri kibernetike, epërsia e forcës vetëmbrojtëse apo bashkëpunimi Japoni-SHBA është vështirë i arritshëm”, u tha në programin pesëvjeçar të mbrojtjes të Japonisë. Në këtë program po ashtu u pranua se ka nevojë për të pasur siguri kibernetike në forcat e vetëmbrojtjes dhe në industrinë japoneze të mbrojtjes. Ky është një zhvillim që mirëpritet nga SHBA, pasi siguria e dobët kibernetike e Qeverisë japoneze ka qenë një “pengesë kritike për thellimin e bashkëpunimit dhe zgjerimit të ndarjes së informacioneve” mes dy shteteve.”¹⁰

“Nëse shtrojmë pyetjen cili mund të jetë objektivi i një plani kombëtar të sigurisë kibernetike, askush nuk ka një përgjigje të qartë. Ekzistojnë shumë plane për të krijuar një standard dhe për ta vlerësuar atë, por kjo nuk do të thotë asgjë për efektin e përgjithshëm të tyre në siguri. Është më lehtë të thuash, “Ky është standardi, por a jemi ne në përputhje me të?” Por ka një masë që mund ta krahasojmë dhe të themi: “Uau, kjo vjen gjithmonë dhe duke u përqesuar për çdo vit.” Nuk ka asnjë mënyrë për të matur në mënyrë sasiore rrezikun. Por në Uashington, janë të qetë duke u mjaftuar vetëm me auditimin ndaj standardit.”¹¹

Ndryshimi që duhet bërë në “Strategjinë për Mbrojtjen Kibernetike 2021-2023” është zotërimi i “aftësive kundërsulmuese”, të cilat konsiderohen “të domosdoshme” dhe imediate. Duke synuar që brenda objektivave të kësaj strategjie të arrihet të zotërohen aftësitë “për të ndërprerë dhe mposhtur shumë më herët sulmet kibernetike”, duke e konsideruar këtë si një nga pjesët më të rëndësishme të strategjisë së sigurisë kombëtare.

Bashkëpunimi me vendet që i përkasin mjedisit tonë strategjik, përpjekjet që synojnë arritjen e një hapësire kibernetike të sigurt dhe të besueshme arrihet duke krijuar marrëdhënie besimi për shkëmbimin e informacionit dhe të dhënave thelbësore të sigurisë kibernetike gjatë realizimit të bashkëpunimit dhe nismave zhvillimore.

Strategjia për Mbrojtjen Kibernetike shërben për të siguruar që një vend përdor sistemet e informacionit dhe telekomunikacionit në mënyrë të sigurt, duke forcuar aftësitë e parandalimit, mbrojtjes, zbulimit analizën, hetimin dhe rikuperimin ndaj sulmeve kibernetike. Gjithashtu, për të siguruar që përdorim informacionin dhe sistemet e telekomunikacionit në mënyrë të sigurt, duke forcuar aftësitë e reagimit ballë për ballë dhe duke kryer veprimet e dizajnuara për të arritur standardet ndërkombëtare të sigurisë kibernetike dhe ngritjen progresive të tyre, duhet që:

¹⁰ “Pse Japonia po rrit aftësitë ushtarake?” Radio Europa e Lirë

¹¹ Richard Bejtlich, analist i Mandiant

- Sistemet e Informacionit dhe Telekomunikacionit të përdorura nga Autoritetet Publike të kenë nivelin e duhur të sigurisë kibernetike dhe qëndrueshmërisë.
- Të nxitet zbatimi i një kuadri kombëtar koherent dhe gjithëpërfshirës për politikën, procedurat dhe standardet teknike që ndihmojnë në sigurimin e mbrojtjes së informacionit publik.
- Sektori i biznesit në përgjithësi dhe operatorët e infrastrukturave kritike në veçanti të nxiten që të përdorin teknologji të sigurtë dhe të qëndrueshme.
- Të sigurohet ruajtja dhe zhvillimi i trashëgimisë teknologjike.
- Të rriten aftësitë e parandalimit, zbulimit, reagimit, analizës, rimëkëmbjes, reagimit, hetimit dhe koordinimit kundrejt aktiviteteve terroriste dhe krimit në hapësirën kibernetike.
- Të forcohet bashkëpunimi ndërkombëtar juridik dhe policor, duke krijuar instrumente të përshtatshme për bashkëpunim dhe shkëmbim informacioni dhe harmonizimin e legjislacionit kombëtar.
- Qytetarët, profesionistët, kompanitë dhe autoritetet publike të ndërgjegjësohen për rreziqet që rrjedhin nga hapësira kibernetike.
- Kompanitë të jenë të vetëdijshme për përgjegjësinë për të garantuar sigurinë e sistemeve të tyre, mbrojtjen e informacionit të klientëve dhe furnitorëve të tyre dhe besueshmërinë e shërbimeve që ofrojnë.
- Të fitohen dhe ruhen njohuritë, aftësitë, përvojën dhe aftësitë teknologjike, për të mbështetur të gjitha objektivat e sigurisë kibernetike.
- Të nxitet dhe të ruhet në mënyrë efektive aktiviteti i R&D&I¹² në sigurinë kibernetike.
- Të kontribuohet në përmirësimin e sigurisë kibernetike në hapësirën ndërkombëtare.
- Globalizimi teknologjik të kërkojë përafrimin me të gjitha nismat e gjithë vendeve që ndjekin një hapësirë kibernetike të sigurt dhe të besueshme.

Kultura e sigurisë kibernetike synon rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve, profesionistëve dhe kompanive për rëndësinë e sigurisë kibernetike dhe përdorimin me përgjegjësi të teknologjive të reja dhe shërbimeve të shoqërisë së informacionit.

¹² Research and Development and Innovation

Përfundime

Plotësimi i domosdoshmërive strategjike në fushën e sigurisë kombëtare është një proces që kërkon zbatimin e SSK-së, e cila ka rëndësi jetike për të ardhmen e vendit dhe mbrojtjen e vlerave tona kombëtare.

Arritja e sigurisë së plotë është një punë e vazhdueshme e cila zgjidhet me mirëmbajtje të vazhdueshme të sistemeve të informacionit, krijimin e mekanizmave të duhur që mundësojnë koordinimin, bashkëveprimin dhe sinergjinë e institucioneve të sigurisë, si dhe harmonizimi i funksionimit të tyre me ato ekzistuese, për të arritur funksionimin e koordinuar dhe efikas të gjithë komponentëve të Sistemit të Sigurisë Kombëtare.

Sulmet e teknologjisë së bazuar në informacion janë jashtëzakonisht të lehta për t'u ekzekutuar. Mjetet janë relativisht të lira, të lehta për t'u kontrabanduar, praktikisht të pazbulueshme dhe të vështira për t'u shoqëruar. E gjithë kjo, së bashku me cenueshmërinë e rrjeteve të komunikimit civil (të cilat janë jashtëzakonisht tërheqëse për terroristët), u mundëson veprimeve të luftës informative një vend të spikatur në arsenalin terrorist.

Strukturat dhe organet e ndryshme ligjzbatuese, në zbatim të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen kibernetike, duhet të përcaktojnë rregullat dhe përgjegjësitë mbi masat e sigurisë së informacionit dhe të stimulojnë nëpërmjet testeve të ndryshme aftësitë dhe kapacitetet e strukturave në përballimin, ose jo, të këtyre sulmeve.

Aktualisht, teknologjia e informacionit është një nga mjetet kryesore për krijimin e avantazheve konkurruese. Teknologjitë e informacionit lejojnë organizimin e proceseve të tilla si: menaxhimi i projektit, menaxhimi operacional, menaxhimi i rrezikut, menaxhimi i shitjeve, menaxhimi financiar dhe proceset e tjera të biznesit në një nivel cilësor të ri.

Bibliografia

1. Ligji nr. 2/2017 “Për sigurinë kibernetike”.
2. Ligji nr. 64/2014 “Për Pushtetet dhe Autoritetet e Drejtimit e të Komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
3. Ligji nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për Informacionin e Klasifikuar “Sekret Shtetëror” (ndryshuar me ligjin nr. 9541, datë 22.05.2006) (ndryshuar me ligjin nr. 25/2012, datë 15.03.2012).
4. Ligji nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

5. VKM nr.1084, datë 28.12.2020 “Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike dhe planit të veprimit 2020-2025”.
6. VKM nr. 553, datë 15.07.2020 “Për miratimin e Listës së Infrastrukturave Kritike të Informacionit dhe të Listës së Infrastrukturave të Rëndësishme të Informacionit”.
7. “Radio Europa e Lirë”, “Pse Japonia po rrit aftësitë ushtarake?”
8. Burimi elektronik: [https://www.researchgate.net/profile/ Karen-Scarfone](https://www.researchgate.net/profile/Karen-Scarfone)
Karen Scarfone konsulente kryesore për sigurinë kibernetike Scarfone në Clifton, Virxhinia, e cila zhvillon botime sigurie për agjencitë federale dhe publikun.

INTELIGJENCA ARTIFICIALE: PËRPARËSI, RREZIQE DHE MASA MBROJTËSE

Msc. Roland TASHI
AISM, Ministria e Mbrojtjes

Trajtesë e shkurtuar.

Inteligjenca artificiale duket se po nxiton për të plotësuar hapësirat ku arsyetimi logjik ka nevojë të ndihmohet duke zgjedhur dhe insistuar të aplikohet në sektorët, fushat kryesore të veprimtarisë njerëzore, përfshi atë ushtarake, civile, ekonomike dhe industriale.

Nuk mjafton vetëm kjo, shpejtësia për ta aplikuar inteligjencën artificiale gati në të gjithë veprimtarinë njerëzore duhet të shoqërohet dhe plotësohet fillimisht me përshtatjen ligjore, e cila duhet të kushtëzojë dhe disiplinojë nëpërmjet një kuadri të plotë ligjor ndërkombëtar. Për shembull, kur mendohet se ajo mundet të “zëvendësojë” inteligjencën njerëzore, deri në cilin nivel arrin besueshmëria e saj, çfarë ndodh në rast se ajo gabon gjatë operacioneve ushtarake dhe kush mban përgjegjësi për pasojat?

Në periudhën para krijimit dhe aplikimeve të inteligjencës artificiale, AI¹, konsiderohej gjithmonë e lidhur ngushtë me vetëdijen. Sot, inteligjenca artificiale tregon se mund të ekzistojë edhe pa vetëdijen, por do të duhen disa qindra vjet për të arritur një inteligjencë të avancuar, të krahasueshme me logjikën njerëzore.

Fjalët kyçe: Inteligjenca artificiale, logjika njerëzore, operacione ushtarake, luftë hibride, luftë asimetrike, teatri i luftës.

¹ AI - Inteligjenca artificiale, disiplinë e shkencës kompjuterike që studion bazat teorike, metodologjinë dhe teknikat që lejojnë dizajnimin e sistemeve hardware dhe software për të krijuar sisteme inteligjente të afta të simulojnë aftësinë dhe sjelljen e mendimit njerëzor.

Hyrje

Termi “inteligjencë artificiale” është përdorur që prej fillimit të viteve ‘50, por ende nuk ka një përkufizim të qartë, të plotë dhe të unifikuar, që të njihet në nivel ndërkombëtar. Termi “AI” (në anglisht) i referohet zakonisht cilësive të një makine për të shfaqur aftësi njerëzore si arsytimi, planifikimi dhe kreativiteti. Sidoqoftë, ky është një formulim që duhet plotësuar, sepse sistemet e AI mund të jenë shumë më komplekse, aplikimet e tyre nuk mund t’i përshtaten një përkufizimi specifik, pasi zhvillimet e shkencës së teknologjisë informatike, avancojnë në mënyrë të shpejtë dhe të vazhdueshme.

Historia e shkencës ka memorizuar disa tentativa për aplikimin e AI, të cilat premtuan se nëpërmjet saj njeriu mund të ndihmohej, por edhe të sfidohej.

Në vitin 1966, shkencëtari Joseph Weizenbaum krijon chatbot-in² e parë në histori, ELIZA, program për të stimuluar një bisedë të shkruar ndërmjet pacientit dhe kompjuterit, “mjekut” psikoterapist.

Në vitin 1997, për herë të parë në histori një kompjuter sfidon kampionin e botës në shah: programi i projektuar nga IBM quhej “DEEP BLUE” dhe kampioni i shahut është Garry Kasparov. Kompjuteri hyn në histori si kalkulatori i parë i aftë për të mposhtur një logjikë të avancuar njerëzore.

Në vitin 1997, një grup shkencëtarësh të udhëhequr nga Dr. Cynthia Breazeal, projektuan “KISMET”, një kokë roboti humanoid, i krijuar për të njohur dhe stimuluar emocionet duke bashkëvepruar me njerëzit.

Këta shembuj janë të ndryshëm, “ELIZA” tentoi të zhvillojë një bisedë përmes mesazheve, “DEEP BLUE” u kthye në shahistin e pamposhtur dhe “KISMET” mendohej të njihnte emocionet dhe të komunikonte si një qenie njerëzore, por ato kanë një emërues të përbashkët, inteligjencën artificiale.

Grupimet e Inteligjencës Artificiale.

Një mënyrë klasifikimi i grupon sistemet AI në tri kategori kryesore:

Inteligjenca artificiale e dobët: një sistem kompjuterik i aftë për të kryer detyra specifike në mënyrë më efikase sesa një qenie njerëzore.

Inteligjenca artificiale e fortë: sisteme kompjuterike të afta të tejkalojnë aftësitë njerëzore.

Super inteligjenca artificiale: Sisteme të afta për të tejkaluar aftësitë njerëzore thuajse në të gjitha fushat, veçanërisht në kërkimet shkencore, logjikën, madje edhe në aftësitë sociale.

² **Chat bot** – aplikacion software që përdoret për të zhvilluar një bisedë nëpërmjet teksteve të shkruara, duke evituar kontaktin e drejtpërdrejtë njerëzor.

Në fushën ushtarake, AI ka avancuar duke dhënë shenja se do të ketë më shumë përdorim në planifikimin, zhvillimin e operacioneve, njohjen e elementëve të luftës hibride, asimetrike dhe informacionit, parashikimin e humbjes apo fitores, etj. Njësitë luftarake përdorin aktualisht sisteme të pavarura për të kryer detyra të vlerësuara të vështira, kryesisht në dhënien e zgjidhjeve ndaj skenarëve komplekse të konflikteve, në operacionet asimetrike dhe luftën hibride. Në këtë proces, përpunimi i të dhënave të mbledhura nga AI, seleksionimi dhe grupimi i tyre sipas qëllimit të përdoruesit, u siguron analistëve ushtarakë dhe atyre të inteligjencës, një vizion më të saktë për situatën, mbledhjen dhe përpunimin e informacionit të nevojshëm, shfrytëzimin, shpërndarjen e produktit deri në vendimmarrje.

Aftësia e AI për të mbledhur në mënyrë të pavarur informacion duke përdorur dronë, sensorë tokësorë, detarë dhe ajrorë, duke lundruar dhe shfrytëzuar hapësirën kibernetike, krijon mundësinë për rritjen e nivelit sasior të informacionit, ballafaqimin e tij dhe si rrjedhim nxjerrjen e rezultatit të nevojshëm në kohën më të shpejtë të mundur për t'u shfrytëzuar. Volumi i të dhënave të grumbulluara analizohet tërësisht nga pajisjet informatike që përdorin AI, operacion që do ishte i vështirë të kryhej në një kohë të shpejtë nga aftësia logjike njerëzore.

Inteligjenca artificiale mund të ndihmojë në zbulimin, identifikimin dhe monitorimin e prezencës së agjentëve CBRN³, nëpërmjet sensorëve gjurmues, integrimin e të dhënave në programe të dedikuara, në përmirësimin teknologjik të sistemeve aktuale të njohura si UAV⁴, UGV⁵, AUV⁶, si dhe në njohjen dhe krahasimin e imazheve, analizën e teksteve, identifikimin e mjeteve të vetëdrejtuar, dekriptimin e materialeve të sekretuara, etj.

Përfitimet në aplikimin e inteligjencës artificiale

Sipas një studimi të kryer nga RAND Corporation⁷, pas analizave, komenteve të ekspertëve të fushës, përfitimet që sjell përdorimi i inteligjencës artificiale gjatë krizave dhe operacioneve ushtarake në fushën e luftës, mund të klasifikohen në disa drejtime.

³ **CBRN** - akronim për lëndët kimike, biologjike, radiologjike dhe bërthamore. Përdoret për t'iu referuar situatave në të cilat një kërcënim mund të jetë pasojë e pranisë, përdorimit të këtyre lëndëve/agjentëve.

⁴ **UAV** - mjete ajrore pa ekuipazh/pasagjerë në bord.

⁵ **UGV** - mjete tokësore pa praninë njerëzore në bord.

⁶ **AUV** - mjete detare nënujore që lundrojnë pa kërkuar të dhëna të vazhdueshme nga një operator.

⁷ **Rand Corporation**, Military Applications of Artificial Intelligence, Ethical Concerns in an Uncertain World, 2020.

RAND Corporation – Themeluar në vitin 1946, me mbështetjen e Departamentit të Mbrojtjes amerikane. Prej vitit 1992 vepron edhe në Europë, nën mbikëqyrjen e RAND Europe.

Shpejtësia në marrjen e vendimeve, përfaqëson një nga përfitimet kryesore që AI mund të sjellë në një skenar kompleks operacional, duke i lejuar vendimmarrësit jo vetëm në sektorin ushtarak, por edhe në atë civil, të vlerësojë shpejt situata të vështira, duke dhënë zgjidhje të drejta. Elementet e parë të analizës, “Vëzhgo dhe Oriento”, lidhen me proceset e zbulimit dhe identifikimit të objektivave, ndërsa proceset pasuese “Vendos dhe Vepr”, kompletojnë marrjen e vendimit për të vepruar në fushën e luftës. Përfitimi mbetet gjithmonë të shpejtësia dhe cilësia e vendimmarrjes, në mënyrë që të kuptohen shpejt qëllimet e kundërshtarit dhe të veprohet në kohë për të reduktuar pasojat.

Përpunimi i trafikut të informacioneve të grumbulluara në volume të larta, të cilat vijnë nga pajisje të ndryshme, nuk mund të kryhet dhe administrohet nga programet e një pajisjeje të vetme kompjuterike, kjo për shkak të shpejtësisë së gjenerimit si dhe të formateve të ndryshme të pajisjeve prej të cilave ato kapen dhe transmetohen. Përzgjedhja, përpunimi dhe vlerësimi i një sasie shumë të madhe të dhënash është praktikisht i pamundur për një logjikë njerëzore. Sistemet AI mund të ndihmojnë në analizimin dhe përpunimin e këtyre të dhënave shpejt dhe saktë, për të njohur fillimisht situatën dhe për të planëzuar më pas veprimet operationale.

Analiza e imazheve, përbën një nga fushat ku mbingarkesa e të dhënave të siguruara, shkakton problemet më të mëdha lidhur me përpunimin cilësor dhe në kohë të shpejtë. Rritja e volumit të informacionit që sigurohet nëpërmjet imazhit të telekamerave dhe transmetimeve video, krijon shumë vështirësi në përpunimin automatik dhe analizimin e tyre. Sistemet e AI mund të ndihmojnë në përmirësimin e shpejtësisë dhe cilësisë së analizës së imazheve me aplikime në fushën ushtarake, kryesisht gjatë operationeve në luftën hibride dhe kundër terrorizmit.

Përmirësimi i saktësisë, rritjes së precizionit të pajisjeve ushtarake, avantazh tjetër i rëndësishëm i aplikimeve të AI. Sistemet dhe pajisjet teknologjike të nivelit të lartë inxhinierik, kanë dukshëm saktësi dhe cilësi më të madhe se logjika njerëzore. Në këtë drejtim, AI mund të korrigjojë vendimet njerëzore, për më tepër ajo mund të ndihmojë në përmirësimin e veprimtarive të simulimit dhe trajnimit, stërvitjes së burimeve njerëzore dhe forcave operationale në terren.

Aftësia për të vepruar në mjediset A2/AD⁸ mbetet një nga kontributet e AI, që lidhet me zbulimin dhe parandalimin e ndërhyrjes, agresionit të forcave kundërshtarë në zona të caktuara brenda rajoneve tokësore, hapësirave detare

⁸ **A2/AD** (Anti-Access/Air-Denial) - Strategji ushtarake për të kontrolluar aksesin brenda një mjedisi operativ, hyrjen dhe manovrimin e një force kundërshtarë në një zonë operationale.

dhe ajrore, me qëllim përfshirjen, ekspozimin e kontrolluar dhe të reduktuar të forcave ushtarake në operacione.

Përmirësimi i operacioneve të mashtrimit dhe luftës së informacionit, si një nga elementët e luftës hibride. Skenarët e sotëm të luftës janë larguar nga operacionet ushtarake tradicionale, ajo që njihet si lufta e rregullt, duke përfshirë tashmë forma dhe mënyra asimetrike, ku lufta me informacionin luan një rol të rëndësishëm. Informacioni po kthehet në armën e ftohtë për të diktuar dhe minuar planet e kundërshtarit, manipulimi nëpërmjet tij mbetet element thelbësor për të informuar apo dezinformuar popullsinë, për ta nxitur atë të jetë aktive, të marrë pjesë në veprime të parregullta ushtarake. Aplikimet e AI në këtë fushë mund të ndikojnë për të bindur një audiencë, komunitet të caktuar lidhur me interesin e veprimeve luftarake në një skenar të mundshëm konflikti, me rëndësi ushtarake dhe gjeopolitike. Programet inteligjente analizojnë fluksin, sasinë e madhe të informacioneve, opinioneve, thirrjeve, mesazheve të fshehura që individët e zakonshëm apo ata të qëllimshëm lëshojnë në internet, rrjete sociale, për të kuptuar përmbajtjen, nivelin e dezinformimi si dhe për të marrë nga AI “rekomandime” për masa, apo skenarë të mundshëm kundërveprimi. Ky proces nuk i është i thjeshtë, pasi format dhe mënyrat e dezinformimit janë komplekse dhe shumë të fshehura brenda propagandës mediatike, e cila ushtrohet për një periudhë të gjatë kohore.

Kufizimet e inteligjencës artificiale

Pavarësisht evolucionit që po ndodh me inteligjencën artificiale dhe aplikimin e saj në fusha të ndryshme të veprimtarisë njerëzore, krahas përparësive teknologjike dhe operacionale duket se ka akoma kufizime, të cilat mund të klasifikohen në tri kategori kryesore; ligjore, operacionale dhe strategjike.

Në këndvështrimin ligjor, referencat rregullatorë kryesore mbeten “Ligji i Konfliktëve të Armatosura” dhe “E Drejta Ndërkombëtare Humanitare”. Këto dokumente ndërkombëtare, të njohura dhe pranura në katër Konventat e Gjenevës të vitit 1949 dhe në dy Protokollet Shtesë të vitit 1977, synojnë të disiplinojnë, vendosin rregulla para, gjatë dhe pas konfliktëve të armatosura, kryesisht për mbrojtjen e civilëve, të plagosurve, të sëmurëve, robërve të luftës, të mbyturve, të personelit mjekësor, fetar, etj. Kuadri ligjor që disiplinon përdorimin e AI në sistemet ushtarake gjatë konfliktëve të armatosura, në veçanti aplikimi i sistemeve AWS⁹, duhet të parashikojë që veprimet dhe “sjellja” e tyre të jetë në përputhje me dispozitat ndërkombëtare.

- Artikulli 36 i Protokollet Shtesë, përcakton: “Në studimin, zhvillimin, blerjen

⁹ AWS (Autonomous Weapons System) - Sisteme autonome ku armët “veprojnë” ndaj objektivave të paracaktuar pa ndërhyrjen dhe kontrollin njerëzor.

ose adoptimin e një arme të re, mjeteve apo metodave të reja luftarake, “Pala kontraktuese” ka detyrimin të përcaktojë nëse përdorimi i saj nuk është i ndaluar, në rrethana të caktuara ose nën çdo rrethanë, nga dispozitat e këtij Protokolli, ose nga çdo rregull tjetër i së drejtës ndërkombëtare. Futja në armatim e pajisjeve të reja inventive, duhet të jetë konformë kritereve të përcaktuara ligjore, nëse pajisjet i plotësojnë këto kritere, janë të lejuara/ndaluara edhe nga konventa të tjera ndërkombëtare, si Konventa për Armët Kimike, Konventa e Armëve Biologjike, etj. Ose nëse përdorimi i këtyre teknologjive do të shkaktonte lëndime të panevojshme, si dhe dëmtime të rënda e afatgjata të mjedisit natyror dhe së fundi, nëse këto armë janë në përputhje me parimet e njerëzimit dhe parimet e ndërgjegjes publike.

- Vazhdon të ketë pikëpyetje nëse, AI është në gjendje të respektojë parimet e kujdesit, domosdoshmërisë dhe dallimit? A mundet që ajo të respektojë dhe veprimet brenda ligjshmërisë së konfliktit, i cili kërkon vlerësime të kryera rast pas rasti, edhe ndaj efekteve anësore të mundshme, si pasojë e goditjes së objekteve ushtarake? Ky vlerësim duket se kërkon më shumë sesa një analizë të sigurtuar nëpërmjet përpunimit të informacionit teknologjik sasior, ai duhet të përfshijë edhe një vlerësim të një natyre cilësore dhe etike, që vetëm logjika e një qenieje njerëzore mund ta ofrojë këtë shërbim. Në vijim të këtij argumenti, dallimi i saktë midis një luftëtari i cili në teatrin e luftës asimetrike nuk ka veshur uniformë ushtarake dhe një civili, ose një ushtari të plagosur që dorëzohet, kërkon diçka më shumë sesa kapaciteti i lartë i përpunimit të të dhënave që vjen nga sensorë të sistemeve të AI. Në këto situata duhet të futet në veprim aftësia për të vlerësuar qëllimin e njeriut, e cila përfshin kuptimin, interpretimin e shenjave të veçanta siç mund të jetë toni i zërit, shprehjet e fytyrës, ose gjuha e trupit, etj. Edhe pse sistemet e reja autonome të udhëhequra nga inteligjenca artificiale janë të avancuara dhe në gjendje të kryejnë shërbime të nivelit të lartë, përdorimi i tyre brenda një skenari konflikti duhet të garantojë një përputhje me të gjitha parimet që qëndrojnë në themel të ligjit të konflikteve të armatosura.

Përfundime

Inteligjenca artificiale nuk i ka zgjidhur të gjitha problemet, ku ndër kryesorët mbetet “përgjegjësia” për veprimet e gabuara të kryera nga sistemet autonome të drejtuara dhe komanduara prej saj, cilët do të mbeten fajtorë: projektuesit, prodhuesit, programuesit apo ushtarakët si operatorët/përdoruesit përfundimtarë.

Në rast se sistemet e armëve të AI veprojnë në mënyrë autonome, pa kontroll njerëzor, përgjegjësia për veprimet e tyre mund t'i mbetet lidërshipt ushtarak dhe politik, të cilët kanë vendosur t'i përdorin këto sisteme brenda një

skenari operacional. Por njëherësh, aftësitë e sistemeve të AI janë të lidhura me karakteristikat e tyre të projektimit dhe programimit. Sa më shumë autonomi të kenë sistemet, aq më të larta duhet të jenë parametrat, standardet e projektimit dhe programimit për të përmbushur ligjshmërinë dhe përkufizuar saktë përgjegjësinë.

Përveç çështjeve teknike, vendet anëtare të aleancave ushtarake duhet të përshtatin dhe të zhvillojnë doktrinat për përdorimin e inteligjencës artificiale gjatë veprimeve, operacioneve të përbashkëta në skenar konflikti, duke respektuar konceptin e ndërveprueshmërisë ligjore në mënyrë që të krijohet një kuadër ligjor, koherent dhe i përbashkët midis tyre.

Për të arritur në përdorimin e kontrolluar të AI, për të krijuar një kuadër të plotë dhe gjithëpërfshirës ligjor, është e nevojshme të sigurohet një bashkëpunim i fortë midis juristëve, projektuesve, prodhuesve dhe specialistëve ushtarakë, për të gjetur ekuilibrin e duhur midis teknikës, ligjit, etikës, sjelljes dhe fuqisë ushtarake. Sistemet e drejtuara nga AI duhet të operojnë në përputhje me ligjin dhe parimet njerëzore, për të parashikuar zhvillimin e operacioneve luftarake, jo vetëm brenda një skenari lufte tradicionale, por edhe gjatë operacioneve komplekse asimetrike dhe hibride, të cilat duket se po dominojnë luftën klasike.

Bibliografia

1. Për përgatitjen e këtij shkrimi, është shfrytëzuar dhe punuar artikulli *“L'intelligenza artificiale nel settore militare: Vantaggi, Rischi e Tutele necessarie”*, botuar në datën 22.09.2021 në *“Network Digital360”*, web italian i dedikuar për trajtimin e temave të *“Transformimit Dixhital”*. Opinonet dhe komentet e trajtuara, shprehin vetëm mendimin dhe gjykimin e autorëve.
2. Szabadföldi I, Artificial Intelligence in Military Application – Opportunities And Challenges, Land Forces Academy Review, 2021.
3. Rand Corporation, Military Application of Artificial Intelligence, Ethical Concerns in an Uncertain World, 2020.
4. HRW And International Human Rights Clinic, 2012.
5. HRW and International Human Rights Clinic, 2015.
6. S. Hill, N. Marsan, Artificial Intelligence and Accountability: A Multinational Legal Perspective, NATO S&T Organization.

APLIKIMI I TEKNIKAVE STATISTIKORE NË SIGURINË KIBERNETIKE NË EPOKËN E BIG DATA

Dr. Gentian HOXHALLI

Fakulteti i Mbrojtjes dhe i Sigurisë

Trajtesë e shkurtuar.

Në kohën kur interneti dhe teknologjia e informacionit janë përdorur gjerësisht në të gjitha aspektet e jetës moderne, siguria kibernetike është bërë një sfidë kryesore për organizatat dhe individët. Me rritjen e sasisë së të dhënave të prodhuara dhe të mbledhura në mënyrë dixhitale, si dhe me zhvillimin e teknologjive të reja si big data, ka nevojë për ndërmarrje të reja dhe të sofistikuara për të parandaluar sulmet kibernetike dhe për të identifikuar rreziqet e mundshme.

Ky artikull analizon aplikimin e teknikave statistikore në sigurinë kibernetike, me fokus të veçantë në kontekstin e big data. Pasqyrohen sfidat specifike të sigurisë kibernetike në epokën e big data, duke përfshirë sasinë e madhe të të dhënave, ndryshimin e shpejtësisë së informacionit dhe ndërveprimet komplekse midis elementëve të rrjetit.

Në artikull, shqyrtohen teknikat statistikore që përdoren për analizën dhe zbulimin e rrezikut në sigurinë kibernetike. Përfshihen metoda të ndryshme të modelimit statistikor, si regresioni logjistik, analiza e grupimeve (clustering), përkthimi i gjuhës natyrale (natural language processing), dhe analiza e renditjes së rrezikut (risk scoring analysis). Gjithashtu, shqyrtohen metodat e ndërlikuara të të mësuarit automatik, duke përdorur algoritme të Deep

Learning dhe Inteligjencën Artificiale (AI) për të identifikuar modele të zakonshme dhe anomalitë në të dhënat e rrjedhshme të sigurisë kibernetike. Përfitimet potenciale të përdorimit të statistikave në sigurinë kibernetike përfshijnë zbulimin e rrezikut të parakohshëm, ndërprerjen e sulmeve të ndërlikuara dhe rritjen e aftësisë për të parandaluar kërcënimet e ardhshme në ambientet kibernetike.

Fjalë kyçe: Modele statistikore, siguria kibernetike, *big data*, *Machine Learning* (ML), Inteligjenca Artificiale (AI)

Hyrje

Siguria kibernetike për sistemet e rrjetit ka qenë në fokusin kërkimor më shumë se tre dekadat e fundit nisur nga përdorimi i një gamë të gjerë aplikacionesh të rrjetit (*Jang - Jaccard & Nepal, 2014*). Sisteme të tilla janë të prekshme ndaj sulmeve të cilat synojnë të prishin ose dëmtojnë funksionalitetin e sistemit që synojnë të rrezikojnë sigurinë e informacionit.

Siguria kibernetike është një çështje kritike në botën e sotme të lidhur ngushtë me zhvillimin e teknologjisë së informacionit dhe rritjen e përdorimit të internetit. Me kalimin e kohës, kërcënimi i sulmeve kibernetike është rritur dhe ka evoluar në mënyra të sofistikuara, duke sjellë sfida të reja për organizatat dhe individët. Në këtë kontekst, aplikimi i teknikave statistikore ka ardhur në pah si një mjet efektiv për të parandaluar, identifikuar dhe luftuar sulmet kibernetike në epokën e *big data*.

Epoka e *big data* është një periudhë e karakterizuar nga sasia e madhe e të dhënave të prodhuara dhe të mbledhura nga sistemet e informacionit. Prandaj, ekziston nevoja për qasje të orientuara nga të dhënat statistikore dhe për analizimin e të dhënave komplekse të krijuara në monitorimin e rrjetit në shumë nivele (*Collins, 2017; F. Zhang et al., 2019*). Me rritjen eksponenciale të përdorimit të teknologjive dixhitale dhe rrjeteve sociale, të dhënat e gjeneruara kanë arritur shifra të larta. Një burim vendimtar i të dhënave janë sistemet operative të makinave në rrjet. Kohët e fundit, industria e sigurisë kibernetike ka prezantuar aftësi të reja për të kapur këto të dhëna, të njohura si teknologjia e zbulimit dhe reagimit të pikës së fundit (EDR) (*Hassan et al., 2020*). EDR përfshin shtimin e softuerit monitorues që ekzekutohet në sistemet operative i cili mat telemetri të ndryshme me interes sigurie dhe i ngarkon këto të dhëna ose në server në premisë ose në *cloud* për analizë.

Në këtë kontekst, teknikat statistikore ofrojnë mjete të fuqishme për të analizuar dhe interpretuar të dhënat e shumta të sigurisë kibernetike. Përdorimi i analizës së regresionit logjistik, analizës së grupimeve (*cluster analysis*), përkthimit të gjuhës natyrale (*natural language*) dhe analizës së renditjes së rrezikut mund

të ndihmojë në identifikimin e modeles së sulmit, për të parashikuar tendencat dhe për të krijuar një sistem parandalues të sigurt. Rritja gjatë viteve të fundit e pajisjeve të lidhura me internetin dhe teknologjive operacionale ka shkaktuar një rritje dramatike të sasisë së të dhënave të mbledhura, duke e bërë më akute nevojën për metoda statistikore të automatizuara dhe të shkallëzuar. Përveç kësaj, ka një rritje të numrit të sensorëve të rinj të matjes që vendosen në rrjete, dhe bashkë me të burimet e reja të të dhënave që kapin sjelljet e rrjetit që më parë nuk ishin monitoruar.¹

Përveç kësaj, metodat e sofistikuara të mësimit automatik, si algoritmet e *deep learning* dhe inteligjenca artificiale, kanë ndikuar thelbësisht në zhvillimin e sigurisë kibernetike në epokën e *Big Data*. Këto teknika lejojnë njohjen e modeles së rrezikut dhe identifikimin e anomalive, duke përmirësuar aftësinë e sistemeve për të parandaluar sulmet dhe për të mbrojtur të dhënat kritike.

Ky artikull shkencor synon të shqyrtojë aplikimin e teknikave statistikore në sigurinë kibernetike në epokën e *Big Data*. Do të analizojmë sfidat e veçanta të kësaj fushe, si dhe përparimet dhe mundësitë që ofrojnë teknikat statistikore për të parandaluar sulmet kibernetike, zbuluar rrezikun, dhe ndërprerë sulmet në mënyrë efektive. Gjithashtu, do të shqyrtojmë përfitimet e përdorimit të metodave të sofistikuara të mësimit automatik dhe inteligjencës artificiale në zbatimin e sigurisë kibernetike.

Ky artikull synon të ofrojë një vështrim të gjerë mbi rolin dhe rëndësinë e teknikave statistikore në sigurinë kibernetike në epokën e *Big Data*. Do të hedhim dritë mbi metodat e përdorura për të analizuar dhe parashikuar tendencat e sulmeve kibernetike, për të identifikuar modele të zakonshme dhe anomalitë në të dhënat e sigurisë, si dhe për të përmirësuar sistemet parandaluese.

Zhvillimet gjatë dekadës të fundit në fushën e *Cyber security*

Siguria kibernetika (*cyber security*) është bërë një sfidë jetike për organizatat dhe individët gjatë dekadës së fundit. Zhvillimet teknologjike të shpejta dhe rritja e përdorimit të internetit kanë sjellë shumë avantazhe, por kanë hapur edhe dyert për sulmet kibernetike të sofistikuara.

Një nga tendencat kryesore është rritja e sulmeve kibernetike të sofistikuara. *Hakerët* kanë zhvilluar metoda të avancuara për të shkelur sistemet e sigurisë dhe për të hyrë në rrjetet kompjuterike të organizatave të ndryshme. Një shembull i tillë është sulmi me *ransomware* WannaCry që ndodhi në vitin 2017². Ky sulm i shkaktuar nga një grup *hakerësh* përdorte një vulnerabilitet

¹ <https://hdr.mitpress.mit.edu/pub/koyzu1te/release/1>

² https://www.cisa.gov/sites/default/files/FactSheets/NCCIC%20ICS_FactSheet_WannaCry_Ransomware_S508C.pdf

të njohur në sistemet *Windows* dhe kërkonte pagesa për rikthimin e të dhënave të bllokuara. Sulmi u përhap në nivel global dhe u tregua se edhe organizatat e rëndësishme mund të jenë të ekspozuara ndaj këtyre rreziqesh.

Një tendencë tjetër është zhvillimi i inteligjencës artificiale (AI) dhe më shumë përdorimi i saj në fushën e *cyber security*. AI mund të përdoret për të identifikuar dhe parashikuar sulmet kibernetike, për të zbuluar anomalitë dhe për të përgjigjur ndaj tyre në kohë reale. Një shembull i kësaj është përdorimi i teknologjisë së *Machine learning* për të zbuluar sulmet e *phishing*-ut dhe për të ndihmuar në ndërtimin e modeleve të parashikimit të rrezikut. Këto zhvillime janë të rëndësishme për të përballuar sulmet e sofistikuara dhe për të rritur rezistencën e sistemeve kibernetike. *Machine learning* dhe *Deep learning* janë aplikuar për të bashkuar dhe për të përfituar nga shumëllojshmëria e burimeve të të dhënave (Sarker et al., 2020), për zbulimin dhe parandalimin e *malware*, (Dua & Du, 2011; Mahmood & Afzal, 2013). Shumë prej këtyre algoritmeve mbikëqyren dhe përdoren për të nxjerrë veçori rreth të dhënave që i lejojnë ato të identifikojnë raste të reja të *malware*. ML ka pasur një ndikim në shërbimet e sigurisë të nivelit të përdoruesit, për shembull, filtrat e postës së padëshiruar të *Gmail* dhe *Yahoo* përfshijnë metoda ML që arrijnë saktësi shumë të lartë të zbulimit (Dada et al., 2019). Kjo sugjeron që ML mund të përdoret për të përmirësuar në mënyrë të ngjashme metodat tradicionale të sigurisë.

Një tjetër aspekt është rritja e ndërgjegjësimit dhe rregullimit ligjor të çështjeve të sigurisë kibernetike. Shtetet dhe organizatat ndërkombëtare kanë bërë përpjekje për të rregulluar dhe për të ndërtuar struktura ligjore për të mbrojtur infrastrukturën kritike dhe për të ndëshkuar sulmuesit kibernetike. Për shembull, në vitin 2018, në Bashkimin Evropian hyri në fuqi Rregullorja e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR), e cila vendos standarde të larta për mbrojtjen e të dhënave personale dhe obligon organizatat të marrin masat e nevojshme për të parandaluar shkeljen e sigurisë kibernetike.

Një shembull tjetër i zhvillimit në fushën e *cyber security* është rritja e ndërgjegjes së përdoruesve për rrezikun kibernetik. Individët dhe organizatat po marrin masat e nevojshme për të ruajtur informacionin e tyre dhe për të minimizuar rrezikun e sulmeve kibernetike. Krijimi i politikave të sigurisë të kompanive, trajnimet për përdoruesit dhe përdorimi i mjeteve të sigurisë si *firewalls* dhe antivirus janë disa nga masat e ndërmarra për të përmirësuar sigurinë kibernetike. Ndërtimi i mbrojtjeve efektive duhet të përfshijë mekanizma të drejtuar nga analiza e të dhënave të kombinuara me modele stokastike, grafe dinamike dhe konceptet të kontrollit statistikor (Neil et al., 2013; Turcotte et al., 2018).

Gjithashtu, është vënë në dukje rëndësia e bashkëpunimit ndërkombëtar

në luftën kundër sulmeve kibernetike. Shumë shtete dhe organizata janë përpjekur të ndërtojnë marrëveshje dhe mekanizma bashkëpunimi për të ndarë informacionin dhe për të përballuar sfidat e sigurisë kibernetike në nivel global. Një shembull i kësaj është krijimi i CERT (*Computer Emergency Response Teams*) dhe organizatave të ngjashme në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar për të reaguar ndaj sulmeve dhe për të mbrojtur rrjetet kibernetike. Megjithëse është bërë progres në fushën e *cyber security* gjatë kësaj dekade, sfidat vazhdojnë të rriten. *Hackerat* dhe sulmet kibernetike vazhdojnë të zhvillohen dhe të përshtaten me zhvillimet teknologjike të reja. Prandaj, është e rëndësishme që organizatat dhe individët të mbajnë hapur sytë dhe të jenë të përgatitur për t'u përballur me këto sfida në mënyrë efektive.

Në përfundim, *cyber security* ka kaluar nëpër ndryshime të mëdha në këtë dekadë. Sulmet kibernetike të sofistikuar, përdorimi i inteligjencës artificiale, ndërgjegjësimi dhe rregullimi ligjor, rritja e ndërgjegjes së përdoruesve dhe bashkëpunimi ndërkombëtar janë disa nga zhvillimet kyçe që kanë ndikuar në këtë fushë. Megjithatë, sfidat vazhdojnë të ekzistojnë dhe duhet të vazhdohet të investohet në sigurinë kibernetike për të parandaluar sulmet dhe për të ruajtur integritetin e sistemeve kibernetike në Epokën e *Big Data*. Një përqendrim i vazhdueshëm në inovacionin e teknologjisë së sigurisë kibernetike dhe përdorimi i teknikave statistikore ka potencialin për të ndihmuar në parandalimin, zbulimin dhe reagimin ndaj sulmeve kibernetike në mënyrë më efektive.

Disa teknika statistikore që përdoren në fushën e sigurisë kibernetike për të analizuar riskun e sulmeve kibernetike

Në hulumtimet e fundit, është vënë theksi në përdorimin e teknikave statistikore për të analizuar dhe modeluar të dhënat e sigurisë kibernetike në epokën e *big data*. Për shembull, analiza e ngjarjeve të largëta (*remote events*) dhe ngjarjeve të brendshme (*insider events*) ka bërë të mundur identifikimin e modeleve statistikore për zbulimin e aktiviteteve të dyshimta dhe anomale në rrjetet kibernetike. Përdorimi i algoritmeve të ML së përkrahur dhe të DL për të zbuluar modele të pazakonta dhe për të identifikuar sulme të mundshme ka qenë një fushë shumë premtuese e hulumtimit shkencor në këtë drejtim. Gjithashtu, përdorimi i teknikave statistikore për analizën e trafikut të rrjetit ka qenë një aspekt tjetër i rëndësishëm në fushën e *cyber security*. Analiza e modeleve të trafikut, identifikimi i përdorimit të të dhënave (*packet sniffing*), dhe zbulimi i aktiviteteve të dyshimta janë disa prej sfidave të cilat mund të adresohen përmes teknikave statistikore. Përdorimi i teknikave të grupimit (*clustering*) dhe analizës së komuniteteve (*community network*) në rrjetet kibernetike mund të ndihmojë në identifikimin e përkushtimit të shpërdorimit të burimeve të rrjetit dhe në parandalimin e sulmeve masive. Zhvillimi i

modeleve statistikore të avancuara dhe përdorimi i teknikave të avancuara të analizës së të dhënave janë duke sjellë përparime në këtë fushë. Në figurën më poshtë tregohet trendi i publikimeve dhe kërkimeve shkencore në lidhje me përdorimin e ML në fushën e sigurisë kibernetike duke u bazuar në një nga databazat më të rëndësishme shkencore ndërkombëtare ELSEVIER (*Scopus*). Nga figura dallohet që gjatë dekadës së fundit kemi rritje të përdorimit të teknikave ML dhe DL në fushën e sigurisë si dhe rritje të hulumtimeve shkencore në këtë drejtimi.




Figura 1-Trendi i hulumtimit për ML dhe Cyber Security në vite
Burimi:Scopus

Nga hulumtimet rezulton se, ka disa qasje të ndryshme të aplikimeve të ML të lidhura me sigurinë, duke përfshirë: modelet e ML dhe Teorinë e Lojës për filtrimin e spam-it në rrjetat e komunikimit (C. Wang et al., 2021); metodat statistikore të zbulimit të anomalive që mund të tregojnë ndryshime delikate në të dhënat e rrjetit (Lazarevic et al., 2003); transferimi për zbulimin e sulmeve të reja të rrjetit (Zhao et al., 2019); dhe metoda gjysmë të mbikëqyrura që mund të mësojnë nga të dhënat e rrjetit (Hou et al., 2018). Është bërë e qartë se algoritmet e ML janë mjaft të prekshme ndaj sulmeve t gjatë fazave të trajnimit dhe testimit, sipas autorëve (Goodfellow et al., 2015), (Y. Zhou et al., 2012). *High - dimensional deep neural network* janë veçanërisht të ndjeshëm, për shembull, klasifikuesit e rrjeteve *Convolutional Neural Network* (CNN) mund të rrezikohen nga sulmuesit që aplikojnë metoda të thjeshta të “optimizimit të rendit zero» (ZOO) (P.-Y. Chen et al., 2017) për të mposhtur klasifikuesin që sipas autorëve vazhdon me diskutimin e përparimeve në metodat statistikore të zbulimit të anomalive që kanë potencial për të përmirësuar sigurinë e sistemit të ndërmarrjes. Sulmet që dobësojnë kibernetikën në infrastrukturën e rrjetit të shumë organizatave të ndërmarrjeve janë në rritje dhe po bëhen gjithnjë e më të sofistikuar dhe kërcënuese (Sanger, 2018).

Teknikat statistikore janë përdorur me sukses në fushën e *cyber security* për të analizuar dhe zbuluar modele të pazakonta, identifikuar aktivitete të dyshimta dhe parandaluar sulme kibernetike. Disa nga teknikat statistikore më të përdorura janë:

1. Analiza e ngjarjeve të largëta (*Remote Events Analysis*): Kjo teknikë fokusohet në identifikimin e modelit statistikorë për zbulimin e aktiviteteve të dyshimta dhe anomale në rrjetet kibernetike. Duke analizuar ngjarjet e largëta, si tentativa të pashpallura për hyrje në rrjet, përpjekjet për të gjetur vulnerabilitete, ose sulmet e kohës së drejtpërdrejtë, mund të zbulohen modele të pazakonta që tregojnë në drejtim të sulmeve kibernetike.

2. Analiza e trafikut të rrjetit (*Network Traffic Analysis*): Ky është një aspekt i rëndësishëm në sigurinë kibernetike. Përdorimi i teknikave statistikore për të analizuar dhe modeluar trafikun e rrjetit mund të ndihmojë në identifikimin e përdorimit të pakuptimit të të dhënave, identifikimin e sulmeve të mundshme, dhe parandalimin e sjelljeve të dyshimta. Kjo përfshin teknika si grupimi (*clustering*) dhe analiza e komuniteteve në rrjet, për të identifikuar shpërdorimet e burimeve të rrjetit dhe sulmet masive. Analiza e rrjetit kategorizohet në tre kategori kryesore: a) e bazuar në nënshkrime që përdoret më së shumti për të zbuluar sulmet e njohura duke shmangur një numër të madh të shkallës së alarmit të rremë (FAR), b) e bazuar në anomali që përdoret kryesisht për të identifikuar sjelljen anormale të rrjetit dhe sistemit, dhe c) me bazë hibride që është kombinimi i kategorisë (a dhe b), për të ulur FAR për sulme të panjohura

3. Analiza e rrezikut (*Risk Analysis*): Teknikat statistikore përdoren për të vlerësuar rrezikun e sulmeve kibernetike dhe për të identifikuar zonat e ndjeshme dhe të ekspozuara në sistemet kibernetike. Kjo përfshin identifikimin e vulnerabiliteteve të mundshme, analizën e ndikimit të mundshëm të sulmeve, dhe përcaktimin e niveleve të rrezikut. Këto informacione ndihmojnë në marrjen e vendimeve të përshtatshme për të përmirësuar sigurinë kibernetike dhe për të reduktuar rrezikun.

4. Modelimi dhe parashikimi i sulmeve (*Attack Modeling and Prediction*): Përdorimi i teknikave statistikore për të modeluar dhe parashikuar sulmet kibernetike është një sfidë e rëndësishme në fushën e *cyber security*. Duke analizuar të dhënat historike të sulmeve dhe duke përdorur modele statistikore të avancuara, është e mundur të bëhen parashikime për llojet e sulmeve të pritshme, mënyrat e tyre të zhvillimit, dhe masat e nevojshme për t'u mbrojtur nga to.

Këto janë vetëm disa nga teknikat statistikore që përdoren në fushën e *cyber security*. Në vazhdim, disa teknika të tjera janë:

1. Analiza e vizualizimit të të dhënave (*Data Visualization Analysis*): Përdorimi i teknikave të vizualizimit të të dhënave mund të ndihmojë në zbulimin e

modeleve të fshehura dhe të pazakonta në të dhënat e sigurisë kibernetike. Duke paraqitur të dhënat në formë grafike dhe vizuale, është më e lehtë të identifikohen tendencat, korrelacionet dhe anomali në aktivitetin e rrjetit.

2. Analiza e rritjes së klasifikimit (*Growth Analysis*): Kjo teknikë përdoret për të identifikuar rritjen e rrezikut në sistemet kibernetike dhe për të parashikuar sulmet e mundshme në të ardhmen. Duke analizuar historinë e rritjes së sulmeve dhe duke përdorur modele statistikore, mund të identifikohen zonat e ndjeshme dhe të përmirësohet përgjigja ndaj këtyre rritjeve.

3. Modelimi i truallit të rrezikut (*Threat Landscape Modeling*): Përdorimi i teknikave statistikore për të modeluar peizazhin e rrezikut në fushën e sigurisë kibernetike është një qasje e rëndësishme. Duke analizuar të dhënat e rrezikut të mbledhura nga burime të ndryshme, si CERT (*Computer Emergency Response Teams*), raportet e sigurisë, dhe organizatat ndërkombëtare të sigurisë kibernetike, mund të krijohen modele statistikore të truallit të rrezikut për të parashikuar sulmet e mundshme dhe për të marrë masa parandaluese.

4. Analiza e rregullsisë së të dhënave (*Data Regularity Analysis*): Kjo teknikë përdoret për të identifikuar aktivitete të pazakonta dhe të dyshimta në të dhënat e sigurisë kibernetike. Përmes analizës së rregullsisë së të dhënave, është e mundur të identifikohen shabllone dhe modele të zakonshme të aktivitetit të rrjetit. Çdo ndryshim i pazakontë në rregullsinë e të dhënave mund të interpretohet si një aktivitet i dyshimtë dhe të vijnë masat e nevojshme për të adresuar këtë situatë.

Këto janë vetëm disa nga teknikat statistikore më të përdorura në sigurinë kibernetike. Përdorimi i tyre në kombinim me teknologjitë e tjera të sigurisë kibernetike dhe me analizën e të dhënave të mëdha (*big data*) siguron një qasje të avancuar për të zbuluar, parandaluar dhe adresuar sulmet kibernetike. Këto teknika ndihmojnë në identifikimin e modeleve të pazakonta dhe të dyshimta në aktivitetin e rrjetit, në parashikimin e sulmeve të mundshme dhe në përmirësimin e aktivitetit të sigurisë kibernetike. Sidoqoftë, është e rëndësishme të theksohet se sfidat në fushën e sigurisë kibernetike janë në vazhdimësi në zhvillim dhe kërkojnë teknika të avancuara për të adresuar to.

Një teknikë shtesë e përdorur në sigurinë kibernetike është analiza e të dhënave të log-ve. Kjo përfshin përdorimin e teknikave statistikore për të identifikuar modelet e dyshimta, tentativat e paligjshme për hyrje, ose aktivitetet e pazakonta në bazë të të dhënave të regjistruara në log-et e sistemit. Përdorimi i analizës së rregullsisë së të dhënave dhe algoritmeve të deteksionit të anomalive mund të ndihmojë në identifikimin e sulmeve të mundshme dhe në reagimin e menjëhershëm ndaj tyre.

Disa masa për parandalimin e sulmeve kibernetike

Gjithnjë e më shumë organizata kibernetike po përdorin teknikat statistikore për të përmbyshur qëllimet e tyre të sigurisë kibernetike. Përdorimi i tyre ndihmon në përmirësimin e aftësive të zbulimit, zbulimin e sulmeve të reja dhe për të përballuar sfidat e sigurisë kibernetike në mënyrë më efektive.

Megjithatë, është e rëndësishme të kuptohet se teknikat statistikore janë vetëm një mjet për të mbështetur sigurinë kibernetike dhe se për të arritur sukses, është e nevojshme të kombinohen me teknologjitë e tjera dhe me një qasje holistike ndërmjet një strategjie të integruar të sigurisë kibernetike. Kështu, përdorimi i teknikave statistikore duhet të shoqërohet me masat e sigurisë të tjera si:

1. Monitorimi i rrjetit: Një sistem i vazhdueshëm monitorimi i rrjetit ndihmon në identifikimin e aktiviteteve të dyshimta dhe sulmeve potenciale. Kjo përfshin përdorimin e teknologjive të monitorimit të rrjetit, duke analizuar trafikun e rrjetit dhe identifikuar ndryshimet e papritura në nivelin e trafikut.

2. Sistemet e identifikimit dhe autentifikimit: Përdorimi i sistemeve të identifikimit dhe autentifikimit të sigurta ndihmon në parandalimin e hyrjeve të paligjshme në sisteme dhe në mbrojtjen e informacionit të ndjeshëm. Këto sisteme përfshijnë verifikimin e identitetit të përdoruesve, përdorimin e faktorëve të dyfishtë të autentifikimit dhe përdorimin e teknologjive të enkriptimit për të mbrojtur të dhënat.

3. Mbrojtja e sistemeve operative: Sigurimi i sistemeve operative dhe zhvillimi i politikave të sigurisë përkatëse janë thelbësore për të parandaluar hyrjet dhe për të mbrojtur integritetin dhe disponueshmërinë e tyre. Kjo përfshin përdorimin e mjeteve të sigurisë së sistemit, si *firewall*, antivirus, dhe sisteme deteksioni të intruzioneve.

4. Trajnimi dhe ndërgjegjësimi i personelit: Një aspekt kritik në sigurinë kibernetike është ndërgjegjësimi dhe trajnimi i personelit. Përdorimi i teknikave statistikore për të identifikuar rreziqet e përgjithshme të sigurisë kibernetike mund të përdoret për të zhvilluar programe trajnimi dhe ndërgjegjësimi të përshtatshme për personelin, duke i informuar ata për metodat e sulmeve dhe praktikat e sigurta.

Përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, si dhe përdorimi i praktikave të mira të sigurisë, është gjithashtu thelbësore për të përballuar sfidat e sigurisë kibernetike në mënyrë efektive.

E ardhmja e aplikimeve të modeleve statistikore në fushën e *cyber security*

Teknikat për sigurinë kibernetike pritet të vazhdojnë të zhvillohen në të ardhmen, për të përshtatur me sfidat e reja të kësaj fushe dhe për të adresuar më mirë rreziqet e sigurisë kibernetike. Disa zhvillime të mundshme të këtyre teknikave janë:

- a. Integrimi i mëtejshëm i AI dhe ML: Një zhvillim i vazhdueshëm pritet të jetë përdorimi i inteligjencës artificiale dhe makinës së mësimit për të përmirësuar aftësinë e sistemeve të sigurisë kibernetike për të identifikuar, parandaluar dhe reaguar ndaj sulmeve kibernetike. Këto teknologji mund të përdoren për të zbuluar modele të reja të sulmeve, për të automatizuar proceset e sigurisë dhe për të zbuluar aktivitetet e dyshimta më shpejt dhe me më pak gabime.
- b. Zhvillimi i teknikave të analizës së *big data*: Me rritjen e vëllimit të të dhënave në fushën e sigurisë kibernetike, është e nevojshme të zhvillohen teknika të avancuara të analizës së *big data* për të identifikuar modele dhe tendenca të reja në sulmet kibernetike. Kjo përfshin përdorimin e teknologjive të analizës së të dhënave të mëdha, si mjedise të skedarave të rrjedhjes së ngjarjeve (SIEM) dhe platforma të specializuara të analizës së *big data*.
- c. Siguria e inteligjencës artificiale dhe ML: Ndërsa inteligjenca artificiale dhe ML janë përdorur për të përmirësuar sigurinë kibernetike, është e rëndësishme të zhvillohen teknika të specializuara për të siguruar vetë sigurinë e këtyre teknologjive. Kjo përfshin zhvillimin e metodave të verifikimit të sigurisë për modele të inteligjencës artificiale dhe makinave të mësuara, për të parandaluar manipulimin e tyre dhe për të garantuar që ata të jenë të besueshëm dhe të sigurt në mjediset kibernetike.
- d. Përdorimi i teknikave të analizës së kontekstit (*data maining*): Me evoluimin e sulmeve kibernetike, është e rëndësishme të përdoren teknika të analizës së kontekstit për të kuptuar më mirë mënyrat se si sulmuesit operojnë dhe për të identifikuar rreziqet. Kjo përfshin analizën e kontekstit të të dhënave të sigurisë kibernetike, si informacionin e sistemit, aktivitetet e përdoruesve, dhe të dhënat e trafikut të rrjetit, për të identifikuar mënyrat se si sulmuesit operojnë dhe për të zbuluar rreziqet potenciale.
- e. Zhvillimi i teknikave të analizës së vizionit kompjuterik: Analiza e vizionit kompjuterik mund të përdoret për të identifikuar automatikisht ndryshime të papritura në sistemet e kompjuterëve ose për të zbuluar sulme të sofistikuara. Kjo përfshin përdorimin e teknologjive të avancuara

të vizionit kompjuterik, si detektimi i pamjeve anormale ose zbulimi i veprimeve të dyshimta nëpërmjet analizës së imazheve dhe video-ve të sistemeve të kompjuterëve.

- f. Përdorimi i teknologjive *blockchain*: Teknologjia e *blockchain* është një teknikë e sigurisë që mund të përdoret në fushën e sigurisë kibernetike për të mbrojtur të dhënat dhe transaksionet nga manipulimi dhe për të siguruar transparencë dhe llogaridhënie. Përdorimi i *blockchain* mund të ndihmojë në sigurinë e identitetit dhe autentifikimit, në monitorimin e të dhënave të trafikut, dhe në zhvillimin e sistemeve të sigurisë së avancuara.

Këto janë vetëm disa nga zhvillimet e mundshme të teknikave për sigurinë kibernetike në të ardhmen. Si fushë që ndryshon me shpejtësi, është e rëndësishme të ndiqen zhvillimet e reja në teknologji dhe metodologji për të përshtatur më mirë me sfidat dhe rreziqet e reja në botën kibernetike.

Përfundime

Aplikimi i teknikave statistikore në sigurinë kibernetike në epokën e *big data* ka bërë ndryshime të rëndësishme në fushën e sigurisë kibernetike. Këto teknika ofrojnë një mjet të fuqishëm për identifikimin e anomalive, zbulimin e rreziqeve dhe përmirësimin e mbrojtjes kibernetike.

Me rritjen e sasisë së të dhënave të gjeneruara nga pajisjet, rrjetet dhe aplikacionet në botën dixhitale, është bërë e pamundur për të menaxhuar dhe analizuar manualisht të gjithë këtë informacion. Këtu hyjnë në lojë teknikat statistikore, që përdoren për të identifikuar modele të zakonshme, për të zbuluar ndryshime të papritura dhe për të identifikuar rreziqe potenciale.

Teknikat statistikore si analiza e rrjedhës së ngjarjeve, analiza e serive kohore, modelimi i të dhënave të trafikut dhe metodat e deteksionit të anomalive, kanë treguar rezultate të mira në zbulimin e sulmeve kibernetike, identifikimin e brendshmeve, dhe përmirësimin e performancës së sigurisë.

Sidoqoftë, është e rëndësishme të theksohet se sfidat në sigurinë kibernetike vazhdojnë të rriten, duke kërkuar zhvillime të vazhdueshme në teknikat statistikore. Nevoja për përdorimin e inteligjencës artificiale, analizën e *big data*, teknikat e analizës së kontekstit, dhe përdorimin e teknologjive të *blockchain* janë vetëm disa prej aspekteve që duhet të merren parasysh në të ardhmen.

Për të garantuar një siguri të përballueshme në epokën e *big data*, është e nevojshme që organizatat të investojnë në infrastrukturë të përshtatshme dhe burime të mjaftueshme për të zbatuar teknikat statistikore në fushën e sigurisë kibernetike.

Në fund, përdorimi i teknikave statistikore në sigurinë kibernetike në epokën e *big data* sjell një ndryshim kualitativ në mënyrën si mund të identifikohen dhe parandalohen sulmet kibernetike. Kjo ndërthurje midis statistikës dhe sigurisë kibernetike do të vazhdojë të zhvillohet dhe të përmirësohet për të adresuar sfidat e sigurisë kibernetike të ardhshme dhe për të mbrojtur infrastrukturat dixhitale nga rreziqet.

Bibliografia

1. Chen, P.-Y., Zhang, H., Sharma, Y., Yi, J., & Hsieh, C.-J. (2017). Zoo: Zeroth order optimization based black-box attacks to deep neural networks without training substitute models.
2. In *Proceedings of the 10th ACM Workshop on Artificial Intelligence and Security* (pp. 15–26). Association for Computing Machinery. <https://doi.org/10.1145/3128572.3140448>
3. Collins, M. (2017). *Network security through data analysis: From data to action (2nd ed.)*. O'Reilly Media.
4. Dada, E. G., Bassi, J. S., Chiroma, H., Abdulhamid, S. M., Adetunmbi, A. O., & Ajibuwa, O. E. (2019). Machine learning for email spam filtering: Review, approaches and open research problems. *Heliyon*, 5(6), Article e01802. <https://doi.org/10.1016/j.heliyon.2019.e01802>
5. Dua, S., & Du, X. (2011). *Data mining and machine learning in cybersecurity*. Auerbach Publications. <https://doi.org/10.1201/b10867>
6. Goodfellow, I. J., Shlens, J., & Szegedy, C. (2015, May 9). *Explaining and harnessing adversarial examples*. Third International Conference on Learning Representations (ICLR 2015), San Diego, CA, United States. <https://doi.org/10.48550/arXiv.1412.6572>
7. Hassan, W. U., Bates, A., & Marino, D. (2020). Tactical provenance analysis for endpoint detection and response systems. In *2020 IEEE Symposium on Security and Privacy* (pp. 1172–1189). IEEE. <https://doi.org/10.1109/SP40000.2020.00096>
8. Hou, E., Sricharan, K., & Hero, A. O. (2018). Latent Laplacian maximum entropy discrimination for detection of high-utility anomalies. *IEEE Transactions on Information Forensics and Security*, 13(6), 1446–1459. <https://doi.org/10.1109/TIFS.2018.2790580>
9. J. Raiyn, “A survey of cyber attack detection strategies”, *Int. J. Secur. Appl.*, vol. 8, no. 1, pp. 247-256, Jan. 2014.
10. Jang-Jaccard, J., & Nepal, S. (2014). A survey of emerging threats in

- cybersecurity. *Journal of Computer and System Sciences*, 80(5), 973–993. <https://doi.org/10.1016/j.jcss.2014.02.005>
11. Lazarevic, A., Ertoz, L., Kumar, V., Ozgur, A., & Srivastava, J. (2003). A comparative study of anomaly detection schemes in network intrusion detection. In D. Barbara & C. Kamath (Eds.), *Proceedings of the 2003 SIAM International Conference on Data Mining* (pp. 25–36). Society for Industrial and Applied Mathematics. <https://doi.org/10.1137/1.9781611972733.3>
 12. Neil, J., Uphoff, B., Hash, C., & Storlie, C. (2013). Towards improved detection of attackers in computer networks: New edges, fast updating, and host agents. In *2013 6th International Symposium on Resilient Control Systems (ISRCS)* (pp. 218–224). IEEE. <https://doi.org/10.1109/ISRCS.2013.6623779>
 13. Sanger, D. E. (2018). *War, sabotage, and fear in the cyber age*. Random House.
 14. Sarker, I. H., Kayes, A., Badsha, S., Alqahtani, H., Watters, P., & Ng, A. (2020). Cybersecurity data science: An overview from machine learning perspective. *Journal of Big data*, 7(1), Article 41. <https://doi.org/10.1186/s40537-020-00318-5>
 15. Turcotte, M., Kent, A., & Hash, C. (2018). Unified host and network data set. In P. R.-D. Nick Heard Niall Adams & M. Turcotte (Eds.), *Data science for cyber-security* (pp. 1–22). World Scientific. https://doi.org/10.1142/9781786345646_001
 16. Wang, C., Zhang, D., Huang, S., Li, X., & Ding, L. (2021). Crafting adversarial email content against machine learning based spam email detection. In *Proceedings of the 2021 International Symposium on Advanced Security on Software and Systems* (pp. 23–28). Association for Computing Machinery. <https://doi.org/10.1145/3457340.3458302>
 17. Zhang, F., Kodituwakku, H. A. D. E., Hines, J. W., & Coble, J. (2019). Multilayer data-driven cyber-attack detection system for industrial control systems based on network, system, and process data. *IEEE Transactions on Industrial Informatics*, 15(7), 4362–4369. <https://doi.org/10.1109/TII.2019.2891261>
 18. Zhao, J., Shetty, S., Pan, J. W., Kamhoua, C., & Kwiat, K. (2019). Transfer learning for detecting unknown network attacks. *EURASIP Journal on Information Security*, 2019(1), Article 1. <https://doi.org/10.1186/s13635-019-0084-4>

19. Zhou, Y., Kantarcioglu, M., Thuraisingham, B., & Xi, B. (2012). Adversarial support vector machine learning. In *Proceedings of the 18th ACM SIGKDD international conference on Knowledge discovery and data mining* (pp. 1059–1067). Association for Computing Machinery. <https://doi.org/10.1145/2339530.2339697>

KAPACITETET DHE MUNDËSITË E PËRDORIMIT TË AVIONËVE PA PILOT TË ARMATOSUR TË TIPIT TB-2 “BAYRAKTAR”

Nënkolonel Msc. Eduart PLLAHA
Forca Ajrore

Trajtesë e shkurtuar.

Avionët pa pilot të tipit TB-2 “Bayraktar” janë bërë të njohur në fushën e betejës për aftësitë, kapacitetet dhe detyrat e ndryshme të kryera me sukses, veçanërisht për rolin e rëndësishëm në konfliktet, si p.sh., Azero-Gjeorgjian, Libi, Siri dhe ai më i fundit midis Rusisë dhe Ukrainës. Ky kapacitet shumë shpejt do të jetë pjesë e Forcës Ajrore Shqiptare për plotësimin e misionit të saj kushtetues por edhe kontributin mbështetës për Forcën Tokësore, Detare, si dhe mbështetjen e organeve të tjera ligzbatuese të vendit tonë.

Në sajë të zbatimit të teknologjive moderne, avionët pa pilot kanë arritur të jenë shumë efikas në dekadën e fundit në detyrat e ndryshme që ata kryejnë, edhe pse këto mjete janë përdorur edhe gjatë gjysmës së dytë të shekullit XX. Këto sisteme përbëhen nga një sërë elementesh të tjera përbërëse si: sistemi i kontrollit, transmetimi i pamjes ajrore, sensorët, armatimi (që mund të montohen për detyra të ndryshme në nivel taktik, operacional dhe strategjik).

Më e rëndësishmja është se ky mjet është një “arkitekturë” e hapur që po i shtohen kapacitete të tjera, për të shkuar drejt një mjeti shumëërolesh.

Fjalët kyçe: TB-2 Bayraktar, sistem modular, game changer, drejtim, zbulim, vëzhgim dhe rikonicion të fushëbetjës, sulm ajror, korrigjim zjarri i artilerisë, C2, “shumëzues force/ force multiplier”.

Vëzhgim historik për avionët pa pilot

Përdorimi i parë i këtij mjeti pa pilot vjen nga shekulli XIX, kur trupat austriake¹ sulmuan qytetin e rrethuar të Venecias me balona të mbushura me ajër të nxehtë dhe secila nga ato mbante disa kilogramë eksploziv. Efektiviteti i tyre la shumë për të dëshiruar pasi këto balona nën ndikimin e erës nuk shkuan në objektiv. Në fillim të shekullit XX, inxhinieri spanjoll² Leonardo Torres prezantoi atë që sot njihet si sistemi i kontrollit të mjeteve ajrore pa pilot, nëpërmjet valëve radio. Gjatë Luftës së Parë Botërore u përdor për herë të parë drejtimi i një mjeti pa pilot me motor nëpërmjet valëve radio. Midis dy luftërave botërore dhe gjatë Luftës II Botërore pati shumë testime për këto mjete por të vetmit që mund të theksohen janë përdorimi i mjeteve pa pilot nga SHBA të tipit “Radioplane OQ-3”, të cilat drejtoheshin nëpërmjet valëve radio dhe përdoreshin për testimin e njësive të artilerisë kundërajrore dhe mjetet e tipit “Argus As 292” për rikonicion nga Gjermania. Ndërsa mjetet më të rëndësishme në këtë kategori, gjatë kësaj periudhe, ishin mjetet me motor reaktiv të tipit “V-1” të prodhuar dhe përdorur nga Gjermania. Këto të fundit u përdorën gjerësisht për të goditur Londrën nga bregdeti francez.

Pas Luftës II Botërore, avancimi teknologjik i këtyre mjeteve vazhdoi kryesisht nga SHBA³, me qëllim zvogëlimin e humbjeve të pilotëve nga zjarri i raketave kundërajrore. Këto mjete u përdorën dhe u bënë të njohura gjatë luftës në Vietnam. Izraeli⁴, duke parë dobinë e madhe të tyre në fushën e betejës, kryesisht për zbulim dhe rikonicion, i zhvilloi më tej dhe i përdori gjerësisht në luftërat e viteve 1970 dhe 1980. E veçanta e këtij përdorimi nga ky vend ishte se u përdorën dhe për mashtrim, për të identifikuar stacionet e radarëve të kundërshtarëve por edhe për t'i konsumuar raketat kundërajrore të kushtueshme të këtyre vendeve. Në fund të viteve 80-të zhvillimi i madh i teknologjisë së informacionit, të transmetimit, si dhe informatikës i dhanë një hov të madh prodhimit dhe përdorimit të tyre, duke sjellë sukses të madh nga SHBA në luftërat e Gjirit, Bosnjës dhe Kosovës. Tashmë këto mjete u përdorën për të sulmuar me raketa nga bordi i tyre objektiva tokësorë dhe ajrorë, duke përdorur raketa kundërtanke, ajër-ajër dhe bomba inteligjente.

Gjatë luftës në Afganistan, rreth 60% e fluturimeve të Britanisë së Madhe u kryen me mjete ajrore pa pilot (Predator MQ-1), ndërsa në SHBA deri në vitin

¹ Kaplan, Philip (2013). “Naval Aviation in the Second World War”. Pen and Sword, f. 19.

² H. R. Everett, “Unmanned Systems of World Wars I and II”, MIT Press - 2015, f. 91-95.

³ Taylor, John W. R. “Jane’s Pocket Book of Remotely Piloted Vehicles”, f. 45.

⁴ Blum, Howard (2003) “The eve of destruction: The untold story of the Yom Kippur War”. Harper Collins. fq. 124.

2012⁵ një në tre fluturime u kryen nga këto mjete.

Në dekadën e dytë të këtij shekulli, mbi 50 shtete i bënë këto mjete pjesë të arsenalit të tyre ushtarak, dhe shumë nga këto vende projektuan dhe prodhuan mjetet e tyre pa pilot. Përveç një rritjeje të prodhimit, u rrit shumë dhe diapazoni i përdorimit të tyre në shumë fusha të ndryshme. Zhvillimi i teknologjive të zgjuara, 3D apo të sistemit elektrik dhe të komandimit, i ka bërë këto mjete me funksion shumërolësh, shumëpërdorimësh dhe mjaft efikas në fushën e betejës. Gjithashtu, këto mjete tashmë janë të maturuar pasi janë provuar në fushën e betejës, janë eficientë⁶ dhe mjaftueshëm të besueshëm dhe po përdoren në mënyrë inovative në një gamë të gjerë operacionesh. Të gjitha këto risi kanë sjellë të ashtuquajturën “Epoka e Dytë e Dronëve”⁷, ndërsa e para konsiderohet periudha pas 11 shtatorit të vitit 2001 në të cilën dronët u përdorën nga perëndimi në të ashtuquajturën “Lufta kundër terrorit” në Afganistan, Irak, Somali⁸.

Konflikte, si ai i Sirisë, Libisë, Etiopisë dhe më i rëndësishmi ai Armeno-Azerbaxhanit⁹, i bëri këto UAV shumë të rëndësishëm, si *mjet i ndryshimit të tendencës (kahut) të konfliktit (game changer)*. Ndërsa në konfliktin e Ukrainës dhe Rusisë pati një përdorim të gjerë si në nivel taktik, ashtu edhe në nivel operacional dhe strategjik për detyra të ndryshme, të cilat nisnin nga ato më të zakonshmet: vëzhgimi e deri në nivel operacional për të korrigjuar zjarrin e artilerisë në thellësi të vijës së frontit, si dhe për goditur baza ajrore të cilat ishin rreth 800 km në brendësi të territorit rus si objektiva strategjike, pa harruar dhe aspektin propagandistik nëpërmjet medias ku u shpërndanë pamje nga detyrat që realizonin këto mjete ajrore për të influencuar mbi shikuesit e këtyre rrjeteve.

Mjetet pa pilot në Shqipëri

Në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, përdorimi i mjeteve ajrore pa pilot daton në fillim të viteve '70, nëpërmjet të ashtuquajturave

⁵ R.A.J. Murphy, 2011, “Measure Twice, Shoot Once: Higher Care for Cia-Targeted Killing”, Univ. Ill. Law. fq. 1201-41.

⁶ M. L. Khan, “The Crowdfunded Drone War in Ukraine”, National Inters, 25.08.2022 “*they become robust, efficient, small, and affordable enough to be used by a broad range of operators for a variety of tasks*”

⁷ A. Callamard (2020). Report of the UN Special Rapporteur..., A/HRC/44/38, Jul. 2020

⁸ J. Rogers, “Future Threats: Military UAS, Terrorist Drones, and the Dangers of the Second Drone Age”, 2021, JAPCC “The American monopoly over the use of military UAS defined the first drone age, with Western powers ... these systems were used to hunt and kill those defined as terrorists and insurgents”

⁹ Washington Post “Azerbaijan’s drones owned the battlefield in Nagorno-Karabkh”, dhjetor, 2020.

“avio-shenja”, të cilat u përdorën deri në vitet 2000. Këto mjete ishin mjete ajrore pa pilot të telekomanduar nëpërmjet valëve radio dhe ishin me motor me djegie të brendshme. Avio-shenjat erdhën nga Kina dhe u përdorën kryesisht për stërvitjen e efektivëve të reparteve kundërajrore¹⁰. Këto mjete ishin shumëpërdorimësh dhe nuk kërkonin pista/aerodrome për ulje e ngritje. Pasi ngriheshin në ajër, ato tërhiqnin në një distancë të madhe nga trupi i tyre një konus e ky i fundit, përdorej si një shenjë ajrore ndaj të cilit njësitë e artilerisë kundërajrore hapnin zjarr. Këto mjete ishin mjaft të thjeshta në përdorim dhe në mirëmbajtje, si dhe shumë efektive për trajnimin e artiljerëve të njësive kundërajrore. Në vitet e fundit, autoritetet e tjera ligjzbatuese të vendit tonë arritën të marrin mjete ajrore pa pilot por me autonomi dhe kapacitet të nivelit taktik. Gjithashtu, autoritetet përkatëse të vendit tonë që merren me rregullimin ligjor të mjeteve ajrore i përfshinë edhe këto mjete¹¹ me synimin për të rifreskuar në vazhdimësi dhe sistemin ligjor¹². Për risitë që kjo teknologji ofron në vendin tonë janë hapur kompani, të cilat ofrojnë shërbime të ndryshme¹³ deri në prodhimin¹⁴ e tyre. Pa harruar dhe përdorimin nga individë dhe biznese për detyra të ndryshme.

Në vitin 2021 mbërritën në Shqipëri avionët e parë pa pilot, për përdorim ushtarak të tipit “RQ-20B Puma Block AE”, (**shih figurën 1**) të blerë nga Ministria e Mbrojtjes për Forcën Tokësore¹⁵. Çdo sistem “RQ-20B Puma Block AE” përbëhet nga tre mjete ajrore (UAV) dhe dy stacione drejtimi¹⁶. Ky model është i përbërë nga trupi, bateria, sensorët (elektro-optik dhe ato infra të kuq), si dhe elementet e transmetimit të pamjes ajrore për në stacionin e drejtimit. Për ngritjen e tij në ajër përdoret lëshimi me dorë. Detyra parësore e këtij sistemi është *rikonicion* dhe *vëzhgim* në fushën e betejës. Përdorimi i tyre i parë për përdorim jo ushtarak ishte në verën e vitit 2021 “Për monitorimin e vatrave të zjarrit në ishullin e Sazanit”. Në dhjetor të vitit 2022 midis Republikës së Shqipërisë dhe kompanisë turke të prodhimit të avionëve pa pilot “Bayraktar Technologies” u nënshkrua marrëveshja për sigurimin nga Ministria e Mbrojtjes të avionëve pa pilot të tipit “TB-2”. Nënshkrimi i kësaj kontrate do të revolucionarizojë të gjithë sektorin e këtyre mjeteve në vendin

¹⁰ Avni Skënderaj, “Mbrojtja kundërajrore e Shqipërisë” Tiranë, Botart, 2012, fq. 117.

¹¹ Udhëzim nr. 3, dt. 07.02.2011 “Për Rregullat e Përbashkëta në Fushën e Aviacionit Civil”, Shtojca II “Mjetet ajrore të përmendura në Nenin 4(4) mjete ajrore pa pilot me një masë përdorimi prej jo më shumë se 150 kg”, fq. 23.

¹² Revista Monitor, “E Ardhmja e Industrisë së Dronëve në Shqipëri”, 12.04.2022.

¹³ Albadron Akademi”. Burimi elektronik: <https://albadron.com>

¹⁴ Burimi elektronik: <https://skaitech.al/al/>

¹⁵ Burimi elektronik: <https://govtribe.com/opportunity/federal-contract-opportunity/foreign-military-sales-fms-albania-puma-system>

¹⁶ Burimi elektronik: https://en.wikipedia.org/wiki/AeroVironment_RQ-20_Puma

tonë por në veçanti në aspektin ushtarak, pasi këto mjete janë për përdorim në nivel operacional. Kjo marrëveshje përfshin në fazën e parë tre mjete dhe në fazën e mëvonshme tre të tjerë. Pjesë e saj janë sistemi i drejtimit, transmetimit dhe i trajnimit të efektivëve që do t'i përdorin ato.



Figura nr. 1. Avion pa pilot i tipit “RQ-20B Puma Block AE”

Avionët pa pilot të armatosur (UAV): kapacitete dhe mundësi

Avionët pa pilot (UAV) të armatosur ofrojnë mundësi por dhe kufizime¹⁷, duke realizuar misione të cilat kanë një rrezikshmëri të madhe; janë shumë fleksibël dhe ofrojnë një mjet me masë të vogël por me një performancë të mirë në realizimin e detyrave të cilat nuk i realizojnë mjete nën drejtimin human. Një element i rëndësishëm në ofrimin e këtyre mundësive është dhe efektiviteti financiar i tyre duke krahasuar çfarë ofrojnë, pasi çmimi i tyre është disa herë më i lirë se avionët apo dhe helikopterët. Gjithashtu faktor i rëndësishëm në këtë performancë të mirë është kohëzgjatja e fluturimit të tyre duke kombinuar dhe realizimin e shumë roleve në një fluturim. Ndërsa kufizimi i tyre kryesisht mund të themi qëndron te kërkesa për lidhje me *data link* midis tij dhe stacionit të kontrollit në tokë, etj.

Përdorimi i UAV nga forcat e armatosura të vendeve të ndryshme gati ka sjellë një revolucion në zhvillimin e luftës në ditën e sotme, ku p.sh., Anglia pas konfliktit Armeni - Azerbajxhan ka nisur të rishikojë dokumentet strategjike dhe doktrinare. Gjithashtu edhe gjendja gjeopolitike rajonale dhe ndërkombëtare ka ndikuar për rishikimin e planeve të modernizimit të Forcave të Armatosura për t'i përfshirë këta dronë të armatosur. Aktualisht, shumë pak vende kanë mjete ajrore pa pilot të armatosur dhe duke marrë shkak nga sukseset e tyre kanë nisur plane për t'i blerë këto mjete ajrore që ofrojnë mbështetje nga ajri, të operacioneve ushtarake.

¹⁷ LCdr Dave Ehredt “Contributing Stakeholders” NATO - Joint Air Power Competence Centre, 2010

UAV-të të cilët janë shumëpërdorimësh e modularë dhe mund të përdoren për zbulim, vëzhgim dhe rikonicion më të mirë të fushëbetejës, si dhe të mbështetjes ajrore të operacioneve të forcave të armatosura (jo vetëm atyre), duke ofruar operacione kinetike dhe jo-kinetike, operacione speciale dhe në mbështetje të forcave tokësore, detare, forcave speciale, etj. Të gjitha këto sisteme të armatosura/të zbulimit ajror mund të integrohen në një sistem komandim-kontrolli në Forcën Ajrore/ Forcën e Armatosur, me qëllim krijimin e një pamjeje nga ajri gjithëpërfshirëse të “Përnjohjes së Situatës në fushëbetejë (Situation of Awareness)” të sigurtë dhe cilësisë së lartë, goditje në kohë reale të objektivave statikë ose të lëvizshëm me efikasitet të lartë në front, në thellësi operative dhe strategjike. Nëpërmjet sensorëve në bordin e këtyre kapaciteteve bëhet gjurmimi i objektivave në gjithë kushtet e motit, ditën/natën, drejtimi i zjarrit të artilerisë, mortajave, si dhe artilerisë reaktive. Gjithashtu këto mjete mund të realizojnë dhe misione të tipit “joint” si: vlerësim të dëmtimeve në fushëbetejë (BDA), kimik, biologjik, radiologjik, identifikim, luftë elektronike, monitorim kufiri, etj. Armatimi i tyre ka një diapazon të gjerë të raketave, municioneve dhe bombave inteligjente, të cilën do e trajtojmë më poshtë.

Nga ana tjetër, nëpërmjet këtij kapaciteti (në versionin e paarmatosur) dhe sipas legjislacionit në fuqi mundësohet edhe mbështetje e institucioneve kombëtare të sigurisë me zbulim, vëzhgim dhe ndjekje të objektivave, individëve apo dhe grupe individësh. Gjithashtu, mund të realizohen detyra të tjera në mbështetje të institucioneve ligjzbatuese, agjencive etj., pasi këto sisteme të armatosura ofrojnë dhe mundësinë “modulare” për të ndryshuar apo modifikuar sensorët në bordin e tyre pa cenuar operacionalitetin si p.sh., vëzhgim dhe kontroll të territorit, monitorim të situatave të ndryshme në mbështetje të operacioneve të emergjencave civile dhe /ose në ndihmë të komunitetit të Agjencisë së Emergjencave Civile (p.sh., monitorimin e zjarreve), Qendrën Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit (SAR), ofrimin e informacionit dhe produktin për Agjencinë e Kadastrave etj.

TB-2 “Bayraktar “ dhe elementet përbërëse

UAV e tipit “Bayraktar TB2” (**shiko figurën nr. 2**) ka një dizajn të unifikuar të trupit me krahët dhe në këtë strukturë janë të vendosura eleronët *në formë “V” të përmbysur*. Shtytja gjenerohet nga një helikë dyfletësh me kënd ndeshje të ndryshueshëm. Helika është montuar midis dy strukturave të bishtit dhe drejtohet nga një motor me djegie të brendshme që ndodhet në trup. Platforma është modulare dhe elementet kryesore janë trupi, krahët, trupat e dy bishtave dhe eleronët *në formë “V”*, sensorët, armatimi, si dhe organet e uljes. Pjesët e trupit janë bërë kryesisht nga fibra karboni ndërsa nyjet bashkuese me alumin

të përpunuar. Karburanti ruhet në rezervuarët e vendosur brenda trupit.

TB-2 ka një hapje krahësh prej 12 metrash dhe peshë totale prej 700 kg dhe përdoret si për zbulimin ashtu edhe për shkatërrimin e objektivave tokësorë. Ai mund të mbajë municione në katër bombë mbajtëset e tij deri në një peshë prej 150 kg. Lartësia maksimale e fluturimit është 8.000 metra me kohëzgjatjen e fluturimit deri në 27 orë dhe shpejtësi maksimale 250 km/h. Kjo platformë u përfshi në arsenalin e forcave të armatosura turke për herë të parë në vitin 2015 dhe aktualisht ai është në arsenalin e mbi 30 vendeve të ndryshme (përfshirë dhe Kosovën). Ndërsa nga vendet anëtare të NATO-s janë Polonia, Rumania dhe Shqipëria.



Sipas klasifikimit të miratuar nga NATO në vitin 2009, UAV-të ndahen në 3(tre) klasa. Secila nga këto klasa ndahet në “**kategori**”, kundrejt parametrave të specifikuar: lartësia e fluturimit, largësia e fluturimit dhe pesha. Kjo e fundit është faktori i vetëm përcaktues për kategorizimin e tyre.

TB-2 është në *klasën III* (sulmi/strategjik) i cili operohet në fushëbetejë, në teatrin e operacioneve: në nivel operacional dhe strategjik, që bën pjesë edhe në “*kategorinë*” e shenjëzuar si: **MALE** “Medium Altitude Long Endurance/ Lartësi Fluturimi të Mesme dhe Kohëzgjatje të Madhe Fluturimi”. Pjesë e kësaj kategorie janë dhe UAV-të e tipit Predator MQ1(USA), MQ-9(USA), si dhe CH-4 (Kina, e ky model është blerë së fundmi nga Serbia). Ndërsa tipi “RQ-20B Puma Block AE” është mjet ajror që përfshihet në *Klasën I* dhe në kategorinë “*MINI*”, i cili operohet në fushën e luftimit nga një individ dhe ka një rreze operimi 15 km, si dhe një kohëzgjatje fluturimi deri në 2 orë. Lartësia e operimit varion nga 40 metra në rreth 2000 metra.

Avionët pa pilot të tipit TB-2 janë sisteme moderne dhe elementet përbërëse të tyre janë:

a. Stacioni i kontrollit tokësor.

Stacioni Mobil i Kontrollit Tokësor (**shih figurën nr. 3**) siguron kontrollin në distancë të TB-2 nga baza e saj e përparuar ose e përhershme dhe një siguri mbrojtje për efektivet e drejtimit. Antenat e fuqishme të komunikimit zgjerojnë

gamën e misionit, duke lejuar të ngrihen dhe të ulen në vendbazimin kryesor ose dhe në ato të tjera. Kjo qendër drejtimi është në përputhje me standardet e NATO-s “ACE III”. Antenat e drejtimit të stacionit mund të ngrihen në një larësi deri në 12 m dhe ato mund të orientohen në mënyrë automatike. Ky stacion drejtimi mund të montohet dhe në trupin e një kamioni për të ofruar lëvizshmëri shumë të nevojshme në teatrin e sotëm të luftimeve.

b. Transmetimi i pamjes.

Detyrat kryesore të tij midis shumë të tjerave janë zbulimi, ndjekja dhe rikonicioni. Këto detyra realizohen nëpërmjet sensorëve të vendosur në trupin e tij. Me zhvillimin e teknologjisë, pamja ajrore mund të transmetohet drejtpërdrejt nëpërmjet valëve radio në Stacionin e Drejtimit (SD) ose dhe në Terminalin Mobil (në terren), etj. Sinjali mund të jetë drejtpërsëdrejti nëpërmjet TB-2 dhe SD ose/dhe e përforcuar me antena për të rritur distancën e transmetimit dhe të mbulimit të fushëbetejës. Ky produkt mund të ruhet në SD ose nëpërmjet transmetimit me fibra optike/ interneti në serverë sipas kërkesës së përdoruesit. Kjo pamje mund të integrohet në salla operationale apo dhe në vende të tjera sipas kërkesës së autoriteteve drejtpërdrejt ose e regjistruar.

Sistemi i transmetimit të imazheve në kohë reale të TB-2 është “Baykar (BGAM)”, e cila ofron zgjidhje për transmetimin dhe përpunimin e imazheve në kohë reale. Ajo lejon që transmetimet e drejtpërdrejta të pamjes ajrore me rezolucion të lartë dhe pa vonesë të monitorohen nga shumë përdorues në të njëjtën



kohë. BGAM është një aplikacion i bazuar në *web*, që lejon përdoruesit të shikojnë transmetime të drejtpërdrejta në mënyrë të mbrojtur dhe të sigurt dhe me cilësi, si dhe rezolucion të lartë në rrjet ose në tableta duke përdorur aplikacionin celular nëpërmjet internetit. Sistemi ruan automatikisht të gjitha imazhet e transmetuara në skedarë 30-minutësh. Ndërsa monitorojnë imazhet e drejtpërdrejta, përdoruesit mund të marrin shënime me shumë etiketa në sistem. Etiketat e ruajtura do të lehtësojnë në një datë të mëvonshme kërkimin, përmes videove të arkivave. Në mënyrë të ngjashme, bazuar në këto shënime, mund të krijohet një regjistër i misionit dhe më pas të eksportohet. Skedarët e

arkivuar mund të filtrohen sipas datës dhe sipas meta të dhënave (meta data). Për arsye sigurie, sistemi rigjeneron automatikisht fjalëkalime të përkohshme për të siguruar akses në imazhet e transmetuara dhe të arkivuara drejtpërdrejt. Transferimi i të dhënave nga rrjeti shumë i sigurt në pajisjet celulare sigurohet duke adaptuar metodën e enkriptimit nga skaji në skaj.

c. Sensorët.

Një nga elementet kryesore të këtyre mjeteve ajrore janë sensorët, të cilët mund të quhen si “sytë e UAV” dhe janë të vendosur në kulla/koka të sensorëve të cilat janë të ndërrueshme sipas detyrave apo dhe të shkëmbyeshme ndërmjet UAV-ve. TB-2 ka në përdorim dy tipe koka/kulla ajo e tipit “Alsesan CATS” dhe “Wscam MX-15D”. Vendi ynë i ka përzgjedhur me kulla të tipit “Wscam MX-15D”, të cilat janë prodhim kanadez dhe kanë peshë më të vogël se sa ajo e tipit “Alsesan CATS”. Në këtë kullë janë të montuar sensorët: **elektro-optikë**¹⁸ “kamera të cilat prodhojnë imazhe me ngjyra ose bardh e zi në modelin HD”, **laser**: “të cilët janë për shenjëstrim (designetor), tregues (pointer) dhe distancë matës (range finder)”. Gjithashtu është i montuar edhe sensori me **infra të kuq**: “kamera e cila përdor nxehtësinë e lëshuar nga trupat për të prodhuar imazhin”.

Në këtë mjet ajror mund të instalohen dhe radarë të tipit SAR (Synthetic Operature Radar)¹⁹ dhe Multi mode AESA radar në vend të kullave “Wscam MX-15D”, të cilët ofrojnë mundësi të madhe për plotësimin e detyrave. Radari i tipit **SAR** ofron produkte më cilësore se kullat/kokat me sensorë **infra të kuq** dhe **elektro-optikë**. Pasi ky tip realizon kapjen dhe krijimin e imazheve të objektivave për shenjëstrim apo dhe për zbulim/ndjekje në terrene me densitet apo të mbuluara (p.sh. pemë), të cilat janë një me saktësi, besueshmëri dhe detaje më cilësore. Sistemi SAR ofron avantazh pasi përdor valët dhe sinjalin e



radarit dhe nuk varet nga kushtet atmosferike si p.sh.: sensorët elektro-optikë, sensorët infra të kuq. **Radari Multi mode AESA**²⁰ është një radar modern, i cili peshon rreth 22 kg dhe si princip pune përdor lëshimin e valëve të tipit radio në drejtime të ndryshme pa e lëvizur antenën. Ky radar ka avantazh se përdor energji më të vogël për të operuar dhe krijon imazhe më cilësore se

¹⁸ Burimi elektronik: <https://en.wikipedia.org/wiki/Wscam>

¹⁹ Burimi elektronik: <https://www.airbornedrones.co/detecting-humans-sar/>


²⁰ Burimi elektronik: https://en.wikipedia.org/wiki/Active_electronically_scanned_array

radar i tipit SAR dhe sensorët elektro-optikë dhe infra të kuq dhe është më pak i cenusshëm nga lufta elektronike. Gjithashtu ka një përdorim të madh për identifikimin e objektivave detare dhe tokësore si dhe ndaj atyre objektivave që janë të vështirë për identifikimin nga sensorë të tjerë, si dhe ata objektiva që lëvizin shumë ngadalë. Ky radar ofron një skanim dhe krijon një hartë të terrenit më të plotë, të saktë dhe me mbulim të madh (200km)²¹.

d. Armatimi i UAV.

TB-2 në bord ka të instaluar 4 (katër) shtrate lëshimi (deri 23 kg në secilën) në të cilat mund të montohen një gamë e gjerë municionesh dhe kombinimesh, pasi ky mjet ka koncept të përdorimit “shumërolësh” sipas detyrës të përcaktuar për të kryer. Në këtë gamë përfshihen *bomba inteligjente të drejtuara me laser* (familja e quajtur MAM me MAM-C dhe MAM-L, të cilat janë me peshë të vogël), *raketa kundërtanke*, *raketa të drejtuara me laser*, *raketa ajër-ajër me rreze të shkurtër veprimi*, si dhe *raketa me rreze të gjatë veprimi* të tipit “cruise missile”. Bombat dhe raketat ofrojnë mbështetje ajrore nëpërmjet sulmit ajror me precizion të lartë në lartësi të ulëta dhe të mesme të operimit të tyre, si dhe sulm ndaj objektivave strategjike operative, taktike dhe korrigjim të zjarrit të artilerisë. Bomba inteligjente të drejtuara me laser të tipit “MAM-C” (shih

figurën nr. 5), të cilat kanë eksploziv dhe përdoren kundër këmbëtorisë dhe mjeteve të blinduara, si dhe ka një diametër prej 70 mm, gjatësi 970 mm, peshë 6.5 kg, largësi qitje prej 8 km. Bomba MAM-L është bombë inteligjente e tipit “Termobarike” përdoret kryesisht kundër mjeteve të blinduara dhe ka diametër 160 mm, gjatësi 1 m, peshë 22 kg, si dhe largësi qitje 15 km.



Pjesë e këtij arsenali janë dhe raketat e drejtuara me laser me një peshë 16 kg të tipit “Bazok” dhe diametër 120 mm, gjatësi 80 cm, me largësi qitje prej 15 km. Kjo raketë përdoret kryesisht kundër këmbëtorisë dhe fortifikatave. Gjithashtu mund të instalohen dhe *raketa kundërtanke të drejtuara me laser* të tipit UTMAM, të cilat kanë një largësi qitjeje prej 8 km dhe lartësi 16 feet (4876 m), si dhe raketa të kalibrit 70 mm (Roketsan) të drejtuara me laser me rreze 1.5-8km.

²¹ Burimi elektronik: <https://bulgarianmilitary.com/2021/11/24/polish-uavs-will-get-x-band-on-board-radar-with-scanning-antennas>

Siç u përmend më lart, TB-2 është shumërolësh dhe ka një arkitekturë të hapur që do të thotë se ky mjet mund të përshtatet dhe për municione të tjera. Aktualisht janë në fazën e fundit të testimeve për përfshirjen përfundimtare në kapacitetet e tij, *raketa ajër-ajër* me rreze të shkurtër veprimi²² të tipit “Sungur” me rreze veprimi nga 500 m deri në 8 km. Kjo raketë ajër-ajër mund të përdoret kundër UAV-ve dhe helikopterëve.



Gjithashtu ka filluar dhe testimi për lëshimin nga TB-2 i raketave me rreze të gjatë veprimi rreth 200 km të tipit “Mini Cruise Missile”, të quajtura “Bayraktar Kemankes”²³ (shih figurën nr. 7). Kjo raketë sipas parametrave që ka,



është e klasifikuar si raketë e tipit “Cruise” dhe ka peshë 30 kg, gjatësi 1.73 m, shpejtësi 360 km/orë, si dhe mund të operojë në të gjithë kushtet e motit, ditën-natën, dhe është e mbrojtur nga sulmet elektronike. Këto dy kapacitete të reja që po i shtohen gamës aktuale që ka, e bën këtë mjet të aftë

të jetë shumërolësh dhe të kryejë detyra të reja të luftës ajrore dhe të sulmit me raketa që godasin në thellësi për të arritur objektiva strategjikë.

TB-2, përveçse mund të godasë objektivat me armatime të ndryshme, ai mund të zbulojë pozicionet e kundërshtarit dhe përqendrimet e trupave, mjeteve dhe sistemeve të zbulimit nëpërmjet sensorëve elektro-optikë dhe infra të kuq (EO/IR) në një distancë të madhe përafërsisht 75 km²⁴. Po ashtu mund të drejtojë zjarrin e artilerisë/artilerisë reaktive dhe mortajave ndaj tyre.

²² Burimi elektronik: <https://www.forbes.com/sites/pauliddon/2022/10/31/bayraktars-armed-with-air-to-air-missiles-are-not-an-optimal-solution-for-defending-ukraine-against-iranian-drones/?sh=600254d54519>

²³ Burimi elektronik: <https://www.thedefensepost.com/2023/05/05/turkey-mini-cruise-missile/>

²⁴ S. Mitzer/ J. Oliemans “Baltic Bayraktars - Lithuania Eyes Buying TB2 UCAVs”, Oryx, 16, 06.2022

Ky bashkëpunim i TB-2 me sistemet e artilerisë maksimizon efektet e tyre në objektivat si një “shumëzues force/ force multiplier²⁵”. Ndër risitë e fundit për këtë tip është dhe drejtimi i predhave reaktive të precizionit të lartë të lëshuara nga artileria reaktive e tipit *TRLG-230*. Këto predha reaktive janë me kalibër 230 mm, me rreze veprimi nga 20 deri në 150 km dhe ato drejtohen drejt objektivit duke ndjekur shenjëzimin laser të kryer nga TB-2. Ky drejtim realizohet duke shenjëzuar/ndriçuar objektivin me lazer të montuar në kullën e “TB-2”. Predha reaktive në të cilën janë të instaluar sistemet e drejtimit laser ndjekin këtë shenjëzim duke e kthyer në shënjestrim e më pas e godet atë²⁶.

Këto predha reaktive (shih figurën nr. 8) janë të ngjashme me ato të tipit “Himmars” të SHBA-ve. Duhet theksuar se sistemi *TRGL-230* është një sistem modular, i cili mund të lëshojë dhe predha reaktive të drejtuara me lazer të kalibrit 122 mm dhe 300 mm përveç atyre



230 mm. Pra, edhe kjo risi rrit shumë gamën e përdorimit të këtij sistemi duke e kthyer TB-2 një “shumëzues force/ force multiplier” për disa sisteme armatimesh duke shumëfishuar efektin e dëshiruar të tyre dhe rritur saktësinë dhe zvogëluar konsumimin e municioneve.

Përfundime

Nënshkrimi i marrëveshjes midis Republikës së Shqipërisë dhe kompanisë turke të prodhimit të avionëve pa pilot “Bayraktar Technologies” për sigurimin e avionëve pa pilot të tipit “TB-2”, do të revolucionarizojë të gjithë sektorin e këtyre mjeteve në vendin tonë por në veçanti në aspektin ushtarak. Aktualisht, Forcat e Armatosura nuk disponojnë asnjë sistem apo mjete ajrore të armatosura për plotësimin e misionit të Forcës Ajrore. Para viteve 90-të deri në vitin 2005, kur u suprimuan dhe avionët luftarakë, Forca Ajrore ka pasur një arsenal prej rreth 240 avionë luftarakë. Armët të cilat përbëjnë këto sisteme gjejnë shprehje edhe në doktrinën dhe detyrat e Forcës Ajrore, e cila

²⁵ Po aty. “Integration of reconnaissance drones with these artillery systems would maximise their effect on target; a UCAV thus constitutes something of a force multiplier for several weapons systems...”

²⁶ Burimi elektronik: <https://www.overtdefense.com/2023/04/26/ukraine-officially-confirms-that-it-has-turkish-laser-guided-trlg-230-missiles/>

shprehej në faktin se FAj duhet të ofrojë mbështetjen me zjarr nga ajri njësisive të FARSH-it.

TB-2 është një mjet shumërolësh me kohëzgjatje të madhe të fluturimit të tyre duke kombinuar realizimin e shumë detyrave në një fluturim. Ai mund të përdoret për zbulim, vëzhgim dhe rikonicion më të mirë të fushëbetejës, si dhe të mbështetjes ajrore të operacioneve të FARSH, duke ofruar operacione kinetike dhe jo-kinetike, operacione speciale dhe në mbështetje të Forcave Tokësore, Detare, Forcave Speciale, etj. Gjithashtu, këto mjete mund të realizojnë dhe misione të tipit “joint”. Këto sisteme të armatosur/zbulimit ajror mund të integrohen në një sistem komandim-kontrolli në Forcën Ajrore/ Forcën e Armatosur, me qëllim krijimin e një pamje nga ajri dhe gjithëpërfshirëse të “Përnjohjes së Situatës në fushëbetejë (*Situation of Awareness*)”. TB-2 mund të angazhohet për goditjen në kohë reale të objektivave statikë ose të lëvizshëm me efikasitet të lartë në front, në thellësi operative dhe strategjike. Nëpërmjet sensorëve në bordin e këtyre kapaciteteve bëhet gjurmimi i gjithë objektivave në gjithë kushtet e motit si: ditën/natën, po ashtu edhe drejtimin e artilerisë së tipeve të ndryshme. Ky bashkëpunim i TB-2 me sistemet e artilerisë maksimizon efektet e tyre në objektiv si një “*shumëzues force/ force multiplier*“ të një apo më shumë sistemimeve të armëve.

Nëpërmjet këtij kapaciteti (në versionin e paarmatosur) dhe sipas legjislacionit në fuqi mundësohet edhe mbështetje për institucionet kombëtare të sigurisë me zbulim, vëzhgim dhe ndjekje të objektivave, individëve apo dhe grupe individësh. Gjithashtu mund të realizohen detyra të tjera në mbështetje të institucioneve ligjzbatuese, agjencive etj., si p.sh., vëzhgim dhe kontroll të territorit, monitorim të situatave të ndryshme në mbështetje të operacioneve të Agjencisë të Emergjencave Civile dhe /ose në ndihmë të komunitetit, Qendrën Kombëtare të Kërkim Shpëtimit (SAR), ofrimin e informacionit dhe produktin për Agjencinë e Kadastrave etj.

Marrja e këtyre mjeteve është një kapacitet i shtuar për Forcën Ajrore për realizimin e misionit të saj kushtetues por duhet të vazhdojë më tej puna e mirë të bërë deri tani, duke kërkuar të arrihet maksimizimi i kapaciteteve të këtyre mjeteve duke u stërvitur, trajnuar në vazhdimësi si dhe dëshirë për të eksploruar kapacitetet e këtij mjeti i cili është me arkitekturë të hapur dhe ka mundësi për të shtuar kapacitete të reja dhe për këtë duhet mbajtur në vazhdimësi azhurnimi i tyre. Gjithashtu duhet dhe një bashkëpunim i vazhdueshëm për shkëmbim eksperience dhe trajnime të përbashkëta me vendet të cilat i posedojnë ose janë në proces të marrjes të tyre si p.sh., Kosova, Rumania dhe Turqia. Kështu me Kosovën do të ishte e udhës të bashkëpunohet në fusha si p.sh., doktrina, rregullore, manuale dhe në atë të rregullimeve ligjore pasi në këtë mënyrë do të kursehej kohë dhe do të kishte

një sinergji të përpjekjeve për të maksimizuar kapacitetet dhe mundësitë që ky sistem ofron. Krijimi i një “Qendre Ekselence” të përbashkët për këto mjete më qëllim perfeksionimin e tyre në nivel taktik, operacional dhe bashkuar si në rang të Forcave të Armatosura përkatëse por dhe në nivel kombëtar.

Bibliografia:

1. NATO fixed-wing UAS Classification (AEP-4671)
2. STANAG 4671
3. STANAG 4670 Joint Mission (Strike UAV)
4. UAV meeting in September 2009 the NATO Joint Capabilities Group agreed to divide UAS into three categories, CLASS I, II, and III.
5. Kaplan, Philip (2013). “Naval Aviation in the Second World War”. Pen and Sword
6. H. R. Everett, “Jane’s Pocket Book of Remotely Piloted Vehicles”, MIT Press - 2015
7. Taylor, John W. R. “Jane’s Pocket Book of Remotely Piloted Vehicles”.
8. Blum, Howard (2003) “The eve of destruction: the untold story of the Yom Kippur War”. Harper Collins. ISBN 9780060013998
9. R. AJ. Murphy, 2011, “Measure Twice, Shoot Once: Higher Care for Cia-Targeted Killing” Univ. Ill. Law.
10. M. L Khan, “The Crowdfunded Drone War in Ukraine” National Inters, 25.08.2022
11. A. Callamard (2020). Report of the UN Special Rapporteur..., A/HRC/44/38, Jul. 2020. The term ‘Second Drone Age’ was originally coined by the founder of Air Wars, Chris Woods.
12. J. Rogers, “Future Threats: Military UAS, Terrorist Drones, and the Dangers of the Second Drone Age”, 2021, JAPCC
13. Radsan, AJ; Murphy (2011). “Measure Twice, Shoot Once: Higher Care for Cia-Targeted Killing”. Univ. Ill. Law Rev
14. Avni Skënderaj, “Mbrotjtja kundërajrore e Shqipërisë”, Tiranë, Botart, 2012
15. LCdr Dave Ehredt, “Contributing Stakeholders” NATO - Joint Air Power Competence Centre, 2010
16. The Turkish Bayraktar TB2: Ankara’s Renewed Prominence in the Drone Market”. FINABEL European Army Interoperability Centre. Retrieved 14 August 2021.
17. Koncepti Operacional për pajisjen me Avionë Pa Pilot të Armatosur me

urdhër nr.484, dt. 12.04.2022 “Për miratimin e vendimit të komisionit të veçantë të klasifikimit numër 03/5 dt. 04.04.2022, për kërkesën operative me objekt “Kompletimi me avion pa pilot (Unmanned aerial vehicles) të armatosur”.

18. Udhëzim nr. 3, dt. 07.02. 2011 “Për Rregullat e Përbashkëta në Fushën E Aviacionit Civil”, shtojca II
19. Revista Monitor “E Ardhmja e Industrisë së Dronëve në Shqipëri” 12/04/2022 <https://www.monitor.al/e-ardhmja-e-industrise-se-droneve-ne-shqiperi/>

Faqe interneti:

1. Washington Post “Azerbaijan’s drones owned the battlefield in Nagorno-Karabkh” Dhjetor, 2020. www.washingtonpost.com.
2. “Albadron Akademi” <https://albadron.com/>
3. Skaitech: <https://skaitech.al/al/#>
4. <https://govtribe.com/opportunity/federal-contract-opportunity/foreign-military-sales-fms-albania-puma-system-panrsa20p0000013348>
5. https://en.wikipedia.org/wiki/Baykar_Bayraktar_TB2
6. https://en.wikipedia.org/wiki/Loitering_munition
7. <https://www.euronews.com/next/2022/03/17/switchblade-drones-what-are-these-kamikaze-weapons-and-how-can-they-help-ukraine>
8. <https://www.defensenews.com/air/2021/05/26/get-ready-for-another-fight-over-the-future-of-the-mq-9-reaper/>
9. <https://www.airbornedrones.co/detecting-humans-sar/>
10. <https://bulgarianmilitary.com/2021/11/24/polish-uavs-will-get-x-band-on-board-radar-with-scanning-antennas/>
11. <https://www.forbes.com/sites/pauliddon/2022/10/31/bayraktars-armed-with-air-to-air-missiles-are-not-an-optimal-solution-for-defending-ukraine-against-iranian-drones/?sh=600254d54519>
12. <https://www.thedefensepost.com/2023/05/05/turkey-mini-cruise-missile/>
13. S. Mitzer/ J. Oliemans “Baltic Bayraktars - Lithuania Eyes Buying TB2 UCAVs”, Oryx, 16, 06.2022
14. <https://www.oryxspioenkop.com/2022/06/baltic-bayraktars-lithuania-eyes-buying.html>
15. <https://www.overtdefense.com/2023/04/26/ukraine-officially-confirms-that-it-has-turkish-laser-guided-trlg-230-missiles/>

RUBRIKA E TRETË

Punime historike

Revista Ushtarake e ka bërë pjesë të saj trajtimin e temave historike, të lidhura me çështje të ndjeshme të historisë së popullit shqiptar dhe mendimin strategjik ushtarak.

Dr. Etleva Smaçi, vjen në këtë rubrikë me shkrimin me titull “*Vizita e mareshalit Zhukov në Shqipëri (1957): Ndikimi në rritjen e kapaciteteve të Ushtrisë Popullore*”.

Pas përfshirjes së Shqipërisë në Traktatin e Varshavës, në tetor të vitit 1957, Georgy Konstantinovich Zhukov, maresjali i lavdishëm i Ushtrisë së Kuqe, viziton për here të parë Shqipërinë. Ardhja e tij në vendin tonë ishte njëkohësisht ngjarje e rëndësisë politike, po aq edhe e rëndësisë ushtarake.

Në literaturën historike shqiptare, kjo vizitë është analizuar dhe trajtuar nga disa studiues të historisë politike. Ndërsa synimi i këtij artikulli dhe risia e tij qëndron në sjelljen e një analize të elementëve qartësisht ushtarakë të saj. Kjo do t’i shërbejë plotësimit të debatit nëse vizita u shoqërua me elemente strategjike në lidhje me vizionin për mbrojtjen kombëtare. Pjesë e këtij debati është edhe këndvështrimi mbi vendimet e marra për rritjen e kapaciteteve të mbrojtjes në kuadër të Luftës së Ftohtë.

Rubrikën e tretë të Revistës e pasuron më tej Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj me punimin “*Karakteristika dhe dukuri të Zonës së Parë Operative gjatë Luftës së Dytë Botërore*”. Zona e parë operative Vlorë-Gjirokastrë-Mallakastrë ishte i vetmi formacion të përmasave operative-strategjike me tipare e karakteristika krejt të veçanta, me një vlerë dhe përvojë historiko-ushtarake dhe atdhetare

për popullin, por veçanërisht për ushtarakët shqiptarë të sotëm e të së ardhmes.

Profesor Zotaj thekson se ky formacion jo vetëm shfaq vlera organizative unike midis forcave të armatosura që u ngritën në Shqipërinë e atë kohë, por edhe afirmoi vlera luftarake të veçanta në pikëpamje drejtimi, shfrytëzim të terrenit kryesisht të thyer e malor të zonës, të formave taktike e të tjera.

Një tjetër shkrim historik sjell në këtë rubrikë koloneli në rezervë Sali Onuzi me titull *“Shtabi i përgjithshëm i ushtrisë nacionalçlirimtare: emërtimi, organizimi dhe funksionimi”*, ku shkruan se “Njësitet guerile, çetat dhe batalionet partizane të krijuara në vitet 1941-1942 dhe në gjysmën e vitit 1943, ishin shprehje e rritjes së qëndresës së popullit shqiptar ndaj pushtuesit fashist italian. Kishte ardhur koha për të filluar ngritjen e një ushtrie nacionalçlirimtare të organizuar në njësi më të mëdha të komanduar nga një qendër, nga një Shtab i Përgjithshëm, për të rritur e ngritur kështu nivelin e luftës antifashiste nacionalçlirimtare (LANÇ) dhe për ta çuar atë drejt fitores.... Dhe se krijimin e Shtabit të Përgjithshëm e kërkonte edhe nevoja e bashkëpunimit me misionet aleate britanike që kishin arritur në Shqipëri dhe që kërkonin një përfaqësues kombëtar ushtarak për bisedime e marrëveshje dhe ndihmë ushtarake. Në kërkesat që paraqiti Shtabi i Përgjithshëm kemi për herë të parë një projekt dhe një dokument strategjik me mundësitë e mobilizimit ushtarak në çdo krahinë dhe të nevojave për armatim e municion”.

VIZITA E MARESHALIT ZHUKOV NË SHQIPËRI (1957): NDIKIMI NË RRITJEN E KAPACITETEVE TË USHTRISË POPULLORE

Dr. Etleva SMAÇI

Fakulteti i Mbrojtjes dhe i Sigurisë

Trajtesë e shkurtuar.

Ky punim analizon vizitën e mareshalit Zhukov në Shqipëri në tetor të vitit 1957. Vizita u zhvillua dy vite pas përfshirjes së Shqipërisë në Traktatin e Varshavës. Ardhja e Zhukovit në Shqipëri ishte njëkohësisht ngjarje e rëndësisë politike po aq edhe e rëndësisë ushtarake.

Në literaturën historike shqiptare vizita është analizuar dhe trajtuar nga disa studiues të historisë politike. Synimi i artikullit dhe risia e tij qëndron në sjelljen e një analize të elementëve qartësisht ushtarakë të saj. Kjo do t'i shërbejë plotësimi të debatit nëse vizita u shoqërua me elemente strategjike në lidhje me vizionin për mbrojtjen kombëtare.

Pjesë e këtij debati është edhe këndvështrimi mbi vendimet e marra për rritjen e kapaciteteve të mbrojtjes në kuadër të Luftës së Ftohtë.

Fjalë kyçe: mareshali Zhukov, Ushtri Popullore, Mbrojtje Kombëtare, Luftë e Ftohtë.

Hyrje

Georgy Konstantinovich Zhukov, mareshali i lavdishëm i Ushtrisë së Kuqe ishte një emër i adhuruar në Shqipëri në fillim të viteve 50 -të. Ai jo vetëm ishte ministër i Mbrojtjes së BS, por ndër figurat e pakta të mbetura nga koha e Stalinit, pas eliminimit të grupit antiparti. Ardhja për vizitë në Shqipëri e një figure kaq të lartë padyshim kishte një vlerë shumë të madhe politike dhe ushtarake. Zhukovi mbërriti në Shqipëri më 17 tetor, një muaj pasi ishte përfunduar marrëveshja e ushtarake që iniciohte fillimin e punimeve në Bazën Detare Luftarake të Vlorës.

Vizita e tij nuk ishte rastësore. Ajo ishte pjesë e turit të mareshalit në Ballkan, rajon ku Moska ishte e interesuar të forconte pozitat në kuadër të Luftës së Ftohtë. Mareshali Zhukov ishte i pari ushtarak i rëndësishëm që vizitonte Shqipërinë.¹ Pala shqiptare kishte shprehur interesin e saj për vizitën e Zhukovit në Shqipëri që prej pranverës së vitit 1957.² KQ i PKBS i ishte përgjigjur kërkesës së palës shqiptare duke e miratuar atë me vendimin e presidiumit të KQ të PKBS më 15 gusht 1957.³ Ftesa ishte mirëpritur edhe nga vetë Zhukovi. “Mendoj se vizita në Shqipëri do të jetë shumë e dobishme, sidomos për faktin se gjatë lundrimit do të na paraqitet mundësia për t’u njohur me pjesën më të rëndësishme për ne, atë të teatrit Jug-Perëndimor të veprimeve ushtarake: me drejtimin bullgar-turk, që do të jetë shtojcë e rikonicionit, që i kam bërë këtij drejtimi në shtator të vitit 1956, me zonën ngushticës së Detit të Zi dhe me territorin, që shtrihet drejt deteve Egje, Mesdhe, Jon dhe Adriatik”.⁴

Zhukovi vetë kishte kërkuar gjithashtu nga Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik që të shihej mundësia që vizita e tij të kombinohej me vizitën e liderit komunist të Bashkimit Sovjetik, Nikita Hrushovit. Ky sugjerim argumentohej me faktin se kështu do të binte më pak në sy natyra e pastër ushtarake e kësaj vizite. Në fakt, jo vetëm nuk u arrit që vizita të ishte e përbashkët, por natyra thellësisht ushtarake binte në sy edhe nga vetë delegacioni shoqërues, ku ishin përfshirë komandanti i trupave të qarkut ushtarak të Odesës gjeneralkoloneli A. I. Raxijevskij, zëvendëskomandanti i

¹ Në maj të vitit 1956, Shqipërinë e kishte vizituar Pospelovi. Pas Pospelovit, vizita e mareshalit Zhukov si ushtarak i lartë, ishte një moment shumë i rëndësishëm në marrëdhëniet ndërkombëtare të Shqipërisë.

² H. Kaba, E. Çeku, *Shqipëria dhe Kosova...*, vep. përm., f. 168-169. Dok. Nr. 44. Bisedë e regjistruar ndërmjet të Ngarkuarit me Punë të Përkohshme të BRSS në RPSH, M.Ja.Hoshev me zëvendëskryetarin e parë të KM, B. Balluku lidhur me veprimtarinë antishqiptare të misionit jugosllav në RPSH dhe ftesën e mareshalit G. K. Zhukov në Shqipëri.

³ *Po aty*, f.170. Dok. nr.45. Vendim i Presidiumit të KQ të PKBS “Mbi masat e udhëtimit të shokut Zhukov në Jugosllavi e Shqipëri”.

⁴ Shënime personale të Zhukovit, Shkresë për KQ të PKBS.

Flotës së Detit të Zi, nënadmiralet S. E. Çursin, zëvendës shefi i Drejtorisë së Përgjithshme Politike gjenerallejtënant F.P. Stepçenko, si dhe një gjeneral me porosi pranë ministrit të Mbrojtjes të BRSS.⁵

Ky vendim përkoi me kohën kur Enver Hoxha ndodhej me pushime në BS. Ai u njoftua nga Hrushovi, se mareshali Zhukov do të vizitonte Jugosllavinë dhe Shqipërinë gjatë muajit tetor. Në shënimet e tij E. Hoxha pohon se e gëzoi ky lajm, që me sa duket iu duk më tepër entuziast seç duhej dhe nuk i pëlqeu Hrushovit. “Shikoni Enverin sa i gëzuar është që do i vejë Zhukovi, ju tha ai shokëve.”⁶ Zhukovi u prit në Shqipëri me të gjitha nderimet e nevojshme. Ministria e Mbrojtjes përgatiti një protokoll të veçantë për pritjen e tij, të detajuar me oraret dhe vizitat që ai do të zhvillonte gjatë kohës së qëndrimit.⁷ Edhe pse nuk ishte parashikuar në këtë protokoll, në aeroport mareshali Zhukov u prit nga vetë E. Hoxha.⁸ Ai bëri një sërë vizitash si p.sh., në Universitetin Shtetëror të Tiranës, Kombinatin e Tekstileve, Shkollën e Bashkuar të Oficerëve, në kooperativa bujqësore etj. Udhëheqja komuniste shqiptare u kujdes që të demonstronte një dashuri dhe besnikëri të madhe ndaj BS. Kjo gjë i tërhoqi vëmendjen mareshalit, i cili u entuziazhua nga pritja e popullit shqiptar, gjë që e shprehu qartë në telegramin që nisi për KQ të PKBS nga Shqipëria për në BS. Ai shkruante se mund thuhet me siguri, se ne kemi popullin shqiptar mik të sigurt e besnik.⁹

Ushtria Popullore në vlerësimin e mareshalit Zhukov

Përshtypjet për ushtrinë shqiptare nga dokumentacioni rezultojnë se ishin pozitive. Gjatë qëndrimit në Shqipëri Zhukovi ndoqi stërvitjen e trupave ushtarake në malet afër qytetit të Korçës [stërvitja u zhvillua në zonën e Voskopojës E.S]. Ushtria shqiptare sipas mareshalit ishte e aftë për luftë. E gjithë trupa ushtarake [ushtarë, rreshterë dhe oficerë] treguan një qëndrueshmëri të lartë dhe shkathtësi të mirë gjatë veprimeve në male.¹⁰ Edukimi ideologjik vlerësohej gjithashtu si një pikë e mirë. Por gjatë vizitës ai konstatoi probleme të mbrojtjes kundërajrore dhe desante, si dhe metodat e vjetra të përgatitjes së

⁵ Po aty...dokument nr.5

⁶ E. Hoxha, *Ditar 1955- 1957*, Tiranë: Shtëpia Botuese “8 Nëntori,” Vol 1, 1987, f. 361.

⁷ *AQFA*, Fondi 100/1, V.1957, D.10, fl.1-6. Urdhër Nr. 0058, datë 19.09.1957. Mbi masat për pritjen e ministrit të Mbrojtjes së BRSS, mareshalit Zhukov.

⁸ E. Hoxha, *Ditar...*, vep. përm., f.360. Zhukovi përfaqësonte sipas shënimeve të Hoxhës jo vetëm ministrin e Mbrojtjes së BS, por edhe “kuadrin e vjetër të Partisë Bolshevike dhe Heroin e Ushtrisë së Kuqe

⁹ H. Kaba, E. Çeku, *Shqipëria dhe Kosova...*, vep. përm., f.172. Dokument Nr.46. Telegram i ministrit të Mbrojtjes të BRSS, G. K. Zhukov, drejtuar KQ të PKBS, mbi ecurinë e vizitës dhe bisedimet me udhëheqësit e Shqipërisë.

¹⁰ Po aty

repartëve të ushtrisë. Por fokusi i vërtetë i kësaj vizite ishte njohja strategjike e bregdetit shqiptar, që del qartë në pikën katër të telegramit që Zhukovi dërgoi në Moskë, gjatë kohës së qëndrimit në Shqipëri. Vetë Zhukovi pohon se vëmendje të veçantë meriton çështja e mbrojtjes së bregdetit shqiptar.¹¹ Tashmë njëhej synimi i sovjetikëve për kthimin e bregdetit shqiptar në bazë për dislokimin e nëndetësve që do të vepronin në detin Mesdhe.

Ministria e Mbrojtjes Popullore bëri një studim paraprak për nevojat e mbrojtjes së vendit me rastin e vizitës së Zhukovit. Në këtë plan mbrojtjeje paraqet interes pika dhjetë, sipas të cilës kërkohej që në bregdetin shqiptar të instaloheshin raketat, për t'u mbrojtur nga Greqia.¹² Në të njëjtin studim preket edhe problem i Marinës. Përfundimi i palës shqiptare ishte që marina të ngelej siç ishte. Për nëndetëset që priteshin të vinin sipas marrëveshjes së 12 shtator 1957, propozohej të kishin efektivë sovjetikë. “Po deshën të vinë sovjetikët me ekuipazhet e tyre.”¹³ Në momentin e vizitës, marina shqiptare nuk kishte personel të specializuar për nëndetëset. Kjo shpjegon edhe arsyen përse jo vetëm u pranua, por edhe u kërkuar që sovjetikët të sillnin jo vetëm nëndetëset, por edhe ekuipazhet e tyre. Ky propozim është i rëndësishëm për të kuptuar konfliktet e mëtejshme, që u shkaktuan nga prania e dy ekuipazheve brenda së njëjtës nëndetëse.^{14*}

Me syrin e një njohësi të specializuar, Zhukovi konstatoi se bregdeti shqiptar i cili nga pikëpamja strategjike ishte jashtëzakonisht i rëndësishëm për gjithë kampin socialist, kishte nevoja serioze të mbrojtjes së bregut.¹⁵ Ai propozoi forcimin e bregdetit shqiptar me gryka zjarri [artilieri] që nënkuptonte luftë kundër mbrojtjes kundër anijeve të armikut në kanalin e Otrantos. Njëri prej shoqëruesve të tij, njëkohësisht dhe atashe ushtarak i Shqipërisë në Moskë, Halim Ramohito, në rrëfimin e tij pohon se “në mendimet e mareshalit nuk kalonin aspak rreziqet që mund t'i kanoseshin vendit tonë nga ndonjë sulm eventual i mundshëm, por për mundësinë e hegjemonisë së tyre nga ai drejtim strategjik.”¹⁶

¹¹ Po aty

¹² *AQFA*, Fondi 100/3, V.1957, D.41, fl.34. Relacion për ministrin e Mbrojtjes B. Balluku.

¹³ *Po aty*, fl.41.

¹⁴ *Gjatë krizës shqiptaro-sovjetike në Bazën e Vlorës në periudhën 1960-1961 ekzistenca e dy ekuipazheve në të njëjtën nëndetëse solli shumë problematika. Ekuipazhet shqiptare pretendonin se ata e kishin kaluar provën e përdorimit të nëndetësve, kurse ekuipazhet sovjetike qëndronin aty me pretendimin se pala shqiptare ishte e paafte. Meqë për ekuipazhet sovjetike u përdor rëndom emërtimi instruktorë, ata në këtë cilësi duhet të largoheshin nga nëndetëset, sapo këto t'i dorëzoheshin palës shqiptare.

¹⁵ H. Kaba, E. Çeku, *Shqipëria dhe Kosova...*, vep. përm., f.173.

¹⁶ H. Ramohito, *Në shërbim...*, vep. përm., f.64.

Gjatë vizitës së tij në Karaburun ai e cilësoi atë si një “vend i mrekullueshëm për predha, aeroplanë dhe raketa të destinuara kundra anijeve me gjatësi hedhjeje gjer në 5- 600km.”¹⁷ Zhukovi propozoi ndërtimin e katër stacioneve raketore¹⁸. Stacioni i Vlorës do të ishte me raketa kundërajrore. Po kështu një stacion tjetër duhet të ngrihej për mbrojtjen e kryeqytetit.¹⁹ Në këtë vizitë u përcaktua edhe vendi ku do të kryheshin punimet.²⁰ Entuziazmi i Zhukovit është bërë i njohur tashmë përmes thënies së tij: “Ky është një gji i mrekullueshëm! Deti i Zi, ku ne kemi një pjesë të flotës sonë, është në fakt një liqen. Ta dislokojmë atë flotë që kemi atje këtu, në këtë bazë.”²¹ Por edhe pala shqiptare llogariste përfitimet e saja. Gjatë takimit të datës 24 tetor të kërkuar nga Enver Hoxha, ai i ripërsëriti Zhukovit se sa e rëndësishme ishte vizita e tij për popullin, partinë dhe qeverinë shqiptare. Kjo vizitë u përdor si një element demagogjik për të përforcuar pozitat e lëkundura të PPSH. Përforcimi i mbrojtjes së vendit ishte një tjetër përfitim madhor.²²

Qëndrimi i udhëheqjes shqiptare ndaj propozimeve të Zhukovit

Në procesverbalin e mbledhjes së Byrosë Politike, më 24 tetor 1957, përmes diskutimit të Enver Hoxhës dhe raportimit të Beqir Ballukut dalin qartë arsyet thelbësore që e shtynë regjimin komunist që me marrëveshjen e 12 shtatorit të pranonte krijimin e një Baze Detare Luftarake, që do të kishte si efektivë një numër të madh ushtarakësh sovjetikë. Ushtrisë shqiptare i mungonte jo vetëm baza materiale, por edhe njerëzit e kualifikuar.²³ Me sigurimin e teknikës moderne dhe ardhjen e nëndetësve, koha nuk priste deri në përgatitjen e kuadrove shqiptarë. Pranimi i ushtarakëve dhe teknikëve sovjetikë ishte një domosdoshmëri dhe të dyja palët e dinin këtë gjë.

Duke lexuar procesverbalin e takimit të 24 tetorit, pohimet e bëra nga Enver Hoxha hedhin dritë mbi faktin se ai e kuptonte se bregdeti shqiptar do të

¹⁷ *AQSH*, Fondi 14 AP/OU, V.1957, D 20, fl.2. Procesverbal i mbledhjes së BP

¹⁸ Mbrojtja me raketa ishte ndër strategjitë më të avancuara për kohën.

¹⁹ *Po aty*.

²⁰ *Po aty*, fl.2. Sipas procesverbalit Zhukovi dhe Enver Hoxha kishin diskutuar për një sistem tunelesh në Karaburun. Duke u nisur edhe nga lloji i armatimit të përmendur në procesverbal kuptohet që gjiri i Vlorës po përgatitej të përballonte veprimet luftarake, që i kalonin kufijtë e mbrojtjes së vendit tonë. Pra ishte më afër një teatri luftarak sulmi, ku mund të përfshihej dy blloqet.

²¹ H. Ramohito, *Në shërbim...*, vep. përm., f.28

²² *AQSH*, Fondi 14 AP/OU, V.1957, D 20, fl.2. Beqir Balluku gjatë raportimit në Byronë Politike shpjegon se dhënia e 4 nëndetësve për vitin 1958 dhe premtimi për 8 të tjera për vitin 1959, ishte i lidhur ngushtë me faktin se zona kishte interes të madh në planet strategjike të mbrojtjes ose të sulmit. Gjithashtu shiko: Ana Lalaj, “Shqipëria: Nga Pakti i Varshavës...”, art. përm., f.177.

²³ *Po aty*, fl.2. Pajisja me mjete luftarake modern, shtronte problemin e modernizimit të ushtrisë edhe me njësi taktike. Të tilla ishin një divizion aeroplanësh dhe një regjiment bombardimesh, të cilat duhet të vihejshin në funksione të veprimeve luftarake në këtë rajon.

përdorej për një përballje të mundshme me NATO-n. “Shokët sovjetikë dhe sidomos Zhukovi na i bënë akoma më të qartë rëndësinë e madhe që ka pellgu i Mesdheut në një luftë të ardhme.”²⁴ Në këtë rajon ishte grumbulluar Flota e Gjashtë Amerikane, së bashku me partnerët e saj, italianë, anglezë etj. Në këto rrethana Enver Hoxha mbështeti idenë, se në Mesdhe duhet të krijohet një bazë e fortë mbrojtëse [që nënkuptonte Bazën e Vlorës] madje shkoi më larg, duke kërkuar që kjo bazë të ishte njëkohësisht edhe sulmonjëse.”²⁵ Në vazhdim të kësaj ideje, Enver Hoxha raportoi në BP edhe bisedat që Zhukovi kishte zhvilluar me oficerët sovjetikë, që e shoqëronin. “Ne duhet të arrijmë ta asgjësojmë Flotën e Gjashtë Amerikane që nga bazat e Shqipërisë.”²⁶

Zhukovi nuk e kishte fshehur faktin se për Flotën Sovjetike të Detit të Zi, Dardanelet, Bosfori dhe ishujt e Greqisë ishin një pengesë e madhe. Shqipëria ishte një mundësi shumë e mirë për Bashkimin Sovjetik. Prandaj edhe gatishmëria për të sjellë nëndetëse të reja ishte e justifikueshme për palën sovjetike. Pala shqiptare aq sa i gëzohej rritjes së forcës mbrojtëse të vendit, aq edhe shqetësohej se ky kapacitet mbrojtës i kalonte kapacitetet ekonomiko-njerëzore të Shqipërisë. Gjithë ky armatim kërkonte një buxhet të dedikuar për ushtrinë. Qeveria shqiptare nuk kishte kuadrot e nevojshme dhe kostoja e mirëmbajtjes për këto mjete luftarake shkonte në miliona rubla.²⁷

Qartazi në procesverbalin e këtij takimi del ideja se 8 nëndetëset e reja duhet të mbaheshin nga sovjetikët. Por “oficerët dhe njerëzit që do të shërbejnë në to të jenë të veshur me uniformën shqiptare dhe mjetet të mbajnë flamurin shqiptar.”²⁸ Pa përmendur emra, por duke përdorur shprehjen e përgjithshme “armiqet”, E. Hoxha e bëri të qartë se ky veprim i ndërmarrë do të bënte zhurmë.²⁹ Pra, implikimet politiko-ushtarake që sillte kjo bazë në rajon nuk ishin të panjohura dhe vendimmarrja nuk mund të konsiderohet naive. Krijimi i një baze të tillë ushtarake nuk mund të kalonte pa vëmendje qoftë nga fqinjët, qoftë nga perëndimi. Shprehje të tilla se “zhurma e armiqve nuk na prish punë aspak”, i shkonte për shtat zgjedhjes pragmatiste, të kushtëzuar së pari nga rrethanat e brendshme. Në këtë moment, baza ushtarake e Vlorës e paraqitur

²⁴ *Po aty*, fl.5.

²⁵ *Po aty*.

²⁶ *Po aty*.

²⁷ *Po aty*, fl.5.

²⁸ *Po aty*, fl.6. Nga pikëpamja ushtarake, nisur nga procesi i angazhimit të trupave të huaja në një vend tjetër këto trupa duhet të deklaroheshin në kuadër të aleancës. Madje edhe në rastin kur ishte një marrëveshje dypalëshe ky dislokim trupash nuk mund të bëhej pa u miratuar nga Kuvendi Popullor. Nuk ekziston deri më tani një diskutim mbi faktin se mbi ç’bazë ligjore u bë dislokimi i trupave sovjetike në vendin tonë. Si dokumente të vlefshme janë marrë parasysh marrëveshjet dypalëshe midis dy ministrive të Mbrojtjes.

²⁹ *Po aty*.

si bazë e TV shihej jo vetëm si një zgjidhje për problemet e mbrojtjes por edhe si një mjet prestigji. Me një eufori të dukshme mbrojtja e Shqipërisë u pa e lidhur ngushtë me mbrojtjen e gjithë kampit socialist.³⁰

E parë në koncepte ushtarake, baza e Vlorës do të ishte vija e parë e frontit të luftës. Ky arsyetim rrjedh nga rënia dakord pa asnjë kusht për ardhjen e 12 nëndetësve dhe hapjes rrugëve sovjetikëve për të dërguar sa më shumë mjete “mbrojtëse” luftarake në Shqipëri për të likuiduar flotën amerikane. Nisur nga rrezja e luftimeve të bazuara në Sazan dhe Vlorë, baza do të shërbente për të bllokuar në rast konflikti furnizimet e NATO-s në Adriatik. Duke hequr paralele me krizën e ndodhur në kanalin e Suezit³¹ Enver Hoxha “justifikoi” dhe qëndrimin e tij se baza iu duhej dhënë shokëve sovjetikë që ndoshta e prisnin një gjë të tillë nga ana e shqiptarëve.³² Dhënia e kësaj zone strategjike u pa si një gjë e pranueshme dhe sepse sipas arsytimit të Enver Hoxhës “nuk kishte asgjë parimore”,³³ pasi jeta e vendit ishte e lidhur shumë ngushtë me jetën e BRSS.

Se sa vërtetësi kishte ky pohim, kjo lidhet ngushtë me nevojat e ngutshme vetjake të ruajtjes së pushtetit nga Enver Hoxha në momentin kur u bë propozimi. Kaq të ngutshme ishin këto nevoja të brendshme sa edhe në fjalën e mbajtur nga Hoxha, ndihet ngutja për t’i dalë përpara Zhukovit me këtë iniciativë. “ne nuk kërkojmë të na japin aq apo kaq, por mendojmë që mbrojtja e vendit tone të konsiderohet si mbrojtja e çdo pike të BS”.³⁴ Vlora do të kthehej kështu në një kështjellë përpara Sevastopolit, duke penguar Flotën Amerikane të kalonte në Detin e Zi. Për këtë arsye në Vlorë nuk duhet të vinin vetëm nëndetëset, por edhe prania e kryqëzorëve³⁵ ishte e mirëpritur, jo thjesht për para si kishte ndodhur në vizitat e viteve 1954 dhe 1956, por sepse duhet t’i jepeshin ushtrisë shqiptare për të rritur kapacitetet e luftimit. Ushtarakisht kjo ishte një thirrje e hapur për luftë jo me karakter mbrojtës, por me karakter sulmues. Edhe pse doktrina ushtarake shqiptare nuk e parashikonte një gjë të tillë, fuqizimi i bazës me mjete luftarake të kësaj kategorie bënte që misioni i saj të transformohej. Në bisedën e datës 24 tetor, Zhukovi i premtoi palës

³⁰ *Po aty*.

³¹ Kriza e Suezit e vitit 1956, shkaktuar nga qeveria e Egjiptit u patronazhua nga Bashkimi Sovjetik.

³² *Po aty*.

³³ Për të kuptuar domethënien e kësaj shprehjeje mund t’i referohemi parimeve ideologjike të kategorizuara nga Brzezinski mbi të cilat vendet satellite të Europës Lindore kishin nënshkruar marrëveshjet e tyre dypalëshe me BS. E para, supremacia sovjetike në proletariatin ndërkombëtar, e dyta, lufta kundër imperializmit në planin ndërkombëtar dhe brenda vendit, e treta dhe ndoshta më e rëndësishmja në këtë rast, gjithëpranueshmëria e konceptit të diktaturës së proletariatit.

³⁴ *Po aty*

³⁵ *Po aty*

shqiptare se raketat që nëndetëset që ishin parashikuar të vinin për vitin 196 do të ishin të pajisura me raketa me rreze km veprimi.³⁶ Të gjitha këto fakte i jepnin të drejtë perëndimit ta shihte BDL të Vlorës si kërcënim në kuadrin e Luftës së Ftohtë.

Përfundime

Vendimi i kthimit të Vlorës në bazë të fuqishme luftarake - detare u “shit” si një vendim i gjithë popullit shqiptar dhe që do të pritej me entuziazëm. E. Hoxha e lëshoi Vlorën pa hezitur, i bindur se kishte realizuar një marrëveshje shumë fitimprurëse me sovjetikët. Prania e një numri të madh ushtarakësh sovjetikë në territorin e Shqipërisë u mbulua me propagandën “sa shumë i do populli njerëzit sovjetikë”, madje u kalua në krahasime edhe brenda kampit socialist, si p.sh., “Shqipëria nuk është si Polonia.”³⁷ Dy ditë pas largimit të mareshalit Zhukov nga Shqipëria, Këshilli Ministrave, nxori udhëzimin “Tepër sekret”, që ndalonte lundrimin dhe qëndrimin e anijeve të huaja dhe të RPSH në gjirin e Pashalimanit (Vlorë) dhe caktimin e gadishullit të Karaburunit zonë ushtarake.³⁸ Nga ana e saj, Ministria e Mbrojtjes Popullore i kërkoi Këshillit të Ministrave që të nxirrte një vendim që Pashalimani nga gji i hapur në bazë të Kodit Ndërkombëtar, të kthehej në gji të mbyllur. Masa të rrepta u vendosën me ngritjen e postblloqeve policore. U kufizua lëvizja e personelit të përfaqësive diplomatike në drejtim të Vlorës, të cilët duhet të kontrolloheshin nga Ministria e Brendshme. Kontroll do të ushtrohej edhe mbi shoferët e autobusëve Vlorë – Gjirokastër.³⁹ Edhe pse në distancë nga zona bregdetare, një kategori tjetër që duhet të mbahej në kontroll ishin të internuarit në zonën e Llakatundit. Një kujtesë bëhej edhe mbi procesin e pasaportizimit në qytetin e Vlorës. Të gjitha këto për të shmangur veprimtarinë agenturore.

Krijimi i Bazës Detare Luftarake të Vlorës që i njohu një rol të ri strategjik vendit tonë, çoi në krijimin e një shteti militar. U rrit numri i ushtarakëve mbi numrin e parashikuar në bazë të strukturës së përcaktuar nga Traktati i Varshavës edhe pse mareshali Zhukov kishte përsëritur idenë se Shqipëria nuk duhet të kishte një ushtri të madhe.⁴⁰ Pasojat e këtij militarizimi të tejskajshëm filluan të duken që në vitet e para të shndërrimit të kësaj baze. Në letrën që

³⁶ AQSH, Fondi 14 AP/OU, V.1957, D 20, fl.2. Procesverbal i mbledhjes së BP

³⁷ Po aty, fl.7.

³⁸ AQFA, F.100/1, V.1957, D.42. Urdhër Nr 788, “Mbi ndalimin e lundrimit dhe qëndrimin të anijeve të huaja dhe të RPSH në gjirin e Pashalimanit (Vlorë) dhe mbi caktimin zonë ushtarake të gadishullit të Karaburunit”.

³⁹ Po aty, fl.2. Urdhri i KM datë 15.09.1958 pika 5.

⁴⁰ AQSH, Fondi 14 AP/OU, V.1957, D 20, fl.2.

Mehmet Shehu i dërgoi N. Hrushovit në gusht të vitit 1960⁴¹, për të kërkuar një kredi prej 125 milionë rublash, shpjegonte se qeveria shqiptare kishte harxhuar vlerën prej 204 milionë rublash të dhënë falas në bazë të marrëveshjes së 9 marsit 1956 për riarmatosjen e Ushtrisë Popullore si dhe një kredi me vlerën 38 milionë rubla me afat shlyerje deri në 10 vite, duke filluar nga viti 1960. Për rrjedhojë nga ky harxhim ishin lënë zbuluar shpenzimet e planit për riarmatosjen që kapnin vlerën 58 milionë rubla.⁴²

Vizita e Zhukovit në Shqipëri nuk pati atë “happy end” që do të dëshironte udhëheqja shqiptare. Pikërisht në udhëtimin e tij nga Shqipëria drejt Moskës, Zhukovi do të merrte lajmin e shkarkimit nga detyra e ministrit të Mbrojtjes dhe zëvendësimit me mareshalin Malinovski. Mënyra se si Zhukovi u largua nga detyra, padyshim e ka tronditur Enver Hoxhën. Madje në analizën që i bënë në kujtimet e tij shkarkimit të Zhukovit e quan atë “antidemokratike; bie erë puçi”.⁴³ Por këto pakënaqësi udhëheqësi shqiptar i ruajti për vete. Beqir Balluku në cilësinë e ministrit të Mbrojtjes i dërgoi letër urimi pasardhësit të Zhukovit, mareshal Malinovskit. Bashkëpunimi ushtarak mes palëve ishte përparësi në politikën e Bashkimit Sovjetik ndaj Shqipërisë. Kurse nga Zhukovi ngeli shprehja anekdotë “u shkarkove në ajër si Zhukovi”. Përsa i përket projekteve ushtarake ato qenë jetëshkurtra pasi prishja me Bashkimin Sovjetik, do të ndodhte përpara se realizimi i tyre të bëhej realitet.

Bibliografia:

Arkivat:

Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë [AQSH]

Fondet:

F:14/Arkivi i Partisë – Organet Udhëheqëse, AP/ OU, viti 1957/ dosja:20

Arkivi Qendror i Forcave të Armatosura [AQFA]

Fondet:

F: 100/1- Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura [SHPFA], viti 1957/ dosja:42

F100/3 – Viti 1957, dosja: 10.382.

1- HOXHA, Enver, *Ditar 1955-1957*, Tiranë :Shtëpia Botuese “8 Nëntori,” Vol 1, 1987.

⁴¹ AQFA, F.100/3, V.1960, D.382, f.4-5. Letër e kryetarit të KM, M. Shehut dërguar N. Hrushovit për dhënien Ushtrisë Shqiptare të një kredie prej 125 milionë rublash.

⁴² Po aty. f.4-5.

⁴³ E. Hoxha, *Ditar 1955- 1957...*, vep. përm., f. 378.

- 2- LALAJ, Ana, “Shqipëri në Paktin e Varshavës, 1955- 1968”, në: *Studime Historike*, 2004, nr 1-2.
- 3- SMAÇI, Etleva, disertacion doktrate, “*Shqipëria në Traktatin e Varshavës*”, Tiranë, 2017.
- 4- Kaba, H &, Çeku, E, *Shqipëria dhe Kosova në arkivat ruse*, Prishtinë: Brezi 81, viti, 2011.
- 5- Ramohito, H, *Në shërbim të popullit tim*, Tiranë:Grandprix, 2015.

KARAKTERISTIKA DHE DUKURI TË ZONËS SË PARË OPERATIVE GJATË LUFTËS SË DYTË BOTËRORE

Prof. Asoc. Dr. Bernard ZOTAJ

Instituti i Studimit të Historisë Ushtarake

Trajtesë e shkurtuar.

Zona e parë operative Vlorë-Gjirokastrë-Mallakastër ishte i vetmi formacion i llojit të përmasave operative-strategjike me tipare e karakteristika krejt të veçanta. Punimi trajton karakteristika dhe dukuri të kësaj zone gjatë Luftës së Dytë Botërore. Zona ishte një tip formacioni me paraqitje të veçantë, me karakteristika dalluese nga ato të formacioneve të mëparshme apo ato pasuese, si brigada sulmuese etj., por ajo mbeti e vetmja e llojit dhe nuk u pasua nga të tjerët. Më tepër se grupi partizan, zona e parë operative (ZIO p) përfshiu të gjitha formacionet partizane që shtrinin veprimtarinë e tyre brenda kufijve të saj, ndërsa në pikëpamje ushtarake, përbënte një formacion të shkallës operative, me mundësi të mëdha luftarake.

Shtabi i Zonës u mbështet mbi disa parime si drejtimi kolegjial që u zbatua me rigorozitet deri në ditët e fundit të funksionimit të tij. Në veprimtarinë e vet shtabi udhëhiqej nga kërkesat e parimeve të tjera, zbatimi me rigorozitet i të cilave kushtëzonte zhvillimin e zgjerimin me sukses të luftës në kushtet e një territori të pushtuar, të cilat ishin vullnetar karakteri popullor dhe mëvetësia e organeve drejtuese dhe formacioneve të zonës në lëvizje, manovrim dhe veprime luftarake.

Organizimi i forcave territoriale vullnetare dhe pushtetit ushtarak të prapavijave përbëjnë një dukuri të re të këtij formacioni të veçantë. Zona përbën një vlerë dhe një përvojë historiko-ushtarake dhe atdhetare për popullin, por veçanërisht për ushtarakët shqiptarë të sotëm e të së ardhmes.

Hyrje

Zona e parë operative shtrihej në Qarkun e Vlorës, në Gjirokastrë dhe në krahinën e Mallakastrës, me një sipërfaqe mbi 6000 km², me disa karakteristika të veçanta të saj si: kishte një sipërfaqe mjaft të gjerë, me dalje në det dhe në kufi me Greqinë; terren tepër të përshtatshëm për mbrojtje, për sulm dhe për prita; shtrihej në krahina të çliruara, me tradita atdhetare të ndezura; ishin vendosur baza të fuqishme të Luftës Antifashiste NÇ; popullsia në shumicën dërmuese ishte e lidhur me luftëtarët e lirisë dhe kishte traditë luftarake; u bë një burim i pashtershëm e i përhershëm për furnizimin e formacioneve partizane me luftëtarë, me ushqime e veshmbathje; krijoi kushte për formimin e formacioneve më të mëdha të ushtrisë së rregullt; rol luajtën edhe besimet fetare, veçanërisht ajo bektashiane¹ që ishte më e përhapur në zonë etj. Anëtarët e shtabit ishin luftëtarë dhe drejtues të njohur të formacioneve partizane në krahina të ndryshme të zonës.²

Shtabi i ZIO p, ishte një strukturë e lehtë, e gatshme për lëvizje, për manovrime të shpejta, që i përshtatej shumë shpejt terrenit malor të zonës e që njihej shumë mirë prej tyre, duke qenë kurdoherë në krye të situatave, duke manovruar me shumë kujdes dhe në situatat më kritike të luftës. Shtabi pati disa veçori që e dallojnë atë nga shumë shtabe të njësive apo edhe të grupeve të qarqeve që u krijuan në shkallë vendi. Ndaj dhe ngeli deri në prag të fundit të luftës, një formacion unik, për vetë rolin që luajti dhe peshën që zuri në LANÇ-in. Pikërisht për risitë dhe veçoritë që solli ky formacion krejt i veçantë luftarak mund të dalim në disa përfundime.

Lidhjet, varësitë e raportet që u mbajtën ndërmjet formacioneve të ndryshme luftarake e ndihmëse të ZIO p, janë të ndryshme nga ato të njësive apo të formacioneve të tjera. Qarqet ushtarake këtu u vunë plotësisht në vartësi të Komandës e të Shtabit të ZIO p, ndërkohë që qarqet e tjera vareshin drejtpërdrejt nga Shtabi i Përgjithshëm dhe krijuan shtabe grupesh partizane. Në juridiksionin e ZIO p kishte forca që vareshin drejtpërdrejt prej saj e më pas dhe njësi sulmuese të shkallës operative (Br.S), të cilat vareshin nga Shtabi i Përgjithshëm, por që sipas detyrave të këtij të fundit, bashkëvepronin dhe kryenin detyra me ide dhe objektiva të përbashkët me ZIO p. Në këtë Zonë u realizua një gërshtim i përkryer i të gjitha veprimeve luftarake³ të Br.S, Gr.P, b p dhe formacioneve vullnetare partizane, si dhe të gjithë komandave të qarqeve dhe të vendit, spitaleve partizane, depove, punëtorive, e deri te skuadrat e mirëmbajtjeve të rrugëve, ndërlidhja etj., të cilat hynin të gjitha në detyrat e shtabit të ZIO p.

¹ Bernd Fisher, Shqipëria gjatë luftës 1939-1945, Tiranë, 2000, f. 89

² AQU, Kutia e Zonës I Operative, dosja 17.

³ AQSH, F. 67/AP, viti 1944, dosja 10, f. 25-26.

ZIO p, në varësi nga koha dhe rrethanat, kreu veprime luftarake fillimisht me forcat e veta partizane e vullnetare, deri në nëntor 1943 dhe, më pas, në bashkëveprim me njësitë sulmuese të Shtabit të Përgjithshëm, deri më tetor 1944, kur pushoi me urdhër veprimtarinë e vet. Zona ka qenë pjesëmarrëse e drejtpërdrejtë dhe ka luajtur rol të rëndësishëm në momentet më kyçe në veprimtarinë luftarake të U N Ç SH. Kështu mund të theksojmë veprimet e njëkohshme për përballimin e sulmit gjerman dhe çarmatosjen e forcave italiane pas kapitullimit, përballimin e luftës së parë balllore në Drashovicë dhe në Konispol më 1943; në Operacionin e Dimrit 1943-1944, në Operacionin e Qershorit 1944; pjesëmarrjen në Kundërmësymjen Pranverore të UNÇSH-së (prill-maj 1944), në çlirimin e qyteteve dhe të territorit të vetë zonës në bashkëveprim me njësitë e UNÇSH-së, apo dhe vetëm deri në tetor 1944, në mbrojtjen e punimeve të Kongresit të Përmetit dhe në ngritjen e forcimin e pushtetit të ri popullor.

Komanda dhe Shtabi i ZIO p, si një organizëm ushtarak por edhe administrativ, ka kryer një kompleks detyrash. Ndër më kryesoret janë: puna politike dhe sqaruese me popullin, mbrojtja e popullsisë nga operacionet dhe veprimet luftarake të armikut dhe të veglave të tij, si dhe ndihma për kapërcimin e vështirësive të operacioneve të armikut; dhënia e ndihmës për familjet partizane, të dëshmorëve dhe të vobektëve; mobilizimi dhe furnizimi i formacioneve luftarake me luftëtarë e materiale në çdo kohë e situatë; sigurimi i të dhënave informative, përpunimi i tyre dhe marrja e masave për përballimin e operacioneve të vazhdueshme; organizimi e riorganizimi i vazhdueshëm i formacioneve partizane, drejtpërdrejt, apo duke bërë furnizime me forca njerëzore, të komandave të qarqeve, të vendit, të pushtetit ushtarak; sigurimi i funksionimit të pushtetit të prapavijave në zonat e çliruara dhe vendosja në to e spitaleve, depove, punëtorive; rindërtimi e mirëmbajtja e rrugëve, e linjave telefonike, duke përdorur për këtë qëllim edhe robërit e luftës; likuidimi i agjenturës rezerviste, pasi zona shtrihej gjeografikisht në kufi me Greqinë, e cila kishte synime territoriale me Shqipërinë, demaskimi i bashkëpunëtorëve të nazistëve dhe i veprimtarisë së tyre armiqësore etj.

Krijimi i Shtabit të ZIO p, sipas urdhrit të Shtabit të Përgjithshëm⁴, përfshinte qarqet Vlorë, Gjirokastrë dhe krahinën e Mallakastrës, erdhi si rezultat logjik i zhvillimit të LANÇ në këtë hapësirë, por edhe si një domosdoshmëri dhe nevojë për të përballuar detyrat e reja në rritje, që i shtroheshin UNÇ për ndërmarrjen e veprimeve të përqendruara luftarake dhe të përmasave më të mëdha në shkallë qarku, zone e më gjerë, edhe deri në shkallë vendi.

Në pamje më konkrete krijimi i qarqeve dhe i ZIO p u kushtëzua edhe nga:

⁴ Dokumente të Shtabit të Përgjithshëm, vëll 1, Tiranë, 1976, f. 77.

ashpërsimi i goditjeve të vazhdueshme mbi armikun në qytete e në krahina të gjera; organizimi i operacioneve në shkallë më të gjerë dhe bashkëveprimi midis forcave të çetave e batalioneve partizane; krijimi i formacioneve më të mëdha luftarake (grup, brigadë etj.) e deri i një ushtrie të organizuar e të rregullt për t'i bërë ballë armikut dhe për të realizuar qëllimin strategjik, çlirimin e vendit; drejtimi i forcave partizane ishte më efektiv; forcat partizane do të ishin më kompakte, me fuqi të madhe goditëse etj.

Në përbërje të Komandës dhe të Shtabit të Zonës, në funksionet përkatëse, u zgjodhën dhe u emëruan personalitete të spikatur e në moshë relativisht të pjekur (ndryshe nga formacionet e tjera partizane, ku në krye të tyre kishte dhe të rinj në moshë). Në përzgjedhjen e tyre del se janë mbajtur parasysh disa kritere. Çdo krahinë e trevës ku shtrihej Zona (Vlorë-Gjirokastër-Mallakastër) të mbulohej në shtab me përfaqësuesit të vet; çdo anëtar apo funksionar i shtabit, me jetën dhe veprimtarinë e vet antifashiste apo luftarake (deri në gusht 1943) të gëzonte autoritet dhe mbështetje nga popullsia vendase e më gjerë krahinës që përfaqësonte; të kishte marrë pjesë në luftërat e mëparshme të popullit shqiptar (në vartësi të moshës) e veçanërisht të ishte angazhuar politikisht dhe ushtarakisht në vitet e para të LANÇ, në funksionet më të larta komanduese dhe në ato që kishin të bënin drejtpërdrejt me problemet luftarake (planëzimi, formulimin e dokumenteve), duke qenë se ky ishte një shtab, në radhë të parë ushtarak. Për bërthamën e shtabit, që merrej me organizimin dhe drejtimin e veprimeve luftarake në Zonë, u bë kujdes që të caktoheshin njerëz me formim të mirëfilltë ushtarak apo me një përvojë të pasur luftarake në të kaluarën, jo thjesht si luftëtar por si drejtues apo komandues.

Parimet mbi të cilat u mbështet Shtabi i Zonës

Drejtimi kolegjal nga Shtabi i Zonës u zbatua me rigorozitet deri në ditët e fundit të funksionimit të tij, si një nga parimet bazë të punës së tij. Por në zbatimin e këtij parimi, në veprimtarinë e shtabit dallojmë dy momente:

Së pari, shtabi dhe gjithë pjesët përbërëse të tij (që nga komanda, shtabi operativ e deri te seksionet e shërbimet) mblidheshin të tërë së toku vetëm në momente të caktuara, për vendime të rëndësishme afatgjata. Kjo kushtëzohej nga vështirësitë e luftës dhe nga fakti se një pjesë e anëtarëve të shtabit, sipas rastit, ose kishin në të njëjtën kohë funksione të paracaktuara nëpër formacionet partizane, territoriale, pushtetin ushtarak apo këshillat NÇ të krahinave nga vinin, ose ishin të deleguar të shtabit pranë tyre për të dhënë ndihmesë konkrete dhe për të bashkërenduar në terrenin praktik veprimet e forcave të ndryshme që merrnin pjesë në të njëjtin aksion. Në Zonë vepronin shumë forca, duke filluar nga çeta, batalione partizane e territoriale, më pas grupe partizane, të cilët ishin në varësi organike të saj, apo edhe brigada partizane,

të cilat vepronin gjerësisht në hapësirën e Zonës dhe kërkohej bashkëveprim konkret, veçanërisht në periudhën përgatitore të veprimeve luftarake dhe në momentet kyçe të zhvillimit të tyre.

Së dyti, zbatimi i parimit të drejtimit kolegjal të shtabit, si hallka kryesore analizuese e planëzuese e veprimeve luftarake, por edhe në fushat e tjera, në atë të ngritjes të pushtetit ushtarak, të këshillave nacionalçlirimtare, në furnizimin materialo-teknik të formacioneve partizane, në ruajtjen e popullsisë nga operacionet armike etj., materializohej në veprimtarinë praktike të përditshme, duke qëndruar së toku, kryesisht pjesa operative e shtabit (oficeri i planeve dhe ndihmësi i tij), si dhe komanda e Zonës (zakonisht komandanti, komisari ose zëvendësi e tyre). Domosdoshmëria e qëndrimit së toku të kësaj bërthame të shtabit kushtëzohej nga nevoja për të marrë vendime të shpejta në kushtet e ndryshimit të shpejtë të situatave, intensiteti i lartë i veprimeve luftarake nga të dy palët.

Nga ana tjetër, hapësira tepër e madhe e zonës, mundësitë e kufizuara për lëvizje të shpejtë me automjet (vetëm në këmbë ose me kafshë), terreni tepër i thyer, daljet në det, kufiri me Greqinë dhe rrjeti i komunikacionit që përshkonte zonën, i cili shfrytëzohej gjerësisht nga pushtuesi për manovër të forcave (me këmbë dhe automjet), vështirësitë të mbërritjes së shpejtë të informacionit, apo mbledhjet e shpejta të shtabit të shpërndarë, përbënin disa nga faktorët që kushtëzonin mbajtjen në gatishmëri të përhershme të pjesës operative të shtabit bashkë me komandën. Në kushtet e atëhershme, si mjet i shpejtë komunikimi ishte ndërlidhja telefonike ajrore në zonat e lira (dhe bëhej kujdes për mbajtjen e saj në gatishmëri). Por ndërlidhja më e sigurt dhe më e gjerë ishte ajo me korrier, edhe pse e ngadaltë në lëvizje. Nga ky kënd komanda e shtabi, për drejtimin e veprimtarisë në zonë, mbanin në vëmendje që urdhrat e udhëzimet të ishin në formë direktive me shtrirje më të gjerë kohore. Por kjo kërkonte aftësi parashikuese e programuese për t'u dalë përpara ngjarjeve. Nga ana tjetër, komandave varëse, për vetë vështirësitë e mbajtjes së lidhjeve të drejtpërdrejta, u lihej hapësirë vetëveprimi ose dërgoheshin pranë tyre përfaqësues të plotfuqishëm të shtabit.

Mbështetur në orientimet e Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH-së, për kryerjen sa më mirë të detyrave dhe për t'u përshtatur sa më mirë zhvillimeve të gjendjes në Zonë, komanda dhe shtabi i Zonës, krahas dërgimit të përfaqësuesve të vet në terren, ishte edhe vetë në lëvizje të vazhdueshme për të qenë sa më pranë ngjarjeve e grupimit të forcave më të rëndësishme. Duke ndikuar drejtpërdrejt në ecurinë e veprimeve luftarake apo të zbatimit të detyrave në fushat e tjera ndihmëse. Pra, vendkomanda e shtabit ngrihej sa më pranë ngjarjeve dhe forcave në mënyrë që të ndikonte më drejtpërdrejt me urdhra, udhëzime, forca e mjete plotësuese. Nga ky kënd vështrimi, edhe shtabi i Zonës, nga gushti

i vitit 1943 kur u krijua e deri në tetor 1944, kur mbylli veprimtarinë e vet, krahas vendkomandave të ndërmjetme, ka drejtuar veprimet luftarake në Zonë nga Kuçi, Manastiri i Cepos, Brataj⁵, Ramicë, Fratar⁶, Krahës, Sheper⁷, Lugjet e Qarrishtës⁸, Nedran⁹.

Krahas parimit të kolegjalitetit, në veprimtarinë e vet shtabi udhëhiqej edhe nga kërkesat e disa parimeve të tjera, zbatimi me rigorozitet i të cilave kushtëzonte zhvillimin e zgjerimin me sukses të luftës në kushtet e një territori të pushtuar. Le të ndalemi në disa prej tyre:

Vullnetarizmi në shtimin e radhëve të formacioneve partizane me luftëtarë të rinj, për ndihmën e luftës nga popullsia vendase etj. ashtu si dhe për gjithë formacionet e tjera të UNÇ-së, vullnetarizmi përbënte bazën për zgjerimin e formacioneve ekzistuese dhe krijimin e formacioneve të reja luftarake të zonës. zbatimi i këtij parimi kushtëzohej nga kushtet e pushtimit të vendit dhe nga vetë shkalla e zhvillimit të luftës (nuk kishte ardhur koha për shpalljen e mobilizimit të detyruar apo për vet funksionimin e ushtrisë në situatë luftarake). Për këtë qëllim, duke vënë në veprim të gjitha instrumentet e strukturat në vartësi të komandës e shtabit të zonës dhe ato bashkëvepruese, veçanërisht bashkëveprimi me qarkorët e partisë komuniste (përfaqësuesi i saj ishte anëtar i komandës), zhvillohej një propagandë e gjerë sqaruese me popullin, në tërësi, e shtresat e veçanta të tij, në veçanti (rininë, gruan, familje e personalitete me autoritet në fshatra e krahina) për nevojën e luftës së armatosur kundër pushtuesit e veglave të tij; për furnizimin e formacioneve partizane, por edhe territoriale, me materialin njerëzor (luftëtarë të lirisë). Furnizimin me ushqim, veshmbathje e deri me municione e armatim për frontin.

Karakteri popullor i LANÇ-it ishte konceptuar e po realizohej në praktikë si një luftë që mbështetej nga populli, sipas parullës luftarake të kohës “*Pa dallim feje, krahine dhe ideje*”. Në rezultat të punës sqaruese e mobilizuese të gjithë strukturave ushtarake e të terrenit, u arrit që karakteri popullor i luftës të materializohej që në fillesat e veta, me mendime e praktika të studiuara e programuara mirë. Kështu, pjesa më jetësore e popullsisë (rinia e të dy sekseve) dhe burrat përfshiheshin në radhët e formacioneve luftarake partizane, pjesa tjetër e popullsisë, e të dy sekseve, që mund të përdornin armë, pavarësisht nga mosha, përfshiheshin në radhët e forcave territoriale (çeta të fshatrave e

⁵ AQSH, F. 67/AP, viti 1943, dosja, 1, f. 11.

⁶ Shefqet Peçi, “Fragmente nga epopeja e lavdishme”, Tiranë, 1984, f. 180.

⁷ Veteranët tregojnë, vëll.1, Tiranë 1979, f. 39.

⁸ M.Kote-K.Bezati, Përmeti gjatë LANÇ 1939-1944, Përmet, 1987, f. 383.

⁹ Veteranët tregojnë, vëll. 1, Tiranë, 1979, f. 49.

batalione të krahinave) si një rezervë e pashtershme njerëzore për formacionet e rregullta partizane, por edhe si një forcë reale luftarake e ndihmëse (në front, në drejtime ndihmëse por në raste të caktuara edhe të rëndësishme si dhe për vetëmbrojtje të fshatit, krahinës dhe të popullsisë vendase). Po ashtu, pjesa tjetër e popullsisë (pleq, gra, fëmijë) angazhoheshin në kryerjen e detyrave të sigurimit të ushqimeve, veshmbathjes e furnizimeve të tjera, duke furnizuar forcat partizane dhe ato territoriale në vijën e frontit. Kjo i jepte luftës një karakter të gjerë popullor dhe e masivizonte atë. Në shkallën më të lartë, ky masivizim u materializua, që në fillesat e funksionimit të Shtabit të ZIO p që në betejat frontale të zhvilluara në Konispol e Drashovicë, ku ishin zhdukur dallimet front-prapavijë.

Mëvetësia e organeve drejtuese dhe formacioneve të Zonës në lëvizje, manovrim dhe veprime luftarake. Mbi bazën e këtij parimi, që buron nga kushtet në të cilat zhvillohej lufta (kundër një armiku me epërsi në forca e mjete), vëmendja e shtabit të zonës përqendrohej në dy drejtime kryesore: Në pajisjen e formacioneve të reja partizane me armatim më të domosdoshëm për kryerjen e veprimeve luftarake kryesisht armatim i lehtë, dhe me municione me sasi të mjaftueshme në vartësi të detyrës që do të kryenin; kushtet në të cilat ngriheshin repartet e reja partizane apo në ato që përsoseshin formacionet më të vjetra, ishin të tilla që nuk lejonin pajisjen e tyre me armatim e teknikë të rëndë prandaj edhe në vëmendjen e shtabit të Zonës, mbi bazën edhe të orientimeve të dërguara nga Shtabi i Përgjithshëm i UNÇSH, kishte përputhje në mes të mundësive luftarake të formacioneve partizane me detyrat që iu ngarkoheshin dhe me taktikat që ato do të përdornin. Në kushtet e një armiku me epërsi në forca e mjete, lëvizshmëria, shpejtësia e befasia e lëvizjes dhe e veprimit të forcave partizane ishte përcaktuese në mbijetesën luftarake të tyre. Detyrat që iu ngarkoheshin formacioneve partizane llogariteshin mirë në hapësirë e në kohë, në mënyrë të tillë që ato të jepnin goditje të befasishme mbi armikun, ta dëmtonin rëndë atë deri në nxjerrjen jashtë luftimit apo asgjësimin e plotë, por ato ishin në gjendje të realizonin menjëherë shkëputjen e kontaktit luftarak me armikun përmes lëvizjeve të shpejta, të befasishme e duke shfrytëzuar karakteristikat e veçanta të terrenit të Zonës, të cilin ato e njihnin dhe e zotëronin mirë. Pra në themel të taktikës së përdorur nga forcat partizane, shtabi i Zonës kishte vënë veprimet luftarake sulmuese duke kultivuar tek efektivat shpirtin dhe karakterin sulmues. Veprimet luftarake me taktikën mbrojtëse vlerësohej e përdorej si një mënyrë luftimi e përkohshme dhe zakonisht e detyruar deri sa të merrej nisma.

Zbatimi me krijimtari e në përshtatje me kushtet e mundësitë konkrete i këtyre parimeve dhe veprimtaria e përditshme dinamike e shtabit të Zonës dha rezultate të menjëhershme si në shtimin e forcave partizane të Zonës ashtu

edhe në dëndurinë e në suksesin e veprimeve luftarake në të gjithë hapësirën e saj. Pikërisht mbi këto baza, u arrit në një shkallë më të lartë organizimi i formacioneve partizane, në atë të grupeve.

Organizimi i forcave territoriale vullnetare

Popullsia vendase e aftë për luftë u rreshtua natyrshëm në rreshtat e formacioneve vullnetare. Ajo u bë një rezervë e UNÇ, luajti rol të rëndësishëm në luftë, mori pjesë në veprimet luftarake me forcat e ushtrisë partizane. Pas krijimit të Shtabit të Përgjithshëm, si dhe të Shtabit të ZIO p, u morën masa për organizimin e forcave territoriale. Nga Shtabi i ZIO p na urdhëruan, në javën e parë të muajt shtator 1943, të përqendroni punën tuaj në shtimin e radhëve të forcave territoriale të fshatrave, në organizimin e tyre dhe të jeni gati për një detyrë luftarake të afërt.¹⁰ Nga çetat vullnetare të fshatit, në raport me zhvillimin e luftës dhe ndërgjegjësimin e pjesëmarrjen e gjerë të popullsisë vendore, u kalua në krijimin e batalioneve territoriale të çdo krahine. Batalioni u organizua mbi bazën e 3-5 çetave. Ato kishin komandant, si dhe zëvendësin e tij, që zgjidheshin, por dhe emëroheshin nga Shtabi i ZIO p. Çeta mbante emrin e fshatit, ndërsa batalioni emrin e krahinës. Forcat territoriale u administruan dhe qëndruan nën kujdesin e komandave të vendit, ndërsa ushtarakisht vareshin dhe merrnin detyra drejtpërdrejt nga Shtabi i ZIO p. Batalionet territoriale vepronin duke bashkëvepruar me forcat e UNÇ. Mblidheshin me urdhër, kur rreziku ishte i madh dhe kërkohej ndihma nga UNÇ. Vepronin brenda krahinës së tyre, por sipas detyrës edhe në krahinat fqinje. U caktohej një sektor ndihmues në luftime, por në disa raste edhe në sektorë të batalioneve partizane. Komanda e batalionit territorial formonte një komandë të përbashkët ose shtab me forcat partizane ku vepronte. Në luftë ato vepronin sipas gjithë ligjeve dhe rregullave të UNÇ, kur plotësonin detyrën luftarake, ndërsa kur ishin të shpërndara zbatonin rregullat e komandës së vendit. Batalioni territorial i Kurveleshit të Sipërm kishte në organikë 250 veta që i mblidhte me sinjalin tre pushkë dhe një bombë.¹¹ Ndërsa çeta territoriale Nivicë kishte 21 vullnetarë, çeta territoriale e Progonatit 44 vullnetarë.¹² Armatimi sigurohej nga vullnetarët ose vetë çetat vullnetare dhe gjendeshin këto lloje armësh; maliher grek, italian; mauzer gjerman; lebër i gjatë; belçik etj.

Çeta Territoriale e Drizarit kishte 23 vullnetarë; ndërsa Çeta e Gracenit 37 vullnetarë.¹³ Çeta Territoriale e Pilurit kishte 51 vullnetarë; Çeta e Dhërmiut

¹⁰ Veteranët Tregojnë, vëll. 7, Tiranë 1982, f. 102.

¹¹ AQU, Dosja 50, Kutia 1, viti 1944, Komanda e Qarkut Gjirokastrë.

¹² Po aty.

¹³ AQU, Komanda e Qarkut Fier, Dosja 30, Kutia 1, viti 1944.

kishte 74 vullnetarë; Çeta e Vunoit kishte 91 vullnetarë; Qeparoi kishte 35 vullnetarë.¹⁴

Grupi i Dishnicës ose Grupi i 5-të, kishte në vartësi dy batalione territoriale, që drejtoheshin nga komandantët Miftar Bejua e Kame Aliu.¹⁵ Në mars 1944, në Përmet kishte gjashtë batalione territoriale dhe konkretisht: një në Përmet, dy në Dishnicë, dy në Dangëlli, një në Malishevë; gjithsej 800 vullnetarë.¹⁶

Në Luftën e Drashovicës, shtator 1943, kanë marrë pjesë këta batalione territoriale; të krahinës së Treblovës, Kudhësit, dy batalione të krahinës së Mesaplikut, si dhe çetat territoriale të Dukatit, Tragjasit, Radhimës, Gumenicës, Kaninës, Nartës etj.¹⁷

Organizimi i pushtetit ushtarak të prapavijave

Shtimi dhe forcimi i reparteve partizane në mesin e vitit 1943, goditjet e shpeshta dhe sukseset e arritura në qendrat e fortifikuara të armikut e kishin tronditur okupatorin dhe e kishin detyruar atë të strukej në qendrat e qyteteve dhe me vështirësi mbronte rrugët dhe linjat kryesore me qytetet e tjera. Forcat partizane kishin çliruar plotësisht Luginën e Mesaplikut, Kudhesin, Treblovën, Dukatin dhe, me përjashtim të fshatit të Drashovicës, qendrën e Selenicës, si dhe Qafën e Llogorasë, që armiku i mbronte si nyje rrugore, Vlorë-Himarë-Sarandë. Pra, gati në 2/3 e Qarkut të Vlorës, qysh në muajin prill 1943, nuk njihej më pushteti i vjetër, ishin krijuar këshillat krahinore dhe çdo gjë administrohej e drejtohej nga organet e pushtetit të këshillave nacionalçlirimtare. E njëjta gjendje ishte dhe në qarkun e Gjirokastrës. Krahina të tëra ishin kthyer në zona të lira, si Kurveleshi, Theolloja, Kardhiqi, Zagoria, Pogoni, Lunxheria, Përmeti, Mesapliku etj. si dhe vetë krahina e Mallakastrës në pjesën më të madhe të saj. Armiku nuk mund të shkelte më në këto zona, veçse me operacion të organizuar dhe të drejtuar me forca të shumta. Në një shkresë që i dërgonte kuestori i Vlorës Ministrit të Brendshëm, më 3 prill 1943, midis të tjerash shkruante: “Tërheqja e disa stacioneve të karabinierisë nga komunitatet e qarkut gjatë kësaj kohe u bë për arsye që të mos u nënshtroheshim goditjeve të partizanëve.”¹⁸

Në bazë të direktivave të Shtabit të Përgjithshëm për prapavijat e zonave të çliruara, për mbajtjen e qetësisë, për forcimin e organizimit të prapavijave dhe lidhjen e kombinimit të veprimeve të forcave partizane me pushtetin e

¹⁴ AQU, Dosja 16, Kutia 1, Viti 1943.

¹⁵ M. Kote- K. Bezati, Përmeti gjatë LANÇ 1939-1944, Përmet 1987, f. 295.

¹⁶ Po aty, f. 295

¹⁷ AIH, Historiku i Qarkut të Vlorës, Dosja 2, A- VIII, Nr. inventari 4311, f.387.

¹⁸ AQSH. Nr. 0214. (nga Historiku i Qarkut të Vlorës).

Këshillave Nacionalçlirimtare, Komanda e ZIO p, më datë 25 gusht 1943, me anën e një qarkoreje urdhëronte organizimin e pushtetit ushtarak të prapavijave, që përfshinte komandat e qarqeve, komandat e vendit dhe rojet partizane. Në të, në mes të tjerash, thuhej: “Në tokën e çliruar të organizohet menjëherë pushteti ushtarak në prapavijat. Organet e këtij pushteti në shkallë hierarkike janë: a) Komanda e Qarkut, b) Komanda e Vendit, c) Komanda e rojave partizane vullnetare fshatare.¹⁹ Në pjesën e parë të qarkores përcaktohet organizimi, funksionimi dhe detyrat kryesore të komandës së qarqeve. Ato kryejnë detyrat e mobilizimit, të grumbullimit të ushqimit, krijimin e punëtorive dhe magazinave ushtarake, shërbimin sanitar, ruajtjen dhe kujdesin për mjetet e transportit, ruajtjen e rendit, organizimin e shërbimit informativ, vendosjen dhe kontrollin e komandave të vendit dhe të rojës partizane, bashkëveprimin me këshillat nacionalçlirimtare etj. Sipas qarkores, komandat e qarkut ngrihen: Komanda e Qarkut Konispol, Qendra në Konispol, Komanda e Qarkut Përmet, Qendra në Poliçan, Komanda e Qarkut Kurvelesh, Qendra në Kuç, Komanda e Qarkut Tepelenë, Qendra në Vasjar, Komanda e Qarkut Gjirokastrë, Qendra në Dhoksat, Komanda e Qarkut Mallakastër, Qendra në Ballsh, Komanda e Qarkut Vlorë, Qendra në Brataj.

Komanda e Qarkut ka në vartësinë e saj komandat e vendit. Komandat e vendit për çdo qark caktohen si më poshtë: Komanda e Qarkut të Konispolit ka komanda vendi në: Konispol, Markatit, Pandelejmon, Dhivre, Dhrovjan, Delvinë, Nivicë-Buall. Komanda e Qarkut të Përmetit ka komanda vendi në: Pogon, Zagorije, Përmet, Çerije, Dangëlli, Dëshnicë, Fratar. Komanda e Qarkut të Kurveleshit ka komanda vendi në: Gusmar, Kuç, Himarë. Komanda e Qarkut të Tepelenës ka komanda vendi në: Lopës, Krahës, Arëz. Komanda e Qarkut të Gjirokastrës ka komanda vendi në: Kardhiq, Libohovë, Labovë, Lunxheri, Dropull i Poshtëm, Dropull i Sipërm. Komanda e Qarkut të Mallakastrës ka komanda vendi në: Fratar, Gracen, Cakran, Ballsh. Komanda e Qarkut të Vlorës ka komanda vendi në: Kuthës, Mesaplik, Dukat, Drashovicë, Treblovë.

Në pjesën e dytë të Qarkores jepen detyrat për rojën partizane të fshatit, ku thuhet: “Ato janë organe të Komandës së Vendit dhe të Shtabit të ZIO p. Ato zbatojnë urdhrat e mobilizimit të përgjithshëm, që i përkasin rajonit, si dhe kanë në shënim për Komandën nga e cila varen të gjitha hollësitë e mobilizimit.²⁰ Por ky sistem i shtrirjes së komandave të qarqeve dhe të vendit, në raport me ndryshimin e gjendjes, pësonte ndryshime. Në një qarkore, që mban datën 10 mars 1944, del se në ZIO p, kishte këto komanda të qarqeve:

¹⁹ AQSH. F.67/AP, viti 1943, d. 1, f. 3.

²⁰ AQSH. F.67/AP, viti 1943, d. 1, f. 5.

Konispol, Poliçan, Kurvelesh, Tepelenë, Mallakastër, Vlorë, krye komanda e vendit Përmet.²¹

Vëmendja e Komandës dhe e Shtabit të ZIO p, u përqendrua edhe në mbajtjen nën kontroll të gjendjes në zonat e çliruara dhe administrimin e tyre. Kjo shprehej në shtrirjen e organizimit të komandave të qarqeve dhe të vendit, e deri te roja vullnetare, si dhe në organizimin e drejtimin e batalioneve territoriale vullnetare dhe shtrirja e tyre në çeta në çdo fshat. Kjo përbën një dukuri të rrallë, për vetë masivizimin që mori lufta kundër pushtuesit të huaj në ZIO p. Ndërsa partizanët në Shqipërinë e Jugut sulmonin garnizonet gjermane, “nacionalistët i humbën shanset e tyre plotësisht, sepse nuk ngritën as gishtin kundër gjermanëve as në çastet e fundit, duke ruajtur forcat vetëm e vetëm për veprime kundër partizanëve”.²²

Përfundime

Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare e popullit shqiptar dhe Ushtria Nacionalçlirimtare, që ishte forca kryesore e armatosur në vend, e cila i shkoi luftës deri në fund, në çlirimin e plotë të Shqipërisë, evidentoi dhe afirmoi në zjarrin e saj formacione të përmasave dhe të cilësive të ndryshme, disa herë krejt të veçanta. Në do të bënte pjesë pikërisht edhe ZIO p, që u krijua, u organizua, u shtri dhe zhvilloi veprimtarinë e saj luftarake në hapësirën e gjerë Vlorë-Gjirokastër-Mallakastër. Ky formacion jo vetëm shfaqti vlera organizative unike midis forcave të armatosura që u ngritën në Shqipërinë e atë kohë, por edhe afirmoi vlera luftarake të veçanta në pikëpamje drejtimi, shfrytëzim të terrenit kryesisht të thyer e malor të zonës, të formave taktike e të tjera.

Përveç këtyre, zona duke pasur në përbërje krahina me një infrastrukturë dhe dendësi relativisht të lartë popullimi, u bë një burim mjaft i lartë prurjesh për formacionet luftarake të shumta që u krijuan në këto zona, që nga çetat, batalionet te grupet partizane. Njëherësh po këto burime sollën prurje të mëdha furnizimesh me luftëtarë për disa brigada sulmuese të Ushtrisë NÇ Shqiptare. Ky formacion nuk do të ishte bërë kurrësiqë i njohur, me një emër të veçantë gjatë gjithë kohës së veprimtarisë luftarake, nëse nuk do të kishte përballuar dhe thyer me sukses operacionet e mëdha dhe të dendura të pushtuesve nazistë. Kështu ky formacion me një jetë, organizim dhe veprimtari luftarake të fuqishme dhe rezultateve, ku u afishuan dhe u afirmuan e u bënë emblematike figura të njohura drejtuese e komanduese ushtarake, përbëjnë një vlerë dhe një përvojë historiko-ushtarake dhe atdhetare për popullin, por veçanërisht për ushtarakët shqiptarë të sotëm e të së ardhmes.

²¹ AQSH. F. 67/AP, viti 1944, d. 10, f. 6.

²² Po aty, f. 293.

Madje kjo përvojë, ka rëndësi të veçantë në aspektin e veçorive mbrojtëse, në raport me terrenin tipik të kësaj zone, me një nyje rrugore mjaft të zhvilluar dhe me një dendësi relativisht të lartë popullsie për vendin tonë. Prandaj kjo përvojë duhet studiuar dhe njohur.

Bibliografia:

1. Bernd Fisher, Shqipëria gjatë luftës 1939-1945, Tiranë, 2000.
2. Shefqet Peçi, “Fragmente nga epopeja e lavdishme”, Tiranë, 1984.
3. Veteranët tregojnë, vëll.1, Tiranë 1979.
4. M.Kote-K.Bezati, Përmeti gjatë LANÇ 1939-1944, Përmet, 1987.
5. Dokumente të Shtabit të Përgjithshëm, vëll 1, Tiranë, 1976.
6. AIH, Historiku i Qarkut të Vlorës, Dosja 2, A- VIII, Nr. inventari 4311.
7. AQSH, F. 67/AP, viti 1943, dosja, 1.
8. AQSH, F. 67/AP, viti 1944, dosja 10.
9. AQU, Kutia e Zonës I Operative, dosja 17.
10. AQU, Komanda e Qarkut Gjirokastrë, Dosja 50, Kutia 1, viti 1944.
11. AQU, Komanda e Qarkut Fier, Dosja 30, Kutia 1, viti 1944.
12. AQU, Dosja 16, Kutia 1, Viti 1943.

SHTABI I PËRGJITHSHËM I USHTRISË NACIONALÇLIRIMTARE: EMËRTIMI, ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI

Kolonel (R) Sali ONUZI

Njësitet guerile, çetat dhe batalionet partizane të krijuara në vitet 1941-1942 dhe në gjysmën e vitit 1943, ishin shprehje e rritjes së qëndresës së popullit shqiptar ndaj pushtuesit fashist italian. Po në mesin e vitit 1943 kishte ardhur koha për të filluar ngritjen e një ushtrie nacionalçlirimtare të organizuar në njësi më të mëdha, si brigada sulmuese (24 të tilla), divizione (tetë) e korparmata (tre) etj., dhe të komanduara nga një qendër, nga një Shtab i Përgjithshëm, për të rritur e ngritur kështu nivelin e luftës antifashiste nacionalçlirimtare (LANÇ) dhe për ta çuar atë drejt fitores.

Këtë e kërkonte dhe nevoja e bashkëpunimit me misionet aleate britanike që kishin arritur në Shqipëri dhe që kërkonin një përfaqësues kombëtar ushtarak për bisedime e marrëveshje dhe ndihmë ushtarake.

I krijuar mbi bazën e traditave më të mira ushtarake shqiptare dhe të nevojave të LANÇ-it, Shtabi i Përgjithshëm luajti rolin që i takonte dhe ka zënë vendin e tij të merituar në historinë e Luftës të popullit shqiptar.

Krijimi i Shtabit të Përgjithshëm

Më 4 korrik 1943, Këshilli i Përgjithshëm Nacionalçlirimtar, që kish marrë mbi vete sovranitetin e Shqipërisë, do të merrte vendimin për të krijuar Shtabin Madhor të Luftës Nacionalçlirimtare, vendim që ishte parashikuar

që në Konferencën e Pezës. Ndryshe nga tradita klasike, anëtarët e Shtabit u zgjedhën në mbledhjen e tij mbi bazën e propozimeve të një grupi më të gjerë, të konsultuar paraprakisht. Zgjedhja dhe jo emërimi tradicional i jepte këtij organi të ri, që po krijohet, një rol të veçantë.

Më 5 korrik 1943, në pikën për kompetencat e Shtabit, Enver Hoxha e merr fjalën i pari dhe thotë se “*Shtabi udhëheqës i Luftës Nacionalçlirimtare ka kompetencë të plotë të bëjë Luftën, ta zhvillojë, ta organizojë dhe ta udhëheqë në bashkëpunim me Këshillin e Përgjithshëm Nacionalçlirimtar*”¹. Edhe në Rezolucionin e Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar shkruhet tekstualisht “*Shtabi i Përgjithshëm asht i pamvarun në rrethin e kompetencës së tij, ashtu siç asht shënue më nalt.*”

Përpjekjet e sotme² për ta politizuar çështjen, sikur Shtabi Madhor varej direkt nga Komiteti Qendror i Partisë Komuniste, nuk kanë të bëjnë me të vërtetën. Nuk ka asnjë dokument të tillë që të vërtetojë këtë vartësi. Udhëheqja e Luftës, pra edhe e Shtabit Madhor nga Partia Komuniste bëhej nëpërmjet anëtarëve të saj që ishin zgjedhur në këtë detyrë për shkak të meritave që kishin në zhvillimin e LNÇ-it.

Por Shtabi Madhor i LNÇ do të ishte sa një shtab ushtarak, po aq edhe një shtab politik. Ai përcaktohej në dokumentet e tij themeluese si: “1) Qendër organizative e Luft(ës) Nac(ional) Çli(rimtare)-Mobilizimi, Transportet-Financat, komandat; 2) Qendër politike-formon politikisht ushtrinë e popullin-ta edukojë popullin, të sigurohet morali i naltë i ushtrisë e i popullit, me buletine, trakte etj.; 3) Qendër operative – operacionet-Lidhjet hierarkike me komandat ma të nalta - të arrijë në kryengritjen e përgjithshme.”³

Shtabi i Përgjithshëm nga ana e tij, po atë ditë, votoi dhe zgjodhi kryetar të tij major Spiro Moisiun dhe Enver Hoxhën, komisar. Më datë 10 korrik, Shtabi diskutoi dhe vendosi strukturën e tij: komanda, shtabi operativ, komisariati politik, komisariati, seksioni i brendshëm dhe seksioni i shëndetësisë. Qysh më 5 korrik, Shtabi i Përgjithshëm kishte zgjedhur një komision që do t’i paraqiste kërkesat e tij delegacionit të Shtabit britanik, i kryesuar nga Bill Maklin, që ato ditë ishte po aty në Labinot dhe kjo gjë u bë më datë 10 korrik. Po atë ditë, Këshilli dhe Komanda e Shtabit të Përgjithshëm njoftuan zyrtarisht me anë të një komunikate për formimin e Shtabit të Përgjithshëm të UPVNÇ.⁴

¹ AQSH.F.41/APL.v.1943 D.1 fl.17.

² Leka, Shahin. Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare (1943-1945), botim “Fillad”, Tiranë1998, f. 46, ISBN : nuk ka.

³ AQSH: F.41/APL,v.1943. D.I, fl 2.

⁴ AQSH,F.41/APL,V.1943,D.I,fl.1,1-3,9-6.

Shqipëria kish pasur përvojën e saj të ngritjes e të funksionimit të Shtabit Madhor, e para në vitet 1913-1914 dhe e dyta nga 1920 deri më 1939. Në të dy herët Shqipëria kish dështuar. Herën e parë për shkak të ndërhyrjes së rëndë e të padrejtë të ndërkombëtarëve (Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit) që ndërprente veprimtarinë e Qeverisë së Përkohshme të Vlorës dhe herën e dytë me dështimin e Shtabit Madhor Shqiptar para pushtimit fashist italian, në prill 1939.

Ky që po krijohet më 4 korrik 1943, do të mbante po atë titull, Shtabi Madhor i Luftës dhe për kohëzgjatje do të kishte në krye po një major (si më 1913), i cili do të thyente traditat klasike duke futur në Shtab edhe civilë dhe ushtarakë. Por ky Shtab Madhor ndryshe nga dy të parët do ta çonte Shqipërinë në fitore, në çlirimin e saj nga pushtuesit nazifashistë. Në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare u aktivizuan edhe mjaft oficerë të ushtrisë monarkiste, të përgatitur në shkollat ushtarake brenda dhe jashtë vendit, në Itali. Këta sollën përvojën e tyre në organizimin e Shtabit dhe në funksionimin e tij (pastaj dhe të Ushtrisë).

Emërtimi i Shtabit Madhor i Luftës Nacionalçlirimtare

Shtabi do të emërtohej **Shtab Madhor i Luftës NÇ**. Pjesa e parë e titullit, “Shtab Madhor”, ishte në traditën e Shtabit që kur ai ishte krijuar për herë të parë më 5 maj 1913, nga qeveria e Ismail Qemalit. Kjo shprehte njëkohësisht edhe ndikimin e ushtarakëve që kishin shërbyer më parë në ushtrinë shqiptare.

Ndërsa pjesa tjetër e titullit, “i Luftës Nacionalçlirimtare”, ishte e përmendur në Konferencën e Pezës. Por nuk mjaftonte me kaq. Kishte edhe arsye të tjera. Ai nuk ishte një Shtab i Përgjithshëm ushtarak klasik, siç e ka vënë në dukje me të drejtë historiografia ushtarake. Ai para së gjithash ishte një Shtab i Përgjithshëm lufte, ku gati gjysma e tyre nuk ishin ushtarakë, por njerëz të politikës, të kulturës, të ekonomisë e të fesë. Pra, ishte Shtab i Përgjithshëm i Luftës, në të cilin secili nga anëtarët kishte një rol për të luajtur dhe nuk është se, për shembull Sejfulla Malëshova, ishte aty simbolikisht, sepse nuk ishte ushtarak – siç është interpretuar ndonjëherë. Pikërisht Sejfulla Malëshova (profesor filozofie), kishte mbaruar në Leningrad Akademinë ushtarako-politike në vitet 1926-1927.

Në kohën kur po krijohet Shtabi i Përgjithshëm, situatat po zhvilloheshin me shpejtësi. Partia Komuniste shqiptare po punonte për zbatimin e direktivave të Kominternit për krijimin e “**Fronteve të bashkuar Nacional Antifashist**” me të gjitha forcat patriotike, pavarësisht nga pikëpamjet e tyre ideologjike, por dhe të direktivave të aleatëve perëndimorë, për të arritur në një mirëkuptim e bashkëpunim ndërmjet forcave të rezistencës në vendet e pushtuara.

Në dokumentet e miratuara në Konferencën e Parë të Partisë Komuniste

Shqiptare, (17 mars 1943) shkruhet se “Një pjesë e nacionalistëve është grumbulluar në “Ballin Kombëtar”... Shumë elementë të “Ballit” kanë luftuar dhe vazhdojnë të luftojnë me armë në dorë kundër okupatorit. Me këta ka shumë mundësi që të bëhet një front luftarak nacionalçlirimtar i përbashkët”⁵.

Pikërisht në këto ditë të krijimit të Shtabit të Përgjithshëm, po në Labinot, më 10 korrik, Këshilli i Përgjithshëm NÇ diskutoi rreth bisedimeve me Ballin Kombëtar për një marrëveshje të mundshme me të, për integrimin e tij në LANÇ. Ky qëndrim i PKSH dhe i Këshillit të NÇ nuk ishte një rastësi, as një politikë ditore. Që në Rezolucionin e krijimit të Partisë Komuniste, në nëntor 1941, shkruhej: *“Të krijojmë dhe organizojmë realisht lëvizjen guerile të masës si skelet të ushtrisë së ardhshme.... bashkë me partitë e tjera politike dhe lëvizjen nacionalçlirimtare.”*⁶

Prandaj, Shtabi i Përgjithshëm sqaron vendimi “asht qendra organizative, politike dhe operative e gjithë fuqive të armatosuna antifashiste”.⁷ Po, siç dihet Balli Kombëtar ndoqi rrugë tjetër, atë të bashkëpunimit me pushtuesit gjermanë. Balli kombëtar nuk donte të hynte në Frontin Nacionalçlirimtar, e rrjedhimisht as në Shtabin madhor. Sepse Balli nuk ia delte dot të konkurronte Partinë komuniste në këto institucione të Luftës (Këshill, Shtab etj.) për shkak të popullaritetit të madh që kishte fituar ajo dhe Fronti NÇ. Balli Kombëtar donte një Shqipëri nën sundimin e tij. Në Konferencën e Mukjes, Balli u përpoq t’i sfidonte organizmat e krijuar deri atëherë të LANÇ dhe pas pushtimit gjerman u lidh me pushtuesit e rinj dhe u bë një bashkëpunëtor i tyre i hapur, me shpresë se nëpërmjet tyre do t’i thyente “nacionalçlirimtaren” ose “komunistët” dhe pas largimit të gjermanëve pushteti do t’i binte në dorë dhuratë. As Balli Kombëtar, as Legaliteti pas tij dhe as bajraktarët e veriut nuk mundën të krijonin dot ushtri dhe shtab madhor.

Ky emërtim **“Shtabi Madhor i Luftës Nacionalçlirimtare”** u vendos edhe në vulën e Shtabit dhe u ruajt deri në Kongresin e Përmetit, pavarësisht se, siç thamë, ai filloi të quhej e të shkruhej në dokumente si Shtab i Përgjithshëm i Ushtrisë partizane vullnetare nacionalçlirimtare e pas Kongresit të Përmetit, “i Ushtrisë Nacionalçlirimtare”.

Në thelb, edhe ky përcaktim është i drejtë pse Lufta me Ushtri bëhet dhe se, si lufta dhe ushtria, nacionalçlirimtare ishin. Por, koncepti i Luftës është padyshim më i gjerë e më i thellë, më strategjik, le të themi edhe më politik e më organizativ, patjetër me një rreze më të gjerë, tamam ashtu siç ishte

⁵ PPSH Dokumenta kryesore. V.I. Botim i II Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë 1971, f.131. ISBN:nuk ka.

⁶ PPo aty, f.25.

⁷ AQSH, F.nr 40, dosja nr. 3, f. 17.

përcaktuar në mbledhjen e parë konstituive të Shtabit të Përgjithshëm. Ky ndryshim, ky zëvendësim u bë gradualisht edhe në dokumentet e vetë Shtabit të Përgjithshëm, në urdhrat e udhëzimet e të cilit shënohej Shtabi i Përgjithshëm i UPVNÇ (Ushtrisë partizane vullnetare nacionalçlirimtare).

Organizimi

Këshilli i Përgjithshëm zgjodhi më 4 korrik 12 anëtarë, personalitete të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Tre prej tyre, Myslym Peza, Haxhi Lleshi dhe Mustafa Xhani ishin komandantë çetash antifashiste e partizane, të shquar në luftë kundër pushtuesve italianë, katër të tjerë, ish-oficerë të ushtrisë shqiptare, major Spiro Moisiu, major Abaz Kupi, nëntoger Bedri Spahiu dhe nëntoger Dali Ndreu, kishin bërë emër në qëndresën kundër pushtuesve fashistë italianë, dy të parët në shkallë kombëtare dhe dy të tjerët në krahinat e tyre. Shtatë të tjerë, si: Enver Hoxha, Mustafa Gjinishi, Ramadan Çitaku, Ymer Dishnica, Sejfulla Malëshova, si dhe Dali Ndreu e Bedri Spahiu, ishin politikanë të Frontit Nacionalçlirimtar dhe drejtues (anëtarë të Komitetit Qendror) të Partisë Komuniste. Malëshova dhe Dishnica ishin intelektualë të spikatur⁸. Kësisoj mund të thuhet me plot gojë se ky ishte një Shtab ushtarako-politik, i përgjithshëm, jo vetëm se do të komandonte gjithë njësitë dhe repartet e Ushtrisë Nacionalçlirimtare, por po ashtu, do të merrej me gjithë aspektet e Luftës e të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, me formimin politik të Ushtrisë e të popullit kryengritës, si edhe me marrëdhëniet me forcat aleate ndërkombëtare (aleatët e mëdhenj dhe aleatët fqinjë antifashistë, jugosllavë dhe grekë).

Në listën e anëtarëve të Shtabit bie në sy pjesëmarrja e katër oficerëve profesionistë (madje pesë, po të shtojmë edhe Sejfulla Malëshovën) dhe ky fakt tregon se Shtabi qe një organizëm i vërtetë ushtarak që do të drejtonte me profesionalizëm.⁹ Bën përshtypje fakti se në listën emërore të Shtabit të Përgjithshëm njihen dhe shënohen gradat ushtarake (të dy majorëve), njihet dhe shënohet edhe titulli fetar i Mustafa Martaneshit.

Dymbëdhjetë anëtarë! Një numër çift. Në fakt, kur po bisedoheshin kandidaturat, qe menduar që i trembëdhjeti të ishte kapiten Shaban Strazimiri, por u la rezervë që ai të thirrej “nëse do të dali ilegal dhe a asht i vendosun për luftë”. “Me zhvillimin e Luftës, - shprehej Këshilli i Përgjithshëm NÇ, - “shtabi i ka të hapta dyert për elementë të rinjë, të vendosun e të provuem”¹⁰.

⁸ AQSH.F 41/APL, V.1943, D.1, fl.1

⁹ Ndryshe siç kish ndodhur në Jugosllavi në vitin 1941 ku u zgjodhën për anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm 10 militantë proletarë, disa prej të cilëve u vranë. Atëherë jugosllavët kaluan në organizimin e Shtabit të tyre me ushtarakë profesionistë, në krye të të cilit thirrën më 12 dhjetor 1941 kapitenin antifashist malazez, Arso Jovanović (shih: www.Врховен штаб на НОВ и ПОЈ - Википедија dhe www.Arso Jovanović - Wikipedia)

¹⁰ AQSH.F.40./APL v.1943 D.3 fl.18

Dhe kjo kish për të ndodhur. Ndërkohë pas vendimit, Mbledhja e KP NÇ i dha të drejtë Abaz Kupit, që “pas bisedimesh që do të zhvillojë me parinë e Matit dhe të Krujës, të propozojë një ose dy veta të përshtatshëm për Shtabin e Përgjithshëm” (gjë për të cilën Kupi nuk bëri asgjë.)¹¹

Zgjedhja direkt nga Këshilli i Përgjithshëm i Shtabit tregonte se të gjithë anëtarët e tij kishin të drejta dhe detyra të barabarta. Shtabi po krijohej si një komandë kolegjiale, si një skuadër udhëheqëse. Më datën 5 korrik, Shtabi me 12 anëtarë, kish zgjedhur një kryetar e një komisar. Por kjo zgjedhje nuk mund të shmangte pyetjet “kush do të ishte komandanti i ushtrisë?”. “Shtabi, për të luajtur një rol komandues, a do të rrijë mbledhur këtu vazhdimisht me 12 anëtarët e tij”, duke u bërë, veç tjerash objektiv numër një i goditjeve të armikut? Më tej, pyetja: a përbënin një komandë dyshe kryetar dhe komisar?! Procesverbali i mbledhjes së Këshillit të Përgjithshëm ANÇ më datë 4 korrik dhe ai i mbledhjes së Shtabit të Përgjithshëm më datë 5 korrik nuk e përmbajnë termin “komandë e Shtabit të Përgjithshëm”.

Por në mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm ANÇ të datës 9 korrik, ora 10.00 paradite, kur po diskutohej për Proklamatën me të cilën do t’i drejtoheshin popullit, në procesverbalin e mbledhjes është shënuar që kjo “Proklamatë” të dalë, siç edhe doli, “me firma të kryesisë së Këshillit në një anë dhe Komandës së Shtabit.”¹² Pra, 6 ditë pas krijimit përmendet si strukturë e Shtabit të Përgjithshëm komanda e tij. Më datën 10 korrik, çështja kthjellohet edhe më tej. Në mbledhjen e Shtabit të Përgjithshëm që u bë në ora 16.00, në strukturën e Shtabit shënohet “Komanda”. Pak më poshtë në “Shtabin operativ” miratohet përbërja me komandat e komisar politik. Fjala “kryetar” nuk përmendet më. Mendojmë se kemi të bëjmë me një zhvillim pozitiv dhe të domosdoshëm për Ushtrinë NÇ që po ngrihej. Ndoshta mund të ketë ndikuar edhe përvoja sovjetike e dikurshme e komandës me komandant e komisar. Kjo komandë e Shtabit të Përgjithshëm, gradualisht, në përputhje me situatat dhe nevojat e drejtimit, u bë në realitet **Komandë e Ushtrisë Nacionalçlirimtare partizane vullnetare**, ose edhe më shkurt, e Ushtrisë NÇ.

Lind pyetja: përse nuk u caktua që në fillim **një Komandant i përgjithshëm**, e në vartësi të tij edhe Shtabi i Përgjithshëm, por vetë Shtabi zgjodhi një komandë të tij? Kjo duhet të ketë qenë më së shumti një ndikim i përfaqësuesve të PK jugosllave që asistonin, pra, një çështje e mosbesimit të tyre apo e presionit të tyre. Por edhe ushtarakisht, në Shqipëri aso kohë kishte vetëm reparte partizane dhe ende nuk ishte krijuar një Ushtri Nacionalçlirimtare e organizuar. Kur kjo ndodhi, Kongresi i Përmetit njësoi komandën dhe zgjodhi

¹¹ AQSH.F.40/APL, v.1943 D.3,fl.17

¹² Po aty, fl.22.

komandant të Përgjithshëm, Enver Hoxhën.

Ka informacione se Enver Hoxha dhe Ymer Dishnica ishin përpjekur për ta shtyrë krijimin e Shtabit të Përgjithshëm pas bisedimeve me Ballin Kombëtar.¹³ Mund të themi se kjo lidhej me rolin që projektohej t'i jepej Shtabit të Përgjithshëm si komandë kolegjiale e Luftës dhe e Ushtrisë, që do të drejtonte në shkallë kombëtare gjithë fuqitë e armatosura. Pra, jo vetëm ato të organizuara nga Fronti NÇ. Mendohej se pas bisedimeve me Ballin Kombëtar, çetave dhe batalioneve të tij t'u lihej hapësirë që të viheshin nën drejtimin e Shtabit të Përgjithshëm të Luftës NÇ.

Ndër detyrat kryesore të Shtabit të Përgjithshëm, ishin hartimi i planeve operativo-strategjike, formimi i njësive të reja, miratimi i funksionarëve të njësive e reparteve ushtarake (më 1943 edhe zv.komandantin e batalionit), urdhri për organizimin, lëvizjet dhe mësymjet e sulmet e njësive të mëdha (sidomos mbi qytete) dhe shpallja në komunikata e veprimeve luftarake të UNÇ, në të cilat gjithmonë botoheshin edhe datat e çlirimit të qyteteve të Shqipërisë, siç e bënin edhe shtabet e vendeve të tjera. Përfaqësuesit e Shtabit prisnin anëtarët e misionëve aleate, të cilëve u paraqisnin kërkesa ose edhe protesta, në një rast edhe ultimatum, siç ishte ai për largimin e oficerëve britanikë pranë A. Kupit, i cili në vjeshtë 1943 doli hapur nga përbërja e Shtabit të Përgjithshëm dhe e Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar për llogari të luftës së tij për pushtet dhe bashkëpunimit të fshehtë me pushtuesit gjermanë.

Me vendimin e Kongresit të Përmetit, 24-28 maj 1944, merr fund edhe emërtimi “komandë e Shtabit të Përgjithshëm” dhe kalohet, në përputhje me situatat e reja, në një organizim të ri të një niveli më të lartë, me organizimin e Komandës së Përgjithshme dhe në postin e Komandantit të Përgjithshëm, nën vartësinë e të cilit do të ishte Shtabi i Përgjithshëm dhe gjithë Ushtria e rregullt Nacionalçlirimtare. Tanimë bashkë me këto zhvillime edhe termi “Ushtri nacionalçlirimtare partizane vullnetare” kishte ndryshuar në “Ushtri Nacionalçlirimtare” dhe ishte kaluar në organizimin e një ushtrie të rregullt, me mobilizimin e detyrueshëm ushtarak, me vendosjen e gradave dhe krijimin e divizioneve e të korparmatave.¹⁴

Në përbërjen e Shtabit të Përgjithshëm u bënë ndryshime: Y. Dishnica e S. Malëshova kaluan në detyra të reja si anëtarë të Komitetit Antifashist NÇ dhe dy të tjerë, kolonel Hysni Kapo e kolonel Islam Radovicka, do të zgjidheshin anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm, si dhe gjeneralmajor Mehmet Shehu, pas

¹³ Dedijer, Vladimir: Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave 1939-1948. Botues në shqip Alfred Ziu, Medaur, Tiranë 2005.f.64. ISBN nuk ka.

¹⁴ AQSH.F.40 (Shtabi i Përgjithshëm në Kongresin e Përmetit).

çlirimit të Tiranës. Ndërkohë, në prag të lirimit, do të vritej pas shpine kolonel Mustafa Gjinishi (Dëshmor i Atdheut) gjë që tregonte, veç tjerash, se sa e vështirë ishte situata në të cilën vepronte Shtabi i Përgjithshëm.

Në fazën e re, Kongresi i Përmetit nuk e ulte statusin e Shtabit të Përgjithshëm, siç e ka paraqitur dikush. Madje Shtabi i Përgjithshëm kësaj here do të miratohej nga organi më i lartë i pushtetit nacional çlirimtar, nga Kongresi. Të mos themi që me termin komandë e Përgjithshme, nënkuptohej edhe Shtabi i Përgjithshëm (ndryshe kur veçohej “Komandanti i Përgjithshëm”). Për inerci, Enver Hoxha vazhdoi edhe pas Çlirimit disa herë, ta thërriste me këtë term Shtabin e Përgjithshëm ose Ministrinë e Mbrotjtjes. Është interesant fakti se në dokumentet e Kongresit të Përmetit nuk gjendet një në të cilin Enver Hoxha të kishte dhënë dorëheqje ose të ishte larguar nga detyra e anëtarit dhe e komisarit politik të Shtabit të Përgjithshëm.

Një moment të veçantë përbën fakti që në fund të gushtit 1943, Shtabi i Përgjithshëm (dhe Komanda e Përgjithshme e UNÇ) u njoh dhe lidhi marrëveshje bashkëpunimi me Shtabin aleat të Mesdheut, ku dërgoi si kryetar anëtarin e Shtabit të Përgjithshëm, kolonel Bedri Spahiu (dhe nënkolonel Kadri Hoxhën). Në këtë kohë Shtabi aleat i Mesdheut njeh Ushtrinë NÇ si forcën e vetme ushtarake që luftonte kundër ushtrisë gjermane në Shqipëri. Siç është bërë e ditur kohët e fundit, përfaqësuesit e Komandës dhe të Shtabit të Përgjithshëm në bashkëpunim me Shtabin aleat të Mesdheut, veç kërkesave për shtimin e ndihmave në armatim e municione, ushqime e veshmbathje, kishin hartuar e nënshkruar edhe një program konkret të veprimeve të forcave speciale të aleatëve në 5-6 zona në Shqipëri, në bashkëpunim me forcat e UNÇ¹⁵.

Funksionimi

Detyra e parë që zgjidhi Shtabi i Përgjithshëm ishin bisedimet dhe propozimet që i paraqiti me përfaqësuesit e tij misionarëve ushtarakë britanikë. Kemi për herë të parë një projekt dhe një dokument strategjik me mundësitë e mobilizimit ushtarak në çdo krahinë dhe të nevojave për armatim e municion, që ua paraqisnin aleatëve.¹⁶

Ndonëse Shtabi i Përgjithshëm ishte forumi a institucioni më operativ e më i rëndësishëm i Luftës, ai nuk mund të mbledhë periodikisht. Gradualisht, komandanti dhe komisar i Shtabit të Përgjithshëm, mesa duket, përqendruan kompetenca, morën përgjegjësi në emër të Shtabit të Përgjithshëm, siç edhe u diktonte jeta e lufta dhe kjo çoi në një centralizim më të madh të drejtimit, në

¹⁵ Paskal Milo në emisionin e RTSH “Në anën e duhur të Historisë”, viti 2019).

¹⁶ AQSH.F41/APL.v.1943.d.1 fl.6,9-10.

një komandë dyshe, komandant dhe komisar, e cila parimisht duhet të jepte llogari para Shtabit të Përgjithshëm (Sa është bërë kjo, është e vështirë ta themi sot). Anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm filluan të shpërndahen nëpër rajone, zona e krahina për të ndjekur e ndikuar nga afër zhvillimin e situatave, për të informuar lart te komanda e Shtabit të Përgjithshëm. Disa si Myslym Peza, Abaz Kupi, Haxhi Lleshi e Mustafa Martaneshi, komandonin çeta e formacione partizane e vullnetare në terren. Ose u emëruan më pas në detyra komanduese të larta si Bedri Spahiu (komandant i shtabit operativ Vlorë - Gjirokastrë) ose Dali Ndreu (komandant i Div. I S e më pas, i Korparmatës I S).

Në fazën e parë, nga Labinoti në Përmet, Shtabi i Përgjithshëm urdhëroi krijimin e brigadave sulmuese si njësi jashtë territoriale që do të vepronin në të gjithë vendin ku do ta kërkonin situatat dhe urdhri i Shtabit të Përgjithshëm. Deri në fund të dhjetorit qenë krijuar 5 brigada sulmuese dhe një zonë operative, ajo Vlorë - Gjirokastrë.

Si ushtria partizane vullnetare NÇ, ashtu dhe vetë Shtabi i Përgjithshëm përballuan me shumë sakrifica e trimëri operacionin famëkeq të Dimrit të forcave gjermano-xhandaro-balliste. Komanda gjermane vendosi ta asgjësonte pikërisht Shtabin e Përgjithshëm, komandën e tij, disa quadro të tjerë dhe personelin e gjeneralit britanik Dejvis, prandaj i rrethoi e sulmoi për rreth dy muaj në zonën Çermenikë, Shëngjergj e Martanesh. Humbjet e Ushtrisë PVNÇ qenë të mëdha: mbi 1000 partizanë dhanë jetën dhe po aq dezertuan nga radhët e saj.¹⁷ Madje edhe vetë gjeneral brigadieri britanik Dejvis u kap nga banda balliste e Haziz Biçakut, e cila e dorëzoi te gjermanët. Por as Ushtria NÇ dhe as Shtabi i Përgjithshëm nuk u asgjësuan. Është vendi të kujtojmë këtu se edhe vetë komanda e Shtabit të Përgjithshëm në rrethim mundi të ruante disa lidhje dhe të jepte disa urdhra ushtarakë. Enver Hoxha i shkruante Nako Spiros për situatën dhe përballimin e saj dhe urdhra për Brigadën e 2-të dhe të 3-të. Tani shohim të shkruhet sikur Enver Hoxha rrinte fshehur dhe nuk kish shkrehur asnjë pushkë.¹⁸ Po cili komandant i përgjithshëm i koalicionit antifashist ose i fuqive të boshtit fashist kishte shkrehur personalisht ndonjë pushkë?! Vetë Stalini përveç një daljeje propagandistike në frontin e Moskës, punonte me gjithë shtabin e tij në një bunker (pallat) shumë kat poshtë sipërfaqes, po kështu dhe Çercilli, Hitleri etj.

Ndërkohë, në operacionin e Dimrit 1943-44, një rol të veçantë luajtën anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm në pozicionet ku ndodheshin. Është me vend të sjellim këtu rolin e Haxhi Lleshit, i cili, i gjendur në zonën malore të Korçës, ku gjermanët po kryenin operacion të gjerë për rrethimin e brigadave dhe

¹⁷ Historia e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare e popullit shqiptar, botim v.1984.v.3 f.587.

¹⁸ Gazeta "Panorama" datë 19 nëntor 2019. Kujtime të Sadik Premtes.

formacioneve territoriale partizane, në bashkëpunim dhe me anëtarët e tjerë të Shtabit të Përgjithshëm Bedri Spahiu e Ramadan Citaku dhe kuadro të tjerë të Këshillit të Përgjithshëm NÇ si Medar Shtylla dhe të Komitetit Qendror të PKSH, (Liri Gega) që ndodheshin me të, lëshoi në emër të Shtabit të Përgjithshëm urdhra me shkrim e me gojë për manovrimin e forcave partizane dhe për krijimin e brigadave të reja, (sipas planit të hartuar kohë më parë nga Shtabi i Përgjithshëm).¹⁹

Veprimet individuale, në udhëheqje të njësive partizane të anëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm në zonat ku ndodheshin, treguan vlerën e organizimit të Shtabit të Përgjithshëm jo vetëm si një komandë kolegjiale, por edhe si përgjegjësi personale, me kompetenca të plota në emër të Shtabit të Përgjithshëm. Ajo dëshmon njëkohësisht edhe disiplinën e lartë të Ushtrisë NÇ, që i zbatonte këto urdhra, pa diferencim.

Në këtë fazë të dytë fillon krijimi i njësive më të mëdha të Ushtrisë NÇ, i divizioneve dhe i korparmatave, të cilat, në përputhje me vendimin e Komandës së Përgjithshme dhe të Shtabit të Përgjithshëm, fillojnë mësymjen vendimtare për çlirimin e gjithë Shqipërisë. Kësaj faze i takojnë përballimi i operacionit armik të Qershorit 1944, urdhri për kalim dhe kalimi i Divizionit të Parë sulmues në Shqipërinë e Mesme e të Veriut, njohja e Ushtrisë Nacionalçlirimtare si forca e vetme ushtarake që luftonte kundër pushtuesve gjermanë, dërgimi i përfaqësuesve të Shtabit të Përgjithshëm në Shtabin Aleat të Mesdheut (Bari, Itali), vendosja e ndërlidhjes me radio me Divizionin IS me 21.06.1944 (pastaj pothuaj çdo brigadë u pajis me radio), krijimi i Korparmatës I S, çlirimi i Tiranës (17 nëntor) dhe i Shkodrës, më 29 nëntor 1944.

Shtabi i Përgjithshëm ishte shtab udhëheqës që planifikonte, drejtonte dhe organizonte veprimtarinë strategjike të Ushtrisë NÇ e të Luftës. Ky rol nuk mund të zëvendësohej e aq më pak të mohohej, siç është përpjekur dikush

¹⁹ AQSH.F.41/APL.v.1944.D.5 fl.7-10

Shënim im: Më 20 shkurt 1944 me firmën e Haxhi Lleshit, me funksionin e anëtarit të Shtabit të Përgjithshëm, iu dërgua Shtabeve të zonave, të qarqeve dhe të brigadave të Ushtrisë NÇ një direktivë mbi taktikën ofensive për shkatërrimin e armikut dhe mbi disa masa organizative për forcimin e ushtrisë partizane, që përmbante një analizë sintetike të veprimeve të Ushtrisë NÇ kundër operacionit gjermano-ballist deri atë kohë dhe bënte rekomandime e vinte detyra për njësitë e repartet partizane. Ky dokument, prej 6.5 faqe me 221 rreshta, që është i vetmi që përmban për këtë fazë, një analizë në kohë reale (me vlera historike) është botuar në Dokumentet e Shtabit dhe të Komandës së Përgjithshme (v.1, f. 230-237), me nënshkrimin “Shtabi i Përgjithshëm”. Por në Arkivin e Shtetit ndodhet origjinali me emër, firmë personale dhe funksion, “Për Shtabin e Përgjithshëm”, Anëtar i Shtabit (Haxhi Lleshi) dhe firma e tij.... Kuptohet ! Redaksia e botimit të këtyre dokumenteve kishte ceduar nga e vërteta, me siguri për arsye politike, se mos i bënte hije tjetërkujt, po edhe vetë Haxhi Lleshi nuk kish guxuar ta kërkonte, madje edhe pas vitit 1991, në kujtimet e tij, nuk ndalet në këtë problem.

apo disa, kinse ky Shtab i Përgjithshëm nuk kishte funksionuar dhe meritat u takonin komandave inferiore.²⁰

Megjithatë Shtabi i Përgjithshëm i UNÇ ende nuk ka një zë të vetin në Fjalorin e sotëm Enciklopedik shqiptar !

Shtabi i Përgjithshëm, i ndihmuar edhe nga gjithë komandat e shtabet e njësive dhe reparteve partizane urdhëroi dhe e ngriti Ushtrinë NÇ, e mësoi që armatimin, municionin e veshmbathjen t'i nxirrte nga lufta me armikun dhe nga bashkëpunimi me aleatët antifashistë. Shtabi i Përgjithshëm e pajisi Ushtrinë NÇ me një art ushtarak origjinal, të përshtatshëm për zhvillimin e Luftës Popullore, terrenin e vendit tonë dhe situatat e brendshme e të jashtme etj. Njësitë e repartet partizane i dallonte morali dhe disiplina e lartë. Ata përvetësuan taktikën e luftës partizane si taktikë sulmuese e jo vetëm mbrojtjeje pozicionale, zbatuan kërkesën e Shtabit të Përgjithshëm që të mos tërhiqeshin në drejtimin e mësymjes a të sulmit armik, por në rast mospërballimi, të shpërndaheshin në grupe më të vogla dhe duke shfrytëzuar natën e terrenin, t'i dilnin armikut në krah e në shpinë, siç u bë në operacionin e Dimrit dhe atë të Qershorit 1944, në të cilat forcat e shumta gjermane, xhandare, balliste, nuk arritën të asgjësonin Ushtrinë NÇ, siç shpresonin, përkundrazi, ajo doli edhe më e fortë. Dhe drejt fundit të Luftës njësitë e mëdha, divizionet e korparmatat ndërmorën edhe sulme frontale dhe bënë betejat të suksesshme që çuan në çlirimin e Shqipërisë më 29 nëntor 1944.

Përfundime

1. Shtabi i Përgjithshëm u zgjodh nga Këshilli ANÇ si një skuadër kolektive udhëheqëse, drejtuese e komanduese për të gjitha fuqitë e armatosura antifashiste, për të ngritur UNÇ dhe drejtuar Luftën Antifashiste. Nën udhëheqjen e tij u ngritën dhe luftuan 24 brigada sulmuese që hynë në përbërjen e tetë divizioneve dhe të tri korparmatave të Ushtrisë ANÇ.

2. Në mesin e vitit 1943, krijimin e Shtabit të Përgjithshëm e kërkonte edhe nevoja e bashkëpunimit me misionet aleate britanike që kishin arritur në

²⁰ Gazeta "Dita", Tiranë, 13.11.2016, artikulli i Fitim Çaushtit, ku jepet një letër e Mehmet Shehut drejtuar majorit sovjetik Ivanov: "Ky shtab nuk ka funksionuar kurrë... E në qoftë se veprimet tona kanë shkuar mirë gjithnjë, është meritë e komandave inferiore, të cilat fatmirësisht gjendeshin larg Shtabit të Përgjithshëm".

Shënim im: M. Shehu dhe të tjerë zbatonin urdhrat e Shtabit të Përgjithshëm dhe hynë më vonë edhe vetë në përbërje të tij. Në lidhje me ambiciet e Mehmet Shehut, i cili në Konferencën I të Partisë komuniste, mars 1943, bë kandidat i Komitetit Qendror të Partisë dhe në Kongresin e Përmetit nuk e mori gradën e gjeneralit. Por në të vërtetë, ai bashkë me tre batalione të Br.I Sulmuese, në mes të dimrit e të armiqve, sakrifikoi aq shumë për të shpëtuar pikërisht komandën e Shtabit të Përgjithshëm, të cilën atëherë e vlerësonte lart.

Shqipëri dhe që kërkonin një përfaqësues kombëtar ushtarak për bisedime e marrëveshje dhe ndihmë ushtarake. Në kërkesat që paraqiti Shtabi i Përgjithshëm kemi për herë të parë një projekt dhe një dokument strategjik me mundësitë e mobilizimit ushtarak në çdo krahinë dhe të nevojave për armatim e municion.

3. Për nevojat e tij të drejtimit, Shtabi zgjodhi komandën e tij, komandantin dhe komisarin. Gradualisht, komandanti dhe komisar i Shtabit të Përgjithshëm, përqendruan kompetenca, morën përgjegjësi në emër të Shtabit të Përgjithshëm, siç edhe u diktonte jeta e lufta dhe kjo çoi në një centralizim më të madh të drejtimit, në një komandë dyshe, komandant dhe komisar.

4. Me vendimin e Kongresit të Përmetit, 24-28 maj 1944, kalohet, në përputhje me situatat e reja, në një organizim të ri të një niveli më të lartë, me organizimin e Komandës së Përgjithshme dhe në postin e Komandantit të Përgjithshëm, nën vartësinë e të cilit do të ishte Shtabi i Përgjithshëm dhe gjithë Ushtria e rregullt Nacionalçlirimtare.

5. Edhe iniciativa dhe veprimet individuale, në udhëheqje të njësive partizane të anëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm në zonat ku ndodheshin, treguan vlerën e organizimit të Shtabit të Përgjithshëm jo vetëm si një komandë kolegjiale, por edhe si përgjegjësi personale, me kompetenca të plota në emër të Shtabit të Përgjithshëm. Ajo dëshmon njëkohësisht edhe disiplinën e lartë të Ushtrisë NÇ, që i zbatonte këto urdhra, pa diferencim.

6. Shtabi i Përgjithshëm ishte shtab udhëheqës që planifikoi, drejtoi dhe organizoi veprimtarinë strategjike të Ushtrisë NÇ e të Luftës. Ky rol nuk mund të zëvendësohej e aq më pak të mohohet.

7. Shtabi i Përgjithshëm e pajisi Ushtrinë NÇ me një art ushtarak original, të përshtatshëm për zhvillimin e Luftës Popullore, terrenin e vendit tonë dhe situatat e brendshme e të jashtme.

Bibliografia:

Arkivore:

Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi nr. 40 dhe 41.

Dokumentare:

1. Dokumente të Shtabit të Përgjithshëm e të Komandës së Përgjithshme të Ushtrisë Nacionalçlirimtare shqiptare. Shtëpia Botuese “8 nëntori”, Tiranë 1976, vëllimi I, ISBN, nuk ka.
2. PPSH. Dokumente kryesore, vëllimi i parë, Shtëpia Botuese “Naim

Frashëri”, Tiranë 1971. ISBN nuk ka.

Historiografike:

1. Historia e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të Popullit Shqiptar. Akademia e Shkencave, Shtypshkronja “8 nëntori”, Tiranë 1984, v. III dhe IV.
2. Historia e Popullit shqiptar; vëll. III, i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, “Toena”, botim i vitit 2002, ISBN 978-99943-1-296-6.
3. Fjalori Enciklopedik shqiptar. Botim i Akademisë së Shkencave të RSH, shtypshkronja Kristalina-KH. Tiranë, 2008, ISBN 978-99956-10-27-2.
4. Shpresë për popullin dhe tmerr për armikun. Mbi jetën dhe luftën e Brigadës së Parë Sulmuese të Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Tiranë, 1971. ISBN nuk ka.
5. Dedijer, Vladimir: Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave 1939-1948. Botues në shqip Alfred Ziu, Tiranë, Medaur, 2005.
6. Ficsher, J. Bernd: Shqipëria gjatë Luftës, 1939-1945, Tiranë, “Çabej” 2004.
7. Gjeçovi, Xhelal: Çështje të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 2014.
8. Hibbert, Reginald: Fitorja e Hidhur. Lufta Nacionalçlirimtare e Shqipërisë, Shtëpia Botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve. Tiranë, 1991; ISBN nuk ka.
9. Kasmi, Marenglen, Pushtimi gjerman i Shqipërisë: 1943-1944, Tiranë, “Filara”, 2013, ISBN 9789928142245.
10. Lalaj, Ana: Dosjet e Luftës; Botimet “Toena”; Tiranë 2014. ISBN 9789928425447.
11. Leka, Shahin “Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare (1943-45); Botim “Fillad”, Tiranë 1998. ISBN nuk ka.
12. Milo, Paskal: Udhëkryqe shqiptaro-gjermane. Botimet “Toena”, Tiranë, 2016. ISBN 9789928205711
13. Materiale nga interneti.

KUJTESË PËR BASHKËPUNËTORËT E REVISTËS USHTARAKE

Të nderuar bashkëpunëtorë të Revistës Ushtarake!

“Revista Ushtarake” është organ teoriko-shkencor i Akademisë së Forcave të Armatosura, në interes të FARSH. Misioni i saj është promovimi i vlerave kërkimore, i zhvillimeve të reja dhe i debatit shkencor në FA. Tematika e saj trajton çështje me karakter teoriko-shkencor e analitik, në ndihmë të veprimtarisë së FA-ve, duke ofruar zgjidhje për çështjet më të rëndësishme në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, në nivel strategjik, operacional dhe taktik, në vend, rajon e më gjerë.

Ftojme studentët/kursantët, akademistët e sistemit të kurseve të larta të AFA, instruktorët, pedagogët, punonjësit kërkimorë, komandantët, shefat dhe trajnuesit e të gjithë institucioneve e njësive të FARSH të bëhen pjesë e shkrimeve në RU.

Në vijim, po japim disa udhëzime e të dhëna teknike për strukturën e artikujve të Revistës Ushtarake, të cilat duhet të respektohen nga autorët e shkrimeve.

Struktura e artikullit

Titulli. Të jetë sintezë e problematikës që ai trajton, i organizuar në mënyrë koncize dhe të përmbledhur. Titulli të mos jetë më i gjatë se 35 karaktere dhe të jetë fjali emërore.

Autori, bashkautori. Poshtë titullit vendoset emri i autorit me titujt shkencorë përkatës dhe funksionin aktual i tij/saj.

Trajtesa e shkurtuar (Abstrakti). është një përmbledhje e shkurtër e artikullit. Ai tregon se për çfarë bëhet fjalë në një artikull, metodat që janë përdorur, rezultatet që janë fituar dhe çfarë impakti ka ky artikull. Mund të

themi se abstrakti shërben si reklamë e artikullit. Paraqitet në shqip dhe në versionin anglisht. Poshtë tij, gjenden fjalët kyçe, pra, fjalët më me rëndësi në artikull. Trajtesa nuk zëvendëson hyrjen e vetë artikullit. Ajo zë rreth 1/2 e faqes me rreth 3-4 paragrafë të shkurtër.

Përmbajtja ose pjesa kryesore e artikullit. Artikulli duhet të jetë i strukturuar gjithmonë me disa nënçështje, në varësi të tematikës që shtron. Nënçështja e parë e çdo artikulli duhet të jetë **“Hyrja”**, në të cilën të jepet qëllimi dhe objektivat që e kanë shtyrë autorin për të shkruar artikullin dhe rëndësia e botimit të tij, parë në këndvështrimin e interesave të FA. Shkruhet në gjuhën shqipe dhe duhet të jetë maksimumi 8-10 faqe kompjuterike.

Formati. Faqja duhet të jetë e formatit A4; lloji i shkrimit: “Times New Roman”; madhësia e shkrimit 12. Kryeradha (paragrafi i ri) përcaktohet me pt 6 (hapësira midis paragrafëve). Teksti duhet të ketë një strukturë me maksimumin 3 nivele çështjesh kryesore. Duhet të shmangen tekstet e theksuara (**bold**) apo shkronjat me ngjyra. Shkrimi i pjerrët (*italic*) dhe thonjëzat duhet të përdoren vetëm për citimet e burimeve të përdorura.

Grafikët, tabelat dhe fotot duhet të jenë të formatuara në grup, duke shmangur shpërbërjen e tyre. Nëse një foto ose grafik është marrë nga një burim tjetër, është e domosdoshme që të citohet burimi përkatës i tij.

Referencat dhe bibliografia. Çdo shkrim duhet të paraqitet me referenca (*footnote*), si dhe me bibliografinë përkatëse, e cila paraqet literaturën e shfrytëzuar. *Referencat* duhet të respektojnë në mënyrë korrekte rregullat kombëtare e ndërkombëtare. Në to duhet të përfshihen: mbiemri, emri (i autorit që i referohet), titulli i materialit të referimit, emri i entit botues, vendi i botimit, viti i botimit, numri i faqeve ku referohet, numri ISBN/ISSN, *website-in* ku ndodhet artikulli. (*p.sh. Smith, James, Siguria në shekullin e 21-të: Histori e panjohur. 2nd edition. New York, London: Oxford University Press, 2006. p..235, ISBN 0071448209, <http://www.iir.cz/display.asp?lng=uk&ida=>*).

Shënim!

1. Artikulli nuk duhet të përmbajë material të klasifikuar dhe duhet të zbatojë rregullat e klasifikimit të informacionit.
2. Artikulli nuk duhet të përmbajë ngjyime e as qëndrime politike apo partiake.
3. Artikulli duhet të dërgohet i printuar dhe në adresën elektronike të IKSHU (ikshu.afa@aaf.mil.al)
4. Vlerësimi dhe miratimi i shkrimeve për botim në Revistën Ushtarake bëhet vetëm nga Bordi Drejtues i RU.

Për çdo informacion të mëtejshëm, mund të kontaktoni në:

Adresa: Akademia e Forcave të Armatosura, (AFA)
Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak (IKSHU)
Grupi i Redaktimit dhe i Publikimit
Nr. Tel: 516 /1515
Adresa elektronike: ikshu.afa@aaf.mil.al
Rruga e Dibrës, Tiranë, Shqipëri

